Ky libër i politologut Fatmir Lekaj, me qartësinë e tij analitike, dokumentimin e pasur dhe referencat e verifikueshme, e paraqet Procesin e Helsinkit si dëshmi se idealet mund të shndërrohen në norma ndërkombëtare. Duke e përfshirë Kosovën në këtë rrëfim, libri na kujton se përpjekjet dhe sakrificat shumëdekadëshe të shqiptarëve për liri u sinkronizuan gjithnjë e më shumë me idealet për liri dhe paqe, të shndërruara në norma ndërkombëtare. Kjo çoi jo vetëm në çlirimin e Kosovës, por edhe në zgjerimin e këtyre normave përmes OSBE-së dhe NATO-s në Ballkan. Si i tillë, ky libër mbetet një kontribut i çmuar dhe reflektues në literaturën mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe, veçanërisht, historinë politike të Kosovës.

Prof. dr. Gazmend PULA,
*themelues dhe ish-kryetar i Komitetit Kosovar të Helsinkit*

ISBN 978-9951-994-06-4
9 789951 994064

VËSHTRIM MBI PROCESIN E HELSINKIT DHE DISA NGA ARRITJET E KOSOVËS NË KUADËR TË KËTIJ PROCESI

FATMIR LEKAJ

FATMIR LEKAJ

# VËSHTRIM MBI PROCESIN E HELSINKIT DHE DISA NGA ARRITJET E KOSOVËS NË KUADËR TË KËTIJ PROCESI

*në 50-vjetorin e Aktit Final të Helsinkit (1975-2025)*



**FATMIR LEKAJ**

# VËSHTRIM MBI PROCESIN E HELSINKIT DHE DISA NGA ARRITJET E KOSOVËS NË KUADËR TË KËTIJ PROCESI

*në 50-vjetorin e Aktit Final të Helsinkit (1975-2025)*

Autor:
FATMIR LEKAJ

Titulli:
VËSHTRIM MBI PROCESIN E HELSINKIT DHE DISA NGA ARRITJET E KOSOVËS NË KUADËR TË KËTIJ PROCESI
*në 50-vjetorin e Aktit Final të Helsinkit (1975-2025)*

Recensent:
PROF. DR. GAZMEND PULA

Redaktor:
BERAT ARMAGEDONI

Lektore:
KIMETE KASUMI

Faqosjen dhe kapakët:
LAURA SHULEMAJA

Botoi:
N. Sh. ARMAGEDONI
shbarmagedoni@gmail.com
+383 44 835 499

© *Të drejtat e botimit, autori.*

**FATMIR LEKAJ**

# VËSHTRIM MBI PROCESIN E HELSINKIT DHE DISA NGA ARRITJET E KOSOVËS NË KUADËR TË KËTIJ PROCESI

*në 50-vjetorin e Aktit Final të Helsinkit*
*(1975-2025)*

Prishtinë, 2025

*Ky libër u kushtohet të gjitha përpjekjeve për lirinë e Kosovës, duke përfshirë institucionalistët si Ukshin Hoti, i cili sakrifikoi çdo privilegj institucional në rrugën drejt realizimit të Republikës së Kosovës; akademikët si Fehmi Agani, që ndërtoi ura mirëkuptimi drejt këtij qëllimi të përbashkët; revolucionarët si dëshmori i parë në uniformën e UÇK-së, Adrian Krasniqi, dhe të gjithë dëshmorët para e pas tij, që dhanë jetën për të njëjtin qëllim; si dhe miqtë dhe organizatat ndërkombëtare që ndihmuan në rrugën drejt paqes së qëndrueshme në Kosovë.*

*Lavdi dhe nderime!*

## PËRMBAJTJA

RECENSION NGA PROF. DR. GAZMEND PULA, *f. 9*

REZYME E PROCESIT TË HELSINKIT, *f. 15*

PËRPJEKJET PËR AVANCIMIN POLITIKO-KULTUROR TË KOSOVËS DHE ARRITJA E NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PLOTË TË SAJ, *f. 29*

MISIONI I PARË FAKTMBLEDHËS NË KOSOVË, PARA SHEMBJES SË MURIT TË BERLINIT, *f. 53*

ORGANIZIMI I VIZITËS SË PARË TË DELEGACIONIT TË KOSOVËS NË KRYE ME IBRAHIM RUGOVËN NË PERËNDIM, PËRKATËSISHT NË OSLO DHE ME NISJE NGA OSLO, MË 14-18 SHKURT 1990, *f. 65*

ORGANIZIMI I VIZITËS SË PARË NË PERËNDIM TË DELEGACIONIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS, NË VIJIM TË DEKLARATËS KUSHTETUESE TË 2 KORRIKUT 1990, *f. 71*

INKURAJIMI DHE MBËSHTETJA E NGRITJES SË SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË, *f. 91*

INKURAJIMI DHE MBËSHTETJA E NGRITJES SË SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI, *f. 99*

KONTEKSTUALIZIMI I VDEKJES TRAGJIKE TË IDEALISTES DHE MIKES SË MADHE NORVEGJEZE TË SHQIPTARËVE, BERIT BACKER, *f. 109*

PRAPAVIJA DHE VAZHDIMËSIA E GRUPIT PËR KOSOVËN NË KUADËR TË KOMITETIT NORVEGJEZ TË HELSINKIT (GKKNH), *f. 139*

ARRITJA E VENDOSJES SË ÇËSHTJES SË KOSOVËS PËR ZGJIDHJE NË KUADËR TË AGJENDËS NDËRKOMBËTARE DHE RRUGA MË TEJ, *f. 198*

SHËNIME PËR AUTORIN, *f. 236*

BIBLIOGRAFIA, *f. 240*

## RECENSION

Libri *Procesi i Helsinkit dhe disa nga arritjet e Kosovës në kuadër të këtij procesi* trajton mënyrën se si ky proces ka ndikuar në marrëdhëniet ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe historinë politike të Kosovës.

Në qendër të tij qëndron analiza e Procesit të Helsinkit, i konsoliduar përmes Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE), e konceptuar si arenë dialogu midis Lindjes dhe Perëndimit dhe e mbështetur në Aktin Final të Helsinkit (1975). Ky akt, i nënshkruar nga pothuajse të gjitha shtetet evropiane së bashku me ShBA-në dhe Kanadanë, u afirmua si një instrument politik dhe moral me ndikim afatgjatë, duke sjellë një risi thelbësore: përfshirjen për herë të parë të të drejtave të njeriut si parim i veçantë në marrëdhëniet ndërshtetërore. Kjo risi e shndërroi KSBE-në në forumin e parë rajonal ku mund të diskutohej hapur edhe statusi i të drejtave të njeriut. Konkretisht, shtetet anëtare të KSBE-së, si nënshkruese të Aktit Final të Helsinkit, edhe pse nuk u ngarkuan me obligim juridik, u angazhuan politikisht dhe moralisht të mbajnë përgjegjësi për zbatimin e parimeve themelore të këtij akti, ndër të cilat një vend të veçantë zinte parimi i të drejtave të njeriut. Kjo nënkuptonte jo vetëm përballjen me kritika për shkeljet e mundshme, por edhe faktin që gjendja e të drejtave të njeriut në vendet e tyre të bëhej objekt diskutimi në nivele të ndryshme politike. Si rrjedhojë, çështja e të drejtave të njeriut dominoi vazhdimisht diskursin midis shteteve anëtare të KSBE-së gjatë Procesit të Helsinkit. Vendet perëndimore kritikonin vendet lindore për shkelje

të të drejtave politike dhe civile, ndërsa këto të fundit e refuzonin kritikën duke iu referuar parimit tjetër të aktit - mosndërhyrjes në punët e brendshme. Në të njëjtën kohë ato akuzonin Perëndimin për shkelje të të drejtave ekonomike dhe sociale. Ky diskurs brenda KSBE-së kontribuoi gjithashtu në forcimin e unitetit të shteteve perëndimore në kuadër të forumit dhe ushtroi një ndikim të rëndësishëm në thellimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare të NATO-s dhe të bashkësisë politike evropiane.

Një tjetër aspekt me rëndësi që thekson ky libër është struktura organizative më pak burokratike e KSBE-së, krahasuar me atë të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara. Kjo strukturë hapi mundësi të reja për ndikimin nga poshtë-lart, përmes veprimtarisë civile në fushën e të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar, e njohur si Lëvizja e Helsinkit. Në këtë kuadër, formimi i grupeve të Helsinkit në Lindje dhe në Perëndim, si dhe rrjetëzimi i tyre transnacional, tregojnë se Procesi i Helsinkit nuk kufizohej vetëm në nivelin ndërshtetëror përmes delegacioneve shtetërore, por zhvillohej paralelisht edhe në një dimension transnacional civil. Ky dimension lidhej si me përpjekjet e aktivistëve në vendet totalitare e autoritare, të cilët kërkonin respektimin e parimit të të drejtave të njeriut të sanksionuar në Aktin Final të Helsinkit, ashtu edhe me mbështetjen që ata gjetën te aktivistët perëndimorë. Shembuj tipikë të kësaj veprimtarie janë Grupi i Helsinkit në Moskë, Solidarnost në Poloni dhe Charta 77 në Çekosllovaki. Njëkohësisht, mbështetja nga komitetet e para të Helsinkit në Perëndim - si Helsinki Human Rights Watch në

ShBA, Komiteti Norvegjez i Helsinkit dhe komitete të tjera simotra - çoi në themelimin e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, e cila forcoi më tej dimensionin e solidaritetit transnacional civil të këtij procesi. Ky dualitet - ndërshtetëror dhe civil - e shndërroi Procesin e Helsinkit në një nga zhvillimet më të rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare, duke ushtruar ndikim të gjerë mbi Luftën e Ftohtë dhe raportet ShBA -Bashkimi Sovjetik. Ky proces, gjithashtu, pati një rol nxitës në politikën reformiste të Mikhail Gorbaçovit, e cila ishte vendimtare që regjimet totalitare dhe autoritare të fillonin të hapeshin ndaj parimit të Aktit Final të Helsinkit për të drejtat e njeriut dhe ndaj ndryshimeve paqësore në Evropën Lindore, duke përshpejtuar përfundimin e Luftës së Ftohtë.

Në thelb, ky libër paraqet një studim me rëndësi të veçantë mbi Procesin e Helsinkit, i trajtuar si një pikë kthese në historinë politike evropiane, që solli një transformim rrënjësor politiko-demokratik jo vetëm në Evropë, por edhe më gjerë, me efekte dhe përfitime të jashtëzakonshme për popullin shqiptar.

Për më tepër, ky libër dëshmon gjithashtu se shqiptarët, në bashkëpunim me miq ndërkombëtarë, arritën ta ndërkombëtarizojnë çështjen e Kosovës në kuadër të këtij procesi historik, edhe pse në atë periudhë as Shqipëria - shteti amë - nuk ishte anëtare formale e KSBE-së. Trashëgimia e këtij procesi, edhe pas institucionalizimit të KSBE-së në vitin 1995 si Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), mbeti me ndikim të rëndësishëm. Në këtë kuadër, Procesi i Helsinkit duhet parë si pjesë e dinamikës dhe e vazhdimësisë së

Luftës së Ftohtë, i cili nga njëra anë kontribuoi në zvogëlimin e rëndësisë absolute të parimit vestfalian të mosndërhyrjes - i konsoliduar me Traktatin e Vestfalisë (1648) - dhe në afirmimin e të drejtave të njeriut si standard ndërkombëtar. Kjo nënkuptonte që shkeljet e të drejtave themelore nuk duhej më të trajtoheshin thjesht si çështje të brendshme, por legjitimonin reagimin ndërkombëtar, sidomos në rastet kur regjimet shtetërore shkelin të drejtat bazike të qytetarëve dhe shkaktojnë kriza humanitare. Nga ana tjetër, ky proces kontribuoi në konsolidimin e politikave evropiane të sigurisë dhe paqes përmes NATO-s. Në këtë vazhdë, autori, në konkluzionet e librit, potencon rëndësinë e dy aspekteve - atij të sigurisë dhe atij humanitar - të cilët u shfaqën si vazhdimësi e drejtpërdrejtë e Procesit të Helsinkit pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe u konkretizuan edhe në rastin e Kosovës. Përpjekjet legjitime dhe komplementare të shqiptarëve të Kosovës për liri - përmes rezistencës me mjete paqësore dhe asaj të armatosur - të kombinuara me gjendjen e rëndë humanitare në terren, u pasqyruan në raportet dhe misionet monitoruese të OSBE-së, duke krijuar bazën normative dhe legjitimimin ndërkombëtar për ndërhyrjen ajrore të NATO-s, e cila çoi në çlirimin përfundimtar të Kosovës.

Rrjedhimisht, ky libër i politologut Fatmir Lekaj, me qartësinë e tij analitike, dokumentimin e pasur dhe referencat e verifikueshme, e paraqet Procesin e Helsinkit si dëshmi se idealet mund të shndërrohen në norma ndërkombëtare. Duke e përfshirë Kosovën në këtë rrëfim, libri na kujton se përpjekjet dhe sakrificat shumëdekadëshe të shqiptarëve për liri u sinkronizuan gjithnjë e më shumë me idealet për liri dhe paqe, të

shndërruara në norma ndërkombëtare. Kjo çoi jo vetëm në çlirimin e Kosovës, por edhe në zgjerimin e këtyre normave përmes OSBE-së dhe NATO-s në Ballkan. Si i tillë, ky libër mbetet një kontribut i çmuar dhe reflektues në literaturën mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe, veçanërisht, historinë politike të Kosovës.

*Prof. dr. Gazmend PULA,*
*themelues dhe ish-kryetar i*
*Komitetit Kosovar të Helsinkit*

## REZYME E PROCESIT TË HELSINKIT



Pikënisje për Procesin e Helsinkit ishte Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE), në kuptimin e një arene të konferencave ndërkombëtare në mes të Lindjes dhe Perëndimit, e bazuar në Aktin Final të Helsinkit të datës 1 gusht 1975. Në fakt, si ide u iniciua në vitin 1954 nga Bashkimi Sovjetik, përkatësisht nga ministri i Jashtëm Vjatsjeslav Molotov, i cili lansoi propozimin për një konferencë të sigurisë në mes të Lindjes dhe Perëndimit, ku parashihej që ShBA-ja të ketë vetëm një status të observatores. Ky propozim u refuzua nga Perëndimi, madje shtetet e fuqishme perëndimore e cilësuan këtë propozim si një tentim të Bashkimit Sovjetik për ta parandaluar/penguar riarmatimin në Gjermaninë Perëndimore dhe t'i dobësojë marrëdhëniet në mes të Evropës dhe të ShBA-së.[1] Po ashtu, Leonid Bresjnev, gjatë Kongresit të partisë në vitin 1966, u bëri thirrje shteteve evropiane për t'i trajtuar dhe zgjedhur bashkërisht çështjet e sigurisë

[1] Mevik, 1990: 31

politiko-ushtarake.[2] Kështututje, kjo çështje u trajtua më shumë edhe nëpërmes Deklaratës së Bukureshtit të vitit 1966, Apelit të Budapestit të vitit 1969 etj., ku u përfshinë temat konkrete se me çfarë do të mund të merrej një konferencë e tillë.[3] Në këtë vazhdë shtetet perëndimore evropiane ishin më të hapura për një konferencë të mundshme të sigurisë, ndërsa presidenti amerikan Richard Nixon dhe ministri i Jashtëm Henry Kissinger ishin skeptikë ndaj iniciativës së Bashkimit Sovjetik, sepse konsideronin se pozicioni udhëheqës i ShBA-së në NATO dhe në bisedimet bilaterale me Bashkimin Sovjetik mund të dobësohej po qe se ShBA-ja bëhej pjesë e një dialogu multilateral për çështjet e sigurisë politiko-ushtarake.[4]

Pas shumë peripecive dhe iniciativave u miratua Akti Final i Helsinkit gjatë Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE) në Helsinki të Finlandës më 1 gusht 1975. Kjo u bë e mundshme, përveç të tjerash, pasi që u arrit që ShBA-ja dhe Kanadaja ta kenë statusin e pjesëtarit të barabartë me shtetet evropiane në kuadër të KSBE-së. Në fakt, kjo nënkupton bumerangun e parë ndaj Bashkimit Sovjetik nga Shtetet Perëndimore ngaqë plani paraprak i Bashkimit Sovjetik ishte që ShBA-ja të ketë vetëm një status të observatores. Megjithëkëtë, Bashkimi Sovjetik, duke e pasur si agjendë pengimin e bashkimit të gjermanëve, insistoi që edhe nëpërmes Procesit të Helsinkit të sigurohen kufijtë

[2] Fry, 2003: 4
[3] Freeman, 1991: 39 - 41, 46
[4] Thomas, 2001: 36

shtetërorë të pas Luftës së Dytë Botërore, njëherësh e arriti pajtueshmërinë e të tjerëve që edhe Gjermania Lindore ta ketë statusin e pjesëtares së barabartë në kuadër të KSBE-së.

Akti Final i Helsinkit, i njohur edhe si Deklarata e Helsinkit (1975) që, përveç Shqipërisë, u nënshkrua nga të gjitha shtetet evropiane, ShBA-ja dhe Kanadaja, nuk ishte juridikisht e detyrueshme, por duke e marrë parasysh se pas shumë peripecive ishte një rezultat i suksesshëm i një konsensusi, kryesisht mes dy superfuqive të kohës (ShBA-së dhe Bashkimit Sovjetik), konsiderohej politikisht dhe moralisht e detyrueshme. Për këtë arsye, KSBE-ja u bë forumi i parë rajonal në të cilin vendet pjesëmarrëse, përfshirë Kanadanë dhe Shtetet e Bashkuara, mund ta diskutonin statusin e të drejtave të njeriut dhe të merrnin kritika për shkeljet e tyre. Kjo solli një risi në kontekstin evropian, ngaqë për herë të parë, të drejtat e njeriut u përfshinë si një parim i veçantë në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe, kësisoj, vendet anëtare të KSBE-së ranë dakord që situata e të drejtave të njeriut në vendet e tyre mund të trajtohej në nivele të ndryshme politike.[5] Njëherësh, vlen të theksohet se KSBE-ja ka luajtur rol kyç në konsolidimin e mëtejshëm të NATO-s dhe Bashkësisë politike Evro-piane, ngaqë vendet anëtare të NATO-s, që ishin gjith-ashtu pjesë e KSBE-së, vepruan si një grup që nga fillimi, duke konsoliduar qëndrimet e tyre përpara dhe gjatë konferencave të KSBE-së. Në fakt, me nismën e Gjermanisë Perëndimore gjatë takimeve të KSBE-së në Madrid

[5] Kleva, 2007: 36

(1980-1983), u krijua i ashtuquajturi "Lunch Club", me përfaqësues nga Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Gjermania Perëndimore, Franca, Norvegjia dhe Holanda, të cilët takoheshin rregullisht për të trajtuar çështje të ndryshme që rezultonin nga diskutimet dhe negociatat në kuadër të KSBE-së.[6] Më vonë, me nismën e Norvegjisë, këtij klubi iu bashkua edhe Kanadaja.[7] Për më tepër, shtetet anëtare të Bashkësisë politike Evropiane zhvilluan profilin e tyre politik duke shfaqur aftësinë për t'i koordinuar qëndrimet e tyre për çështjet ndërkombëtare nëpërmjet KSBE-së, dhe kjo kontribuoi në synimin e Bashkësisë politike Evropiane për t'u forcuar politikisht gjithnjë e më shumë.[8]

KSBE u shpërfaq strukturalisht ndryshe (më pak e burokratizuar) krahasuar me Këshillin e Evropës (KE) dhe Kombet e Bashkuara (KB). Një ndër arsyet kryesore për këtë ishte se KSBE u zhvillua si një proces i vazhdueshëm dhe arenë e dialogut ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit përmes takimeve vijuese të shteteve pjesëmarrëse dhe takimeve të ekspertëve, i njohur si Procesi i Helsinkit. Në periudhën deri në vitin 1989 mbledhjet e KSBE-së (me takimet pasuese) u mbajtën në Beograd (1976-'77), Madrid (1980-'83) dhe në Vjenë (1986-'89). Në vazhdimësi, në kuadër të Procesit të Helsinkit, kritika kryesore e shteteve perëndimore ndaj shteteve të lindjes ishte në lidhje me shkeljen e të drejtave të njeriut.[9] Dhe, edhe pse autoritetet sovjetike

---

[6] Po aty: 24-25, 113
[7] Po aty: 25
[8] Po aty: 25
[9] Po aty: 66

vazhduan ta shtypnin popullsinë dhe situata mund të dukej e pashpresë për veprimtarët e drejtave të njeriut, megjithëkëtë roli i OJQ-ve (Grupeve të Helsinkit) u bë gradualisht qendror në zhvillimin e Procesit të Helsinkit.[10]

Në fakt, kur filloi Konferenca e Vjenës në vitin 1986, Andrej Sakharov ishte ende në "ekzilin e brendshëm" dhe shumica e aktivistëve të të drejtave të njeriut në Bashkimin Sovjetik ose u internuan ose u persekutuan nëpërmes metodave të tjera shtetërore.[11] Anatoly Marchenko, disident dhe një nga themeluesit e Grupit të Helsinkit të Moskës, arriti fshehurazi t'u dërgojë një apel delegacioneve të KSBE-së në takimin e Vjenës, në të cilin ai kërkoi mbështetje për t'u përmirësuar kushtet e dënimit në Bashkimin Sovjetik. Ndër të tjera, nëpërmes apelit ai kërkonte ushqim më shpesh se çdo të dytën ditë. Marchenko vdiq në burg më 6 dhjetor 1986, pasi kishte kaluar gjithsej rreth 20 vjet në burgjet sovjetike, kampet e punës dhe në internim. Vdekja u shënua me një minutë heshtje e iniciuar nga kreu i delegacionit amerikan të KSBE-së, Warren Zimmermann, që rezultoi me largimin e delegacionit sovjetik të KSBE-së nga takimi, së bashku me delegacionin nga Bullgaria, nga Gjermania Lindore dhe nga Çekosllovakia. Ndërsa delegacioni nga Hungaria nuk veproi njëjtë në këtë takim, gjë që simbolizon edhe krisjen e parë të kohezionit të Traktatit të Varshavës.[12] Të njëjtin vit (1986), me presionin

---

[10] Freire, 2003: 71-72

[11] "Andrej Dmitrijevitsj Sakharov," *Store norske leksikon,* http://snl.no /Andrej_Dmitrijevitsj_Sakharov.

[12] C. Van Esterik and H. Minnema 1991: 2-7

e Perëndimit, u lirua Andrej Sakharov dhe, në këtë vazhdë, gjatë procesit të mbledhjeve të rregullta të KSBE-së, në Vjenë, në vitet 1986-’89, u vendosën edhe parimet e KSBE-së për pjesëmarrje më aktive në proces të organizatave joqeveritare (Komiteteve të Helsinkit).

Me fjalë të tjera, në mesin e dhjetë parimeve të Deklaratës së Helsinkit, ishte i përfshirë edhe parimi për të drejtat e njeriut, dhe gjatë gjithë Procesit të Helsinkit (nga viti 1975) ndikoi për inkurajimin dhe angazhimin e veprimtarisë vullnetare ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti nëpërmes etablimit të Grupeve të Helsinkit të mirënjohur më pastaj ndërkombëtarisht si Komitetet e Helsinkit, në kuadër të të ashtuquajturit Procesi Civil i Helsinkit, i cilësuar edhe si Lëvizja e Helsinkit. Në këtë mënyrë, në kuadër të Procesit të Helsinkit, rezultoi një bumerang i dytë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe shteteve të tjera totalitare dhe autoritare, ngaqë grupi i parë i Helsinkit, i njohur edhe si Moscow Helsinki Watch Group, u themelua në Moskë, në banesën e Andrej Sakharovit në vitin 1976 (në krye me Yuri Orlov etj.), me qëllim që ta monitorojë respektimin e parimit të Deklaratës së Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Kjo ndikoi që të njëjtin vit të themelohen dy Grupe të Helsinkit në Lituani dhe Ukrainë. Gjithashtu, të njëjtin vit në Poloni u formua Komiteti për Mbrojtjen e Punëtorëve (KOR) dhe në vitin 1977 Lëvizja për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe të Drejtave Qytetare (ROPCiO). Ky komitet dhe kjo lëvizje në Poloni gradualisht rezultuan në aleancën në mes të punëtorëve, intelektualëve dhe kishës dhe themeluan Solidarnostin në

vitin 1980 dhe Komitetin Polak të Helsinkit në vitin 1982. Gjithashtu, në vitin 1977 u themelua Charta 77 në Çekosllovaki, në krye me Vaclav Havelin etj., të cilët kishin krijuar kontakte me strukturat e KSBE-së. Në Rumani dhe Bullgari pati ca zëra kundërshtues kundër regjimeve që u dëgjuan në vitet e para të fillesës së Procesit të Helsinkit, por lëvizjet kundërshtuese kundër regjimeve dolën në sipërfaqe vetëm në fundvitet 1980 - dhjetë.

Autoritetet shtetërore sovjetike, çekosllovake dhe polake iu përgjigjën me represion aktivistëve për të drejtat e njeriut. Në veçanti autoritetet shtetërore sovjetike iu përgjigjën me represion të ashpër pjesëtarëve të Grupit të Helsinkit në Moskë, me arrestime, burgosje dhe internime të brendshme. Kjo shkaktoi indinjatë të thellë te shtetet anëtare të KSBE-së dhe rezultoi edhe me themelimin e Grupeve të Helsinkit në shtetet perëndimore, që si qëllim parësor kishin mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shtetet lindore. Me këtë qëllim, në vitin 1978 u formalizua themelimi i Grupit të Helsinkit në ShBA, i njohur si Helsinki Human Rights Watch (e nga viti 1988 i njohur si Human Rights Watch) dhe, për shkak të reputacionit si informator i mirë në lidhje me çështjen e të drejtave të njeriut, e ka pasur në vazhdimësi një ndikim të rëndësishëm këshillues në politikën e jashtme amerikane (delegacionet amerikane të KSBE-së) në kuadër të Procesit të Helsinkit. Gjithashtu, në kontekstin evropian, Grupi i Helsinkit në Norvegji, i njohur si Komiteti Norvegjez i Helsinkit, u themelua shumë herët, përkatësisht në vitin 1977. Në këtë vazhdë,

bazuar në një apel të Andrej Sakharov, Komitetet e Helsinkit në Shtetet Perëndimore, në kuadër të Procesit Civil të Helsinkit, e themeluan Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit në vitin 1982, me qëllimin, përveç qëllimeve të tjera, të forcohet dhe bashkërendohet edhe më shumë veprimtaria ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të inkurajohen forcat opozitare në Lindje. Gjithashtu, politika reformiste e Mikhail Gorbatsjovit ka qenë vendimtare që sistemet totalitare dhe autoritare të fillojnë të hapen ndaj parimit të Deklaratës së Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Rrjedhimisht Procesi i Helsinkit u zhvillua në dy nivele, përkatësisht si Proces Ndërshtetëror i Helsinkit (nëpërmes delegacioneve ndërshtetërore në kuadrin e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian - KSBE-së etj.), dhe si Proces Civil Ndërkombëtar i Helsinkit (nëpërmes Komiteteve Kombëtare të Helsinkit në kuadrin e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit - FNH-së etj.).

Vonesa e themelimit të Grupit të Helsinkit (Komitetit të Helsinkit) në Finlandë (1985) është e kuptueshme, e lidhur me linjën përgjithësisht të kujdesshme të politikës së jashtme finlandeze ndaj Bashkimit Sovjetik. Por, çuditërisht, edhe në Suedi dhe Danimarkë, Grupet e Helsinkit (Komitetet e Helsinkit) u themeluan më vonë, përkatësisht në vitin 1982 dhe 1985. Ndërsa themelimi i Komitetit Norvegjez të Helsinkit që në vitin 1977 mund të shpjegohet vetëm përmes gatishmërisë së madhe të Norvegjisë për t'u angazhuar në shërbim të paqes botërore dhe respektimit të të drejtave të njeriut, në përputhje me traditën humanitare të humanistit, diplomatit dhe shkencëtarit të njohur norvegjez Fridtjof Nansen.

Njëkohësisht, kjo ka të bëjë edhe me kontekstin politik të shteteve nordike pas Luftës së Dytë Botërore. Ngase Finlanda u kushtëzua nga marrëveshja me Bashkimin Sovjetik, kjo marrëveshje, ndër të tjera, e obligonte atë që në praktikë t'i mbështeste qëndrimet sovjetike në kuadër të Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, pavarësisht prej këtyre kufizimeve, marrëveshja i mundësoi Finlandës ta ruante pavarësinë e saj shtetërore dhe ta shmangte okupimin sovjetik. Madje në këtë mënyrë (në mënyrë të heshtur) u kushtëzua nga Bashkimi Sovjetik edhe politika e jashtme suedeze, pos të tjerash, për shkak se në Finlandë banonte një popullatë e konsiderueshme suedeze, në veçanti për shkak të influencës historiko-politike të Suedisë në Finlandë. Neutraliteti i politikës së jashtme në Suedi që u riformulua pas Luftës së Dytë Botërore ishte strategji e mençur dhe e rëndësishme si për Finlandën ashtu edhe për Suedinë, sepse kështu forcohej besueshmëria edhe në praktikë në relacion me Bashkimin Sovjetik, në kuptimin se: neutraliteti i Suedisë në mënyrë të heshtur e bënte më të besueshëm në praktikë relacionin e Finlandës ndaj Bashkimit Sovjetik. Përndryshe, një politikë e jashtme suedeze, e zhbalancuar, rrezikonte ta shkaktojë invazionin e Bashkimit Sovjetik në Finlandë, në Suedi dhe më gjerë në shtetet nordike. Për dallim nga Finlanda dhe për dallim nga Suedia, Danimarka nuk ka qenë e predispozuar nga një presion ekuivalent nga Bashkimi Sovjetik. Por politika e jashtme në Danimarkë pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë më shumë e kushtëzuar nga fragmentimi parlamentar, sepse në nivelin skandinav parlamenti danez e

ka një traditë më të theksuar të konfliktit rreth politikës së jashtme. Qeveritë daneze si rezultat i fragmentimit parlamentar në lidhje me politikën e jashtme, një periudhë të gjatë janë detyruar të bëjnë rezervime të caktuara në relacion me politikat e NATO-s dhe ShBA-së, sepse jo vetëm krahu i majtë politik, por edhe liberalët në mënyrë kontinuale i kanë detyruar qeveritë daneze së paku të mos pajtohen në disa pika me linjën politike të NATO-s. Ndërsa Norvegjia (përkundër edhe presionit deri në një masë nga Bashkimi Sovjetik) pas Luftës së Dytë Botërore u bë kampione e shteteve nordike në politiken e jashtme në relacionin me NATO-n, ShBA-në dhe me struktura të tjera në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare si KSBE etj.

Gjithashtu vlen të përmendet, siç edhe e potencon historiania norvegjeze Ingrid Olstad Busterud, se në politikën e jashtme norvegjeze që herët është formësuar ideja se shtetet e vogla si Norvegjia mund të luanin role të rëndësishme në promovimin e paqes dhe të drejtave të njeriut në mbarë botën. Përkatësisht duke e mbajtur të qartë bindjen se Norvegjia mund të vepronte si një kampion moral dhe humanitar dhe se Norvegjia kishte një mision për të kryer në shërbim të zhvillimit botëror. Rrjedhimisht kjo dëshirë për të qenë një fuqi e madhe morale u bë gjithnjë e më e fortë, dhe pavarësisht prej ndryshimeve të qeverive, ekzistonte një pajtim i gjerë ndërpartiak se Norvegjia kishte burimet dhe traditat e nevojshme për të arritur ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare.[13] Për më tepër, Leif Mevik, i cili

[13] Busterud, 2010: 2-3

kryesoi delegacionin norvegjez në KSBE për gati 20 vjet radhazi dhe më vonë shërbeu si ambasador i Norvegjisë në NATO deri më 1998, e ka trajtuar këtë perspektivë në librin e tij "Siguria në bashkëpunim: vijat kryesore të politikës norvegjeze ndaj KSBE-së". Ai përveç të tjerash shkruan se: *"Tradita e Nansenit në politikën e jashtme norvegjeze është, pa dyshim, një nga arsyet kryesore për përqendrimin e Norvegjisë në çështjet humanitare të KSBE-së".*[14]

Me fjalë të tjera, Norvegjia, si në kuadër të Procesit Ndërshtetëror të Helsinkit (përmes delegacionit shtetëror norvegjez në KSBE), ashtu edhe në mënyrë të veçantë në kuadër të Procesit Civil Ndërkombëtar të Helsinkit (përmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit në ndërlidhje me Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit), ka dhënë kontribut të çmuar për Procesin e Helsinkit si tërësi. Madje kjo ndihmon të shpjegohet se përse Grupi për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) ka pasur një ndikim të rëndësishëm dhe të drejtpërdrejtë në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës në kuadër të Procesit të Helsinkit - veçanërisht me ndihmën e idealistëve dhe miqve të mëdhenj të Kosovës, Berit Backer, Kristoffer Gjøtterud (ish-bashkëpunëtor i Andrei Sakharovit) etj.

Në përgjithësi, Procesi i Helsinkit duhet parë si pjesë e Luftës së Ftohtë, duke kontribuar në zvogëlimin e rëndësisë së parimit vestfalian të mosndërhyrjes, për sa i përket çështjes së të drejtave të njeriut dhe marrëdhënieve ndërmjet shteteve evropiane. Kjo nuk do të thotë

[14] Mevik, 1992: 106

se ky parim që rregullon marrëdhëniet ndërshtetërore u shfuqizua apo u zhduk, por rëndësia e tij u zvogëlua për aq sa lidhet me të drejtat e njeriut. Me fjalë të tjera, Procesi i Helsinkit pati pasoja të paparashikuara, të cilat kontribuuan në zbehjen e parimit të mosndërhyrjes, pasi palët mund t'i monitoronin politikat e njëra-tjetrës në fusha të ndryshme, t'i evidentonin shkeljet e marrëveshjeve të përbashkëta dhe, kur ishte e nevojshme, të kërkonin ndërhyrjen nga institucione të caktuara.[15] Si rrjedhojë, KSBE-ja, si një arenë për konferenca ndërkombëtare të bazuara në Aktin Final të Helsinkit, kontribuoi në zbutjen dhe përmirësimin e marrëdhënieve midis Lindjes dhe Perëndimit, pavarësisht prej mosmarrëveshjeve midis vendeve anëtare. Dhe shënoi posaçërisht fillimin e një etape të rëndësishme në marrëdhëniet ndërkombëtare, i njohur si Procesi i Helsinkit, me synimin e formimit të një Evrope të re dhe një rendi të ri botëror.

Pas 20 vjetësh në rolin e një arene për konferenca ndërkombëtare, KSBE-ja u institucionalizua në vitin 1995 si Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Në të njëjtin vit, shtetet anëtare të OSBE-së nënshkruan të ashtuquajturin Pakti për Stabilitet në Evropë. Qëllimi i tyre ishte të krijonin një zgjidhje paqësore për të gjitha mosmarrëveshjet që lidhen me çështjet e kufijve dhe pakicave kombëtare. Në këtë kontekst, për operacionet e saj paqeruajtëse, OSBE-ja mund të kërkonte mbështetje ushtarake nga NATO ose BE[16], siç edhe ndodhi me rastin e Kosovës. Ku edhe fatmirësisht

---

[15] Stykket, 2010: 12, 149.
[16] "OSSE," *Store norske leksikon,* https://snl.no/OSSE

ndodhi që Norvegjia si shteti me pothuajse ekspertizën dhe përkushtimin më të fortë në kuadër të Procesit të Helsinkit të jetë edhe shtet udhëheqës i OSBE-së gjatë periudhës së luftës në Kosovë.

Rrjedhimisht, të dy aspektet - ai i sigurisë dhe ai humanitar (si faktor kryesorë për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë) duhet të shihen si vazhdimësi e Procesit të Helsinkit pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Në kuptimin e konsolidimit të fuqishëm të politikave evropiane të sigurisë dhe paqes përmes NATO-s, ku parimi i të drejtave të njeriut vendoset mbi parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve, në rastet kur regjimet shtetërore shkelin të drejtat themelore të qytetarëve të tyre dhe krijojnë një krizë serioze humanitare. Në lidhje me këtë aspekt humanitar, ia vlen të citohet një nga aktivistët më të rëndësishëm për të drejtat e njeriut në kuadër të Procesit Civil Ndërkombëtar të Helsinkit, Václav Havel, nga intervista e tij për gazetën franceze Le Monde, më 29 prill 1999, ku shprehet: *"Konsideroj se ndërhyrja e NATO-s ka një gjë që askush nuk mund ta kundërshtojë: sulmet dhe bombat nuk janë të nxitura nga ndonjë interes material. Karakteri i tyre është ekskluzivisht humanitar. Këtu kemi të bëjmë me të drejtat e njeriut, që janë prioritet. Dhe këto të drejta qëndrojnë më lart se sovraniteti i shteteve. Ja çka e bën të ligjshëm sulmin kundër Federatës Jugosllave, edhe pse nuk e ka mandatin e Kombeve të Bashkuara."*[17] Prandaj,

---

[17] Vaclav Havel, intervistë për gazetën franceze *Le Monde,* 29 prill 1999: "Moi aussi je me sens albanais," https://www.lemonde.fr/.../moi-aussi-je-me-

çlirimi dhe liria e Kosovës duhet të shihen gjithashtu si një fitore e parimit të të drejtave të njeriut të Deklaratës së Helsinkit (1975), në kuadër dhe në vazhdimësi të Procesit të Helsinkit.

Në vijim është fragmenti nga një pjesë e intervistës së cituar të Havelit, ku ai shprehet edhe me fjalët "Moi aussi je me sens albanais" ("Edhe unë gjithashtu ndihem shqiptar"), duke shprehur kështu solidaritetin e tij të fortë me viktimat e dhunës së regjimit të Miloševićit në Kosovë.


Le Monde

S'abonner

ARCHIVES

Moi aussi je me sens albanais

Par PAR VACLAV HAVEL
Publié le 29 avril 1999 à 00h00, modifié le 29 avril 1999 à 00h00 · Lecture 4 min.

Lire dans l'application

Article réservé aux abonnés

DANS l'intervention de l'OTAN au Kosovo, je pense qu'il y a un élément que nul ne peut contester : les raids, les bombes, ne sont pas provoqués par un intérêt matériel. Leur caractère est exclusivement humanitaire : ce qui est en jeu ici, ce sont les principes, les droits de l'homme auxquels est accordée une priorité qui passe même avant la souveraineté des Etats. Voilà ce qui rend légitime d'attaquer la Fédération yougoslave, même sans le mandat des Nations unies. Mais, en m'appuyant sur

sens-albanais…; shih edhe *Libquotes,* Václav Havel Quote, https:// libquotes.com/václav-havel/quote/lbz0b6j.

## PËRPJEKJET PËR AVANCIMIN POLITIKO-KULTUROR TË KOSOVËS DHE ARRITJA E NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PLOTË TË SAJ

Në kontekstin e Jugosllavisë, rezistenca ndaj hegjemonisë së regjimit autoritar u manifestua me intensitet më të madh në Kosovë dhe Kroaci. Në rastin e Kosovës, përpjekjet për avancimin politiko-kulturor pas Luftës së Dytë Botërore u artikuluan kryesisht përmes ndikimit të tri rrymave politike: institucionalistëve, revolucionarëve dhe akademikëve.

***Institucionalistët*** identifikohen me udhëheqjen e institucioneve politike të vendit, e cila u zhvillua fillimisht përmes Partisë Komuniste të Kosovës – e njohur më vonë me emrin Lidhja Komuniste e Kosovës (LKK) – dhe më pas përmes institucioneve kryesore të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Kuvendit të Krahinës, Kryesisë së Krahinës, Këshillit të Krahinës, Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Krahinës etj. Disa nga këta udhëheqës institucionalistë, duke qenë të fokusuar kryesisht në sigurimin dhe konsolidimin e karrierës personale brenda strukturave udhëheqëse krahinore dhe atyre federative jugosllave, nuk dhanë ndonjë kontribut për perspektivën politike të Kosovës. Ndërsa, një pjesë tjetër e konsiderueshme e udhëheqësve institucionalistë – ndër ta Fadil Hoxha, Imer Pula, Veli Deva, Xhavit Nimani, Rezak Shala, Iljaz Kurteshi, Rexhai Surroi, Mahmut Bakalli e të tjerë –përveç të tjerash, luajtën një rol të rëndësishëm në proceset reformuese që nisën në Jugosllavi pas vitit 1966.[18]

[18] Lekaj, 2021: 127

Këto reforma politike u shënuan nga Plenumi i Brioneve (1966), i cili solli rrëzimin e Aleksandar Rankovićit, nënkryetar i Jugosllavisë, numri dy pas Titos, njëkohësisht ministër i Brendshëm dhe shef i Shërbimit të Sigurisë Shtetërore (UDB). Veprimtaria e UDB-së ishte akuzuar për abuzime të shumta, përfshirë terrorizimin e popullit dhe përgjimin e vetë Titos, çka rezultoi me mënjanimin e Rankovićit nga të gjitha pozitat e larta udhëheqëse.[19] Si pasojë, u dobësua dukshëm aparati represiv i Sigurimit të Shtetit, i cili deri atëherë kishte ushtruar një kontroll të rreptë në tërë hapësirën e Jugosllavisë, por sidomos mbi Kosovën dhe shqiptarët, duke pasur qëllim shpërnguljen e tyre nga Jugosllavia. Ky zhvillim shënoi një pikë kthese në marrëdhëniet federale dhe krijoi hapësira të reja për një rishikim të pozitës së krahinave. Në këtë klimë reformuese, udhëheqësit institucionalistë shqiptarë kontribuuan duke artikuluar nevojën për avancimin e statusit politik të Kosovës. Proceset reformuese kulmuan me ndryshimet kushtetuese të Federatës Jugosllave në fillim të viteve 1970, të cilat përfshinë edhe miratimin e Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974. Ky akt kushtetues e përcaktoi Kosovën si një element konstituiv në kuadër të federatës jugosllave.

Megjithëkëtë, në planin formal-juridik Kosova mbeti e përcaktuar si krahinë autonome brenda Republikës Socialiste të Serbisë, gjë që dëshmonte për kufizimet strukturore të avancimit të saj politik. Rrjedhimisht, si gjatë këtij procesi, ashtu edhe në periudhën pasuese, përkushtimi i udhëheqësve institucionalistë është cilësuar

[19] Mønnesland, 2006: 222

si jo mjaftueshëm proaktiv në raport me përpjekjet për transformimin e Krahinës së Kosovës në Republikën e Kosovës. Ky vlerësim, sidoqoftë, duhet parë në kontekstin e pengesave reale dhe strukturave politike frenuese që ekzistonin në federatën jugosllave, të cilat e bënin të vështirë, në mos të pamundur, një transformim të tillë në rrethana historike konkrete. Në lidhje me këtë, historiani Noel Malcolm rendit "tri pengesa" kryesore që e pamundësuan Kosovën të avancohet në Republikë në vitin 1974. Pengesa e parë ishte teorike, e bazuar në doktrinën komuniste të zhvilluar në Bashkimin Sovjetik që, në fakt, ishte edhe gurthemel i federatës jugosllave dhe nënkuptonte se republikat ishin entitete për "kombet" dhe jo për "kombësitë". Ky kriter teorik nuk respektohej plotësisht. Për shembull, popullata rumanishtfolëse e Moldavisë që kufizohej me Rumaninë e kishte republikën e vet në kuadër të Bashkimit Sovjetik. Pengesa e dytë praktike nënkuptonte se Kosova si republikë formale do të mund t'i bashkohet Shqipërisë. Pengesa e tretë politike nënkuptonte se avancimi i Kosovës në republikë formale do të krijonte indinjatë të madhe te serbët në Serbi dhe te serbët në Kosovë.[20]

Pa dyshim, avancimi kulturor e politik i shqiptarëve në Kosovë gjatë fundviteve 1960 dhe fillimviteve 1970 - duke kulmuar me miratimin e Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974 - përbënte një arritje të rëndësishme historike. Megjithatë, ky zhvillim nuk ofronte garanci për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Jugosllavi, pasi Kosova nuk kishte evoluar në një republikë formale, status i cili

[20] Malcolm, 2001: 341-343

do të mund t'u garantonte shqiptarëve një siguri më të qëndrueshme politike brenda federatës, sidomos edhe pas vdekjes së Titos, i cili prioritet parësor kishte pushtetin dhe stabilitetin politik dhe jo të ardhmen politike të shqiptarëve në Jugosllavi. Për më tepër, në kuadër të këtyre ndryshimeve pozitive që solli Kushtetuta e vitit 1974, dolën në pah edhe pasoja të padëshiruara, sepse shqiptarëve u imponohej dhe u mundësohej më së shumti mobilizimi në radhët e partisë. Sipas Malcol-mit, "... pabarazia e përgjithshme në punësimin publik asnjëherë nuk u përmirësua: më 1980 llogaritej se çdo i pesti serb kishte rrogë shtetërore, kurse çdo i njëmbëdhjeti shqiptar merrte rrogë shtetërore. Aty ku shqiptarët bënë përparimin më të madh ishte hyrja e tyre në radhët e partisë dhe të administratës lokale".[21] Rrjedhimisht, rekrutimi masiv i shqiptarëve në Lidhjen Komuniste, dhe privilegjet e pozitave partiake dhe burokratike, përveç anës pozitive, bartnin me vete imponimin, presionin dhe indoktrinimin, në kuptimin e lojalitetit dhe servilitetit ndaj Jugosllavisë dhe titizmit. Në këtë vazhdë rezultoi strategjia "përçaj dhe sundo" nga shërbimi i sigurisë shtetërore jugosllave, i dominuar nga Serbia (UDB), që nëpërmjet privilegjeve, shantazheve dhe presioneve, përdorte një pjesë të shqiptarëve për ta luftuar veprimtarinë revolucionare të grupeve klandestine.

Madje edhe përafrimi i Titos me Enver Hoxhën ishte strategjik. Malcolmi konstaton se pajtimi i Jugosllavisë me Shqipërinë kishte të bënte se Tito ishte frikësuar

---

[21] Po aty: 340

paraprakisht nga pushtimi i Çekosllovakisë nga Bashkimi Sovjetik dhe kishte nevojë për të gjitha shtetet antiruse në Ballkan. Shqipëria në këtë periudhë kohore i kishte të prishura marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe nuk merrte subvencione nga sovjetikët. Rrjedhimisht, në fillimvitin 1969 rezultuan marrëveshjet tregtare në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë dhe, pas disa muajsh, edhe marrëveshja në bazë të së cilës erdhën (gjatë fillimviteve '70), rreth 200 profesorë nga Shqipëria për të ligjëruar në Universitetin e Prishtinës, duke përfshirë përdorimin e teksteve të botuara në Shqipëri.[22]

Gjatë fillimviteve '80 filloi gradualisht edhe zhbërja e rrymës politike institucionaliste të shqiptarëve të Kosovës. Pas demonstratave të vitit 1981, për shkak të përkeqësimit të situatës së përgjithshme në Kosovë, dy ndër udhëheqësit institucionalistë më me ndikim, Mahmut Bakalli dhe Fadil Hoxha, dhanë dorëheqje. Në këtë kontekst, me ardhjen e Slobodan Miloševićit në pushtet, situata në Kosovë u përkeqësua edhe më tej. Më 23 mars 1989, nën rrethimin policor dhe ushtarak të Kuvendit të Kosovës, u imponua suprimimi i autonomisë së Kosovës. Një pjesë e delegatëve shqiptarë të Kuvendit të Kosovës – si pjesë e establishmentit të rrymës politike institucionaliste – pavarësisht presionit, e kundërshtuan hapur ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës: Riza Lluka, Melihate Tërmkolli, Shkëlzen Gusinja, Ukë Bytyqi, Sadik Zuka, Remzi Hasani, Menduh Shoshi, Bajram Buçani, Mehdi Uka, Avdi Berisha etj.[23] Në këtë

---

[22] Po aty: 339

[23] Telegrafi.com (2014): Kujtesë: *25 vjet nga suprimimi i dhunshëm i autonomisë së Kosovës*:

kuadër, dy nga udhëheqësit institucionalistë më me ndikim që kishin mbetur ishin Azem Vllasi dhe Kaqusha Jashari. Në fund të muajit mars 1989, me urdhër të Miloševićit, u arrestua Azem Vllasi, nën akuzën për "veprimtari kundërrevolucionare".

***Revolucionarët*** identifikohen me vazhdimësinë e përpjekjeve të rezistencës aktive të shqiptarëve për çlirimin e Kosovës dhe viseve të saj pas vitit 1912, si vijimësi e pandërprerë e përpjekjeve për arritjen e lirisë kombëtare, duke përfshirë edhe përpjekjet kundër ripushtimit të Kosovës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Kjo vazhdimësi u shpreh në forma të ndryshme të qëndresës, e cila karakterizohej kryesisht nga një frymë idealiste që shpesh i tejkalonte kalkulimet dhe kufizimet e rrethanave realpolitike të kohës. Në këtë vazhdë, pas Luftës së Dytë Botërore, rezistenca ndaj regjimit të Beogradit u shfaq përmes veprimtarisë së grupeve revolucionare klandestine. Këto grupe, që vepronin në kushte të fshehta dhe shpesh në rrethana represive, përfaqësonin një vijimësi të traditës së qëndresës dhe të përpjekjeve idealiste për liri kombëtare. Ndër figurat që luajtën rol të rëndësishëm në inkurajimin dhe drejtimin e këtyre grupeve ishin Adem Demaçi, Metush Krasniqi, Ahmet Haxhiu, Kadri Osmani, Hyrie Hana, Mehmetriza Murtezani, Rexhep Gali Balidemaj dhe shumë të tjerë.

Veprimtaria e grupeve revolucionare klandestine, rezultoi, ndër të tjera, me organizimin e demonstratave të vitit 1968, të cilat patën ndikim të tërthortë edhe në

---

*https://telegrafi.com/kujtese-25-vite-nga-suprimimi-i.../*

procesin politik të nisur në udhëheqjen jugosllave në vitin 1966. Ky proces çoi në ndryshime kushtetuese që përfshiu edhe Kosovën me Kushtetutën e vitit 1974. Edhe pse veprimtaria e grupeve klandestine u godit rëndë pas demonstratave të vitit 1968 - me burgosjen, torturimin dhe ndjekjen e shumë prej pjesëtarëve të tyre - ajo arriti të rimëkëmbet gjatë viteve '70, duke u fuqizuar organizativisht. Ky aktivizim i ri u bë një ndër faktorët vendimtarë që çuan në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981, të cilat artikuluan me vendosmëri kërkesën: "Republikë, Kushtetutë - ja me hatër, ja me luftë."[24]

Për demonstratat e vitit 1981 kanë qarkulluar edhe interpretime me prirje konspirative, sipas të cilave ato mund të kenë qenë orkestruar nga qarqe të shërbimeve sekrete serbe, ruse apo të tjera, me qëllim minimin e pozitës politike që kishin fituar shqiptarët në bazë të Kushtetutës së vitit 1974. Megjithatë, një vlerësim i tillë mbetet spekulativ dhe antihistorik, pasi demonstratat e vitit 1981, në thelb, përfaqësonin vazhdimësinë e traditës së përpjekjeve të shqiptarëve për liri kombëtare që nga viti 1912, duke përfshirë edhe përpjekjet pothuajse identike të manifestuara gjatë demonstratave të vitit 1968. Në këtë kontekst, ato ishin gjithashtu të ndikuara nga veprimtaria dhe shtypi i grupeve revolucionare klandestine të viteve '70. Një element i ri i kësaj periudhe ishte fakti se disa prej këtyre grupeve kishin arritur të botonin dhe të shpërndanin shtypin klandestin, i cili pati ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në një

---

[24] Lekaj, 2021: 124, 125, 131

pjesë të konsiderueshme të shoqërisë studentore të Universitetit të Prishtinës. Gjithashtu, manifestimi i 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i mbajtur në vitin 1978, pati ndikim të ndjeshëm në forcimin e vetëdijes kombëtare dhe në frymëzimin e rinisë studentore, veçanërisht në Kosovë. Kjo ngjarje historike rigjallëroi kujtesën kolektive për liri dhe barazi kombëtare me popujt e tjerë, duke krijuar një klimë të re vetëdijeje dhe mobilizimi shoqëror, e cila u reflektua fuqishëm në demonstratat e vitit 1981, përmes kërkesës për barazinë politike të shqiptarëve brenda federatës jugosllave.

Një faktor tjetër i rëndësishëm lidhej me kontekstin e përgjithshëm socio-politiko-ekonomik në Kosovë. Siç konstaton edhe ballkanologu norvegjez Svein Mønnesland: *"Mund të duket i çuditshëm rebelimi i shqiptarëve në një kohë kur kishin arritur të kenë më shumë të drejta se ndonjëherë më parë. Por 'periudha e lulëzimit' në vitet '70 ndikoi në ngritjen e vetëdijes kombëtare, sidomos në mesin e të rinjve që pashmangshëm rezultoi me rritjen e kërkesave politike. Pse Kosova nuk duhet të ketë status republike kur ka më shumë banorë sesa në Mal të Zi apo në Slloveni? Gjithashtu, për pakënaqësinë ndikonte që Kosova kishte mbetur ende zona më e varfër në vend".*[25]

Përndryshe, edhe çdo element eventual i komplotit nuk arriti ta dezorientonte qëllimin politik të shqiptarëve të Kosovës. Organizimi i grupeve klandestine kishte evoluar politikisht, veçanërisht nën drejtimin e Grupit Revolucionar të Kosovës, me figura si Hydajet Hyseni dhe të tjerë, të cilët arritën të orientojnë politikisht

[25] Mønnesland, 2006: 239

demonstratat përmes fjalimeve, shkrimeve dhe argumenteve që theksonin se Kosova përmbushte kushtet për t'u njohur si Republikë në kuadër të barazisë së popujve të federatës jugosllave. Në këtë kuadër, një kontribut të veçantë dha Ukshin Hoti, simbol i guximit akademik. Në një mbledhje në Universitetin e Prishtinës, më 19 nëntor 1981, ai argumentoi nga një këndvështrim shkencor-politologjik për përfitimet që do të sillte Republika e Kosovës, përfshirë edhe forcimin e stabilitetit politik në rajon.

Vlen të theksohet se veprimtarët e grupeve revolucionare klandestine, si idealistë të bindur dhe të ndikuar nga përvojat e hidhura historike të shqiptarëve në Jugosllavi (para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore), ishin thellësisht të motivuar në përpjekjet e tyre për ta transformuar Krahinën e Kosovës në Republikën e Kosovës. Këtë e shihnin si hap të domosdoshëm për sigurinë politike të shqiptarëve në Kosovë me vise dhe, njëkohësisht, si parakusht për bashkimin kombëtar të shqiptarëve në të ardhmen. Pikërisht për këtë arsye, ata nuk u magjepsën nga ndryshimet që solli Kushtetuta jugosllave e vitit 1974 dhe as nga Kushtetuta e Kosovës e atij viti, pasi këto ndryshime nuk e zgjidhnin çështjen politike të shqiptarëve në Jugosllavi. Në vazhdën e përpjekjeve për transformimin e Kosovës në Republikë, një pjesë e konsiderueshme e këtyre grupeve, në vitin 1982, themeluan Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRShJ). Kjo organizatë më vonë u riemërua: si Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), dhe në vitin 1993 si Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK).

***Akademikët*** identifikohen kryesisht me veprimtarinë e zhvilluar në kuadër të institucioneve shkencore dhe kulturore që u themeluan në dekadat pas vitit 1960: Instituti Albanologjik i Prishtinës (1967), Enti i Historisë (1967) – që më vonë evoluoi në Institutin e Historisë së Kosovës – dhe veçanërisht Universiteti i Prishtinës, si dhe me themelimin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (1975). Disa nga personalitetet më të spikatura dhe me ndikim në këtë veprimtari ishin: Fehmi Agani, Idriz Ajeti, Rexhep Qosja, Ali Hadri, Esad Mekuli, Dervish Rozhaja, Gazmend Zajmi, Ejup Statovci, Anton Çeta, Mark Krasniqi, Ibrahim Rugova, Zekeria Cana, Edi Shukriu, ndër të tjerë.

Gjatë viteve 1970-1980, kjo elitë akademike në përgjithësi nuk u karakterizua nga përpjekje të drejtpërdrejta për transformimin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Republikë të Kosovës – përjashtuar disa raste të veçuara, si ato të Ukshin Hotit, Halil Alidemës, Ekrem Kryeziut dhe ndonjë shembulli tjetër të izoluar. Pavarësisht kësaj, kontributi i kësaj elite ishte thelbësor në zhvillimin e veprimtarisë shkencore e kulturore, si dhe në konsolidimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e vetëdijes kombëtare shqiptare. Një element i rëndësishëm i këtij zhvillimi ishte edhe pjesëmarrja e pedagogëve nga Shqipëria, të cilët gjatë viteve 1970 ligjëronin në Universitetin e Prishtinës, duke forcuar lidhjet akademike dhe kulturore shqiptare në nivel gjithëkombëtar.

Pas shembjes së Murit të Berlinit në vitin 1989 dhe ndryshimeve të mëdha politike në Evropën Lindore, kjo

elitë mori gjithashtu një rol të rëndësishëm në jetën politike të Kosovës, duke u përfshirë në themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Nën drejtimin e Ibrahim Rugovës, kjo parti u shndërrua në një lëvizje të gjerë politike e shoqërore, e cila mishëroi strategjinë e rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve 1990.

Pavarësisht prej divergjencave ndërmjet tyre, këto tri rryma politike - revolucionarët, institucionalistët dhe akademikët - në mënyra të ndryshme dhe shpeshherë komplementare, dhanë kontributin e tyre (më shumë ose më pak) në kuadër të përpjekjeve për avancimin politiko-kulturor dhe për çlirimin e Kosovës. Megjithatë, asnjëra prej tyre nuk arriti, gjatë viteve 1970–1980 (para shembjes së Murit të Berlinit), të nxirrte figura të një kalibri të tillë si Václav Havel etj. Në këtë kuptim, Kosova mbeti pa një zë të fuqishëm individual, i aftë ta kanalizonte çështjen e saj në forume ndërkombëtare, përfshirë Procesin e Helsinkit dhe strukturat e tjera perëndimore.

Në fakt, përgjegjësia dhe mundësia më e madhe për ta marrë këtë rol gjatë viteve 1970–1980 - duke u frymëzuar nga shembulli i Havelit dhe personaliteteve të ngjashme - i takonte në radhë të parë elitës akademike të Kosovës. Por, përkundrazi, një pjesë e madhe e saj (në shkallë të ndryshme) deri në shembjen e Murit të Berlinit, shfaqej e lëkundur ndërmjet titizmit dhe, herë-herë, edhe enverizmit, madje disa ndër akademikët më të njohur nuk hezitonin të botonin elozhe për Titon ose të shprehnin simpati për Enver Hoxhën. Ky pozicionim e kufizoi rolin e saj si faktor disident dhe ndërkombëtarizues,

si dhe si potencial përfaqësues i një agjende më të qartë politike.

Për dallim nga akademikët, institucionalistët kishin përgjegjësinë dhe mundësinë më të kufizuar për të marrë mbi vete detyrën e një ndërkombëtarizimi më të hershëm të çështjes së Kosovës në kuadër të diskursit të shteteve perëndimore dhe të Procesit të Helsinkit. Duke vepruar në rrethana të ndërlikuara politike, si establishmenti real politik i Kosovës në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, ata e kishin si alternativë të vetme përdorimin e titizmit si instrument politik. Kjo u shfaq si përpjekje për t'i forcuar institucionet politike të Kosovës deri në një masë të caktuar dhe për të amortizuar goditjet dhe synimet neofashiste të Serbisë ndaj Kosovës. Në këtë kuptim, për institucionalistët titizmi ishte më tepër mjet politik sesa ideologji, me përjashtim të ndonjë shembulli / shembujve të izoluar.

E për dallim nga akademikët dhe institucionalistët, revolucionarët - të cilët që nga viti 1982 kryesisht identifikoheshin me LPK-në - e kishin edhe më të kufizuar përgjegjësinë dhe mundësinë për marrjen e detyrës së ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës në kuadër të diskursit perëndimor dhe të Procesit të Helsinkit. Si idealistë, të angazhuar kryesisht në përpjekjet për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin kombëtar, ata ruanin një lojalitet të theksuar ndaj Shqipërisë (të quajtur shpesh "Shqipëria londineze"), pasi çlirimi dhe realizimi i Republikës së Kosovës, në perceptimin e tyre, ishte i pamendueshëm pa mbështetjen e shtetit amë, pavarësisht nga sistemi politik që mbretëronte atje. Në këtë

drejtim, pushteti në Shqipëri, veçanërisht pas demonstratave të vitit 1981, u pozicionua publikisht në mbështetje të kërkesave të demonstruesve shqiptarë të Kosovës, njëherësh në kuadër të kësaj përkrahjeje përpiqej ta kontrollonte veprimtarinë revolucionare të grupeve klandestine të shqiptarëve në Jugosllavi, me "përgjegjësinë e kalkulimit real-politik" që kishte si pushtet/shtet amë. Pra në rrethanat që vepronin dhe si idealistë që ishin, veprimtarët e grupeve revolucionare klandestine s'kishin alternative tjetër, dhe në këtë kuptim enverizmin e kishin më shumë mjet politik sesa ideologji, përveç ndonjë shembulli/shembujve të izoluar. Kjo dëshmohet edhe nga fakti se pas shembjes së Murit të Berlinit, LPK-ja jo vetëm që u distancua nga Enverizmi, por edhe shfuqizoi pararojën marksiste-leniniste si organ udhëheqës të saj, duke vazhduar përpjekjet për çlirimin e Kosovës mbi baza të qarta kombëtare. Madje, edhe përpara këtij momenti historik, brenda LPK-së ekzistonin zëra kritikë për heqjen e pararojës marksiste -leniniste. Në këtë kuadër, një ndikim të veçantë pati mendimi kritik i Adem Demaçit ndaj Enver Hoxhës, sidomos pas daljes së tij nga burgu dhe vizitës së parë në Shqipëri. Një dëshmi tjetër domethënëse se LPK-ja e kishte qëllim parësor çështjen kombëtare mbi çdo ideologji është edhe shembulli i një prej themeluesve të saj kryesorë, Jusuf Gërvallës. Në një intervistë të realizuar në vitin 1980 (para demonstratave të vitit 1981) dhe të publikuar më 20 janar 1982 në gazetën gjermane Tagische Zeitung, ai u pyet nga gazetari nëse do ta kërkonte bashkimin me Shqipërinë, pavarësisht se atje

mund të mbretëronte një sistem radikal komunist, një sistem radikal demokratik ose një sistem i së drejtës. Përgjigjja e tij ishte e qartë dhe lapidare: "Pavarësisht nga çfarëdo sistemi!"[26]

Njëherësh, vlen të theksohet se, në kuadër të përpjekjeve për avancimin politiko-kulturor dhe çlirimin e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, pati veprimtari që ndikuan në ndërkombëtarizimin e çështjes së Koso-vës edhe para shembjes së Murit të Berlinit. Në fakt, demonstratat e vitit 1981, të cilat artikuluan kërkesa socio-ekonomike dhe politike për barazi të shqiptarëve me popujt e tjerë të federatës jugosllave, ushtruan një ndikim gradual në ndërkombëtarizimin e situatës së të drejtave të njeriut për shqiptarët në Jugosllavi – sidomos përmes Amnesty International, e cila reagonte veçanërisht ndaj përdorimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor të të burgosurve politikë shqiptarë, duke u bërë një burim i rëndësishëm informacioni për Komitetet e Helsinkit në shtetet perëndimore. Këto demonstrata, më masive se ato të vitit 1968, u përballën me një reagim dukshëm më brutal të regjimit të Beogradit, si gjatë ngjarjeve, ashtu edhe në trajtimin e të burgosurve politikë shqiptarë pas tyre. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se gjatë periudhës së viteve 1980–1990, mijëra shqiptarë u dënuan me burgime të rënda për

---

[26] Intervistë e Jusuf Gërvallës botuar në gazetën gjermane *"Tagische Zeitung"*: https://m.gazetaexpress.com/arkiva/interviste-e-jusuf-gervalles-botuar-ne-gazeten-gjermane-tages-zeitung-131866/?arch_tb=temp https://rajonipress.com/interviste-e-jusuf-gervalles-botuar-ne-gazeten-gjermane-tagische-zeitung/

“veprimtari armiqësore kundër Jugosllavisë”. Konsiderohet se rreth 80 % e të burgosurve politikë në ish-Jugosllavi kanë qenë shqiptarë, ndaj të cilëve u ushtruan tortura të rënda, madje edhe raste vrasjesh gjatë procesit të torturës. Gjithashtu, në ushtrinë jugosllave u burgosën qindra dhe u vranë dhjetëra ushtarë shqiptarë.

Duhet të kihet parasysh se politizimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore pati pasoja edhe në emigracion. Deri në vitet 1980, veprimtaria e emigracionit politik shqiptar ishte e përqendruar kryesisht në kundërshtimin e regjimit diktatorial të Enver Hoxhës, dhe jo në ndërmarrjen e një veprimtarie të drejtpërdrejtë për ndërkombëtarizimin dhe çlirimin e Kosovës me viset e saj – me disa përjashtime, si Hysen Tërpeza, Tahir Kerrnaja, Sami Repishti, Ihsan Toptani, si dhe ndonjë rast tjetër i izoluar. Në këtë kuadër, vlen të përmenden Organizata “Rinia Shqiptare-Kosovare në Botën e Lirë”, e themeluar në Nju-Jork në vitin 1970, si dhe Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare (BKDSH), e cila vepronte që nga fillimi i viteve 1970 me seli në Shtutgart të Gjermanisë.

Njëkohësisht, duhet theksuar se aktivitetet e dekadës së viteve 1980 shënuan një nisëm të rëndësishme për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Pas demonstratave të vitit 1981, kjo prirje u fuqizua veçanërisht përmes themelimit të LPK-së (1982) – konkretisht veprimtarisë së Degës së saj jashtë vendit, e cila, përveç mbështetjes për organizimin dhe riorganizimin e strukturave të LPK-së brenda vendit pas goditjeve të pushtetit

jugosllav, kishte një rol të rëndësishëm në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Kjo Degë organizonte në mënyrë të vazhdueshme demonstrata, peticione dhe protesta në qendrat kryesore të shteteve perëndimore, duke apeluar për ndalimin e shtypjes dhe diskriminimit të shqiptarëve në Jugosllavi, duke insistuar për kërkesën "Kosova Republikë" si shprehje e barazisë në kuadër të federatës jugosllave, dhe duke ushtruar njëkohësisht lobim dhe diplomaci joformale. Kjo veprimtari u zhvillua përmes Grupit për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, i ndërlidhur me LPK-në; Komitetit të Kosovës për Informimin e Opinionit Botëror në Gjenevë, që rezultoi nga strukturat e LPK-së; si dhe përmes Klubit Kombëtar "Jusuf Gërvalla" në Nju-Jork, që për një periudhë funksionoi si degë e LPK-së, me nëndegë aktive në Detroit, Chicago, Dallas etj. Gjithashtu, një rol të rëndësishëm në fuqizimin dhe përshpejtimin e ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës kishin edhe disa struktura të tjera lobuese dhe të diplomacisë joformale të emigracionit politik shqiptar, të themeluara para shembjes së Murit të Berlinit, si Komiteti i Kosovës për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Belgjikë (1983), Shoqata "Migjeni" në Slloveni (1989), dhe Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane në ShBA (1989).

Për më tepër, edhe hovi i ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës në vitin 1990, përveçse ishte rezultat i drejtpërdrejtë i efekteve të shembjes së Murit të Berlinit – që solli ndryshime të mëdha në gjithë Evropën Lindore dhe u reflektua edhe në Kosovë me

themelimin e partive politike dhe të organizatave të para për të drejtat e njeriut – ishte njëherësh edhe fryt i kontributit të emigracionit politik shqiptar, i cili paraprakisht kishte krijuar miqësi dhe lidhje bashkëpunimi me personalitete me ndikim në Evropë dhe ShBA. Pikërisht këto lidhje, në bashkëpunim të ngushtë me emigracionin politik shqiptar, i hapën rrugën vizitave të para të delegacioneve nga Kosova në shtetet perëndimore, të cilat shënojnë edhe fillimin e lidhjeve paradiplomatike të Kosovës me botën perëndimore. Kështututje edhe organizimi në kuadër të emigracionit politik shqiptar u forcua edhe më shumë. Më 19 tetor 1991, u themelua Qeveria e Kosovës në ekzil, në krye me Bujar Bukoshin, që fillimisht u vendos në Lubjanë të Sllovenisë dhe më pastaj nga viti 1992 në Bon të Gjermanisë. Kjo Qeveri kishte edhe Ministrinë e Informacionit me seli në Gjenevë në krye me Xhafer Shatrin. Deri në këtë periudhë kohore ishin themeluar edhe degët e LDK-së në shtetet perëndimore dhe koordinoheshin nga një qendër në Shtutgard të Gjermanisë në krye me Hafiz Gagicën. Në këtë drejtim, shumica e takimeve ndërmjet Ibrahim Rugovës dhe përfaqësuesve të shtetit gjerman, si dhe përfaqësuesve të tjerë evropianë, u koordinuan përmes zyrës së LDK-së në Shtutgart, e cila njëkohësisht e ka luajtur një rol si zyrë ndërlidhëse e Kosovës.

Pas rënies së Murit të Berlinit, kundërshtimi i shqiptarëve të Kosovës ndaj hegjemonisë së regjimit neofashist të Miloševićit u karakterizua nga një mobilizim i gjerë dhe gjithëpërfshirës. Në këtë mobilizim ndikuan një sërë ndodhish dhe aktivitetesh politiko-shoqërore

në Kosovë, ndër të tjera: gjatë demonstratave të vitit 1989-1990 (si reaksion kundër suprimimit të autonomisë së Kosovës), ranë dhjetëra dëshmorë. Më 2 nëntor 1989 ranë heroikisht në Prishtinë dy udhëheqësit kryesorë të LPK-së, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, nën rrethim dhe përballje të armatosur e të pabarabartë me forcat policore. Më 2 shkurt 1990 filloi aktivitetin aksioni për pajtimin e gjaqeve dhe ngatërresave, i iniciuar nga disa veprimtarë të LPK-së (Jashar Salihu, Nurie Zeka, Naser Veliu, Ibish Neziri, Adem Grabovci, Hava Shala, Myrvete Dreshaj, Lulzim Etemaj, Xhemajl Fetahaj, Ibrahim Dreshaj etj.) dhe u udhëhoq nga profesor Anton Çetta etj., duke evoluar në një mobilizim dhe solidaritet gjithëpopullor. Në këtë vazhdë, përveç themelimit të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), Komitetit Kosovar të Helsinkit (KKH), dhe partive të para Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Partisë Socialdemokrate të Kosovës, u themeluan edhe disa parti të tjera të shqiptarëve në Kosovë (Partia Shqiptare Demokristiane, Partia Liberale, Partia Fshatare, Partia Republikane, Parlamenti Rinor që, në fakt, ishte bërthama e Partisë Parlamentare etj.), dhe u organizuan në kuadër të një këshilli koordinues të udhëhequr nga LDK-ja, në krye me Ibrahim Rugovën. Paralelisht me këto zhvillime u themelua bashkësia e sindikatave të pavarura e Kosovës, në krye me Hajrullah Goranin. Ndërsa delegatët shqiptarë të legjislaturës së re të Kuvendit të Kosovës, që filloi punën më 4 dhjetor 1989, morën vendimin e guximshëm dhe shpallën Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut 1990.

Rreth dy muaj më vonë, më 7 shtator 1990, në sallën e Shtëpisë së Kulturës në Kaçanik, në një mbledhje të kryesuar nga Iliaz Ramajli, ku morën pjesë pothuajse të gjithë delegatët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës, u miratua Kushtetuta e Kosovës (e njohur si Kushtetuta e Kaçanikut). Ajo ishte përpiluar paraprakisht nga akademikët Gazmend Zajmi, Ejup Statovci dhe të tjerë.

Këshilli koordinues i partive politike të Kosovës (i përbërë nga Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Ali Aliu, Ramush Tahiri, Veton Surroi, Shkëlzen Maliqi, Reshat Nurboja etj.) emëroi një komision qendror për organizimin dhe mbajtjen e referendumit popullor (i përbërë nga Fehmi Agani, Fatmir Sejdiu, Rifat Blaku, Hivzi Islami, Ramush Tahiri, Ejup Statovci, Ismet Saliu etj.). Pavarësisht prej rrethanave të vështira, referendumi u mbajt nga 26 deri më 30 shtator 1991, ku mbi 90 % e shqiptarëve të Kosovës votuan për pavarësinë e Kosovës, duke legjitimuar kështu Deklaratën e 2 korrikut dhe Kushtetutën e 7 shtatorit. Po ashtu, më 24 maj 1992 u mbajtën zgjedhjet e para parlamentare[27] dhe presidenciale në Kosovë, të cilat i fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kryetari i saj Ibrahim Rugova, u zgjodh president. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, disa pjesëtarë të ish-strukturave institucionaliste të Kosovës, si dhe disa përfaqësues të mirënjohur të ish-veprimtarisë revolucionare klandestine (kryesisht ish-të burgosur politikë), iu bashkuan strukturave udhëheqëse të LDK-së, në krye me Ibrahim Rugovën.

---

[27] Rifat Blaku (2016): *Referendumi i parë shqiptar në Kosovë u mbajt në mënyrë dinjitoze*: https://www.kosova-sot.info/opinione/140682/referendumi-i-pare-shqiptar-nekosove-u-mbajt-ne-menyre-dinjitoze/

Vlen të theksohet se shpallja e Deklaratës së 2 korrikut 1990 ishte rezultat i bashkëveprimit ndërmjet disa prej ish-pjesëtarëve të elitës institucionaliste, në koordinim me forcat e tjera politike shqiptare në Kosovë - përkatësisht me akademikët të cilët tashmë identifikoheshin kryesisht me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), dhe me revolucionarët, të lidhur kryesisht me Lëvizjen Popullore të Kosovës (LPK). Kjo Deklaratë, në thelb, përbënte një rikonfirmim të shpalljes së parë të Republikës së Kosovës gjatë demonstratave të vitit 1981, të cilat kishin karakterin e një referendumi popullor për Republikën e Kosovës. Në këtë kontekst, Ukshin Hoti e ka konsideruar kërkesën për Republikë gjatë demonstratave të vitit 1981 si pikënisjen e procesit të brendshëm të demokratizimit (demokraci autentike) në Kosovë. Në librin e tij *Filozofia politike e çështjes shqiptare* (1995), përveç të tjerash, konstaton se: *"Demokracinë në Kosovë nuk e lindën të tjerët e as nuk u lind për qefin e tyre. Ishte e ndërlidhur me proceset demokratike të Evropës dhe me synimet e tilla të njerëzimit. Demokracia në Kosovë u vetëlind në vitin 1981, do të rritet vetë, së bashku, e barabartë dhe e ndërlidhur me të tjerat".*[28] Hoti ishte një ndër figurat më të veçanta të jetës politike dhe intelektuale të Kosovës në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Ai kontribuoi në kuadër të tri rrymave politike të shqiptarëve të Kosovës gjatë përpjekjeve për avancimin politiko-kulturor të Kosovës. Së pari, ishte pjesë e elitës institucionaliste, në cilësinë e sekretarit të Sekretariatit të Kosovës për Marrëdhënie

[28] Hoti 1995: 76

me Jashtë, duke u angazhuar për afirmimin politik të Kosovës brenda kuadrit jugosllav. Së dyti, ishte pjesë e elitës akademike, si studiues i shkencave politike dhe profesor në Universitetin e Prishtinës, ku ndikoi thellë në formimin intelektual të brezave të rinj dhe në zhvillimin e mendimit politik shqiptar. Së treti, ishte pjesë e elitës revolucionare, si i burgosur politik dhe veprimtar aktiv pas demonstratave të vitit 1981, duke u bërë një ndër figurat më frymëzuese të LPK-së. Me fjalë të tjera, Ukshin Hoti - pothuajse si shembull i izoluar - i sakrifikoi të gjitha pozitat dhe privilegjet për t'ia kushtuar dijen akademike dhe përvojën politike realizimit të Republikës së Kosovës. Ky angazhim i tij ishte i pandërprerë që nga demonstratat e vitit 1981 e deri në vrasjen e tij nga regjimi neofashist i Slobodan Miloševićit në vitin 1999.

Në fund të viteve '90, gjatë periudhës kur Ukshin Hoti ndodhej në burg, ai u nominua nga Parlamenti Evropian për Çmimin "Sakharov", si njohje për veprimtarinë e tij intelektuale, qëndrueshmërinë morale dhe sakrificën për parimet demokratike e lirinë e popullit të tij. Në të njëjtin kuadër të vlerësimit evropian, gjatë viteve '90, me Çmimin "Sakharov" u nderuan edhe dy kryedisidentë të tjerë shqiptarë: Adem Demaçi, si simbol i rezistencës së shqiptarëve për liri dhe barazi, dhe Ibrahim Rugova, si misionar i paqes. Këto vlerësime të larta nga Parlamenti Evropian nuk përbënin vetëm një akt njohjeje individuale ndaj tri figurave të shquara të lëvizjes shqiptare të Kosovës për liri dhe demokraci por, po ashtu, një formë të fuqishme dhe të plotë të

ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, duke e përfshirë atë në diskursin evropian dhe global mbi të drejtat e njeriut, demokracinë dhe vetëvendosjen.

Për më tepër, në këtë perspektivë, nderimi i Adem Demaçit, Ibrahim Rugovës dhe nominimi i Ukshin Hotit për Çmimin "Sakharov", mund të shihet si shprehje e tri dimensioneve plotësuese të rezistencës politike shqiptare në Kosovë: rezistenca morale dhe e pandërprerë kundër shtypjes dhe veprimtaria për të drejtat e njeriut (Demaçi), vizioni paqësor dhe diplomatik për afirmimin ndërkombëtar të Kosovës (Rugova), si dhe mendimi filozofik dhe politik që artikulonte lidhjen midis demokracisë, vetëvendosjes dhe lirisë (Hoti). Kështu, përmes këtyre tri figurave, çështja e Kosovës u projektua në arenën evropiane si një kërkesë legjitime për liri, barazi dhe dinjitet politik, duke e bërë Çmimin "Sakharov" jo vetëm një shenjë vlerësimi individual, por edhe një instrument simbolik të afirmimit ndërkombëtar të së drejtës së popullit të Kosovës për demokraci dhe vetëvendosje.

Të tre - Ukshin Hoti, Ibrahim Rugova dhe Adem Demaçi - ishin miq dhe bashkëpunëtorë të Berit Backerit, e cila, së bashku me bashkëpunëtorët e saj norvegjezë dhe shqiptarë, si dhe me rrjetin e gjerë të kontakteve ndërkombëtare, luajti rol kyç në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës në kuadër të Procesit të Helsinkit – një dimension që do të shtjellohet më konkretisht në vazhdim të këtij libri.

Në vijim, fotot e Adem Demaçit dhe Ibrahim Rugovës gjatë ceremonive të dhënies së Çmimit "Sakharov" në

vitet 1991 dhe 1998. Në mes foto e Ukshin Hotit, gjithashtu, më poshtë gjenden dy fragmente - njëri nga ballina dhe tjetri nga lista e nominimeve për Çmimin Sakharov të vitit 1998, ku përmendet Ukshin Hoti si i nominuar. Burimi: Qendra e Arkivit dhe Dokumentacionit (CARDOC), Parlamenti Evropian, nr. 11, nëntor 2013: "25 *Years of the Sakharov Prize*":












**1998**

In 1998, there were eight nominations from political groups or Members[164]:

- Accept, a Romanian human rights organisation active in the defence of homosexual rights. Nominated by Joost Lagendijk (V) and others.
- Akin Birdal, Chair of a Turkish human rights association. Nominated by Pauline Green (PSE) and others.
- His Holiness the Dalai Lama, a great defender of the rights of Tibetans. Nominated by James Moorhouse (PPE) and others.
- Ukshin Hoti, a Kosovar university lecturer and political prisoner. Nominated by Olivier Dupuis (ARE) and others.
- José Rainha, one of the leaders of the Brazilian landless workers movement. Nominated by Alonso José Puerta (GUE/NGL) and others.
- Marta Beatriz Roque Cabello, Cuban intellectual and human rights activist. Nominated by Pat Cox (ELDR) and others.
- Ibrahim Rugova, head of the Democratic League of Kosovo since its foundation in 1989. Nominated by Wilfried A. E. Martens (PPE) and others.
- Mordechai Vanunu, Israeli political prisoner. Nominated by Wilfried Telkämper (V) and others.[165]

## MISIONI I PARË FAKTMBLEDHËS NË KOSOVË PARA SHEMBJES SË MURIT TË BERLINIT

Grupi për Kosovën, që nga themelimi i tij më 1988 si sektor në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (KNH), dhe nga viti 1990 me status zyrtar si pjesë integrale e këtij Komiteti dhe e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH), ka dhënë një kontribut të çmuar për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Në fakt, informatat dhe sugjerimet lidhur me situatën në Kosovë, që Grupi për Kosovën në kuadër të KNH-së i dërgonte si pjesë e "Procesit Civil të Helsinkit" (nën ombrellën e FNH-së), si dhe drejtpërdrejt delegacioneve të shteteve perëndimore në kuadër të "Procesit Ndërshtetëror të Helsinkit" (Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - KSBE), kishin një peshë të padiskutueshme. Ato vlerësoheshin si për besueshmërinë e burimit, po ashtu edhe për rolin në ndërtimin e një kuptimi më objektiv të situatës politike në Kosovë dhe në rrëzimin e imazhit të rremë të përhapur nga propaganda serbo-jugosllave. Rëndësia e këtyre informacioneve dhe sugje-rimeve shtohej nga fakti se Komiteti Norvegjez i Helsin-kit vepronte si organizatë gjysmë-shtetërore dhe këshilluese për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Norvegjisë - një shtet me rol aktiv dhe me kredibilitet të lartë moral në marrëdhëniet ndërkombëtare. Një meritë të veçantë për këtë kontribut kanë pasur Berit Backer dhe Kristoffer Gjøtterud, në cilësinë e koordinatorëve të Grupit për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH).

Backer dhe Gjøtterud kanë qenë idealistë dhe veprimtarë të shquar në rrafshin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, përkatësisht në kuadër të Procesit Civil të Helsinkit, i njohur edhe si Lëvizja e Helsinkit. Gjatë veprimtarisë së tyre kanë krijuar shumë miqësi dhe kontakte të rëndësishme ndërkombëtare. Për më tepër, Backer dhe Gjøtterud, meqë ishin bashkëpunëtorë të ngushtë, u pasuruan edhe anasjelltas me rrethet e tyre miqësore duke përfshirë kontaktet ndërkombëtare. Rrjedhimisht ata kishin arritur të kenë miq dhe kontakte ndërkombëtare me shumë ndikim jo vetëm në nivel skandinav, por gjithandej në botë.

Gjøtterud ka qenë shkencëtar i mirënjohur norvegjez në lëmin e fizikës bërthamore-nukleare, njëkohësisht i interesuar për epistemologjinë dhe metafizikën, në kuptimin e ndërlidhjes në mes të besimit, fesë dhe shkencës etj., së këndejmi ashtu veprimtar i mirënjohur ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut. Me fjalë të tjera, një personalitet shumë i nderuar dhe me ndikim, përveç të tjerash, kryetar i Komitetit për Hebrenjtë e Bashkimit Sovjetik, që nga viti 1982 (veçanërisht i përkushtuar për shkencëtarët hebrenj, të cilëve iu vështirësohej dhe ndalohej udhëtimi jashtë Bashkimit Sovjetik).[29] Gjithashtu, ka qenë bashkëpunëtor i Grupit të Helsinkit të Moskës (Moscow Helsinki Group) i themeluar në vitin 1976[30], përkatësisht mik dhe bashkëpunëtor

---

[29] Store Norske Leksikon; Kristoffer Gjøtterud (2009): https://nbl.snl.no/Kristoffer_Gjøtterud

[30] Forskningsmagasinet Apollon (1995) *Kristoffer Gjøtterud: En åpen horisont:* https://www.apollon.uio.no/ portretter/1995/horisont.html

i veprimtarëve të shquar të këtij grupi, si fizikani dhe nobelisti Andrej Sakharov etj.

Gjithashtu, Backer ka qenë një shkencëtare shumë kompetente në fushën e socialantropologjisë, në ndërlidhje me studimet e saj për shqiptarët në Kosovë dhe Shqipëri, veçanërisht një idealiste dhe aktiviste shumë e shkathtë në përpjekjet e saj titanike për ta ndihmuar Kosovën, Shqipërinë dhe shqiptarët në përgjithësi. Sidomos pasi lidhi bashkëpunim në vitin 1987 me disa ndër eksponentët e LPK-së në emigracion (Nufri Lekën, Ibrahim Kelmendin, Xhavit Halitit etj.), u bë aktiviste e pakompromis për të drejtat e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, duke vënë tërë potencialin e vet në këtë drejtim. Në kuadër të kësaj përpjekjeje ajo vuri në funksion të gjitha miqësitë që kishte jo vetëm në nivel norvegjez dhe skandinav, por edhe miqësitë dhe kontaktet që kishte në nivel ndërkombëtar. Disa ndër miqtë dhe kontaktet e saj në nivel ndërkombëtar kanë qenë, përveç të tjerëve: Karl von Schwarzenberg (kryetar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, duke përfshirë miqtë e tij, Vaclav Havel, Lech Walesa etj.), Jeri Laber (nënkryetare e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit dhe, njëherësh, drejtore ekzekutive e Helsinki Watch Amerikan, i njohur më pas si Human Rights Watch), Warren Zimmermann (drejtues i delegacionit të ShBA-së në KSBE në periudhën 1986-1989, dhe ambasador i ShBA-së në Jugosllavi në periudhën 1989-1994) etj. Me fjalë të tjera, Berit Backer ka pasur njohje me personalitete të rëndësishme të jetës shoqëroro-politike kudo në botë, veçanërisht në Angli, ku ka pasur edhe një lidhje të traditës familjare, ngaqë gjyshi i saj (babai i nënës së saj), Edvard Christian

Danielsen, ishte (gjatë LDB-së) agjenti i parë norvegjez i shërbimit informativ britanik (Secret Intelligence Service – SIS, gjithashtu i njohur me emrin M16), i cili në mënyrë të suksesshme e udhëhoqi operacionin e rëndësishëm "oldell" të lidhëmbajtjes – informacionit në mes të Norvegjisë dhe Britanisë së Madhe. Më pastaj u emërua admiral i Marinës Norvegjeze dhe është një personalitet i mirënjohur për udhëheqjen e luftës kundër okupimit të vendit nga gjermanët. Gjithashtu, babai i saj, Ole Friele Backer (me profesion fotograf), u detyrua gjatë LDB-së të shpërngulet në Londër, pasi fotografitë e tij për gjendjen e luftës në Norvegji (si pasojë e sulmit gjerman) u publikuan jashtë Norvegjisë. Ai u punësua fotograf në Zyrën e Informacionit të Qeverisë norvegjeze në ekzil në Londër. Kontributi i tij si fotograf (për familjen mbretërore norvegjeze, për aktivitetet e Qeverisë në ekzil, për personelin ushtarak norvegjez, kampet e luftës etj.) bëri që të fitojë publicitet të gjerë, duke iu publikuar fotografitë jo vetëm në Britaninë e Madhe, por edhe në ShBA.

Njëherësh duhet theksuar se sugjerimet dhe këshillat e Berit Backerit lidhur me çështjen e Kosovës u vlerësuan jo vetëm nga qarqe të caktuara politike e diplomatike në Perëndim, por edhe nga ekspertë të fushës si, p. sh., Harry Hodgkinson. Ky i fundit kishte shërbyer si oficer i zbulimit dhe ishte, njëherësh, njohës i mirë i çështjeve ballkanike. Ai kishte vizituar Shqipërinë para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe, pas kthimit në Angli, iu bashkua Shoqatës Anglo-Shqiptare, duke mbajtur një korrespondencë të gjatë me Edith Durham. Shoqata Anglo–Shqiptare kishte mbështetur çështjen

shqiptare që nga viti 1912. Megjithatë, pas Luftës së Dytë Botërore fokusi i saj kryesor ishte fati i emigrantëve shqiptarë të ikur nga regjimi totalitar i Enver Hoxhës. Në vitin 1985 Hodgkinson u emërua kryetar i shoqatës dhe zhvilloi një korrespondencë të rregullt me Berit Backerin. Ai i vlerësonte veçanërisht sugjerimet e saj, ndër to edhe rekomandimin që shoqata të përqendrohej më shumë në situatën e shqiptarëve në Jugosllavi. Në një letër të vitit 1987 drejtuar Backerit, Hodgkinson shprehte respekt të veçantë për të, duke e vlerësuar si një burim të çmuar njohurish dhe mirëkuptimi për çështjen e Kosovës: *"Ishte kënaqësi t'ju takoj te Doreen dhe Anton Logoreci, dhe një privilegj i madh të mund të përfitoj nga dituria juaj e madhe dhe mirëkuptimi për kosovarët. Kam drojë se, duke e shfrytëzuar zemërgjerësinë tuaj, ju kemi stërlodhur me pyetjet dhe spekulimet tona. U treguat shumë e durueshme duke ndërmarrë aty për aty dhe pa parapërgatitje ta realizoni seminarin, me aq dashamirësi dhe përzemërsi. Herën tjetër kur të vizitoni miqtë tuaj në Manor House, ndoshta do të mund të organizojmë një drekë të përbashkët me Antonin, Doreen dhe Ishan Toptanin".*[31]

Për dallim të Kristoffer Gjøtterud, Berit Backer ka krijuar njohje dhe miqësi me shqiptarë shumë më herët. Që nga vitet '70, në kuadër të punës kërkimore social-antropologjike në Kosovë, është njohur me Selim Kuklecin, Ukshin Hotin, Idriz Ajetin, Fehmi Aganin, Mark Krasniqin

[31] Ann Christine Eek: *Berita - the Norwegian Friend of the Albanians*: Introduction of the book; Behind the Stone Walls…: 2003: f. 12 ; Letter from Harry Hodgkinson, London, 22nd of April 1987.

etj. Në këtë vazhdë, më vonë, përveç njohjes me Ibrahim Rugovën dhe Adem Demaçin, gjatë udhëtimeve në Kosovë ka krijuar njohje dhe miqësi edhe me të tjerë si Gazmend Pula, Shkëlzen Maliqi, Avni Spahiu, Zenun Çelaj, Rexhep Qosja, Masar Stavileci etj. Gjithashtu ka krijuar njohje dhe miqësi shumë herët edhe me veteranë të emigracionit politik shqiptar, si Ihsan Toptani, Anton Logoreci etj.

Grupi për Kosovën si sektor në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH), veçanërisht me ndihmën e Berit Backerit dhe Kristoffer Gjøtterudit, ka inkurajuar (para shembjes së murit të Berlinit), dhe ka arritur ta bindë Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit dhe Helsinki Watch Amerikan (Human Rights Watch), që një delegacion i përbashkët të udhëtojë me misionin për ta vëzhguar situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Duke insistuar se te shtetet perëndimore ishte një përshtypje e gabuar për Jugosllavinë, që e dallonin "si më e mira ndër më të këqijat" krahasuar me shtetet e tjera autoritare dhe totalitare në Evropën Lindore. Kjo sidomos kishte të bëjë kur në pyetje ishin të drejtat e njeriut në Kosovë, ku edhe qasja në informata lidhur me gjendjen e këtyre të drejtave ishte më e vështirë krahasuar me zona të tjera në Jugosllavi.

Në dhjetor 1988, në emër të U.S. Helsinki Watch, M. Bernard Aidinoff dhe Kenneth Anderson vizituan Jugosllavinë. Në raportin e tyre ata rekomanduan se *"(...) duke marrë parasysh pengesat për mbledhjen e informatave në Kosovë, si dhe shkeljet e shumta dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut, një delegacion i veçantë i*

*vëzhguesve ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut duhet të lejohet ta hetojë gjendjen".*[32]

Rrjedhimisht, një delegacion i përbërë nga kryetari i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, Karl von Schwarzenberg, nga përfaqësuesi i Helsinki Watch Amerikan, Kenneth Andersson, dhe nga përfaqësuesi i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Kristtoffer Gjøtterud, të drejtuar nga Berit Backer, kanë udhëtuar në të ashtuquajturin first fact - finding mission në Kosovë në shtator 1989 (para shembjes së murit të Berlinit), ndërsa në janar të 1990-s botohet raporti i parë për situatën në Kosovë nga ky delegacion i përbashkët, përkatësisht nga autori Kenneth Andersson, me titull "…Crisis in Kosovo".

Kjo e kishte një rëndësi të veçantë duke e marrë parasysh kontekstin politik të atëhershëm në Kosovë, dhe duke e marrë parasysh se ky raport ishte rezultat i ekspertëve ndërkombëtarë të nivelit të lartë për të drejtat e njeriut, të cilët, nëpërmes këtij raporti, u ofruan sugjerime konkrete vendimmarrësve të politikës së jashtme të ShBA-së, Bashkësisë Evropiane dhe Këshillit të Evropës lidhur me situatën në Kosovë. Madje Helsinki Watch – amerikan (Human Rights Watch), si pjesë e rëndësishme e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, e ka pasur në vazhdimësi që nga fundvitet '70 një rol të rëndësishëm këshillues për politikën e jashtme të ShBA-së, sidomos për delegacionin e ShBA-së në kuadër të KSBE-së, i cili delegacion në periudhën 1986-1989 u udhëhoq nga Warren Zimmermann. Në këtë vazhdë, Zimmermann

[32] A Helsinki Watch Report (1989): *As the Federation Disintegrates: Human Rights in Yugoslavia*, f. 37

shërbeu ambasador i ShBA-së në Jugosllavi, e në vitin 1994 dha dorëheqje në shenjë proteste ndaj hezitimit të presidentit Bill Clinton për të ndërhyrë në luftën e Bosnjës.[33]

Sipas njërës prej mikeve dhe bashkëpunëtoreve më të afërta të Backerit, Ann Christine Eek, raporti "...Crisis in Kosovo", i first fact-finding mission në Kosovë, është: *"në një masë të madhe, i bazuar në informacionin e mbledhur nga Berit Backer".*[34] Në fakt, në këtë raport, me insistimin e Berit Backerit janë aprovuar dy gjëra të rëndësishme këshilluese që të jenë pjesë e këtij raporti. Përkatësisht, vendimmarrësve të politikës së jashtme të ShBA-së u është sugjeruar formalisht kërkesa e hapjes së konsullatës amerikane në Kosovë. Kërkesa për hapjen e konsullatës amerikane në Kosovë ishte edhe e mëhershme (siç është shembulli i iniciativës së Sami Repishtit), por tanimë arsyetohej formalisht si pjesë e një raporti të rëndësishëm të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, përfshirë Helsinki Watch – amerikan dhe Komitetin Norvegjez të Helsinkit. Njëkohësisht në këtë raport i bëhet thirrje Bashkësisë Evropiane dhe Këshillit të Evropës që ta kushtëzojnë çdo integrim të ardhshëm të Jugosllavisë në treg dhe qasje ekonomike me një rikthim të plotë të respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë, dhe potencohet se Bashkësia Evropiane dhe Këshilli i

---

[33] The Guardian (10th of February, 2004): *Warren Zimmermann: Principled US diplomat who resigned in protest at the west's failure to intervene early in former Yugoslavia*: https://amp.theguardian.com/news/2004 /feb/10/guardianobituaries.hellapick

[34] Ann Christine Eek: *Berita - the Norwegian Friend of the Albanians*: Introduction of the book; Behind the Stone Walls…: 2003: f. 12

Evropës kanë detyrimin që t'i kërkojnë Jugosllavisë përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, standarde të cilat ajo është zotuar prej kohësh se do t'i respektojë. Për më tepër në raport thuhet se Bashkësia Evropiane dhe Këshilli i Evropës duhet të fillojnë me kërkesën për llogaridhënie se pse delegacioni i Parlamentit Evropian, i cili ishte dërguar në Kosovë për t'i hetuar zhvillimet në maj të vitit 1989, ishte i detyruar të largohej sepse, siç deklaroi ai vetë, ishte e pamundur të përmbushej mandati i tij. Gjatë kësaj periudhe në Kosovë organizoheshin demonstrata. Madje pikërisht gjatë qëndrimit të delegacionit të sipërcekur të Parlamentit Evropian në Kosovë, ra heroikisht gjatë demonstratës në Llap, veprimtari i shquar i LPK-së, Ali Ajeti, më 30 maj 1989. Kërkesat kryesore në këtë demonstratë ishin "Kosova Republikë" dhe "Europe help!". Në këtë vazhdë ranë heroikisht edhe udhëheqësit emblematikë të LPK-së në Kosovë, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, më 2 nëntor të vitit 1989. Ndërsa bashkëpunëtorët e tyre të ngushtë, Bardhyl Mahmuti, Ramadan Avdiu, Sabri Kiçmari, Jashar Salihu etj., përveçse dhanë kontribut të rëndësishëm në Kosovë, gjithashtu dhanë kontribut të rëndësishëm edhe në kuadër të emigracionit politik shqiptar, sidomos gjatë luftës së UÇK-së, së bashku edhe me të tjerë - si Grupi Diplomatik i UÇK-së.

Në vijim në lidhje me raportin (e sipërcekur/sipërcituar) të delegacionit të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (përfshirë pjesëtarët e Helsinki Watch Amerikan dhe të Komitetit Norvegjez të Helsinkit): Është fotografia e kopertinës së këtij raporti, duke përfshirë një pjesë të

falënderimit për Berit Backerin dhe Kristoffer Gjøtterudin etj., në hyrje të këtij raporti (acknowledgements). Gjithashtu nga një kopje e faqeve 43 dhe 44 (të këtij raporti) ku ofrohen sugjerime konkrete lidhur me situatën në Kosovë për vendimmarrësit e politikës së jashtme të ShBA-së, të Bashkësisë Evropiane dhe të Këshillit e Evropës.






**Acknowledgements**

This report was written by Kenneth Anderson following a mission (the "mission") to Kosovo and other regions of Yugoslavia in September1989. The mission was a joint mission of the U.S. Helsinki Watch, New York City, and the International Helsinki Federation for Human Rights (the "IHF"), Vienna. Members of the mission were Kenneth Anderson, a member of the U.S. Helsinki Watch Committee and an attorney in private practice in New York; Berit Backer, a Norwegian anthropologist with field experience in Kosovo and knowledge of the Albanian language; Kristoffer Gjotterud, a physicist of the University of Oslo, Norway, and a member of the Norwegian Helsinki Committee; Hester Minnema, Program Director of the IHF in Vienna, Austria; and Karl von Schwarzenberg, Chairman of the IHF, Vienna, Austria. Invaluable

## United States And European Community Policies

### United States Foreign Policy

The United States in 1988 appointed a new ambassador to Yugoslavia, Warren Zimmerman, who began his duties in 1989. The Helsinki Watch and the IHF have been pleased with his attention to human rights in Yugoslavia and in Kosovo. Ambassador Zimmerman has visited Kosovo, taking care to speak to persons from all sides of the dispute, despite bitter denunciations from the Belgrade media. He has made it plain that the U.S. is concerned about human rights in Kosovo and, at this time especially, with the treatment of ethnic Albanians.

Despite the increased visibility of human rights in Kosovo on the U.S.-Yugoslavia diplomatic agenda, the Helsinki Watch and the IHF would like to see the issue become still more visible. More attention could be paid to the conflict in Washington, D.C., at the State Department, and more U.S. economic leverage could be brought to bear. What is distinctly not helpful are more U.S. congressional hearings organized by U.S. congressmen who are, in effect, captive to constituencies of either emigre Serbs or emigre Albanians. Rather than hearings aimed to placate constituencies that have become mere propaganda events for one side or the other, it would be useful to have hearings aimed at developing a position designed to protect the human rights of ethnic minorities.

The possibility of opening a U.S. consular office in Pristina in order to raise U.S. visibility there has been mentioned informally on occasion. Although the Helsinki Watch and the IHF recognize the many factors that go into such a decision besides matters of human rights, including budgetary and personnel questions, from the standpoint of human rights in Kosovo it is a useful and constructive idea.

## European Community and Council of Europe Policy

Foreign policy of the European Community obviously has an enormous impact on the behavior of Yugoslavia, because of the proximity of markets, the labor pool, and so on. Moreover, Yugoslavia has made it clear that the only road of its economic salvation lies in greater economic integration with Europe. Yugoslavia has also taken first steps to become a member of the Council of Europe, which has as one of its principal tasks the maintenance and further realization of human rights. This goal, which requires true democratization in Yugoslavia and an acceptance of European norms of the rule of law and human rights, is incompatible with the situation in Kosovo. More important, it is incompatible with the vector of the regime now being created in Kosovo. The situation is getting worse, not better. The abuses which this report addresses generally have occurred within the past year and are the result of a new, authoritarian, racist policy by the government of Serbia.

Accordingly, the Helsinki Watch and the IHF call upon the European Community and the Council of Europe to condition any future integration of market and economic access on a full reversal of the human rights course in Kosovo. The European Community might well begin with a demand for an accounting of why the European Parliamentary Commission, which was sent to Kosovo to investigate matters in May 1989, was forced to leave because, as it stated, it was impossible to fulfill its mandate. The reason it was unable to do its work was that Yugoslav troops had sealed off the hotel in Pristina where the Commission was staying to all but a select group of ethnic Albanians approved by the government. After the Commission withdrew, government police and troops dispersed the crowd with tear gas and truncheons, causing various injuries and arresting many. The European Community and the Council of Europe have an obligation to require Yugoslavia to live up to international standards of human rights, standards which Yugoslavia has long pledged itself to follow.

## ORGANIZIMI I VIZITËS SË PARË TË DELEGACIONIT TË KOSOVËS NË KRYE ME IBRAHIM RUGOVËN NË PERËNDIM, PËRKATËSISHT NË OSLO DHE ME NISJE NGA OSLO, MË 14-18 SHKURT 1990

Në vazhdën e zhvillimit të ngjarjeve në Kosovë pas shembjes së murit të Berlinit (dhe duke marrë parasysh se një ndër pikat kyçe të veprimtarisë në kuadër të "Procesit Civil të Helsinkit" ishte inkurajimi dhe promovimi i forcave opozitare nën regjimet shtypëse), rrjedhimisht koordinatorja e Grupit për Kosovën në Komitetin Norvegjez të Helsinkit (GKKNH-së), Berit Backer me bashkëpunëtorë e organizoi (menjëherë pas themelimit të LDK-së), vizitën e parë zyrtare të delegacionit të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën në Perëndim, përkatësisht në Oslo, me nisje nga Oslo më 14-18 shkurt 1990.[35] Me sugjerim të Berit Backerit dhe Kristoffer Gjøtterudit (që të pasqyrohet pluralizmi politiko-demokratik i Kosovës) ky delegacioni i Kosovës ishte në përbërje nga Ibrahim Rugova, kryetar i partisë Lidhja Demokratike e Kosovës, Shkëlzen Maliqi, kryetar i partisë Social-Demokrate të Kosovës, dhe Nufri Lekaj në cilësinë e përfaqësuesit të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës, të cilët u takuan me disa personalitete të rëndësishme shtetërore dhe kulturore

---

[35] Dokument nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit: "Agjenda e vizitës së parë zyrtare e Ibrahim Rugovës në Perëndim, përkatësisht në Oslo, me nisje nga Oslo më 14-18 shkurt 1990: *Mr. Rugova's and Maliqi's visit in Oslo 14–18.2.90.*"

norvegjeze.[36] Në vazhdën e kësaj vizite të delegacionit të Kosovës në Oslo dhe me nisje nga Oslo, GKKNH, nëpërmes kontakteve që kishte Berit Backer, Kristoffer Gjøtterud etj., ka lobuar që t'i hapen dyert misionarit të paqes Ibrahim Rugovës, nga politikanët perëndimorë, me qëllim të faktorizimit të Kosovës në bashkëveprimin ndërkombëtar.

Madje Berit Backer, paraprakisht më 12. 09. 1989, ishte e pranishme në cilësinë e inkurajueses dhe observatores, gjatë diskutimeve të para në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës, që më pastaj rezultuan me themelimin e LDK-së. Kjo ndodhi konkretisht kur Backer drejtoi vizitën e delegacionit të përbashkët në Kosovë të përfaqësuesve të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, Helsinki Watch Amerikan dhe Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Ky rol inkurajues dhe ndihmues i Berit Backerit ishte një katalizator i rëndësishëm për kyçjen e çështjes së Kosovës për diskutim jo vetëm në kuadër të "Procesit Civil të Helsinkit", përkatësisht në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH-së), por edhe në kuadër të "Procesit Ndërshtetëror të Helsinkit", përkatësisht në kuadër të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian - KSBE-së, si një arenë

[36] Milaim Zeka, "Jetëshkrim i shkurtër i dr. Berit Backerit", *Revista Ekskluzive,* nr. 7 (2000), f. 54: "Berit Backer, kështu u bë e vetmja specialiste në shtetet skandinave që aq mirë e kishte studjuar dhe e njihte mirë Kosovën. Veçanërisht pas vitit 1990, ajo u bë një ambasadore e vërtetë e Kosovës. Në këtë vit, me bashkëpunëtorët shqiptarë, për herë të parë mundi të sillte një delegacion të nivelit të lartë nga Kosova në krye me dr. Ibrahim Rugovën që shoqërohej nga Nufri Leka dhe Shkëlzen Maliqi. Ata u pranuan nga tre ministra norvegjezë dhe personalitete të tjera të larta parlamentare dhe kulturore të Norvegjisë…"

e konferencave ndërkombëtare në mes të Lindjes dhe Perëndimit, e bazuar në Aktin Final të Helsinkit - 1975, që në ndërlidhje me shembjen e murit të Berlinit rezultoi me fitoren e shteteve perëndimore ndaj shteteve totalitare dhe autoritare të lindjes.

Për një orientim më konkret, në vijim është një fragment nga shënimet e Berit Backerit më 12.09.1989, në cilësinë e inkurajueses dhe observatores, gjatë diskutimeve të para në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës, që më pastaj rezultuan me themelimin e LDK-së. Faksimilja e dytë është dokumenti i agjendës që dëshmon se GKKNH, në kuadër të veprimtarisë së vet, pëveç të tjerash, e organizoi edhe vizitën e parë zyrtare të delegacionit të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën në Perëndim, më 14-18 shkurt 1990, përkatësisht në Oslo, me nisje nga Oslo, dhe një foto e shkrepur gjatë kësaj vizite gjatë takimit të hapur me gazetarë dhe të tjerë të pranishëm më 17.02.1990 në Komitetin Norvegjez të Helsinkit (në foto nga e majta: Kristoffer Gjøtterud, Berit Backer, Ibrahim Rugova dhe Shkelzen Maliqi). Dhe më tutje është një shkrim në Gazetën Ekskluzive nr. 7/2000, që përshkruan këtë vizitë të parë zyrtare të delegacionit të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën në Perëndim, përkatësisht në Oslo, me nisje nga Oslo.

Writers Assoc 12/9. 89

- Ali Aliu - litt
Jusuf Buxhovi - jour / poet
Milazim Krasniqi

---

Ali Aliu: Indiv. cases not imp. - but the coll. consequences.
Many const. rights supressed.

FROM 47 2 170753 '90.02.14 12:33

MR.MR. RUGOVA'S AND MALIQI'S VISIT IN OSLO
14 - 18.2.90

WENSDAY, 14.2.90

15.20 - ARRIVAL TO OSLO
16.30 - INTERVIEV IN THE NORWEGIAN RADIO
19.00 - MEETING WITN PEN-CLUB IN NOBEL INSTITUTE, DINNER

THURSDAY, 15.2.90

9.00 - MEETING IN STATE OFFICE FOR FOR ALIENS
11.15 - LECTURE AT OSLO UNIVERSITY ( INST. FOR SLAVIC AND BALTIC LANGUAGES )
13.30 - LUNCH IN PRESS-CENTER
13.45 - INTERVIEV FOR NORWEGIAN TV
14.00 - PRESS - CONFERANCE
15.00 - EVENT. INTERVIEVS
19.30 - DINNER ( INV. BY KRISTOFFER GJØTTERUD AND MICHAELA SPANDOW)

FRIDAY. 16.2.90
9.30 - SEMINAR IN NORWEGIAN INST. OF FOREIGN AFFAIRS
14.00 - MEETING IN MINISTERY OF JUSTICE (RUGOVA )
16.00 - MEETING IN FOREIGN OFFICE ( MALIQI )
14.00 - MEETING WITH REIULF STEEN FROM SOC.DEM. ( ~~[illegible]~~ MALIQI )
16.00 - MEETING WITH NORWEGIAN ADVOCATS ( ~~MALIQI~~ )
19.30 - MEETING WITH WRITERS, DINNER ( INV. BY TORIL BREKKE )

SUTERDAY, 17.2.90
11.00 - DISSCUSION "WHAT CAN BE DONE IN NORWAY FOR KOSOVO"
13.00 - OPEN MEETING IN NORW. HELSINKI COMM.
19.30 - MEETING WITH NORWEGIAN "VIP" (I = INTERWSTING ), DURING DINNER (INV.BY BERIT BACKER)

SUNDAY, 18.2.90

SIGHTSEEING, DISSCUSIONS, LUNCH

17.00 - FLY TO STOCKHOLM



tesë EKSKLUZIVE NR. 7/2000

# Jetëshkrim i shkurtër i Dr. Berit Backer-it




**Backer dhe Demaçi para Komitetit të Helsinkit (1992)**

Dr. Berit Backer u lind në vitin 1947 në qytetin Mandal të Norvegjisë. Ajo kreu studimet në degën Sociologji Antropologji në Universitetin e Bergenit. Studimet e larta universitare i mbaroi në Universitetin e Osllos. Temën për diplomim, magjistrim, specializim dhe doktoranturë e kishte nga kultura shqiptare dhe titullohej: «STRUKTURA E FAMILJES SHQIPTARE». Për ta realizuar këtë temë shkoi në Kosovë dhe gjatë viteve 1974-1976 qëndroi në familjet shqiptare në fshatin Isniq dhe në rrethinën e tij të pasur me lëndë burimore konkrete për interesimin e saj. Antropologia Berit ishte përqëndruar me banim dhe studim në familjen e madhe të Kuklecëve. Aty gjeti dhe studjoi me kujdes të madh strukturën e trashëguar nëpër shekuj të jetës së familjes shqiptare. Ajo u mahnit me format e jetës, punës, qëndrimit dhe raporteve të familjeve të mëdha shqiptare, struktura e së cilave ishte një eveniment i jashtëzakonshëm. Prandaj studimi i saj bëri një jehonë të fuqishme në Universitetin e Osllos. Mjerisht ai studim dhe vlerat e tij ende nuk njihen nga opinionin lexues, madje as nga opinion studiues shqiptar, ashtu siç nuk njihet as edhe Raporti mbi gjendjen e të burgosurve politikë që kjo studiuese e bëri në vitin 1987.

Dr. Berit Backer, kështu u bë e vetmja specialiste në shtetet skandinave që aq mirë e kishte sudjuar dhe e njihte mirë Kosovën. Veçanërisht pas vitit 1990, ajo u bë një ambasadore e vërtetë e Kosovës. Në këtë vit, me bashkëpunëtorët shqiptarë, për herë të parë mundi të sjellë një delegacion të nivelit të lartë nga Kosova në krye me dr. Ibrahim Rugovën që shoqërohej nga Nufri Leka dhe Shkëlzen Maliqi. Ata u pranuan nga tre ministra norvegjezë dhe personalitete të tjera të larta parlamentare dhe kulturore të Norvegjisë. Më vonë, delegacionet që vinin nga Kosova i kishin dyert e hapura në të gjitha rangjet e këtij shteti.

Dr. Berit Backer ftohej, konsultohej dhe i kërkoheshin raporte dhe relacione nga organet qeveritare të Norvegjisë si Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Emigracion dhe asociacionet e ndryshme humanitare e profesionale si Amnesty International, Federata e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut etj., sepse ishte kompetente profesioniste për çështjen e Kosovës.

Jeta e atropologes së shquar Dr. Berit Backer u shua në mënyrë mizore, më 7 mars 1993. Ajo u vra me armë të ftohtë nga një vrasës shqiptar me emrin Malë Lajçi, i cili studionte në Suedi. Atëherë u fol shumë për mundësinë e motivimit politik të vrasjes, si një atentat politik, nxitur nga UDB-ja mbi miken e madhe të shqiptarëve, dr. Berit Backer-in. Gjyqi norvegjez konstatoi se krimineli shqiptar ka vrarë Berit Backerin për motive të ulëta! Vallë a është kjo e vërteta!?

Vrasësi gjendet ende në burg. Ndërsa shqiptarët, Kosova humbi, një ndër përkrahëset konkrete më të spikatura në Evropë, në luftën për liri dhe pavarësi nga Serbia.

SHKRUAR NGA MILAIM ZEKA

## ORGANIZIMI I VIZITËS SË PARË NË PERËNDIM TË DELEGACIONIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS, NË VIJIM TË DEKLARATËS KUSHTETUESE TË 2 KORRIKUT 1990

Grupi për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) ka qenë organizator i programit të vizitës së parë të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Perëndim menjëherë pas Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990. Asokohe, pas Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, pjesa më aktive e delegatëve të Kuvendit të Kosovës u shpërngul në ekzil në Slloveni, ku për vendosjen/akomodimin e tyre u përkujdes Shoqata "Migjeni" në Lubjanë që udhëhiqej nga Sali Kabashi etj. Delegatët zgjodhën Muharem Shabanin, Skënder Skënderin dhe Bujar Gjurgjealen t'i përfaqësojnë si delegacion i Kuvendit të Kosovës në takimet me ndërkombëtarët gjatë vizitave të tyre në shtetet perëndimore. Programin e organizimit të këtyre vizitave e realizoi Grupi për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) në koordinim me komitetet e Helsinkit në shtet perëndimore. Për më tepër, me ndihmën e koordinatorëve të GKKNH-së, Berit Backer dhe Krisoffer Gjøtterud, u realizuan takime në mes të delegacionit të Kuvendit të Kosovës dhe zyrtarëve qeveritarë, parlamentarëve etj., në shtetet perëndimore. Delegacioni i Kuvendit të Kosovës u shoqërua nga Sllovenia nga aktivisti i Shoqatës "Migjeni", Fadil Demiri.

Njëherësh vlen të theksohet se në vigjilje të shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, partitë politike të Kosovës u karakterizuan nga një bashkëpunim i duhur, dhe në mënyrë të koordinuar kontaktonin me

struktura të caktuara jashtë Kosovës, si Komiteti Norvegjez i Helsinkit, duke kërkuar ndihmë për ndërkombëtarizimin - duke përfshirë ardhjen e vëzhguesve nga jashtë me rastin e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese.

Në vijim, si ilustrim për këtë, ca faksimile. Faksimilja e parë është një letër dërguar Nufri Lekës nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë dhe tri parti/subjekte politike nga Kosova (Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Fshatare e Kosovës dhe Parlamenti Rinor i Kosovës, e cila ishte bërthamë e Partisë Parlamentare të Kosovës). Faksimilja e dytë paraqet një letër drejtuar delegacionit të Kuvendit të Kosovës nga Kristoffer Gjøtterud, në cilësinë e nënkryetarit të Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Faksimilja e tretë dhe e katërt është komunikimi i Berit Backerit me Parlamentin Evropian dhe Ministrinë e Jashtme të Britanisë së Madhe. Faksimilja e pestë dhe e gjashtë është komunikimi i Berit Backerit me Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit dhe Helsinki Watch Amerikan. Faksimilja e shtatë është një fragment nga buletini *Kosova-Info* në lidhje me programin e vizitës së delegacionit të Kuvendit të Kosovës në vendet perëndimore ku, përveç të tjerash, thuhet: *"Tre anëtarët e parlamentit të Kosovës janë aktualisht në një turne në Evropë. Filloi më 16 korrik në Austri dhe vazhdoi të Norvegji, Suedi, Danimarkë, Gjermani, Holandë, Britani të Madhe dhe Belgjikë. Ata synojnë të vizitojnë edhe vende të tjera evropiane. Ata janë pritur nga zyrtarë qeveritarë, deputetë, gazetarë dhe OJQ-t, si dhe radio dhe televizionet. Programi është organizuar nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit dhe ata mirëpriten nga Komitetet Kombëtare të*

*Helsinkit në të gjitha vendet ku udhëtojnë. Delegatët kërkojnë mbështetjen evropiane për zgjidhjen e problemeve të Kosovës në mënyrë paqësore, kushtetuese dhe ligjore".*

Buletini i GKKNH-së (*Kosova-Info*) shpërndahej si informacion në kuadrin e "Procesit Civil të Helsinkit" (përkatësisht në kuadrin e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit - FNH-së etj.), dhe në kuadrin e "Procesit Ndërshtetëror të Helsinkit" (përkatësisht delegacioneve të shteteve perëndimore në kuadrin e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian - KSBE-së etj.). Ky buletin shpërndahej gjithashtu nga drejtuesit e LPK-së në Gjermani (Ibrahim Kelmendi, Rexhë Ibërdemaj etj. ), në institucionet përkatëse gjermane. Në fakt, edhe kur GKKNH organizoi vizitën e parë të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në vendet perëndimore, drejtuesit e LPK-së në Gjermani (Ibrahim Kelmendi, Sabri Kiçmari dhe Rexhë Ibërdemaj) e shoqëruan delegacionin në takimet me parlamentarët gjermanë.

Faksimilja e tetë është një artikull i Berit Backerit i botuar në faqen e parë të gazetës zyrtare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, "Appell", numri 3/4 i vitit 1990, në lidhje me vizitën e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në vendet perëndimore dhe përkeqësimin e gjendjes së përgjithshme në Kosovë. Në këtë artikull, me titull "Kosova nën kontroll të plotë policor", ajo informon për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në fund të këtij artikulli sugjeron: *"Është e rëndësishme që autoritetet norvegjeze të adresojnë këto shkelje në forumet ndërkombëtare ku vendi merr pjesë."* Një fotografi që shoqëron këtë shkrim, paraqet delegacionin e

Kuvendit të Kosovës (nga e majta: Skënder Skënderi, Muharrem Shabani, Bujar Gjygjeala, të shoqëruar nga Fadil Demiri), gjatë vizitës së tyre në Shtëpinë Norvegjeze të të Drejtave të Njeriut në Oslo. Vlen të theksohet se disa nga shkrimet për Kosovën në gazetën zyrtare "Appell" të KNH-së përktheheshin në gjuhën angleze dhe shpërndaheshin si informacion në kuadrin e "Procesit Civil të Helsinkit" (përkatësisht në kuadrin e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit - FNH-së etj.), dhe në kuadrin e "Procesit Ndërshtetëror të Helsinkit" (përkatësisht delegacioneve të shteteve perëndimore në kuadrin e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian - KSBE-së etj.).

Faksimilet nëntë dhe dhjetë janë nga numri 3/4 i gazetës "Appell" (redaktuar nga Ole Drolsum). Faksimilja e nëntë thekson se: *"Një delegacion nga Federata Ndërkombëtare e Helsinkit u arrestua në Kosovë në fillim të shtatorit. Delegacioni u mor në pyetje, iu konfiskuan të gjitha dokumentet dhe më pas u vu në arrest shtëpiak në kryeqytetin krahinor, Prishtinë. Ata u dëbuan nga Jugosllavia për 3 vjet. Delegacioni kishte mbledhur informacione mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Gjashtë javë më vonë, sekretari i përgjithshëm i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Bjørn Cato Funnemark, u arrestua në Kosovë."* Faksimilja e dhjetë përfshin emrat e përfaqësuesve të Bordit, Sekretariatit dhe Këshillit të Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Jo vetëm që Bordi dhe Sekretariati përfaqësoheshin nga personalitete me ndikim shoqëror dhe politik, si Stein Ivar Aarsether, Kristoffer Gjøtterud dhe Bjørn Cato Funnemark, por edhe Këshilli i Komitetit Norvegjez të Helsinkit përfaqësohej

nga njerëz me ndikim të madh, përfshirë kryetarin e Këshillit Reiulf Steen, i cili gjatë karrierës së tij politike ka qenë udhëheqës i partisë laburiste norvegjeze në vitet 1975–1981, deputet në vitet 1977–1992 dhe dy herë ministër, si dhe nënkryetarin e Këshillit Jan Petersen, i cili ka qenë udhëheqës i partisë konservatore norvegjeze Høyre; deputet; dhe ministër i Jashtëm. Gjatë kësaj periudhe Jens Stoltenberg, i cili aktualisht deri tash së voni ishte sekretar i përgjithshëm i NATO-s, ishte gjithashtu anëtar i Këshillit të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Pas këtyre faksimileve është edhe përkthimi në gjuhën shqipe i faksimiles së tetë të sipërpërmendur, përkatësisht përkthimi i shkrimit të Berit Backerit.

Empfängeradresse

Nufri Lekaj
Maria Dehlisvei 47/B
N-1084 OSLO 10

(Einsendung)

S.O.S. KOSOVA

With pressure and evident cheat, one year ago Serbia took away from the Assembly of Kosova many vital functiones, causing a massive revolt, bleedshed and terror. Serbia is now preparing a new constitution wich would in fact annul the autonomy of Kosova. At the same time it has undertaken all the measuements to obstruct the work of the Provincial organs, particularlly the Assemby, in order to prevent the expression of the will of the people for the future status of Kosova as well as the articulation of the dissatisfation and the revolt against the violence of the human rigts and of the national rights of Albanians.

The blockage of the work of the Provincial Assembly is being performed in various ways. The delegates are not allowed to discuss the existencial problems of Kosova. The police has been threatening the delegates, even within the locations of the Assemly. They are even threatening with a massacre.

We consider that the eventual arrival of Your observers for the postponed meeting of the Assembly of Kosova which is to be held in 2 July 1990, would be extremely helpful for the information about the real state of work in this Assembly as well as about the blockage of the democratic processes in Kosova.

We look forward to your help!

Prishtina

25.06.1990

The Cuncil for the Defence of Human Rights and Freedoms in Prishtina
The Democratic League of Kosova
The Party of the Peasants of Kosova
The Parlament of the Youth of Kosova

Mr. Muharrem Shabani
Mr. Skender Skenderi
Mr. Bujar Gjurgjeala

Oslo July 15, 1990

Dear Sirs,

With this the Norwegian Helsinki Committee has the pleasure of wishing you, delegates from the Kosovo Parliament, welcome to Norway as one of your first stays on your travel in Europe. We shall be your hosts and accompany you in your talks with Norwegian authorities. We expect you on Wednesday the 18th of July. Please inform us about the time of your arrival.

The Norwegian Helsinki Committee is much concerned about the present situation in Kosovo, in particular about the worksituation for governmental bodies and the Parliament. This is a concern shared by other European institutions as well.

Upon your arrival we hope to have the schedule ready for your continued trip to the following countries:

Denmark
Germany
Great Britain
Hungary
Italy
Netherland
Poland
Sweden
Tschekoslovakia

Besides meeting local Helsinki Committees, you will have talks with foreign ministries and parliamentarians in these countries

Hopefully a meeting with The Council of Europe's reportgroup on Yugoslavia can be arranged as well. They are very much interested in the parliamentary situation in Kosovo.

Yours Sincerely

Christoffer Gjterud
Deputy Chairman

To:
The European Parliament
Brussels Headquarters
Rue Belliard 97-113
B-1040 Brussels
Belgium

Oslo June 26, 1990

**Re: The parliamentary situation in Kosovo**

The following statement has been transferred to me from the undersigned delegates of the People's Assembly of Kosovo with the request to translate it and send it on to the European Parliament.

As can be read it contains a request to the European Parliament for sending observers to the session of the Kosovo People's Assembly at July 2, 1990. The former session was suspended and the chairman of the assembly refused to put on the agenda a proposal for an initiative to draft a new constitution for Kosovo. The delegates question whether the change of the constitution made in June 1989 was lawful, as it was done while there was an emergency situation.

The undersigned is a social anthropologist who happened to meet several Albanian intellectuals from Kosovo at a meeting in Ljublana on June 22 and 23 at which time the suspension of the Assembly's procedures took place. These intellectuals were very worried about the situation, and I share their concern.

Therefor I implore you to take this request seriously and react in some way. It is very important that the legal bodies of Kosovo can work in peace and according to the laws and regulation, otherwise the situation might deteriorate and serious confrontations might occur, more grave than experienced until now.

Please excuse this rather untraditional approach. It is the situation in the Kosovo People's Assembly and the limited time at disposal that causes these procedures. Otherwise the contact person among the undersigned delegates is Muharrem Shabani, who may perhaps be reached through the People's Assembly. His phone and address will be forwarded later.

Yours sincerely

Berit Backer

DEN NORSKE HELSINGFORSKOMITE
Urtegt. 50
0187 Oslo 1, Norway
Phone: 47 2-570070 Fax: 47 2-570088

The Ministry of Foreign Affairs
East European Section
Att: Mr. Charles Grey - Deputy Head
Fax. 4471-2702152

Oslo July 17, 1990

RE. VISIT OF KOSOVO PARLIAMENTARIANS

Dear Mr. Charles Grey,

Thank You for Your kind resons to our request for the Kosovo parliamentarians, Mr. Shabani, Mr. Skenderi and Mr. Gjergjeala to visit the Ministry of Foreign affairs (see enclosed description). The date July 30th, and 31st if necessary, has been reserved for London, and we would suggest for them to see Your section on the morning of the 30th. Hopefully that is suitable for you.

They shall also meet members of human rights organizations as well as members of parliament and the press.

They are much concerned about presenting the problems Kosovo as they have developed lately. Our concern is the importance for this conflict to be chanalized through suitable democratic channels, so that more serious confrontations than have been seen so far will not develop. The development of the human rights situation in Kosovo at present, is worrying.

As you are well informed about the genereal development, we assume that there is no need for further bakcground material. The parliamentarians will bring documentation on recent violations of human rights in Kosovo.

Please respond to the above listed fax number.

Yours sincerely
For the Norwegian Helsinki Committee

Berit Backer

Berit Backer

T E L E F A K S

===========================================

**FRA:** **Berit Backer**
**Balderagt. 1a, 0263 Oslo 2**
**Tel: 02-44 94 47 Fax:02-44 95 79**

**TIL:** The Helsinki Federation
Attention: Christina von Kohl
Fax:(43 222) 48 74 44

**DATO:** 26/6-90

**SIDER TOT.:** 5

**KOMMENTAR:** This is a translation of a fax sent me last night from the delegates of the Kosovo assembly. It explains what has happened and expresses the delegates wish for the arrival of observers on the 2nd of July. It is adressed to the European Parliament and has been passed on to it. But neither I, nor the delegates have any specific name of a person who might take action in some way or other. Can the Helsinki Federation be helpful to pass it on to someone who might take it seriously? It is important that the legal bodies of Kosovo should work normally, otherwise the situation might deteriorate and very serious confrontations may occur, according to my judgement of the present state of affairs. Otherwise the police has requested that another charge should be raised against Cekrija Cana on the grounds of "misinforming the public". He thinks it is due to the fact that he is invited to the USA in July, and that they try to delay returning his passport.

===========================================

T E L E F A K S

===========================================

**FRA:** **Berit Backer**
**Balderagt. 1a, 0263 Oslo 2**
**Tel: 02-44 94 47 Fax:02-44 95 79**

**TIL:** Ken Anderson
Fax: (1 212) 558 3588

**DATO:** June 25, 1990

**SIDER TOT.:** 5

**KOMMENTAR:** This is the translation of the text faxed to me from the

# KOSOVA - info

**Kosova-Info NEWSLETTER**: Information on the Kosova situation
from the Kosova-group of the Norwegian Helsinki Committee
No 2 - July 29, 1990

## "Europe should be concerned"

*- To deprive a people of its civil and political rights never creates stability, says Kosova parliamentarian Dr. Skender Skenderi travelling in Europe with two other Kosova MPs, Muharrem Shabani and Bujar Gjurgjeala.*
*- The totalitarian nature of the Serbian regime, lack of democracy, violations of human rights as well as the explosiveness of the situation should make Europe react. There is am end to Albanian patience.*

**KOSOVA TURNS TO EUROPE**

Kosova Albanians were largely out of communication with the outside world until a year ago. Except for some odd specialists on Albanian language and culture, few knew about the about the province. Ironically Serbia drew the world's attention to Kosova through a massive campaign in 1988-89 against alleged harassments of the Slavic speaking minority in Kosova, some 10 percent of the population.

Today the Albanian Kosovars are actively exercising in diplomatic skills, seeking contact with international organizations and governmental bodies in various countries in order to discuss the tragic situation in the province.

**Parliamentarians travel**

The three members of the Kosova parliament are presently on a tour in Europe. It started in Austria on the 16th of July, and continued to Norway, Sweden, Denmark, Germany, Holland, Great Britain and Belgium. They also intend to visit other European countries. They have been received by government officials, parliamentarians, press and NGOs, as well as radio and television.

The program has been organized by the Norwegian Helsinki Committee, and they are received by national Helsinki committees in all the countries where they travel.

The delegates seek European support for solving the Kosova problems in a peaceful, constitutional and legal way.

**No free elections**

- The situation is very tense and the danger for the outbreak of a civil war is present, says Skender Skenderi in an interview given in Norway. - To deprive a people of all civil and political rights, does not create stability. Albanians have been extremely patient, but there is an end to this patience. When channels of democratic political procedure

################################################################

**Kosova-Info** is a newsletter from the Kosova-group of the Norwegian Helsinki Committee which is published at irregular intervals. It shall bring the inside-Kosova news as a supplement to other news media.
Address: **Kosova-Info** Den Norske Helsingforskomite, P.b. 8261 Hammersborg, 0129 Oslo 1, Norway. Tel: 47 2-570070 Fax: 47 2-570088

# APPELL

Utgitt av Den Norske Helsingforskomité NR. 3/4 1990


# Kosovo under total politikontroll

**Av Berit Backer, DNH**

Situasjonen i Kosovo er blitt drastisk forverret de siste månedene etter at republikken Serbia fratok Kosovo all autonomi den 5.juli 1990. Provinsen er under total politikontroll, og mange frykter hva utviklingen vil ende med. Parlamentarikere, regjeringsmedlemmer og menneskerettighetsaktivister er blitt fengslet. Det er reist siktelse, som kan gi opptil 10 års fengsel mot de andre provinspolitikerne som befinner seg på flukt i ulike andre deler av landet og i utlandet. Den Norske Helsingforskomite har derfor intensivert sitt arbeid for menneskerettigheter i Jugoslavia.

Siden november 1988 er den politiske situasjonen i Kosovo blitt gradvis forverret. Da ble de lokale partitoppene Azem Vllasi og Kaqusha Jashari avsatt, fordi de gjorde motstand mot de forfatningsmessige endringene som skulle komme. Store deler av provinsens befolkning samlet seg i protestmøter i Prishtina.

### Fra masseprotester til unntakstilstand

I mars 1990 gikk gruvearbeiderne i den store Stari Trg-gruven i byen Mitrivica til sultestreik, og det ble opptakten til unntakstilstanden som kun formelt ble opphevet en tid. Kosovo ble beleiret av pansrede kjøretøyer og veltrente styrker med automatgeværer.

Ungdommen demonstrerte våren 1989 og 1990 for autonomi og demokratiske reformer, og man kjenner navnene på omkring 80 som er blitt drept av ulike væpnede styrker i perioden mars 1989 til september 1990. 300 sårede er blitt registrert av ulike menneskerettighetsorganisasjoner som er aktive i provinsen.

Tidligere på åttitallet var det i hovedsak opprørske ungdommer som ble rammet av de politiske paragrafer i den jugoslaviske straffeloven, som gir svært vide fullmakter til å fengsle og dømme opposisjonelle. I prinsippet kan alt fra private samtaler til systematisk organisering gi fengsel i opptil 10-15 år.

Paragrafene har nesten bare vært anvendt mot albanere i Kosovo de siste årene. Nå er imidlertid hele befolkningen rammet av en brutal overmakt fra de serbiske myndigheters side. Serbias politistyrker har helt tatt over kontrollen etter at Serbias parlament opphevet provinsens autonomi 5. juli i år. Etter den tid virker det som om de vil sulte den kosovoalbanske befolkning til underdanighet. Albanerne, som utgjør 90 prosent av innbyggertallet i Kosovo, sies opp i tusenvis. Til i dag har minst 35.000 mistet jobben fordi de på en eller annen måte ikke ville godta de nye makthaverne.

### Leger under angrep

Visse grupper er spesielt rammet. Det gjelder tidligere myndighetspersoner som har støttet kravet om autonomi. Og det gjelder ikke minst medisinsk personale. Den arbeidsplass som ble angrepet tidligst var Universitetssykehuset i provinshovedstaden Prishtina.

### Farlig medisinsk etikk?

I dag er omkring 200 leger sagt opp fra sine stillinger, og 800 sykepleiere og annet medisinsk personale. Spesielt kirurgene har vært angrepet for blant annet å hjelpe demonstranter som ble såret. Partimøter og kommisjoner fra sentralt hold prøvde tidlig å få de aktive avsatt, men hadde ikke noe legalt grunnlag før de spesielle serbiske unntakslovene ble vedtatt. Andre klinikker der alle albanske leger er blitt oppsagt, er gynekologi og indremedisin. Legene ved institutt for folkehelse har også blitt satt ut av funksjon. I disse dager har samme prosess startet på barneklinikken ved at direktøren er blitt avsatt.

Universitetssykehuset var det hospital som kunne ta mer kompliserte og alvorlige sykdommer. De resterende sykestuer og sykehus har altfor dårlig bemanning og utstyr. Resultatet er at befolkningen ikke har skikkelig legetilsyn, ettersom den mangler tillit til de serbiske legene som er blitt igjen.

En teori om grunnen til de harde sanksjoner mot nettopp det mest kompetente medisinske personalet er at de engasjerte seg aktivt da det foregikk noe som kan ha vært en masseforgiftning av albanske skolebarn. Legene var aktive når det gjaldt å yte assistanse til pasientene, og de tok blodprøver som senere skulle analyseres.

Myndighetene var raskt ute med å erklære de mange tusen skolebarns kramper, kvalme og pustebesvær for skuespill og massehysteri. Blodprøvene ble konfiskert av politiet, og inntil resultatene fra internasjonale team som kom til foreligger, vil man ikke ha endelige labaratorieanalyser av hva som har skjedd.

Det uttrykkes imidlertid sterk tvil om den offisielle fortolkningen fra flere utenlandske observatører. At det dreier seg om skuespill utelukker flere. Det er vanskelig å tro at så mange barn på samme tid og på ulike steder skulle koordinere et slikt skuespill. Noen av dem var bare seks år gamle.

### En utfordring til Europa

Både leger og menneskerettighetsaktivister oppfordrer europeiske land til å sende kommisjoner og team til Kosovo for å rapportere om situasjonen. Det er viktig at norske myndigheter tar opp overgrepene i de internasjonale fora der landet deltar.



*Albanske parlamentarikere fra Kosovo på besøk i Det Norske Menneskerettighetshuset.*

**10 års jubileum for Solidaritet**
Landsstyremedlem i Solidaritet, Bogdan Karauda kom til Norge som Helsingforskomiteens gjest, blant annet for å delta i Solidaritets 10 års jubileum. Dette ble feiret i Det Norske Menneskerettighetshuset 31 august. Kunstneren Marek Sobočinski fra Solidaritet Norge-Polen laget en kopi av porten foran Leninveftet i Gdansk slik den så ut for 10 år siden. Karauda hadde under sitt besøk i Norge først og fremst samtaler med representanter for flere fagvegelser.

**Kosovo-albanere risikerer 10 års fengsel**
Medlemmene av det oppløste parlamentet i Kosovo-provinsen i Jugoslavia, Muharrem Shabani og Gjurgjala besøkte Norge i juli. I Jugoslavia idag står de sammen med en tredje parlamentariker Adem Miklocvi tiltalt for å ha «satt Jugoslavias teritorielle integritet i fare». De risikerer for dette opptil 10 års fengsel.

**Helsingforskomiteen arrestert i Kosovo**
En delegasjon fra Den Internasjonale Helsingfors Føderasjonen ble primo september arrestert i Kosovo. Delegasjonen ble avhørt, fikk alle sine papirer konfiskert og ble deretter plassert i husarrest i provinshovedstaden Pristhina. De ble utvist fra Jugoslavia for 3 år. Delegasjonen samlet inn opplysninger menneskerettighetssituasjonen i Kosovo. Seks uker senere ble generalsekretær Bjørn Cato Funnemark fra Den Norske Helsingforskomite arrestert i Kosovo.

**Protest mot Jugoslavia**
D.N.H. protesterer overfor jugoslaviske myndigheter mot arrestasjonen av den Kosovo-albanske fagforeningslederen Hajrullah Gorani (leder for albanernes fagbevegelse). Etter det Helsingforskomiteen erfarer har 15.000 Kosovoalbanere mistet arbeidet bare i løpet av de siste 3 ukene i august mnd. d.å.

**Besøk fra Tsjekkoslovakia**
Lazlo Dobos som er representant i det slovakiske parlament og tidligere medlem av Dubcek-regjeringen besøkte Norge i oktober etter invitasjon fra Den Norske Helsingforskomite.
Dobos er talsmann for den ungarske minoritet i Tjekkoslovakia.

## Den Norske Helsingforskomité i 1990


**Styret**

| | |
|---|---|
| Stein Ivar Aarsæther | – formann |
| Kristoffer Gjøtterud | – viseformann |
| Tor G. Birkeland | – styremedlem |
| Ole Drolsum | – styremedlem |
| Aleksander Gleichgewicht | – styremedlem |
| Ingunn Jordheim | – styremedlem |
| Ellen Juul Andersen | – styremedlem |
| Inge Mannsåker | – styremedlem |
| Sverre H. Smebye | – styremedlem |
| Astrid Øverbye | – styremedlem |

**Sekretariatet**

| | |
|---|---|
| Bjørn Cato Funnemark | – generalsekretær |
| Jaroslaw Pawlak | – organisasjonssekretær |

**Rådet**

Reiulf Steen – formann
Jan Petersen – viseformann
Liv Andersen
Frode Bakken
Bjarte Botnen
Ingeborg Botnen
Andes Bratholm
Bernt Bull
Johan Buttedahl
Kjell Bækkelund
Asbjørn Eide
Grete Faremo
Osmund Faremo
Arne Fjeld
Per-Kristian Foss
Anre Fossum
Dankert Freilem
Aase Gjerdrum
Fredrik Grønningsæter
Knut M. Hansson
Ingvar Helle
Bente Heuch
Johan Hjort
Bjørn Hoelseth
Tora Aasland Houg
Leif Hovelsen
Ragnhild Q. Haarstad
Ottar Julsrud
Michael Konupek
Kåre Kristiansen
Berit Kvæven
Anne Enger Lahnstein
Aase Lionæs
Anette London
Eigil Nansen
Pål-Erik Plaum
Viktor Roddvik
Jon Skard
Marianne B. Skou
Victor Sparre
Jens Stoltenberg
Bjørn Stordrange
Eilif Straume
Ragnar Udjus
Sigrid Utkilen
Leif Vetlesen
Wieslaw Wika-Czarnowski
Svein Wilhelmsen
Jacob Aano



**Ansvarlig utgiver:**
Den Norske Helsingforskomité
Urtegt. 50, 0187 Oslo 1
Postboks 8261 Hammersborg
0129 Oslo 1
Tlf.: (02) 57 00 70
Fax.: (02) 57 00 88

**Redaktør:**
Ole Drolsum

**Sats og paste up:**
A/S Frysja Fotosetteri

**Trykk:**
Spesialtrykk A/S

Në vijim është përkthimi në gjuhën shqipe i faksimiles së tetë, përkatësisht artikullit të Berit Backerit i botuar në faqen e parë të gazetës zyrtare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, "Appell", numri 3/4 i vitit 1990 :

**GAZETA ZYRTARE E KOMITETIT NORVEGJEZ TË HELSINKIT, APEL, NR. 3/4, 1990**

***Publikuar nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit***

**Kosova nën kontrollin total të policisë**

**Nga Berit Backer**

Situata në Kosovë është përkeqësuar në mënyrë drastike në muajt e fundit pasi Republika e Serbisë i hoqi Kosovës plotësisht autonominë më 5 korrik 1990. Krahina Autonome është nën kontrollin total të policisë dhe ka shumë që kanë frikë se çfarë do të ndodhë tutje me parlamentarët, anëtarët e qeverisë dhe aktivistët e të drejtave të njeriut që janë burgosur. Janë ngritur akuza të cilat mund të rezultojnë deri në 10 vjet burg kundër politikanëve dhe të tjerëve që janë në arrati në pjesë të ndryshme të vendit dhe jashtë vendit. Për këtë arsye, Komiteti Norvegjez i Helsinkit ka intensifikuar punën e vet për të drejtat e njeriut në Jugosllavi.

Që nga nëntori i vitit 1988 situata politike në Kosovë gradualisht është përkeqësuar. Më pas u ndërruan kryetarët e partisë vendore Azem Vllasi dhe Kaqusha Jashari, sepse u rezistuan ndryshimeve kushtetuese që do të vinin. Një pjesë e madhe e popullsisë së Krahinës u mblodh në tubime proteste në Prishtinë.

## Nga protestat masive në gjendjen e jashtëzakonshme

Në shkurt-mars 1989 minatorët e minierës së madhe Stan Tërg në qytetin e Mitrovicës hynë në grevë urie e cila ishte prelud i gjendjes së jashtëzakonshme, e cila u hoq vetëm formalisht për një kohë. Kosova u rrethua nga automjete të blinduara dhe forca speciale të armatosura me pushkë automatike.

Rinia demonstroi në pranverën e vitit 1989 dhe 1990 kundër heqjes së autonomisë dhe kërkoi reforma demokratike, dihen emrat e rreth 80 të vrarëve nga forca të ndryshme të armatosura në periudhën mars 1989 deri në shtator 1990. 300 të plagosur janë regjistruar nga organizata të ndryshme të të drejtave të njeriut që veprojnë në krahinë.

Më herët në vitet tetëdhjetë ishin kryesisht të rinjtë e rebeluar ata që prekeshin nga seksionet politike të kodit penal jugosllav të cilat jepnin kompetenca shumë të gjera për të burgosur dhe gjykuar figurat e opozitës. Në parim, çdo gjë nga bisedat private deri tek organizimi politik mund të çojë në burgim deri në 10-15 vjet.

Paragrafët janë aplikuar pothuajse ekskluzivisht për shqiptarët në Kosovë vitet e fundit. Tani e gjithë popullata është e prekur nga forcat brutale të udhëzuara nga ana e autoriteteve serbe. Forcat policore të Serbisë kanë marrë kontrollin e plotë pasi parlamenti i Serbisë i hoqi autonominë krahinës më 5 korrik të këtij viti. Pas kësaj, duket sikur duan krejtësisht të varfërojnë dhe nënshtrojnë popullsinë shqiptare të Kosovës. Shqiptarët, të cilët

përbëjnë 90 për qind të popullsisë së Kosovës, po hiqen nga puna me mijëra. Deri më sot, të paktën 35 000 kanë humbur punën e tyre sepse, në një mënyrë ose në një tjetër, ata nuk donin t'i pranonin pushtetarët e rinj.

**Mjekët nën sulm**

Grupe të caktuara janë veçanërisht të prekura. Kjo vlen për ish-zyrtarët qeveritarë që kanë mbështetur kërkesën për mbrojtjen e autonomisë. Dhe kjo vlen, po ashtu, për personelin mjekësor. Vendet e punës që u sulmuan fillimisht ishte Spitali Universitar në kryeqytetin e Krahinës, Prishtinë.

**Etika mjekësore në rrezik**

Tanimë janë shkarkuar nga pozitat e tyre rreth 200 mjekë dhe 800 infermierë dhe personel tjetër mjekësor. Veçanërisht kirurgët janë sulmuar, përveç të tjerash, se kanë ndihmuar protestuesit e plagosur. Mbledhjet e partisë dhe komisionet nga autoritetet qendrore u përpoqën që herët t'i shkarkonin ata që ishin aktivistë, por nuk kishin bazë ligjore për aplikimin e ligjeve të veçanta serbe. Klinikat e tjera ku janë shkarkuar të gjithë mjekët shqiptarë janë gjinekologjia dhe mjekësia interne. Po ashtu, mjekët në Institutin e Shëndetit Publik janë hequr nga puna. Këto ditë ka nisur i njëjti proces edhe në Klinikën për Fëmijë, me shkarkimin e drejtorit.

Spitali universitar ishte spitali që mund të trajtonte sëmundje më të komplikuara dhe të rënda. Infermieret

dhe spitalet e mbetura kanë shumë pak staf dhe pajisje. Rezultati është se popullata nuk ka mbrojtje të duhur mjekësore, pasi i mungon besimi te mjekët serbë që kanë mbetur.

Një teori për arsyen e sanksioneve të ashpra ndaj personelit mjekësor më kompetent është se ata u përfshinë aktivisht kur ndodhi ajo që duket të jenë helmimet masive të nxënësve shqiptarë. Mjekët ishin aktivë në lidhje me ofrimin e ndihmës për pacientët dhe ata morën mostra gjaku të cilat më vonë do të analizoheshin.

Autoritetet serbe i larguan shpejt nga puna duke deklaruar se mijëra konvulsione, të përziera dhe me vështirësi në frymëmarrje të fëmijëve të shkollës, janë aktrim dhe histeri masive. Mostrat e gjakut janë konfiskuar nga policia dhe derisa të dalin rezultatet nga ekipet ndërkombëtare që kanë mbërritur, nuk do të ketë analiza përfundimtare laboratorike për atë që ka ndodhur.

Njëkohësisht, nga disa vëzhgues të huaj janë shprehur dyshime të forta në lidhje me interpretimin zyrtar. Shumica e tyre e përjashtojnë mundësinë se kemi të bëjmë me aktrim. Është e vështirë të besohet se kaq shumë fëmijë në të njëjtën kohë dhe në vende të ndryshme do të koordinonin një aktrim të tillë. Disa prej tyre ishin vetëm gjashtëvjeçar.

### Një sfidë për Evropën

Si mjekët ashtu edhe aktivistët e të drejtave të njeriut po kërkojnë nga vendet evropiane që të dërgojnë

komisione dhe ekipe në Kosovë për të raportuar për situatën. Është e rëndësishme që autoritetet norvegjeze t'i adresojnë abuzimet në forumet ndërkombëtare në të cilat vendi merr pjesë.

Faksimilja e njëmbëdhjetë në vijim (e përkthyer më poshtë edhe në gjuhën shqipe), është një komunikatë për shtyp e Sekretarit për Informim të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Aleksander Gleichgewicht (njëherësh disident dhe personalitet i shquar i lëvizjes polake 'Solidarnost'). Në këtë komunikatë, menjëherë pas shpalljes së Deklaratës së 2 Korrikut në Kosovë, ripërsëritet qëndrimi i Komitetit Norvegjez të Helsinkit për zgjidhjen paqësore të çështjes së Kosovës dhe i bëhet thirrje e fuqishme shtetit norvegjez që të angazhohet për ndaljen e dhunës së regjimit të Miloševićit në Kosovë.



Den Norske Helsingforskomité 5.7.90
tel. 570070
fax. 570088

PRESSEMELDING

I går, torsdag 5.7.90 slo republikken Serbia tilbake mot Provinsen Kosova som hadde erklært seg republikk på lik linje med de andre republikkene innen federasjonen Jugoslavia. Klokken 16.00 i går slo serbisk pliti til mot Folkeforsamlingen, fjernsyn, radio og albanske aviser. Spesialpolitiet, som varblitt forsterket de siste dagene dagene, overtok mediene og kastet journalister og andre ansatte ut med makt. Nå tilates kun nyheter på serbokroatisk av journalister som er lojale mot partisjefen for Serbia, Slobodan Milosevic og hans regime. Politiet inntok også bygningen til Kosovas Forfatterforening, som hadde vært huvedsete for de nye demokratiske organisasjonene og for Komiteen til Forsvar av Menneskerettigheter og Frihet. Mange ble arrestert.

Den Norske Helsingforskomité gjentar igjen at Kosovoproblemet kan løses bare med fredelige midler og at den politiske striden blir utkjempet innen de legale organene. I dagens situasjon med demokratisering i resten av Øst-Europa, er Serbias reaksjoner overfor Kosova en farlig anakronisme som tilhører andre tider. Den Norske Helsingforskomité ber om at den norske regjering reagerer skarpt mot Serbias voldelige politikk mot Kosovas folk og øverste myndighet.

Aleksander Gleichgewicht
inf. sekretær

Komiteti Norvegjez i Helsinkit 5.7.1990

tel. 570070

fax. 570088

KOMUNIKATË PËR SHTYP

Dje, të enjten, më 5.7.1990, Republika e Serbisë ndërmori masa kundër Provincës së Kosovës, e cila

ishte shpallur republikë në të njëjtin nivel me republikat e tjera brenda federatës së Jugosllavisë. Në orën 16:00, policia serbe ndërhyri kundër Kuvendit Popullor, televizionit, radios dhe gazetave shqiptare. Forcat policore speciale, të cilat ishin përforcuar ditët e fundit, morën kontrollin e mediave dhe me forcë dëbuan gazetarët dhe punonjësit e tjerë. Tani lejohen vetëm lajme në gjuhën serbokroate nga gazetarë që janë lojalë ndaj kryetarit të partisë në Serbi, Slobodan Millosheviç, dhe regjimit të tij. Policia hyri me forcë dhe mori kontrollin e objekteve që shërbenin si seli të organizatave të reja demokratike, përkatësisht të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe të Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Shumë persona u arrestuan.

Komiteti Norvegjez i Helsinkit e ripërsërit se problemi i Kosovës mund të zgjidhet vetëm me mjete paqësore dhe se konflikti politik duhet të trajtohet brenda organeve legale. Në situatën e tanishme të demokratizimit në pjesën tjetër të Evropës Lindore, reagimet e Serbisë ndaj Kosovës përbëjnë një anakronizëm të rrezikshëm, që i përket kohërave të tjera. Komiteti Norvegjez i Helsinkit kërkon që qeveria norvegjeze të reagojë ashpër ndaj politikës së dhunshme të Serbisë kundër popullit të Kosovës dhe udhëheqjes së saj.

Aleksander Gleichgewicht
sekretar informativ

## INKURAJIMI DHE MBËSHTETJA E NGRITJES SË SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË

Grupi për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) inkurajoi dhe mbështeti ngritjen e bërthamës së shoqërisë civile në Kosovë, përkatësisht themelimin e Komitetit Kosovar të Helsinkit nëpërmes bashkëpunimit konkret në mes të Berit Backerit dhe Gazmend Pulës, Po ashtu, mbështeti vazhdimisht veprimtarinë e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, ku Gazmend Pula ishte gjithashtu një nga anëtarët themelues. Ky këshill fillimisht drejtohej nga Bajram Kelmendi, Zekeria Cana, Zenun Qelaj etj. Në këtë vazhdë, përpjekjet e këtij këshilli vetëm sa u shtuan pas lirimit nga burgu të Adem Demaçit, më 21 prill 1990, kur ai mori drejtimin e tij.

Në fakt, themelimi i Këshillit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe i Komitetit Kosovar të Helsinkit - duke përfshirë themelimin e Shoqatës Bamirëse të Kosovës "Nëna Terezë" (1990) dhe organizatës për të drejtat e grave dhe grupeve të margjinalizuara, "Motrat Qiriazi" (1990), ndër të tjera - përveçse e përbënin bërthamën e Shoqërisë Civile në Kosovë, njëkohësisht ndikuan (sidomos në fillim) në afirmimin dhe përkrahjen e rezistencës paqësore në Kosovë, të udhëhequr nga Ibrahim Rugova.

Gjatë kësaj periudhe, përveç Ibrahim Rugovës, edhe aktivistë të tjerë në Kosovë luajtën rol kyç në forcimin e lidhjeve paradiplomatike me vendet perëndimore. Në veçanti, kryetari i Komitetit Kosovar të Helsinkit– Gazmend Pula, dhe anëtarët e këtij komiteti, Shkëlzen

Maliqi, Veton Surroi, Arbër Xhaferi etj. Një nga anëtarët e Komitetit Kosovar të Helsinkit, Muhamedin Kullashi, dha një kontribut të rëndësishëm edhe në kuadër të emigracionit politik shqiptar, pasi që emigroi në Paris ku u përkushtua për ndërkombëtarizimin dhe për sqarimet e duhura në lidhje me çështjen e Kosovës si përmes Komitetit të Kosovës në Paris, po ashtu edhe si profesor i filozofisë në Universitetin Paris 8.

Vlen të theksohet se kryetari i Komitetit Kosovar të Helsinkit përveç se ishte pjesë e delegacionit, njëherësh ishte shoqërues i rëndësishëm i Ibrahim Rugovës gjatë vizitës së parë zyrtare të delegacionit të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën në Kongresin Amerikan në muajin prill 1990. Përkatësisht gjatë vizitës në seancën dëgjimore të Grupit të Kongresit Amerikan për të Drejtat e Njeriut, e mbajtur në Uashington, lidhur me çështjen e Kosovës. Kjo vizitë u organizua nga Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane në krye me Joseph DioGuardin. Në fakt, organizimi i dy vizitave të para dhe historike të delegacioneve të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën (në shkurt 1990 në Oslo, dhe në prill 1990 në Uashington) u hapi rrugë vizitave të tjera gjithandej shteteve perëndimore udhëheqësit karizmatik të lëvizjes paqësore të Kosovës, Ibrahim Rugovës, njëkohësisht ndikuan në ngritjen edhe më të madhe të popullaritetit të tij (dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës në përgjithësi), si në Kosovë ashtu edhe në diasporën shqiptare. Dy kryeorganizatorëve të këtyre dy vizitave, iu ndalua hyrja në Jugosllavi, Berit Backerit iu ndalua hyrja në fillimvitin 1990, ndërsa Joseph DioGuardit iu ndalua hyrja në korrik 1990. Në këtë vazhdë, Grupi për Kosovën i Komitetit

Norvegjez të Helsinkit organizoi një konferencë të përbashkët për shtyp në Komitetin Norvegjez të Helsinkit (si pjesë integrale e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit) për kryetarin e Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, Joseph DioGuardin, dhe sekretarin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, Zekeria Canën, me synimin për ta ndërkombëtarizuar më tej çështjen e Kosovës në kuadër të Procesit të Helsinkit. Kjo konferencë është mbajtur konkretisht më 22 gusht 1990 gjatë vizitës evropiane të DioGuardit dhe gjatë kësaj konference është ngritur për diskutim edhe tema në lidhje me ndalesën për hyrje në Jugosllavi për Berit Backerin dhe Joseph DioGuardin.

Që në vitin 1978 Berit Backeri ishte kontaktuar dhe informuar nga Amnesty International, konkretisht nga shoqja e saj Melanie Anderson, lidhur me një të burgosur politik, përkatësisht Adem Demaçin. Gjatë kësaj kohe Backeri punonte hulumtuese në Institutin Norvegjez të mirënjohur ndërkombëtarisht si PRIO – Peace Research Institute Oslo, duke specializuar në lidhje me shqiptarët në Jugosllavi dhe Shqipëri.[37] Në këtë vazhdë, pas lirimit të Demaçit nga burgu (më 21 prill 1990), Backeri pati një bashkëpunim të ngushtë me Demaçin. Konkretisht që nga takimi i saj i parë personal në Norvegji me Adem Demaçin lidhi miqësi me të. Ata krijuan një konsideratë dhe respekt të ndërsjellë ndaj

[37] Berit Backer, *Peace Research Institute Oslo (PRIO),* "Berit Backer – PRIO," https://www.prio.org/people/5165. "Backer (1947–1993) was a researcher at PRIO from 1978 to 1982, specializing in the study of the Albanian population in Yugoslavia and Albania; in 1979 she earned the degree *Mag. Art.* in Social Antropolog".

njëri-tjetrit, veçanërisht një bashkëpunim substancial në veprimtarinë e tyre për të drejtat e njeriut. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, që shërbente si një bazë e fortë "për njohjen e realitetit në Kosovë" nga ana e diplomacisë perëndimore, e kishte peshën e vet të rëndësishme sepse udhëhiqej nga simboli i rezistencës së shqiptarëve për liri dhe barazi, Adem Demaçi, ndërsa Berit Backeri me diturinë dhe nëpërmes kontakteve të saj kudo në Evropë, ndikoi që ky "realitet" të shpërndahet më thellë në strukturat e pushtetit të shteteve perëndimore. Kjo pati ndikimin e vet të rëndësishëm edhe për kyçjen e drejtpërdrejtë dhe veçanërisht për promovimin e meritueshëm të Adem Demaçit në kuadër të Procesit të Helsinkit, si simbol i të drejtave dhe lirive të njeriut, që rezultoi edhe me mirënjohjen e tij me çmimin Sakharov (1991), dhe me mirënjohje të tjera, përfshirë çmimin Leo Eitinger (1995) etj.

Në vijim faksimilja e parë ilustron rëndësinë e bashkëpunimit të Berit Backerit në fushën e ngritjes së shoqërisë civile në Kosovë. Përkatësisht letra dërguar Backerit ku kërkohet mendimi i saj lidhur me përbërjen e Bordit të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë. Faksimilja e dytë është një ndër dëshmitë në lidhje me mbështetjen dhe bashkëpunimin e duhur në mes të Grupit për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit dhe Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë. Më tutje është një fotografi e Backerit me Demaçin në një nga takimet e punës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Në foton tjetër janë

kryetari i Komitetit Kosovar të Helsinkit, Gazmend Pula, dhe kryetari i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, Adem Demaçi, gjatë një vizite në Komitetin Norvegjez të Helsinkit. Në foton tjetër është kryetari i Komitetit Kosovar të Helsinkit, Gazmend Pula, duke e shoqëruar kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, njëherësh kryesuesin e delegacionit, Ibrahim Rugovën, gjatë vizitës në seancën dëgjimore të Grupit të Kongresit Amerikan për të Drejtat e Njeriut, e mbajtur në Uashington, lidhur me çështjen e Kosovës. Fotoja e katërt është shkrepur gjatë konferencës së përbashkët për shtyp në Komitetin Norvegjez të Helsinkit (si pjesë integrale e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit) për kryetarin e Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, Joseph DioGuardi, dhe sekretarin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë, Zekeria Canën, me synimin për ta ndërkombëtarizuar më tej çështjen e Kosovës në kuadër të Procesit të Helsinkit, duke e ngritur për diskutim edhe temën në lidhje me ndalesën për hyrje në Jugosllavi për Berit Backerin dhe Joseph DioGuardin. Në këtë foto nga e majta janë: Osman Osmani, Joseph DioGuardi, Zekeria Cana, Mehdi Hajdari dhe Nufri Lekaj.

DATE: 27.07.1990
TO: BERIT BACKER
TOTAL PAGES: 1

Lista e individëve
për Këshillin për Mbojtjen e të Drejtave të Njeriut
të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit
me seli në Prishtinë

Ju dërgojmë listën e individëve që këtu mendohet se kan të drejtë morale të jenë në Këshilin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Merita e tyre që të jenë në këtë Këshill qëndron në faktin se atyre u janë shkelur rëndë të drejtat ose njëkohësisht janë marrë me mbrojtjen e të drejtave të tyre.

1. Adem Demaci, shkrimtar
2. Rexhep Qosja, akademik
3. Ekrem Kryeziu, dramaturg dhe regjisor
4. Masar Stavileci, historian i letërsisë
5. Arif Demolli, shkrimtar
6. Zenel Kelmendi, hirurg
7. Gazmend Zajmi, akademik
8. Burhan Kavaja, inxhinier
9. Zymber Neziri, albanolog
10. Avni Spahiu, gazetar

FROM : KMDLNJ-PRISHTINE PHONE NO. : 38 409 P01

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë

KMDLNJ

Council for the Defence of Human Rights and Freedoms in Prishtina

adresa: Xhavit Mitrovica nr 15 39000 Prishtinë-Kosova tel/fax: 038-38-30409

KOMITETIT TË HELSINKUT, Osllo

fax: 9947 22570088

Prishtinë, 6 maj 1993

Të dashur Miq,

Letrën Tuaj të dërguar më 4.05.1993, të nënshkruar nga zoti Nufri Lekaj në lidhje me kërkesën tuaj për lëshimin e një dëshmie nga ana e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, për të hollat në shumë prej 10.000 $ US (dhjetëmijë dollarë amerikanë), të cilat i ka dorëzuar z. Tomas Wacko në muajin prill të vitit 1992, ne Ju njoftojmë me sa vijon:

Në prill të vitit 1992, z. Tomas Wacko i dorëzoi z. Zenun Çelaj, sekretar i Këshillit tonë një shumë të hollash prej 17.000 DM (shtatëmbëdhjetëmijë marka gjermane), të dedikuara për të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë.

Të hollat e përmendura janë shpërndarë gjatë vitit të kaluar, për çka është njoftuar edhe zonj. Guri Rusten me rastin e vizitës në Kosovë, në fillim të këtij viti.

Ne posedojmë me listën e njerëzve të cilëve u janë shpërndarë këto ndihma, të cilën me kërkesën Tuaj mund t'ua dërgojmë në çdo kohë.

Njëherit, Miq të dashur, Ju lutemi T'i pranoni përshëndetjet tona të përzemërta për kujdesin Tuaj ndaj personave të cilët, më shumë se ndihmë materiale këtë e konsiderojnë si përkrahje morale. Ju lusim miqësisht që t'ua përcillni përshëndetjet dhe falënderimet tona të gjithë atyre që kanë marrë mundimin të ndihmojnë njerëzit në nevojë.

Me përshëndetje
Në emër të Këshillit
Sami Kurteshi

Sami Kurteshi






## INKURAJIMI DHE MBËSHTETJA E NGRITJES SË SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

Pas shembjes së murit të Berlinit ndikimi dhe ndihma e Grupit për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) nuk mungoi as për Shqipërinë. Kjo ndihmë u realizua në kuadër të një projekti shtesë të GKKNH-së, i ashtuquajturi projekti Aksioni Norvegji - Shqipëri (ANSh), i mbështetur drejtpërdrejt nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze (MPJN). Ky projekt u udhëhoq nga Berit Backer (përgjegjëse e projektit) dhe nga Nufri Lekaj (koordinator i projektit). Fillimisht, nëpërmes këtij projekti u realizuan ndihmat emergjente nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë për në Shqipëri dhe, në këtë vazhdë, me ndihmën e këtij projekti, u etablua OJQ-ja e parë në Shqipëri, si bërthama e parë nga jashtë për të drejtat e njeriut dhe demokratizim në Shqipëri, përkatësisht Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe për Rehabilitimin e të Përndjekurve Politikë nga Regjimi Totalitar. Në fakt, kjo është OJQ-ja e parë e regjistruar në Shqipëri e cila vazhdoi të funksionojë edhe pas vitit 1994 nën udhëheqjen e Kozara Katit etj. Gjithashtu, nëpërmes këtij projekti (ANSh-së) u ndihmua themelimi i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShN-së) nëpërmes bashkëpunimit konkret në mes të Berit Backerit, Arben Putos, Kujtim Çashkut etj. Madje në kuadër të kësaj veprimtarie Berit Backeri, përveç të tjerash, ndihmoi që Shqipëria të përfaqësohet në takimin e ekspertëve të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE-së). Po ashtu, në kuadër të kësaj

veprimtarie, koordinatori i ANSh-së, Nufri Lekaj, si pjesë e koordinimit të Qendrës për Rehabilitimin e të Burgosurve Politikë në Tiranë me Qendrat Ballkanike, merr iniciativën, në takimin në Greqi në vitin 1993, për etablimin e Qendrës në Kosovë për rehabilitimin e ish-të burgosurve politikë shqiptarë, e cila qendër u jetësua në vitin 1999 nga Feride Rushiti.

Në vijim, në aneks paraqiten disa faksimile si ilustrim. Faksimilja e parë është një shkrim i vitit 2015 nga profesor Shaban Sinani, me titull *"Komiteti Shqiptar i Helsinkit, dallëndyshja e parë e demokracisë në Shqipëri"*, ku, ndër të tjera, theksohet roli i rëndësishëm i Berit Backerit në themelimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit: *"Komiteti Shqiptar i Helsinkit sot kujton e nderon rrugën e vet 25-vjeçare të veprimit si organizatë për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në vend. Ky komitet është organizatë e parë joqeveritare që u krijua në Shqipëri, pikërisht në ditët e para në kapërcyell prej shoqërisë së vigjilencës në shoqërinë e lirive themelore njerëzore(...). Me themelimin e të parës organizatë të të drejtave të njeriut, Shqipëria e asaj kohe, megjithëse ende nuk e kishte nënshkruar Aktin Final të Helsinkit për një Europë të Re, mbi bazën e së cilës do të krijohej OSBE-ja e sotme, do të hidhte një hap historik europianizues të mendimit qytetar. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, qysh në ditët e para gjeti mbështetje dhe solidaritet të menjëhershëm prej veprimtarëve të mirënjohur të të drejtave të njeriut në Europë. Themelimi i tij u përshëndet menjëherë prej agjencive perëndimore të shtypit dhe emisioneve shqip të radiove dhe televizioneve europiane e amerikane, që kishin intensifikuar transmetimet e tyre për zhvillimet në Shqipëri.*

*Homazhi ynë shkon sot tek të gjithë ata që inkurajuan themelimin dhe mëkëmbjen e tij, në mënyrë të veçantë tek aktivistja e njohur, studiuesja, humanistja dhe dashamirësja e shqiptarëve Berit Backer, fundi i së cilës edhe sot mbetet i errët; apo tek veprimtarja e vendosur Christine von Kohl, që me kohë ishte bërë një zëdhënëse e denjë e shqetësimeve të mëdha që kishte kaluar Shqipëria në kushtet e shoqërisë së kontrollit dhe të mosnjohjes së lirive individuale (...). Ka pasur jo pak arritje në veprimtarinë e Komitetit Shqiptar të Helsinkut, por në këtë ditë jubilare le të veçojmë tri ngjarje-shenja të jetës së tij: 1. Kërkesa për lirimin e të dënuarve politikë vetëm një ditë pas themelimit, duke rezultuar zëri më i hershëm i shqiptuar brenda vendit në mbrojtje të kësaj shtrese që ishte privuar nga liritë dhe të drejtat ekzistenciale pikërisht sepse kishte ëndërruar për to; 2. Pjesëmarrja kontribuuese për konceptimin dhe përfshirjen e një kreu thelbësor për të drejtat e njeriut në Dispozitat Themelore, që luajtën rolin e një kushtetute në tranzicionin e parë drejt shoqërisë së demokracisë liberale; 3. Roli i posaçëm për heqjen e dënimit me vdekje. Në të tria këto çështje advokimi i KSHH, në sinkroni me faktorët europianë e ndërkombëtarë, ka qenë më se i rëndësishëm..."*[38].

Vlen të përmendet se gazetarja e sipërcekur, danezo–austriake Christine von Kohl, ka qenë një nga miket dhe kontaktet ndërkombëtare të Berit Backerit. Ajo punoi

[38] Shaban Sinani, "Komiteti Shqiptar i Helsinkit, dallëndyshja e parë e demokracisë në Shqipëri", *Telegraf*, (më 8 dhjetor 2015): https://telegraf.al/opinion/shaban-sinani-komiteti-shqiptar-i-helsinkit-dallendyshja-e-pare-e-demokracise-ne-shqiperi/.

në Vjenë si korrespondente e jashtme dhe në Beograd nga viti 1968 deri në vitin 1985, duke kontribuar për një sërë mediash në mbarë Evropën. Pas kthimit në Vjenë, nga viti 1990 deri në vitin 1994, punoi konsulente për Federatën e Helsinkit dhe themeloi Shoqatën e Refugjatëve dhe të Zhvendosurve nga Bosnjë-Hercegovina në Austri. Gjatë luftërave të Jugosllavisë në vitet 1990, ajo u njoh në mbarë Evropën si një nga gazetaret më të besueshme mbi konfliktet në Ballkan.[39]

Faksimilja e dytë është kopja në lidhje me hapjen e workshopit të parë rajonal më 8-10 dhjetor 2000 në Tiranë (organizuar nga Qendra e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës, në bashkëpunim me Rehabiltation and Research Center for Torture Victims), ku u shprehen fjalët mirënjohëse për Berit Backerin dhe për Nufri Lekën për kontributin e tyre paraprak në lidhje me këtë çështje. Faksimilet tre, katër dhe pesë kanë të bëjnë me iniciativën e Nufri Lekës në takimin në Greqi në vitin 1993, për etablimin e Qendrës në Kosovë për rehabilitimin e ish-të burgosurve politikë shqiptarë, e cila qendër u jetësua në vitin 1999 nga Feride Rushiti. Më tutje është një fotografi e Nufri Lekës, gjatë një fjalimi në vitin 1991, duke u solidarizuar me grevën e ish-të burgosurve dhe të mbijetuarve të torturës në Shqipëri.

Vlen të theksohet se Komiteti Norvegjez i Helsinkit, respektivisht Projekti "Aksioni Norvegji–Shqipëri" (ANSh), përveçse në fushën e të drejtave të njeriut dhe të

---

[39] "Christine von Kohl gestorben. *Ein fast unbemerkter Abgang,*" *Ö1 / ORF,* April 8, 2017, https://oe1.orf.at/artikel/214323/Christine-von-Kohl-gestorben.

asistencës për ish-të përndjekurit nga regjimi totalitar, u angazhua edhe në grumbullimin dhe dërgimin e ndihmës humanitare në një periudhë krize për Shqipërinë. Koordinatori i ANSh-së, Nufri Lekaj, pas një qëndrimi në Shqipëri, në një apel të nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Bjørn Catto Funnemark, drejtuar autoriteteve dhe organizatave norvegjeze, përshkroi situatën socio-ekonomike në Shqipëri dhe kërkoi ndihmë të mëtutjeshme për Shqipërinë. Ky apel u publikua më 21 gusht 1991 edhe në disa medie norvegjeze, ndër të tjera, edhe në gazetën "Vårt Land" ku thuhet: *"Komiteti Norvegjez i Helsinkit u bënë apel si qeverisë norvegjeze ashtu edhe organizatave humanitare që të ofrojnë ndihmë urgjente për Shqipërinë. Komiteti vlerëson se situata është aq e rëndë, sa kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Shqiptarëve u nevojiten, para së gjithash, ushqime dhe barna. (...) Sipas përfaqësuesit të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Nufri Lekaj, i cili kohët e fundit vizitoi Shqipërinë, në mesin e popullsisë vërehet një gjendje paniku. (...) Komiteti Norvegjez i Helsinkit konsideron se ndihma urgjente për Shqipërinë do të përbënte një kontribut aktiv, si për popullsinë shqiptare, ashtu edhe për zhvillimin e demokracisë dhe forcimin e stabilitetit në Ballkan..."*[40]

Në vijim është edhe faksimilja e gjashtë e gazetës "Vårt Land", në të cilën bëhet thirrje për ndihmë ndaj Shqipërisë.

---

[40] Den Norske Helsingforskomité. *"Appell om nødhjelp til Albania."* Nënshkruar nga sekretari i përgjithshëm Bjørn Cato Funnemark. Vårt Land (Oslo), 21 gusht 1991.

Qendra Shqiptare e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës

## WORKSHOPI I -RË RAJONAL

**"Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi"**

Një Perspektivë Rajonale: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

Tiranë
*8-10 Dhjetor, 2000*

*Organizuar nga:*
*Qendra e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës-QSHRMT*

Në bashkëpunim me
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims-RCT



Tiranë

## FJALA E HAPJES NË WORKSHOP-IN E PARË RAJONAL

Të nderuar miq, të ftuar pjesëmarrës në këtë takim pune, mirë se keni ardhur! Në mënyrë të veçantë përshëndesim miqtë tanë të ardhur nga Prishtina dhe Tetova.

Do të doja të hapnim punimet e këtij workshopi duke nderuar viktimat e torturës kudo në botë me një minutë heshtje.

Jemi mbledhur së bashku, këtu në Tiranë, për të shkëmbyer mendime dhe përvoja lidhur me punën tonë fisnike për të lehtësuar dhimbjet e për të rehabilituar të mbijetuarit nga tortura. Në përputhje me nevojat për një punë të përbashkët midis qendrave të Tiranës, Prishtinës, dhe departamentit përkatës në Tetovë, kemi menduar që të koordinojmë punën në mënyrë që të ndihmojmë këtë departament të ngrihet në nivelin e një qendre dhe kësisoj të mund të krijojmë një lidhje koordinuese të bashkëpunimit midis tyre. Ne e kemi emërtuar atë Network-u Rajonal Mbarëshqiptar i Qendrave për Rehabilitimin e të Mbijetuarve nga Tortura. Ndoshta ky emërtim nuk është shumë i goditur dhe nuk i përgjigjet si duhet pikësynimeve tona, por mendoj se nuk është kjo gjëja më kryesore. Ne dëshirojmë të ecim përpara dhe të zhvillohemi nga pikëpamja institucionale, duke rritur kapacitetet në funksion të realizimit sa më të mirë të misionit tonë fisnik.

Jemi të mendimit se e gjithë kjo punë që do të bëjmë së bashku në këtë workshop ështënë logjikën e punës sonë, përfshirë këtu edhe atë në kuadrin e Network-ut Ballkanik si dhe të veprimtarisë ndërkombëtare për të realizuar stabilitetin në gadishullin ballkanik.

Ne shpresojmë që në këtë punë do të kemi mirëkuptimin dhe ndihmën e të gjithë miqve dhe kolegëve tanë, në veçanti të atyre të rrjeteve të Qendrave të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës. Gjithashtu, duam të përshëndesim Z. Nufri Lekaj nga Kosova, një nga ideatorët e këtij bashkëpunimi.

Shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për veprën e Znj. Berit Backer në shërbim të kulturës shqiptare dhe në ndihmë të ish të përndjekurve politikë.

Në emër të Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës, ju falenderoj edhe njëherë për pjesmarrjen tuaj dhe shpallim të hapur këtë workshop dhe i uroj atij punime të mbara!

MEDICAL
REHABILITATION CENTER
FOR TORTURE VICTIMS

***Minutes of BALKAN MEETING at the Medical Rehabilitation Center for Torture Victims***

ATHENS, 13 NOVEMBER 1993

**AGENDA**

1. Presentation of Maria Piniou-Kalli:
Aims - goals and current realities in the wider district.
Discussion - Propositions - Decisions

2. Structure. Election of the network's membership
Election of Executive Secretariat
Election of General Secretary

3. Time of meetings

4. Functioning
Place, Name
Personnel

5. Work to be carried out: Short - term
Long - term

PRESENT: Albania - Kozara Kati
Bulgaria - Evgeni Guentchev
Kroatia - Suzana Kulovic
Kossovo - Nufri Lekaj
Hungary - Lilla Hardi
Maria Frank
Turkey - Zuhal Amato
Turkcan Baykal
Metin Basoglu (as individual researcher residing in London)

LYCABETTOUS STREET, ATHENS - GREECE TEL. [illegible] FAX [illegible]

This Declaration has been adopted in Athens on November 13, 1993 by the following:

| | | |
|---|---|---|
| Maria Piniou-Kalli<br>Medical Director<br>Greece | Veli Lök<br>Turkey | Lilla Hardi<br>Hungary |
| Nufri Lekaj<br>Kossovo (Serbia) | Suzana Kulovic<br>Kroatia | Kozara Kati<br>Albania |
| Evgeni Guentchev<br>Bulgaria | | |

The General Meeting of representatives took the decision to elect a Secretariat which is composed of 3 members and will have a mandate of 3 years.

MEDICAL
REHABILITATION CENTER
FOR TORTURE VICTIMS

Nufri Lekaj
Aksjon Norge Albania
Urlegata 50, N-0187
Oslo

Athens, 8 February 1994

Dear friend,

Enclosed please find the text of the *BALKAN'S DECLARATION* for your signature, as well as the Minutes of the Balkan Meeting.

Please let us know within two days if you have any observations.

In case we do not receive anything within this period we will consider that we have your full agreement.

In any case please return, within two days, dully signed by you a copy of the text of the Declaration and the organizational principles needed in order to present an operational budget to the appropriate authorities on behalf of the Network. (The Network has to look as one entity).

Best regards,

M Kalli

Maria Piniou-Kalli
Medical Director



NORSKE ARGUS
A-S
BYRÅET FOR AVISUTKLIPP
P.B. 1180, SENTRUM - 0107 OSLO 1
TLF. 20 43 75

Utklipp fra

VÅRT LAND
OSLO
Pol. tendens: Uavh. kr.
(Se baksiden!)

21 AUG. 1991

**REPLIKK**

# Appell om nødhjelp til Albania

Den Norske Helsingforskomité appeller både til den norske regjering og til de humanitære hjelpeorganisasjonene om å yde nødhjelp til Albania.

Helsingforskomitén mener at situasjonen er så akutt at øyeblikk hjelp må til. Det er i første rekke mat og medisiner albanerne trenger. . Den dramatiske flyktningesituasjonen vi nå opplever er et resultat av matmangel og ikke politisk undertrykkelse.

Matrasjonene i Albania er svært små: Familier med småbarn har rett til 1 liter melk i uken, 100 gram kaffe pr. måned, 1/2 kg sukker i uken, 2 kg mel i måneden, 100 gram margarin, noe makaroni og 1 kg ris i uken samt et 100 grams såpestykke pr familie – også det ukentlig. Det innvilges ikke noe kjøtt, men derimot 1 kylling pr. familie i uken. Albania har den høyeste befolkningstilveksten i Europa. De fleste familier er barnrike.

Helsingforskomiteens Nufri Lekaj som nettopp har besøkt Albania forteller om panikkstemning blant vanlige folk. Han forteller at det er mulig å kjøpe mat også på det frie arkedet, men at denne er så dyr at de aller fleste ikke har råd til å kjøpe den. Det frie markedet tilbyr noe kjøtt samt paprika og tomater. Lekaj forteller at p.g.a. matmangelen er også tilliten til den nasjonale samlingsregjeringen (av sosialister og demokrater) i ferd med å smuldre opp.

Industriproduksjonen har mer eller mindre gått i stå. Det er stort sett bare elektrisitetsvesenet og renholdsvesenet som er noenlunde intakt. De fleste arbeidere mottar 80% av lønnen sin mot at de melder seg på arbeidet daglig. Det lille som produseres av matvarer, produseres hovedsaklig på de små privateide jordstykkene bøndene fikk anledning til å eie tidligere i år. Helsingforskomiteen mener at nødhjelp til Albania vil være et aktivt bidrag til såvel den albanske befolkning som til demokratiet og stabiliteten på Balkan i tiden framover.

*for den norske helsingforskomiteen*
*Bjørn Cato Funnemark*
*daglig leder*

## KONTEKSTUALIZIMI I VDEKJES TRAGJIKE TË IDEALISTES DHE MIKES SË MADHE NORVEGJEZE TË SHQIPTARËVE, BERIT BACKER

Berit Backer gëzonte respekt dhe besim të madh në radhët e elitës politike shqiptare të Kosovës. Si rrjedhojë, ajo ishte e vetmja këshilltare e huaj që gëzonte autoritet moral dhe profesional të tillë dhe që, njëkohësisht, kishte potencialin të inkurajonte dhe të koordinonte një bashkëpunim të qëndrueshëm ndërmjet dy forcave kryesore politike të shqiptarëve të Kosovës: LPK-së, në krye me udhëheqësin e saj shpirtëror Adem Demaçi, dhe LDK-së, të drejtuar nga Ibrahim Rugova. Në të njëjtën kohë, afrimi ndërmjet LPK-së dhe LDK-së perceptohej nga Shërbimi Shtetëror i Sigurimit Serbo–Jugosllav (UDB) si rrezik serioz, pasi një bashkëpunim i tillë do t'i forconte përpjekjet e shqiptarëve si brenda vendit, po ashtu edhe në kuadër të emigracionit politik për realizimin e aspiratës për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës. Pikërisht kjo ishte arsyeja pse Berit Backerit iu ndalua hyrja në Jugosllavi në shkurt të vitit 1990. Në fakt, Backer, e cila më herët identifikohej kryesisht si bashkëpunëtore e LPK-së, në këtë periudhë u perceptua gjithashtu si një koordinatore e rëndësishme ndërmjet LPK-së dhe LDK-së. Ky perceptim u përforcua pas organizimit të vizitës së parë zyrtare të delegacionit të Kosovës në Perëndim, të kryesuar nga Ibrahim Rugova, përkatësisht në Oslo dhe me nisje nga Oslo, më 14–18 shkurt 1990. Kjo vizitë përkoi me një nga demonstratat e LPK-së në Oslo, më 17 shkurt 1990, gjatë së cilës u rishpreh indinjata ndaj dhunës së ushtruar nga regjimi i

Beogradit kundër shqiptarëve në Jugosllavi dhe u ripërsërit kërkesa politike për Republikën e Kosovës.

Vlen të theksohet se, lidhur me këtë vizitë, një nga anëtarët e delegacionit, Shkëlzen Maliqi, në një intervistë për televizionin *Klan Kosova* më 18 janar 2022, deklaroi se gjatë kësaj vizite kishte vënë re survejimin e UDB-së. Ai shtoi se ai dhe Rugova u ndaluan pas kthimit të tyre nga kjo vizitë në Jugosllavi dhe se marrja në pyetje e Rugovës zgjati më shumë se e vet Maliqit.[41] Rrjedhimisht, qëllimi i këtij veprimi represiv të UDB-së ndaj Rugovës dhe Maliqit duket se kishte për synim pengimin e çdo forme bashkëpunimi të mirëfilltë ndërmjet LPK-së dhe LDK-së, si dhe ndërmjet LPK-së dhe partive të tjera politike shqiptare që u formuan në Kosovë pas rënies së murit të Berlinit. Madje regjimi i Beogradit, edhe pas fillimit të pluralizmit partiak në Kosovë, vazhdoi të mbante qëndrim tejet armiqësor ndaj LPK-së, duke mos e lejuar të vepronte në mënyrë legale në Kosovë, ndryshe nga partitë e tjera shqiptare. Përkundrazi, burgosjet, torturat dhe dënimet e gjata me burg ndaj udhëheqësve, veprimtarëve dhe anëtarëve të LPK-së mbetën një praktikë e qëndrueshme dhe sistematike shtetërore.

Në vijim janë dy faksimile. E para përmban një artikull të botuar në shkurt 1990 nga gazeta serbe *Politika Ekspres*, ku Berit Backeri ishte vënë në shënjestër për aktivitetin e saj në mbështetje të shqiptarëve të Kosovës. Sipas gazetës, Backer mbante lidhje me strukturat e Procesit të Helsinkit dhe, njëkohësisht, me grupet e

[41] Shkëlzen Maliqi, intervistë për televizionin *Klan Kosova*, 18 janar 2022, https://youtu.be/Sbn_tAwjTLc.

lidhura me Adem Demaçin - që në atë periudhë gjendej ende në burg - si dhe me rrethin politik të Ibrahim Rugovës. Faksimilja e dytë paraqet qëndrimin e LPK-së lidhur me demonstratën e mbajtur në Oslo më 17 shkurt 1990, gjatë së cilës u rishpreh indinjata kundër dhunës së ushtruar nga regjimi i Beogradit ndaj shqiptarëve në Jugosllavi dhe u ripërsërit kërkesa politike për Republikën e Kosovës.


на, и са групом професора који су годинама предавали на Универзитету у Приштини, као што су Скендер Ђиђо, Цери Мишига, Пеломб Битри и други. Иначе, за рад ове групе директно је заинтересован албански краљ у избеглиштву Лека први.

Трећа група је група Идриза Ајетија, председника Одбора за заштиту људских права и слобода на Косову, која је повезана са групом косовских интелектуалаца као што су академик Марк Краснићи, академик Фехми Агани, др Јусуф Барјактари, надахнути радом покојног академика Алија Хадрија, чији син др Фљамур Хадри, као и академик Дервиш Рожаја, такође припадају групи. Сигурими се укључује и у рад ове групе, која, на другој страни, хвата везу са групом парламентараца из Хелсинкија, чији је представник био др Берит Беацкер из Осла.

Амбасадор Албаније у Бечу непосредно прати у раду све три ове косовске „алтернативне групе" – тврди наш добро обавештени саговорник.

Према писању „Света", у овом галиматијасу личности је и др Тефик Тефику из Тетова, директор агенције „Форист-милт" за коју се више нико и не пита да ли је страна агенција или агентура.

svet

Politika ekspres 27.02.90


LEVIZJA POPULLORE PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS - LPRK
FOLKBEVEGELSEN FOR KOSOVA REPUBLIKK - FKR
Narodni Pokret za Kosovsku Republiku ☆ Die Volksbewegung für die Republik Kosova
The Peoples Movement for Kosovas Republic ☆ Mouvement Populaire pour la République de Kosova

Utenriksdep.
7. juni pl.
OSLO

Den, 17.02.1990

Folkbevegelsen for Kosova Republikk
v/ N.R.L
Sogn Studentby
P.B 2119
0858 OSLO 8

I dag 17.02.90 demonstrerer vi albanere fra Kosovaprovinsen, Jugoslavia, mot den jugoslaviske (serbisk) regjering som angriper albanere i Jugoslavia både politisk og kulturelt.
Ifjor mistet Kosova sitt selvstyre (med alt hva dette innebærer) og etter den nye grunnloven har albanere blitt en minoritet, på tross av at 90% av befolkningen er albanere.

Den norske regjering protesterer imot situasjonen i Kina, Sovjet, Romania, Israel, o.s.v.
Nå må den norske regjering ta sitt klart standpunkt mot den jugoslaviske (serbiske) regjerings handlemåte av hele Kosovasituasjonen.

I disse dager bruker Beograds regjering spesielle politistyrker, militære helikoptere, stridsvogner, organiserer serbiske sjovenister til demonstrasjoner mot albanere:
"Våpen, Våpen" "Alle albanere i fengsel" "Vi vil ha russere"
"Død Albanere" o.s.v.

Dessverre har mange albanske barn og voksne blitt drept.
-flere hundre har blitt såret.
-flere tusen har blitt fengslet.
-mange har mistet jobben.

Albanere krever: Demokrati, frie valg, flerpartisystem, løslatelse av politiske fanger og republikk for Kosova i jugoslavisk federasjon.

Ifjor sendte Europarådet, USA Kongress, Helsinki Federasjon, Amnesty International og mange andre regjeringer og institutsjoner protester til den jugoslaviske (serbiske) regjering.
AT DE IKKE RESPEKTERER MENNESKERETTIGHETENE SÆRLIG I KOSOVA
Vi ber dere om å gjøre det samme.

Folkbevegelsen for Kosova Republikk

Berit Backeri nuk e ndërpreu kurrë mbështetjen e saj për Kosovën dhe Shqipërinë, të cilat i donte thellësisht, deri në vdekjen tragjike në vitin 1993. Sipas njoftimit zyrtar, ajo u vra nga një person me origjinë shqiptare që vuante nga çrregullime mendore. Megjithatë, që në fillim u ngritën dyshime se pas kësaj vrasjeje mund të fshihej, në një mënyrë ose në një tjetër, UDB-a, e cila më herët ia kishte ndaluar Berit Backerit hyrjen në Jugosllavi dhe, paralelisht, përpiqej të ushtronte ndikim në mesin e shqiptarëve përmes metodave perfide, duke e portretizuar Beritën si spiune dhe antishqiptare. Sipas disa hipotezave që lidhen me këtë ngjarje tragjike, autori i krimit mund të jetë përdorur apo manipuluar, në një mënyrë apo tjetër - qoftë edhe tërthorazi - nga UDB-a për shkak të gjendjes së tij mendore. Në këtë kuptim, ai mund të konsiderohet, deri në një masë të caktuar, edhe si viktimë - i manipuluar në mënyrë të sofistikuar dhe të qëllimshme për ta kryer aktin e vrasjes. Qëllimi i supozuar i UDB-së mendohet të ketë qenë arritja e një efekti të dyfishtë: nga njëra anë, diskreditimi ose dobësimi i aktivitetit të emigracionit politik shqiptar në vendet perëndimore - meqë autori i vrasjes së Backerit ishte me origjinë shqiptare - dhe, nga ana tjetër, pengimi apo kufizimi i mundësisë që çështja e Kosovës të shtrohej për zgjidhje në kuadër të agjendës ndërkombëtare. Duke ndjekur këtë pikëpamje, mospërfshirja e çështjes së Kosovës në agjendën e Konferencës së Dejtonit (1995) mund të shihet si pasojë e drejtpërdrejtë e synimeve të supozuara të UDB-së.

Ashtu siç ka mbetur enigmatike vetë arsyeja e vrasjes së Backerit, po aq enigmatik ka mbetur edhe rasti i

autorit të krimit. Pas lirimit të tij nga qëndrimi në një institucion psikiatrik, ai u shpall person i zhdukur, ndërsa trupi i tij u gjet pas disa vitesh.

Kur vdekja e Backerit kontekstualizohet në kuadrin e vrasjeve dhe tentimvrasjeve të veprimtarëve të emigracionit politik shqiptar gjatë viteve 1980 dhe 1990, të cilat i atribuohen UDB-së, dyshimet vetëm sa thellohen. Raporti i Amnesty International i vitit 1985, që u referohet vrasjeve të udhëheqësve të emigracionit politik shqiptar - përfshirë edhe ato kundër udhëheqësve të emigracionit politik kroat - ndër të tjera theksonte: "*Qarqet e emigracionit kanë deklaruar vazhdimisht se agjentët e Shërbimit të Sigurimit të Shtetit të Jugosllavisë (UDB) kanë qenë përgjegjës për këto vrasje. Autoritetet jugosllave, megjithatë, ia kanë atribuar këto vrasje grupeve rivale të emigracionit. Akuzat për përfshirjen e UDB-së janë mbështetur nga prova të paraqitura në disa raste të trajtuara nga gjykatat jashtë territorit të Jugosllavisë.*"[42]

Me fjalë të tjera, UDB-a jo vetëm që kishte organizuar vrasjen e themeluesve kryesorë të LPK-së: Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, por ishte përfshirë edhe në vrasje të tjera me prapavijë politike, si ajo e Enver Hadrit, si dhe në tentimvrasje ndaj veprimtarëve të tjerë, përfshirë rastet e Xhafer Shatrit dhe Xhavit Halitit, të cilat u pasqyruan në mediet perëndimore. Megjithatë, ka pasur edhe raste të tjera, përfshirë përpjekje të dështuara për atentat, kërcënime serioze për eliminim fizik dhe forma të tjera presioni e

[42] Amnesty International Report (1985): *Yugoslavia: prisoners of conscience.* Printed by Shadowdean Limited, Mitcham, Surrey, f. 8

frikësimi ndaj veprimtarëve të emigracionit politik shqiptar, veçanërisht ndaj veprimtarëve të LPK-së, të cilat nuk u pasqyruan në mediet perëndimore dhe që vetë LPK-ja zgjodhi të mos i bëjë publike në mjetet e saj të informimit. Kjo strategji e vetëpërmbajtjes duket se kishte për qëllim ta shmangte frikësimin dhe dekurajimin e anëtarësisë së gjerë të LPK-së, veçanërisht në lidhje me vazhdimin e përpjekjeve për çlirimin e Kosovës.

Vlen të përmendet se në fund të viteve 1980, në periudhën e përkeqësimit të situatës politike dhe të të drejtave të njeriut në Kosovë, Berit Backeri përgatiti një raport për ministritë e jashtme skandinave dhe institucione të tjera ndërkombëtare me titull *"Politika dhe dënimet në Kosovë"*. Në kuadër të përgatitjes së këtij raporti, Backeri ndërmori një udhëtim në Zvicër me qëllim mbledhjen e të dhënave shtesë. Gjatë këtij udhëtimi ajo u takua me vëllanë e Jusufit dhe Bardhoshit, Hysen Gërvallën, si dhe me disa prej drejtuesve të LPK-së - dega jashtë vendit, ndër ta edhe Mustafë Xhemajlin.[43] Në të njëjtën frymë, Backeri shprehu interesimin për t'u takuar edhe me Xhafer Shatrin, me synimin për të kontribuar në koordinimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së organizatave të emigracionit politik shqiptar, në funksion të ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës. Në atë periudhë Shatri drejtonte Komitetin e Kosovës për Informimin e Opinionit Botëror (KKIOB), i cili kishte rezultuar nga strukturat e LPK-së, ndërsa Berit Backeri ushtronte funksionin e koordinatores për veprimtarinë e ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës ndërmjet

[43] *Revista Ekskluzive*, nr. 7 (2000), f. 52.

Grupit për Kosovën të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH), Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH) dhe strukturave të tjera të përfshira në kuadër të Procesit të Helsinkit. Edhe pse rrethanat e atëhershme - para shembjes së Murit të Berlinit - e bënin të ndërlikuar ndërtimin e bashkëpunimeve të tilla, megjithëkëtë më pastaj pati një lloj bashkëpunimi edhe në mes të KKIOB-it dhe GKKNH-së, kryesisht në fushën e shkëmbimit të informacionit për shkeljet e të drejtave themelore të njeriut në Kosovë. Ndërkaq, njohja e Backerit me Xhavit Halitin kishte ndodhur pak më herët, gjatë periudhës së zgjerimit dhe konsolidimit të veprimtarisë së LPK-së në Norvegji. Njëherësh, vlen të përmendet se, pasi Enver Hadri dhe bashkëpunëtorët e tij inkurajuan një vizitë në Kosovë, në maj të vitit 1989, nga një delegacion i Parlamentit Evropian, me qëllim që të vëzhgonte nga afër gjendjen e të drejtave të njeriut dhe situatën politike në vend, regjimi i Miloševićit ndërmori një sërë pengesash që e pamundësuan realizimin e plotë të mandatit të këtij delegacioni. Kjo situatë pasqyrohet qartë në raportin e Misionit të Parë për Mbledhjen e Fakteve në Kosovë (First Fact-Finding Mission to Kosovo), mision i përbërë nga përfaqësues të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, Helsinki Watch (amerikan) dhe Komitetit Norvegjez të Helsinkit, i drejtuar nga Berit Backer. Në raportin përfundimtar të këtij misioni u bëhet thirrje Bashkësisë Evropiane dhe Këshillit të Evropës që çdo proces i ardhshëm i integrimit të Jugosllavisë në tregun dhe sistemin ekonomik evropian të kushtëzohet me ndryshime thelbësore në qasjen e saj ndaj të drejtave të njeriut, si dhe me përmirësimin e dukshëm të gjendjes

së tyre në Kosovë. Ndër të tjera, raporti thekson: *"Bashkësia Evropiane mund të fillojë me një kërkesë për dhënien e llogarive se pse delegacioni i Parlamentit Evropian, i cili ishte dërguar në Kosovë për të hetuar çështjet në maj të vitit 1989, u detyrua të largohej, pasi – siç deklaroi vetë – ishte e pamundur të përmbushte mandatin e tij. [...] Bashkësia Evropiane dhe Këshilli i Evropës kanë detyrimin t'i kërkojnë Jugosllavisë të respektojë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut — standarde ndaj të cilave Jugosllavia është zotuar prej kohësh."*[44]

UDB-a kishte organizuar vrasje në radhët e emigracionit politik edhe në periudha më të hershme, siç dëshmojnë disa raste të veprimtarëve kroatë. Megjithatë, në kuadër të emigracionit politik shqiptar, këto veprime u shtuan menjëherë pas demonstratave të vitit 1981 - ngjarje që tronditën themelet e shtetit jugosllav dhe shënuan fillimin e një faze të re të rezistencës politike shqiptare. Në këtë periudhë UDB-a përpiqej të mbillte frikë edhe te veprimtarët e emigracionit politik shqiptar me qëllim që të frikësonte dhe dobësonte çdo potencial veprimtarie që solidarizohej ose që mund të promovonte kryekërkesën e demonstratave të vitit 1981: "Republikë, Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë." Fillimisht, goditjet e UDB-së u drejtuan kundër veprimtarëve të cilët, qysh më herët, kishin qenë ndër më të ekspozuarit në kuadër të emigracionit politik shqiptar, me synim që të mbillte frikë te të tjerët. Revista gjermane

[44] Kenneth Anderson: *Yugoslavia: Crisis in Kosovo*, International Helsinki Federation and Human Rights Watch, New York, 1990, f. 44

*Der Spiegel*, në numrin 4 të vitit 1982, raportoi për tentimvrasjen ndaj veprimtarit shqiptar Rasim Zenelaj në Frankfurt, Gjermani, më 14 prill 1981. Ndër të tjera, në raportim sqarohej se, me udhëzimet dhe ndihmën e agjentëve të UDB-së, Svjetozar Mirjačić, Rade Šurla dhe të tjerë, atentatorja Zorica Aleksić tentoi të arratisej, por u kap nga policia gjermane në aeroportin e Frankfurtit. Nën ndikimin e propagandës së UDB-së u përhapën zëra se rasti kishte të bënte me një histori dashurie të dështuar. Megjithatë, hezitimi fillestar i atentatores për të folur hasi në vendosmërinë e ekipit hetimor gjerman, dhe ajo përfundimisht pranoi se kishte kryer atentatin me urdhër të UDB-së. Për këtë arsye, ajo u dënua me shtatë vjet burg. Zenelaj mbeti rëndë i plagosur dhe përfundoi në karrocë invalidi.[45]

Në tetor 1981 gazeta belge *Le Soir* raportonte për vrasjen e veprimtarit shqiptar Vehbi Ibrahimi në Bruksel më 10 tetor 1981, me titullin domethënës "... Kush është i radhës?".[46] Ibrahimi humbi jetën në vendngjarje, ndërsa bashkëshortja e tij mbeti rëndë e plagosur. Autori i vrasjes nuk është identifikuar dhe as arrestuar ndonjëherë. Sipas disa burimeve dhe hetimeve të mëvonshme të pavarura, gjatë viteve 1980 UDB-a filloi të organizonte vrasje politike jashtë vendit në mënyrë gjithnjë e më profesionale, me qëllim shmangien e zbulimit të autorëve. Kjo përfshinte, ndër të tjera, rekrutimin e elementeve kriminale serbe që vepronin në

---

[45] *Der Spiegel,* "Die mörderische Zärtlichkeit der dunkelhaarigen Zorica," nr. 4 (1982)

[46] *Le Soir,* "Le Chabanais Albanais – À qui le tour ?", tetor 1981

vendet e Evropës Perëndimore, veçanërisht në Gjermani, Belgjikë dhe Skandinavi, gjatë viteve 1970 dhe 1980. Ndër figurat më të njohura të këtij rrjeti përmenden: Ljubomir Magaš (Zemunac), Željko Ražnatović (Arkan), Rade Ćaldović (Čenta), Dragan Joksović (Jokso), Veselin Vukotić, Andrija Drašković, Darko Ašanin, Ranko Grgić, Miroslav Paravinja, deri te Milorad Ulemek (Legija). Ky i fundit është përmendur gjithashtu në disa raportime mediatike si person që mund të ketë qenë i përfshirë, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, në vrasjen e prezantueses dhe gazetares britanike Jill Dando, e cila u gjet e vrarë para banesës së saj në Fulham, Londër, më 26 prill 1999. Për vite me radhë kanë ekzistuar dyshime se ajo ishte shënjestruar nga një vrasës profesionist, ndoshta si hakmarrje për përfshirjen e saj në një apel të BBC-së në mbështetje të refugjatëve shqiptarë gjatë Luftës së Kosovës (1998–1999). Më 25 prill 2025, disa medie britanike, përfshirë *London Broadcasting Company* (LBC), raportuan se, sipas dëshmive të reja të dëshmitarëve okularë, Ulemek ishte identifikuar ose si autor i mundshëm i krimit, ose si person i lidhur ngushtë me vrasjen e Dandos.[47] Rasti i Jill Dandos mund të interpretohet si pjesë e një strategjie më të gjerë të shërbimit të sigurimit shtetëror serb, e cila synonte frikësimin e gazetarëve të huaj me ndikim që raportonin për krizën humanitare në Kosovë dhe kërkonin veprim ndërkombëtar kundër regjimit të

[47] "New Clues Unveiled in Mysterious Jill Dando Murder Case as Second Witness Links 'Serbian Assassin' to TV Star's Death," LBC, April 25, 2025, https://www.lbc.co.uk/article/new-clues-unveiled-mysterious-jill-dando-murder-case-serbian-assassin-5Hjd5nD_2/.

Miloševićit. Ulemek, i dënuar më pas për vrasjen e kryeministrit serb Zoran Gjingjić më 12 mars 2003, përfaqëson një hallkë të rëndësishme në ndërthurjen midis krimit të organizuar dhe strukturave të shërbimit shtetëror në Serbi, gjatë dhe pas periudhës së Luftës së Kosovës.

Dhjetë vjet pas vrasjes së Berit Backerit u vra ministrja suedeze e Punëve të Jashtme, Anna Lindh. Ajo u godit me thikë nga Mijailo Mijailović në qendrën tregtare NK në qendër të Stokholmit, më 10 shtator 2003, e vdiq të nesërmen në Spitalin Universitar Karolinska. Vrasësi kishte lindur në Stokholm, Suedi, më 6 dhjetor 1978, nga prindër serbë. Në një kronikë të vitit 2023, lidhur me vrasjen e Anna Lindhit, Ann-Sofie Dahl - docente e politikës ndërkombëtare, bashkëpunëtore e lartë jorezidente në Atlantic Council, eksperte për ShBA-në dhe NATO-n, e cila, së bashku me Henrik Landerholm, themeloi Komitetin Atlantik Suedez në vitin 1996, shkroi, ndër të tjera, se: *"Përshkrimi i vrasjes së Anna Lindhit si një akt çmendurie, i kryer nga një person i izoluar me probleme mendore, ka dominuar për 20 vjet. Por ky shpjegim e anashkalon motivin politik të vrasjes - faktin që Anna Lindh kishte shprehur mbështetjen e saj për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë. [...] Vrasja e Anna Lindh-it në vitin 2003 përshkruhet zakonisht si një akt çmendurie, por kjo qasje shpërfill kontekstin politik. [...] Sulmi i Mijailović-it ndaj saj ndodhi vetëm disa vite pasi ajo kishte dhënë mbështetjen për bombardimet e NATO-s në Kosovë, në pranverën e vitit 1999. Ashtu si shefi i saj, kryeministri Göran Persson, ajo e kuptoi se duhej vënë një kufi ndaj ambicieve të neveritshme serbe*

*për spastrime etnike në Kosovë. [...] Mbështetja e saj dhe përkrahja suedeze për operacionin e NATO-s në Kosovë ishte një veprim i guximshëm dhe moralisht i drejtë nga ana e Anna Lindh-it. Por, me shumë gjasë, kjo mbështetje i kushtoi asaj jetën"*.[48]

Rrjedhimisht, nuk mund të përjashtohet mundësia që shërbimi sekret shtetëror serb të ketë qëndruar pas vrasjes së Anna Lindhit, në kuptimin që vrasësi mund të ketë qenë rekrutuar ose nxitur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga ky shërbim për ta vrarë atë. Me fjalë të tjera, nga njëra anë, vrasësi mund të ketë marrë udhëzime nga shërbimi sekret serb për ta simuluar rolin e një personi me probleme mendore dhe më pas të kryente vrasjen, duke qenë se në Skandinavi kriteret për shpalljen e dikujt me sëmundje mendore janë më të ulëta, ndërsa dënimet për personat e tillë janë më të lehta se në vende të tjera. Nga ana tjetër, është e mundur që vrasësi të ketë qenë realisht me probleme mendore, por shërbimi sekret serb ta ketë nxitur dhe manipuluar në mënyrë perfide për ta vrarë Lindhin. Pavarësisht nga mënyra se si mund të ketë ndikuar shërbimi sekret serb, qëllimi i supozuar i tij mendohet të ketë qenë frikësimi i politikanëve të tjerë perëndimorë, duke u dhënë atyre sinjale se edhe ata mund të përballeshin me vrasje arbitrare në publik, nëse mbështesnin rrugën e pavarësisë së Kosovës në të ardhmen.

Një shembull i rëndësishëm në këtë drejtim është angazhimi i qeverisë suedeze, kryesuar nga kryeministri

---

[48] Ann-Sofie Dahl, "Anna Lindhs mördare hade politiskt motiv," *Smedjan,* 9 oktober 2023, Timbro, https://timbro.se/smedjan/anna-lindhs-mordare-hade-politiskt-motiv/.

Göran Persson (1996–2006) dhe ministrja e Jashtme Anna Lindh (1998–2003), për themelimin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, me qëllim vlerësimin e situatës dhe propozimin e zgjidhjeve për statusin e ardhshëm të saj. Ata shprehën shqetësim të thellë për mungesën e një analize të pavarur mbi konfliktin e Kosovës dhe u angazhuan në mënyrë aktive për të nxjerrë mësime nga ky konflikt. Më 23 tetor 2000, Komisioni Ndërkombëtar për Kosovën i paraqiti raportin e vet sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Kofi Annan, në Nju-Jork. Në këtë raport Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar ndriçoi shumë nga faktorët e krizës së Kosovës dhe arriti në përfundimin se rruga më e qëndrueshme për të ardhmen e rajonit ishte pavarësia e mbikëqyrur - një zgjidhje në të cilën bashkësia ndërkombëtare do ta merrte përgjegjësinë për garantimin e sigurisë fillestare, mbikëqyrjen e mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe lehtësimin e integrimit të Kosovës në një pakt stabiliteti efektiv.[49]

Në fakt, megjithëse Suedia s'ishte anëtare e NATO-s deri në vitin 2024, ajo e mbështeti në mënyrë aktive përpjekjen për të arritur dhe konsoliduar paqen në Kosovë. Veçanërisht përmes këtij raporti të besueshëm ndërkombëtar u konsiderua për herë të parë se rruga e Kosovës drejt pavarësisë ishte një proces legjitim. Ka të ngjarë që ky të ketë qenë motivi kryesor pas hakmarrjes

---

[49] *The Independent International Commission on Kosovo,* The Kosovo Report, October 23, 2000, https://reliefweb.int/report/albania/kosovo-report, https://reliefweb.int/attachments/784047f3-501d-3af1-a1a9-31498003d4a5/6D26FF88119644CFC1256989005CD392-thekosovoreport.pdf.

së regjimit serb ndaj Lindhit për të dërguar një paralajmërim të heshtur ndaj politikanëve të tjerë perëndimorë se kushdo që mbështeste pavarësinë e Kosovës mund të përballej me vrasje arbitrare publike, si ajo e Lindhit.

Në vijim, në faqen tjetër, është faksimilja e shkrimit të sipërcituar të Ann-Sofie Dahlit, të botuar në *Smedjan*, e cila është revista e *think tank*-ut Timbro, një platformë gazetarie opinion-formuese me orientim liberal.

SAMHÄLLE | KRÖNIKA

# Anna Lindhs mördare hade politiskt motiv

Beskrivningen av mordet på Anna Lindh som ett vansinnesdåd, utfört av en psykiskt störd enstöring, har varit rådande i 20 år. Men förklaringen bortser från mordets politiska motiv: att Anna Lindh uttalat sitt stöd för Nato:s intervention i Kosovo, skriver Ann-Sofie Dahl.

ANN-SOFIE DAHL | [illegible] OKTOBER 2023




Tjugo år efter mordet på Anna Lindh saknas fortfarande svaret på den allra mest centrala frågan: varför?

I de många minnesreportagen vid årsdagen den 11 september – detta ödesdigra datum – var motivet till Mijailo Mijailovics brutala överfall på utrikesministern ännu en gång påfallande vagt och oklart.

I alla dessa år har antagandet att det skulle handla om ett ospecificerat hat mot det svenska samhället rakt av accepterats, utan minsta analys eller ifrågasättande.

Omväxlande med och omväxlande utan hänvisning till de omtalade rösterna i Mijailovics huvud som skulle ha befallt honom att attackera den livvaktslösa utrikesministern mitt bland klädställningarna på NK en septemberdag för två decennier sedan.

***I alla dessa år har antagandet att det skulle handla om ett ospecificerat hat mot det svenska samhället rakt av accepterats.***

Att det aldrig har gjorts några försök att gräva djupare i motivfrågan, och att något slags allmänt hat mot svenska samhället utan vidare har godtagits som förklaring, är minst sagt anmärkningsvärt.

Inte minst som det faktiskt var landets utrikesminister det handlar om – och en förövare som har sitt ursprung på Balkan, som just hade slitits sönder av krig på kors och tvärs över nationsgränserna. Och där Anna Lindh dessutom klart hade tagit ställning mot sin framtida mördares hemland.

Det borde ha fått en och annan klocka att ringa hos både media och rättsväsendet.

Annat var det efter mordet på Olof Palme, där man tvunget har velat få det till att det låg en stor internationell konspiration bakom dådet. Än i dag är det uppenbart svårt för socialdemokratin att acceptera att Palmes baneman skulle kunna vara något så simpelt som en lodis, utan minsta koppling till statsministerns många uppdrag i "världsfredens" tjänst.

Med mordet på Anna Lindh är det precis tvärtom; här skall det till varje pris handla om en psykiskt störd enstöring som håller i den dödande kniven. Några motiv som kan kopplas samman med hennes gärning som utrikesminister har aldrig någonsin berörts, mer än i någon enstaka debattartikel.

* * *

Anna Lindh var förvisso långt ifrån lika kontroversiell som Olof Palme. Men det fanns en fråga där hennes agerande väckte särskilt starka känslor, och det var just ovan nämnda Balkan.

Mijailovics attack på Anna Lindh ägde ju rum bara några år efter att hon hade gett sitt stöd till Natos bombningar av Kosovo våren 1999. Liksom sin chef, statsminister Göran Persson, insåg hon att det måste sättas stopp för de avskyvärda serbiska ambitionerna på etnisk utrensning i Kosovo.

Och för att kunna göra det var det nödvändigt att kringgå det av socialdemokrater vanligtvis så omhuldade FN, där serbernas vänner i Ryssland blockerade varje försök till handling.

***Den enda organisation som militärt kunde få stopp på de serbiska utrensningsplanerna var Nato, förklarade Anna Lindh.***

Den enda organisation som militärt kunde få stopp på de serbiska utrensningsplanerna var Nato. Det förklarade Anna Lindh i riksdagens frågestund (29/4 -99) för sina upprörda partivänner, för vilka Nato utgjorde ett mycket rött skynke.

Desto populärare blev Nato hos landets albanska invandrare – medan det på serbiskt håll utbröt våldsamma demonstrationer mot såväl Nato som svensk politik, med regelrätta slagsmål mitt i Malmö mellan serber och albaner.

Till sina vänner lär Mijailo Mijailovic, enligt vittnesuppgifter under rättegången, ha sagt att om han någonsin fick en chans så skulle han döda Anna Lindh, den svenska utrikesminister som stödde Nato-bombningarna mot hans serbiska hemland.

Den chansen uppenbarade sig en solig höstdag 2003.

Att ge sitt stöd och svensk uppbackning till Natos *Operation Allied Force* i Kosovo var modigt av Anna Lindh, och det var moraliskt rätt.

Men det kostade henne sannolikt livet.

ANN-SOFIE DAHL
*Ann-Sofie Dahl är docent i internationell politik, Nonresident Senior Fellow vid Atlantic Council (US) och Nato-expert. Tillsammans med Henrik Landerholm grundade hon Svenska Atlantkommittén 1996.*

Vrasja e Berit Backerit ishte një goditje e rëndë dhe një tronditje e thellë për bashkëpunëtorët e Beritës si në Norvegji ashtu edhe jashtë saj për të gjithë ata që e njihnin nga afër dhe ishin të vetëdijshëm për rolin e saj të rëndësishëm, edhe për shumë shqiptarë që, ndonëse nuk e njihnin personalisht, ishin në dijeni - në një mënyrë apo në një tjetër - për rëndësinë e veprimtarisë së saj në mbështetje të shqiptarëve gjatë viteve '80 dhe në fillim të viteve '90. Me fjalë të tjera, kjo vrasje ishte e rëndë jo vetëm sepse shkelte traditën shqiptare (vrasje e një gruaje), por edhe sepse shqiptarët humbën një mike idealiste, të përkushtuar dhe të rëndësishme për Kosovën dhe Shqipërinë. Për më tepër, vrasja e saj përbënte një atentat të qëllimshëm ndaj çështjes shqiptare në opinionin evropian, në kuptimin që propaganda e UDB-së përpiqej në mënyrë të sofistikuar ta përdorte këtë ngjarje për ta krijuar përshtypjen tek opinioni i huaj se "shqiptarët i shpërblejnë" në këtë mënyrë miqtë e tyre. Edhe pse kjo vrasje mizore pati pasoja të pashmangshme për imazhin e shqiptarëve, rëndësi të veçantë pati fakti që shqiptarët reaguan me dinjitet, duke marrë pjesë masivisht në varrimin e Berit Backerit, veçanërisht pjesëtarët e mërgatës shqiptare në Norvegji.

Në mesin e shumë bashkëpunëtorëve të Beritës në Norvegji dhe jashtë saj që morën pjesë në varrimin e saj (dhe të tjerëve që dërguan telegrame ngushëllimi), ishin edhe bashkëpunëtorët e saj të ngushtë nga Kosova, Adem Demaçi dhe Gazmend Pula, si dhe Ibrahim Kelmendi në cilësinë e përfaqësuesit të LPK-së. I pranishëm ishte edhe ambasadori i Shqipërisë në Suedi, Bardhyl Kokalari, ndërsa presidenti Sali Berisha dërgoi

telegram ngushëllimi. Presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova, kërkoi përmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit që në mediet norvegjeze të bëhej një deklaratë në emrin e tij për të shprehur publikisht ngushëllimet e tij për popullin norvegjez.

Në mesin e telegrameve dhe shkrimeve me rastin e vdekjes tragjike të Berit Backerit, drejtoresha e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, Yadja Zeltman, në telegramin e ngushëllimit të datës 9 mars 1993, ndër të tjera, shkruante: *"Puna dhe përkushtimi i saj i paepur për shqiptarët inkurajoi për një kuptueshmëri më të madhe për nevojat e domosdoshme të shqiptarëve, veçanërisht në Kosovë, dhe nevojën për një përfshirje më të madhe të bashkësisë ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të tyre themelore të njeriut".*[50] Ndërkaq, një ndër miqtë e afërt të Berit Backerit, ambasadori i Suedisë në Jugosllavi dhe Shqipëri gjatë viteve 1987–1992, Jan af Sillén, në shkrimin e tij në gazetën norvegjeze *Aftenposten*, me rastin e vdekjes tragjike të Backerit, shprehej: *"Me pikëllim të thellë unë dhe zonja ime morëm lajmin për vrasjen e Berit Backerit nga një shqiptar i Kosovës. Askush në shtetet nordike nuk ka bërë më shumë se Berit Backeri për ta njohur dhe sqaruar situatën e shqiptarëve. Ajo ishte një shkencëtare shumë kompetente për popullin shqiptar dhe vrojtuese e mirinformuar dhe objektive e situatës në Ballkan, posaçërisht në Shqipëri dhe Kosovë. Unë e kam takuar shumë herë këto vitet e fundit në rrugën e saj për në Shqipëri dhe shpesh kam pasur mundësinë të*

[50] Ann Christine Eek (2003): *Berita - the Norwegian Friend of the Albanians*, parathënie në librin *Behind the Stone Walls…*, f. 7.

*përfitoj nga njohuritë e saj të thella për gjendjen politike dhe ekonomike atje. Gjithashtu, nganjëherë më ka rastisur t'i lexoj edhe analizat interesante të saj. Për mua, zonjën time dhe kolegët e tjerë të cilët ishim në kontakt me të, ajo ishte një person i mrekullueshëm, e guximshme, e shkathtë, e hapur, miqësore. Me vdekjen e Berit Backerit shtetet nordike kanë humbur një observatore të situatës së shqiptarëve të cilën nuk ka kush ta zëvendësojë. Ajo iku kur më shumë se kurrë nevojiteshin njohuritë e saj. Mendimet tona shkojnë te të gjithë ata të cilët ishin të afërt me Berit Backerin dhe te shumë shqiptarë në Shqipëri dhe Kosovë të cilët i ka prekur vdekja e saj tragjike dhe i ka kapluar zija për humbjen e një mike dhe përkrahëse të pashoqe".*[51]

Njëherësh, Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) bëri një deklaratë publike, duke e dënuar vrasjen e Berit Backerit dhe duke i ftuar pjesëtarët e mërgatës shqiptare të merrnin pjesë sa më masivisht në varrimin e saj.

Në vijim janë katër faksimile. Faksimilja e parë përmban artikullin e ish-ambasadorit të Suedisë në Jugosllavi dhe Shqipëri gjatë viteve 1987–1992, Jan af Sillén, botuar në gazetën norvegjeze Aftenposten, me rastin e vrasjes së Berit Backerit – shkrim i cituar më sipër në tekst. Në fotografinë që shoqëron artikullin, duke e bartur arkivolin e Berit Backerit, shihen: Adem Demaçi, Gazmend Pula, Nufri Lekaj, Shkëlzen Kukleci, Qani Dehari dhe Musa Ramadani. Faksimilja e dytë është deklarata

[51] Jan af Sillén, "Berit Backer," *Aftenposten,* 18 mars 1993. Autori i shkrimit në gazetën *Aftenposten* ka shërbyer si ambasador i Suedisë në Jugosllavi dhe Shqipëri në periudhën 1987-1992.

publike e LPK-së me rastin e vrasjes së Berit Backerit. Faksimilja e tretë paraqet fjalimin prekës të Adem Demaçit, të mbajtur në ceremoninë mortore në nderim të Berit Backerit.[52] Faksimilja e katërt përfshin përkthimin në shqip të artikullit të botuar në gazetën norvegjeze Dagbladet (së bashku me faksimilen e origjinalit në norvegjisht), ku përcillet mesazhi i Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, drejtuar popullit norvegjez, me shprehjen e keqardhjes së thellë dhe ngushëllimet për humbjen tragjike të Berit Backerit.[53]



Aftenposten Torsdag 18. mars 1993

**Berit Backer**

Det är med djup bestörtning som jag och min fru mottar budet om att Berit Backer mördats av en kosovoalban.

Ingen i Norden har förmodligen gjort mer än Berit Backer för att sätta sig in och förklara albanernas situation. Hon var en mycket kompetent forskare om det albanska folket och en välinformerad och objektiv iakttagare av situationen på Balkan, särskilt i Albanien och Kosovo.

Jag har träffat henne åtskilliga gånger under de senaste åren i framförallt Albanien, och ofta kunnat dra nytta av hennes djupa insikter om det politiska och ekonomiska läget där. Jag har ibland också haft tillfälle att läsa hennes intressanta analyser.

För mig, min fru och andra kolleger som kom i kontakt med henne, var hon en härlig människa — modig, kunnig, öppen och vänlig.

Med Berit Backers bortgång har de nordiska staterna förlorat en forskare och observatör om den albanska situationen som vi inte kan ersätta utan vidare.

Hon gick bort i en tid när hennes kunskaper behövdes mer än någonsin.

Våra tankar går till dem som stod Berit Backer nära och de många albaner i Albanien och Kosovo som nu måste uppröras över illdådet och sörja en nära vän och insiktsfull hjälpare.

JAN AF SILLÉN
Sveriges ambassadör i Jugoslavien och Albanien 1987—92.

52 *Revista Ekskluzive*, nr. 7 (2000), f. 53.

53 *Dagbladet,* "Kosovos president beklager drapet", mars 1993. Artikull që raporton reagimin e presidentit Ibrahim Rugova pas vrasjes së Berit Backerit.

# *LAJMËRIM*

Me keqardhje të madhe e morëm lajmin mbi vrasjen e Berit Backerit, aktiviste e shquar për të drejtat e njeriut pranë Komitetit të Helsinkit dhe mikesh e popullit shqiptar.

Barit Backer ishte një ndër figurat e shquara norvegjeze e cila e kuptoi drejt çështjen shqiptare dhe u angazhua me forcë për internacionalizimin e saj. Atëherë kur më së tepërmi populli ynë kishte nevojë për miq, ishte Berit Backeri e cila iu gjend popullit tonë për parashtrimin real të gjendjes në Kosovë. Pikërisht për këtë, vrasja e Berit Backerit përveçse është një akt kriminal, njëherit është edhe një atentat mbi çështjen shqiptare në opinionin evropian!

Armiqtë e kombit tonë, ata që na mbajnë të pushtuar dhe veglat e tyre, do të propagandojnë te opinioni i huaj se kështu i «shpërblejnë» shqiptarët miqët e tyre, ata që i dalin krah popullit shqiptar! Ne e dijmë se kjo nuk është e vërtetë. Populli shqiptar i ka nderuar dhe respektuar në mënyrë të veçantë miqtë që e kanë ndihmuar atë.

Por ja si ndodhi! Një shqiptar (sipas informatave të pavërtetuara deri më tash - i sëmurë psikik) vrau një veprimtare të shquar për çështjen tonë kombëtare! A u bë kjo nga marrëzia, nga interesat e ngushta egoiste apo të shtyrë nga pushtuesit, në fund të fundit, kjo pak çon peshë. Fatkeqësia është aty se dyfish u dëmtua çështja jonë: ***së pari***, humbëm një përkrahëse të zellshme të çështjes sonë dhe një mikeshë të mirë që zor e kemi ta gjejmë një tjetër si ajo, dhe ***së dyti***, kjo ka lënë përshtypje aq të keqe te opinioni i huaj dhe veçanërisht te opinioni norvegjez, i ka indinjuar ata pa masë, sa çështja jonë në këtë opinion do të pritet me akullsi!

Ditën e mërkurë, më 17 mars 1993, në ora 11.00 do të bëhet varrimi i së ndjeres Berit Backer në Oslo. Shkuarje për t'i bërë homazhin e fundit Berit Backerit për shqitparët kudoqofshin dhe në mënyrë të veçantë për shqiptarët në Skandinavi është një ***OBLIGIM MORAL***. Masoviteti ynë sa më i madh është mirënjohja jonë më e thellë për Berit Backerin si mikesh e popullit tonë dhe kështu, njëherit, do të diferencoheshim dhe do ta dënonim aktin kriminal dhe vetë kriminelin shqiptar para opinionit norvegjez!

PJESËMARRJA NË VARRIMIN E BERIT BACKERIT ËSHTË NJË KONTRIBUT I MADH PËR TË TREGUAR RESPEKTIN E POPULLIT TONË NDAJ SË NDJERËS!

**- Lavdi Jetës dhe Veprës së Berit Backerit!**

**- I përjetshëm qoftë kujtimi për Të!**

## Lëvizja Popullore e Republikës së Kosovës

Telegramet e ngushëllimit Komitetit të Helsinkit në Oslo mund t'i drejtohen në këtë telefaks: (0047) 22 - 57 00 88 (në Oslo).
Komittit të Helsinkit mund t'i drejtoheni edhe gojarisht (në shqip) përmes telefonit (0047) - 22 - 57 00 70.

# Fjala e Adem Demaçit në ditën e varrimit të Berit Backerit

**Nënë e familje e nderuar e zonjës Berit, zonja e zotërinj, miq e dashamirë të zonjës Berit Backer !**

*Më takoi fati i hidhur që së bashku të ndajmë pikëllimin e thellë që na pushtoi zemrat tona. Në emër të gjithë popullit shqiptar dhe në emër të gjithë udhëheqjes shqiptare, me zemër të thyer e shpirt të përvëluar gjithë miqve norvegjezë u shpreh ngushëllimet më të thella dhe lus që të kenë mirësinë, e të gjejnë edhe për ne shqiptarët ndonjë fjalë ngushëllimi, sepse pikëllimi ynë është i pafund dhe për shkak se këtë krim të paparë e bëri një kriminel i cili nuk meriton as emrin njeri e as shqiptar.*

*Jam i bindur se populli mik norvegjez nuk dëshiron dhe se edhe motra Berit nuk do të dëshironte që ky krim sado pak të ndikonte në ftohjen e miqësisë së popullit norvegjez.*

*Norvegjia mike humbi bijën e vet fort të çmuar, humbi një humaniste e shkencëtare shumë të zellshme, kurse ne shqiptarët mbetëm pa të vetmen motër norvegjeze që kishim.*

*Kur militaristët serbomëdhenj na i rrëmbyen edhe të drejtat e fundit kombëtare e njerëzore që patëm, motra Berit si shqipe mali na mbrojti me dinjitet dhe na qau hallet, para të gjitha forumeve humanitare e shtetërore të Norvegjisë dhe botës.*

*Kur hordhitë e shfrenuara të ushtrisë e të policisë së Millosheviqit i vranë e masakruan të rejat e të rinjët shqiptarë- motra Berit bashkë me ne qau me lot martirët e Kosovës. Kur popullin tonë e kërcënoi uria e imponuar nga pushtuesi i egër - motra Berit gjeti udhë që i t'i dërgonte atij bukë e ilaqe, të fala e dëshira të ngrohta, këshilla të vlefshme e përkrahje të çmueshme.*

*I përjetshëm qoftë kujtimi për Ty, motër MERITË!*

*Në Osllo, 17.03.1993, Adem DEMAÇI*



*Gazeta "Dagbladet", mars '93*

## Presidenti i Kosovës shpreh keqardhje për vrasjen

Nuk mund ta kuptoj se një person me gjak shqiptari në deje të vrasë një person si Berit Backeri, i tha presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova, Nufri Lekajt dje pasdite. Rugova e mori në telefon dhe i tha se është i shokuar nga lajmi i vrasjes, thotë Lekaj.

Berit Backeri ishte ambasadorja më e spikatur në Perëndim si për Shqipërinë ashtu edhe për dy milionë shqiptarë në Kosovë. Ajo ishte mike e afërt si për presidentin e Shqipërisë, Sali Berishën, po ashtu edhe për presidentin e Qeverisë Provizore të Kosovës, Ibrahim Rugovën.

Ismail Kadare, shkrimtar shqiptar i cili është me vite një ndër kandidatët kryesorë për Çmimin Nobel për Letërsi, ishte një ndër miqtë e saj.

Berit Backeri për më shumë se 20 vjet ishte informatorja kryesore për gjendjen në Shqipëri dhe ish-Jugosllavi nëpërmes librave, radioprogrameve, artikujve në gazeta etj. Ajo ishte një nga shumë pak persona që ka pasur kontakte me ata të cilët më herët ishin opozitë, prandaj edhe kishte kontakte shumë të mira me liderët aktualë. Berit Backeri fliste rrjedhshëm shqipen dhe serbokroatishten.



**Kosovos president beklager drapet**

**– Jeg kan ikke forstå at en person med albansk blod i årene kan drepe et menneske som Berit Backer, sa den kosovoalbanske presidenten Ibrahim Rugova til Nufri Lekaj i går ettermiddag. Rugova ringte selv og sa, han var sjokkert over drapet, sier Lekaj.**

Berit Backer var en av de viktigste ambassadørene i Vesten for både Albania og de to millioner albanerne i Kosovo.

Hun var nær venn både av den albanske presidenten Sali Berigha, og av presidenten for den provisoriske regjeringen i Kosovo, Ibrahim Rugova.

Også den albanske forfatteren Ismail Kadare, som i mange år har vært en av de fremste favorittene til Nobels litteraturpris, var blant hennes venner.

I bøker, radioprogrammer og avisartikler har Berit Backer i snart 20 år vært en av de viktigste informatorer om forholdene i Albania og det tidligere Jugoslavia. Hun var en av meget få som har hatt kontakter i det som før var den politiske opposisjonen. Og hadde derfor meget gode kontakter med dagens ledere.

Berit Backer snakket både albansk og serbokroatisk flytende.

Dagbladet mars 93

Sipas Ann Christine Eek, njërës prej mikeve më të afërta të Berit Backerit, "jo vetëm që jeta e Berit Backerit përfundoi në mënyrën më tragjike, por ajo dukej sikur të ishte e paracaktuar për ngjarje dramatike shumë kohë para se të lindte. Një vajzë e re, e cila më vonë do të bëhej nëna e Beritit, u arrestua së bashku me një grup studentësh radikalë në prill të vitit 1941, gjatë okupimit gjerman të Norvegjisë në Luftën e Dytë Botërore. Forcat gjermane zbuluan se arkitektja e re, Ina Margrethe Danielsen, ishte vajza e admiralit Edvard Christian Danielsen, i cili kishte arritur të arratisej në Britani gjatë okupimit dhe qëndronte atje si pjesë e Marinës Mbretërore Norvegjeze, duke bashkëpunuar me Admiraltyn e Flotës Detare Britanike. Për këtë arsye ajo u burgos në Grini, një burg në veriperëndim të Oslos, të cilin gjermanët e kishin shndërruar në një lloj kampi përqendrimi. Burgosja e saj katërvjeçare e shndërroi në një komuniste të përkushtuar (...).

"Ole Friele Backer u njoh me Ina Danielsen përmes vëllait të saj, Per Danielsen, me të cilin kishte ndarë shumë përvoja gjatë luftës. Ata u martuan pas përfundimit të luftës dhe më 3 gusht 1947 lindi vajza e tyre, Berit. Thuhet se, kur i ati i Beritit mori lajmin për lindjen e saj në Oslo, ndërsa ndodhej me detyrë në Svalbard, ai u gëzua sikur të ishte njeriu më i lumtur në botë. Megjithatë, nuk pati mundësi të kalonte shumë kohë me vajzën pasi, fatkeqësisht, vdiq papritur vetëm një muaj më vonë. Kështu, Berit u rrit në rrethana të vështira: ajo me nënën fillimisht shkuan të jetonin në Kirkenes, në veri të Norvegjisë, më pas u detyruan të shpërnguleshin disa herë

për shkak të punës së nënës e cila dokumentonte ndërtesat e shkatërruara gjatë luftës. Për disa periudha Berit jetoi edhe me të afërm të ngushtë në Oslo dhe në Mandal.

"Si vajzë e re e një komunisteje, Berit dërgohej në kampet e 'pionierëve' gjatë pushimeve verore dhe, ndoshta si pasojë e bindjeve politike të nënës së saj, herë pas here gjendej në situata të sikletshme. Fëmijët dinë të jenë tepër të ashpër me njëri-tjetrin, dhe kjo mund të ketë qenë një tjetër arsye pse Berit filloi të marrë 'arsim politik' që herët. Pas përfundimit të shkollimit të mesëm ajo ndoqi një kurs në Shkollën 'Nansen' në Lillehammer gjatë viteve 1965–1966 dhe, më vonë, në pranverën e vitit 1968, u regjistrua në Universitetin e Bergenit. Gjatë viteve në vijim ajo studioi statistikë, antropologji sociale, filozofi dhe sociologji. Në kundërshtim me pikëpamjet e nënës, Berit iu bashkua brezit të të rinjve radikalë në fund të viteve gjashtëdhjetë. Interesimi i saj për Shqipërinë u ndez kur ajo e vizitoi për herë të parë në vitin 1969, të cilën propaganda e kohës e quante 'Feneri i Socializmit'. Një bashkëstudent kujton vitet në Bergen, kur lëvizja studentore lulëzonte dhe debatet politike ishin të gjalla: 'Berit Backeri ishte në qendër të shumë prej aktiviteteve më interesante dhe, madje, edhe ata që nuk ndanin të njëjtat bindje politike me të, admironin aftësinë e saj të jashtëzakonshme intelektuale dhe përkushtimin e saj të ngrohtë njerëzor (...)".

"Gjatë vizitës së saj të parë në Shqipëri, Berit Backeri mbeti e mahnitur nga shqiptarët, kultura e tyre dhe lufta e pandërprerë për pavarësi. Për këtë arsye, ajo

vendosi t'ia kushtojë kërkimin e saj shkencor, për marrjen e një grade akademike në antropologji sociale, studimit të shqiptarëve (...). Pas demonstratave në Kosovë në vitin 1968 gjendja e shqiptarëve u përmirësua ndjeshëm. Në vitin 1970 u themelua Universiteti i Prishtinës, ndërsa një kushtetutë e re, në vitin 1974, i dha krahinës statusin e autonomisë. Në atë periudhë Berit Backeri u pranua si e para e huaj që do të kryente punë kërkimore në zonë për një vit, gjatë viteve 1974–1975. Për lejimin e kërkimeve të saj ishte përgjegjës ministri i Kulturës i asaj kohe, Ukshin Hoti, ndërsa ajo gëzoi ndihmën dhe mbështetjen e rektorit të Universitetit të Prishtinës, profesor Idriz Ajeti, si dhe të studiuesve - profesorë Fehmi Agani dhe Mark Krasniqi. Në hyrje të studimit të saj, Berit Backeri përshkruan fillimin e punës kërkimore që zhvilloi në fshatin Isniq (...).

"Korespondenca që la pas Berit Backeri dëshmon për kontaktet e saj të ngushta me studiues, shkrimtarë, gazetarë dhe persona të tjerë që ishin të interesuar për aspekte të ndryshme të Shqipërisë - politike, ekonomike dhe shoqërore. Përmes thellimit të njohurive të saj, ajo arriti në një kuptim gjithnjë e më të thellë të shkeljeve të të drejtave të njeriut ndaj shqiptarëve, veçanërisht në Jugosllavi. Në vitin 1978 ajo u kontaktua nga Amnesty International në lidhje me një të burgosur të ndërgjegjes, Adem Demaçin, shkrimtarin shqiptar nga Kosova, i cili kishte qenë i burgosur për pjesën më të madhe të periudhës që nga viti 1958 (...).

"Përvoja që kishte përvetësuar Berit Backeri në Shqipëri gjatë viteve 1975–1981, në shumë aspekte, ishte zhgënjyese. Duke qenë nën vëzhgim të vazhdueshëm,

ajo kuptoi se 'Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë' nuk ishte aspak një parajsë dhe, përfundimisht, u distancua nga bindjet politike që kishte pasur në rininë e saj. Megjithatë, interesimi i saj për popullin shqiptar nuk u zbeh aspak; ajo vazhdoi punën kërkimore, por nga jashtë, duke e drejtuar vëmendjen drejt mjediseve shqiptare jashtë vendit, më afër saj. Gjithashtu, ajo u ftua të mbante kumtesa në konferenca ndërkombëtare dhe të ligjëronte në Norvegji mbi shqiptarët në Shqipëri dhe në Kosovë (...)

"Berit Backer, emri i së cilës shqiptohej nga shqiptarët si 'Berita', me kalimin e kohës mori nofkën 'Merita' për shkak të respektit dhe vlerësimit që gëzonte ndër shqiptarët e Kosovës, për njohuritë e saj të thella mbi ta dhe për angazhimin e pandërprerë në informimin e opinionit evropian mbi gjendjen e tyre (...). Berit Backeri kishte një dëshirë të fortë për t'i bërë të njohur botës situatën e shqiptarëve (...), më vonë ajo u akuzua publikisht në shtypin serb si një 'separatiste shqiptare e Kosovës', krahas Adem Demaçit, i cili në atë kohë ishte ende në burg (...)".

"Gjatë jetës së saj Berit Backeri mori përsipër shumë angazhime dhe pati kontakte të shumta ndërkombëtare. Që nga fëmijëria ajo kishte qenë politikisht aktive - gjë që nuk kishte qenë gjithmonë pa ndërlikime - dhe, si rrjedhojë, kishte mësuar që herët vlerën e diskrecionit. Njerëzit nuk kanë pse të dinë më shumë se ç'është e nevojshme, mendonte ajo. Për këtë arsye, ajo e ndante jetën e saj në pjesë, si një tortë, dhe njerëzit që përbënin këto pjesë të tortës mezi e njihnin ekzistencën e njëri-tjetrit, e aq më pak numrin e tyre të vërtetë. Disa prej

tyre ishin politikisht aktivë ose të përkushtuar ndaj çështjeve humanitare, disa të tjerë ishin kolegë në projekte të ndryshme, ndërsa të tjerët ishin thjesht miq me të cilët ajo kalonte çaste shoqërore (...)".

"Ajo rrallëherë përmendte vështirësitë që haste në punën e saj, por në vitet e fundit ishte e dukshme për autoren e këtyre rreshtave se Berit kishte përjetuar gjëra që e kishin lënduar thellë. Kuptimi i saj për situatën në Ballkan ishte aq i mprehtë saqë shpesh i provokonte ata që kishin pranuar pikëpamjet 'zyrtare' të popullsive dominuese sllave dhe greke. Rezistenca, me të cilën përballej kur përpiqej të raportonte mbi gjendjen e shqiptarëve, ishte nganjëherë aq e fortë saqë ajo ndiente sikur gjithë njohuritë e saj kishin humbur vlerën dhe se tërë përpjekjet e saj kishin qenë të kota...".[54]

Në vijim është një fotografi nga viti 1976, kur Berit Backeri po zhvillonte kërkime në Kosovë, duke biseduar me një bari. Ajo nuk komunikonte vetëm me persona me pushtet politik ose me prapavijë akademike, por edhe me njerëz të zakonshëm, për të kuptuar më thellë dhe më plotësisht situatën shoqërore e politike, si edhe kulturën vendore.

---

[54] Ann Christine Eek (2003): *Berita - the Norwegian Friend of the Albanians*, parathënie në librin *Behind the Stone Walls*..., f. 7-8, 9, 11-14



Pas vitit 2008 autori i këtij libri i ka shkruar dy herë kërkesa Hashim Thaçit, duke i shpjeguar rëndësinë dhe obligimin që kemi ndaj popullit norvegjez, veçanërisht ndaj Berit Backerit, në mënyrë që nga shteti i Kosovës t'i bëhet një nderim i dinjitetshëm Berit Backerit. Pas shumë zvarritjeve dhe pas intervenimit të Adem Demaçit dhe Fatmir Zymberit për këto zvarritje, më 14 maj 2018 Hashim Thaçi e dekoroi me Medaljen Presidenciale të Kosovës, Berit Backerin. Autori i këtij libri u ka shkruar dy herë edhe instancave përkatëse të shtetit shqiptar duke u shpjeguar rëndësinë dhe obligimin që kemi ndaj popullit norvegjez, veçanërisht ndaj Berit Backerit, në mënyrë që t'i bëhet një nderim i dinjitetshëm Berit Backerit nga shteti shqiptar. Por, fatkeqësisht, ende s'është ndërmarrë ndonjë hap nga shteti shqiptar në këtë drejtim.

Gjatë të gjitha vizitave të tij në Norvegji, pas vdekjes tragjike të Berit Backerit në vitin 1993, Adem Demaçi e vizitonte rregullisht varrin e saj. Në vijim, në fotot një dhe dy, është Adem Demaçi gjatë njërës prej këtyre vizitave pranë varrit të Berit Backerit, i shoqëruar nga

Nufri Lekaj. Më tutje në vijim është foto e Medaljes Presidenciale të Kosovës për Berit Backerin. Dhe në foton e tretë në vijim, janë disa nga miqtë dhe bashkëpunëtorët e Berit Backerit, mbledhur me rastin e dëkorimit të Backerit me Medaljen Presidenciale të Kosovës: në foto, ulur nga e djathta në të majtë: Adem Demaçi, Ali Aliu, Zekë Sinanaj. Në këmbë nga e djathta: Xhelali (shoqëruesi i Adem Demaçit), Nufri Lekaj, Ann Christine Eek, Fatmir Zymberaj, Gazmend Pula, Shkëlzen Maliqi dhe Shkëlzen Kukleci.










## PRAPAVIJA DHE VAZHDIMËSIA E GRUPIT PËR KOSOVËN NË KUADËR TË KOMITETIT NORVEGJEZ TË HELSINKIT (GKKNH)

Në fillim të viteve 1980 Komiteti Norvegjez i Helsinkit e zgjeroi veprimtarinë e vet, duke përfshirë edhe mbështetjen ndaj lëvizjes polake "Solidarnost". Në kuadër të kësaj përfshirjeje, një nga disidentët polakë, Aleksander Gleichgewicht, ish-i internuar politik në Poloni, pas arratisjes së tij në Norvegji, u angazhua sekretar për informim në Komitetin Norvegjez të Helsinkit. Gjithashtu, një tjetër pjesëtar i lëvizjes "Solidarnost", Tomasz Wacko, i cili kishte ndjekur studimet e historisë dhe kishte qenë i burgosur politik në Poloni, pas arratisjes në Norvegji u përfshi në veprimtarinë e Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Ky angazhim pasqyronte hapjen e organizatës ndaj bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me përfaqësues të lëvizjeve kundër regjimeve shtypëse në Evropën Lindore. Në të njëjtën frymë, Komiteti filloi të interesohej gjithnjë e më shumë për lëvizjet disidente të Kosovës, të cilat vepronin kundër regjimit shtypës të Beogradit. Ky interesim çoi në themelimin e Grupit për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) - një zhvillim që përbënte një çast të veçantë, pasi për herë të parë përpjekjet për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës u bënë pjesë zyrtare e agjendës së një organizate perëndimore me ndikim. Duke qenë një organizate pothuajse gjysmështetërore, me rol këshillues pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë (MPJN) dhe me peshë të konsiderueshme brenda Federatës

Ndërkombëtare të Helsinkit dhe vetë Procesit të Helsinkit, Komiteti Norvegjez i Helsinkit i dha çështjes së Kosovës një dimension të ri ndërkombëtar. Në fakt, përfshirja e Kosovës në agjendën e Komitetit Norvegjez të Helsinkit, përfaqësonte nismën e parë brenda një organizate perëndimore për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, duke e shndërruar atë në një temë me dimension të plotë ndërkombëtar brenda Procesit të Helsinkit.

Për më tepër, koordinatorët e GKKNH-së, Berit Backer dhe Kristoffer Gjøtterud, ushtruan ndikim të rëndësishëm këshillues në qasjen dhe vizionin e rezistencës në Kosovë, duke dhënë këshilla të vlefshme dhe të maturuara politikisht. Ata rekomandonin që përpjekjet të përqendroheshin në metoda demokratike dhe joviolente, duke iu shmangur çdo veprimi të nxituar dhe duke mos rënë në provokime, të cilat mund t'i jepnin regjimit të Miloševićit pretekstin për ta paraqitur rezistencën shqiptare si të dhunshme. Një perceptim i tillë, sipas tyre, do ta ndihmonte Beogradin t'i bindte vëzhguesit e huaj dhe opinionin ndërkombëtar se shqiptarët nuk ishin të gatshëm ta zgjidhnin çështjen e Kosovës me mjete demokratike. Këto këshilla ishin veçanërisht të rëndësishme për LPK-në, e cila duhej të shmangte çdo nxitim, pasi ishte e vetmja organizatë politike e fuqishme e shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe në diasporë që, në programin e saj, nuk e përjashtonte kryengritjen e armatosur si mjet të fundit për çlirimin e shqiptarëve në Jugosllavi. Njëherësh, vlen të përmendet se gjatë vizitës së parë zyrtare të delegacionit të Kosovës, të kryesuar nga Ibrahim Rugova, në Perëndim - konkretisht në Oslo dhe me nisje nga Oslo - më 14–18 shkurt 1990, në kuadër të një tubimi të

hapur për gazetarë në Komitetin Norvegjez të Helsinkit, më 17 shkurt 1990 (ku edhe autori i këtij libri ishte i pranishëm), Ibrahim Rugova, gjatë fjalimit të tij, shprehu publikisht konsideratën më të lartë për Backerin dhe Gjøtterudin, si dhe për këshillat e tyre të vlefshme. Ndërkaq, Adem Demaçi, në cilësinë e kryetarit të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë (KMDLNj-së), i kishte vlerësuar vazhdimisht këshillat e Backerit dhe të Gjøtterudit, ky i fundit anëtar nderi i KMDLNj-së.[55] Me rëndësi të veçantë ishte fakti se Demaçi, i cili konsiderohej udhëheqësi shpirtëror i LPK-së dhe që nga shumë bashkëpunëtorë shihej si njeri me qëndrime të palëkundura, megjithatë i vlerësonte posaçërisht këshillat e Backerit. Ai nuk e shprehu këtë vetëm në fjalimin e mbajtur ditën e varrimit të saj, kur përmendi "këshillat e saj të vlefshme", por e kishte theksuar shpesh edhe në biseda private (ku ndodhte që edhe autori i këtij libri të ishte i pranishëm), se për lirinë që gëzon Kosova sot, këshillat e Berit Backerit kishin qenë tejet të rëndësishme. Është domethënëse që Backeri e kishte bindur Demaçin se, nëse shqiptarët e Kosovës s'do të mund të çliroheshin përmes përpjekjeve paqësore ose rezistencës pasive, kjo do të legjitimonte forma të tjera të rezistencës aktive dhe mbështetja ndërkombëtare për Kosovën nuk do të humbiste. Me të drejtë Adem Demaçi e quante Beriten, Merita, dhe porosiste që të gjithë shqiptarët ta quajnë me këtë emër siç, zakonisht, e thërriste Baca Adem: Merita e shqiptarëve.

[55] "Kristoffer Gjøtterud: En åpen horisont," *Apollon: Forskningsmagasinet ved Universitetet i Oslo,* 1995, https://www.apollon.uio.no/portretter/1995/horisont.html.

Me fjalë të tjera, edhe pse Demaçi nuk ishte optimist se Kosova do të çlirohej vetëm përmes metodave paqësore, ai ishte bindur se këto metoda do të krijonin një efekt legjitimizues për forma të tjera të mundshme të çlirimit të Kosovës, me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare. Prandaj, ai mbeti besnik ndaj kësaj qasjeje politike deri në Konferencën e Dejtonit. Si shembull për këtë, në një intervistë të vitit 1992, Demaçi deklaroi: *"Rezistenca paqësore është metodë moderne, por kam frikë se Serbia po mundohet të na nxjerrë prej taktit për të «dëshmuar» para botës se shqiptarët nuk e pëlqejnë zgjidhjen e problemeve me mjete demokratike e pa dhunë. Por, në saje të ndihmës së LDK-së, populli po e ruan qetësinë, urtinë, paqen, durimin... Kështu siç po ecin punët, koha do të kërkojë edhe forma të tjera të rezistencës, që unë nuk di se çfarë mund të jenë, por populli në një moment do t'i kërkojë dhe do t'i gjejë ato forma. Në qoftë se bashkësia ndërkombëtare do të na përkrahë energjikisht për realizimin e synimeve tona, atëherë sakrificat dhe flijimet do të jenë më të vogla..."*[56]

Sa i përket prapavijës konkrete të themelimit të GKKNH-së në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit - një organizatë pothuajse gjysmështetërore, me rol këshillues pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë (MPJN) - ky nuk ishte aspak një projekt i lehtë, sidomos po të merret parasysh lidhja e fortë e miqësisë ndërmjet shtetit norvegjez dhe ish-Jugosllavisë. Përkatësisht propaganda serbo-jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore kishte arritur gradualisht të ketë ndikim

[56] Gashi, 2010: 98

të madh në Norvegji, duke e shtrirë këtë ndikim propagandistik edhe në shtetet e tjera nordike. Fillimisht propaganda serbo-jugosllave e kishte arritur suksesin, duke e përdorur si mjet propagandistik historinë e të burgosurve jugosllavë të luftës në Norvegji (gjatë Luftës së Dytë Botërore) në kuptimin se vetëm serbët kanë qenë anti-nazifashistë të devotshëm: nga njëra anë duke i bashkëlidhur nocionet serb-partizan-antinazifashist-jugosllav, nga ana tjetër duke aluduar se popujt e tjerë në Jugosllavi, sidomos shqiptarët dhe kroatët, kanë qenë më shumë bashkëpunëtorë të nazifashistëve sesa kundërshtarë të nazifashistëve. Në bazë të kësaj propagande Serbia e stimulonte miqësinë me Norvegjinë edhe për arsyen se Norvegjia pas Luftës së Dytë Botërore rezultoi si shteti nordik më proaktiv në politikën e jashtme (krahasuar me shtetet e tjera nordike) dhe me shumë ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare. Për shkak të kësaj lidhjeje ndërmjet Norvegjisë dhe Jugosllavisë, kolegët norvegjezë në kuadër të Grupit për Kosovën të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) - Berit Backer dhe Kristoffer Gjøtterud - propozuan që Nufri Lekaj ta merrte përgjegjësinë në cilësinë e përgjegjësit të GKKNH-së, meqenëse që nga viti 1987 ishte profiluar dhe identifikuar në mediet norvegjeze si një shembull i dëshmuar i viktimës së torturës nga regjimi jugosllav, si ish-i burgosur dhe i përndjekur politik, si dhe si pjesëtar aktiv e i organizuar i lëvizjes së shqiptarëve të Kosovës kundër regjimit shtypës të Beogradit. Rrjedhimisht, në këtë mënyrë kolegët norvegjezë të GKKNH-së nuk mund të akuzoheshin drejtpërdrejt nga diplomacia jugosllave si anti-jugosllavë (dhe të

vënin në siklet të madh marrëdhëniet shtetërore norvegjeze-jugosllave), ndërsa përkrahjen e tyre për GKKNH-n e legjitimonin bazuar në njërin ndër parimet e rëndësishme të Aktit Final të Helsinkit (Deklaratës së Helsinkit), përkatësisht parimin për respektimin e të drejtave të njeriut ngaqë edhe Jugosllavia, si një ndër shtetet nënshkruese, obligohej moralisht dhe politikisht ta respektonte Aktin Final të Helsinkit (1975).

Në vijim, pas disa sqarimeve, si orientim më konkret, janë të paraqitura/radhitura disa nga faksimilet/artikujt e gazetave norvegjeze dhe serbe për periudhën e viteve 1987-1989. Përkatësisht pesë faksimile/ artikuj që përshkruajnë organizimin e demonstratave në Oslo dhe në qendrat e tjera skandinave me kërkesën Kosova Republikë, dhe paraqitjet e njërit ndër përfaqësuesit e LPK-së në emigracion, Nufri Lekës, në mediet norvegjeze etj., i cili, më 29 shtator 1987, dha një deklaratë në shtypin norvegjez, që e sfidoi shumë miqësinë në mes të shtetit norvegjez dhe Jugosllavisë, sepse nëpërmjet kësaj deklarate u informua opinioni norvegjez për përdorimin e torturës ndaj të burgosurve politikë shqiptarë në Jugosllavi për përndjekjet politike ndaj shqiptarëve, për kërkesën Kosova Republikë dhe për një rezyme historike të popullit shqiptar si popull me prejardhje ilire.[57] Ambasada Jugosllave në Norvegji, si reagim ndaj kësaj deklarate, duke e përdorur si mjet miqësinë jugosllave-norvegjeze të formuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndikoi që organet shtetërore norvegjeze ta

[57] Jan-Erik Smilden, *"Torturistene trakk ut tåneglene mine", Dagbladet,* 29 september 1987

nënvlerësojnë në shtypin norvegjez vërtetësinë e kësaj deklarate. Në veçanti këtë nënvlerësim e bëri zëvendësministrja e Jashtme e Norvegjisë në atë kohë, Helga Hernes, e cila, në emër të Ministrisë së Jashtme norvegjeze që udhëhiqej nga Thorvald Stoltenberg (i cili prej vitit 1961 deri në vitin 1964 ka qenë sekretar i parë i Ambasadës Norvegjeze në Beograd), deklaroi se nuk ndodh përdorimi i torturës dhe shkelja e të drejtave nga pushteti jugosllav në Kosovë.[58]

Qëllimi kryesor i Ambasadës Jugosllave ishte që shteti norvegjez ta dëbonte Nufri Lekën. Kjo do t'u mundësonte autoriteteve jugosllave ta burgosnin sërish. Megjithëkëtë, Nufriu insistoi edhe më shumë, nëpërmjet medieve norvegjeze, për ndërkombëtarizimin e dhunës nga regjimi serbo-jugosllav ndaj shqiptarëve në Jugosllavi, sidomos duke e marrë përkrahjen publike nga Amnesty në shtypin norvegjez dhe nga avokati Arild Farstadvoll, u arrit nga njëra anë një fillesë për dobësimin e ndikimit të propagandës së Ambasadës Jugosllave në Norvegji, nga ana tjetër ky aktivitet në medie i bëri presion edhe Ministrisë së Jashtme norvegjeze ta rivlerësojë vërtetësinë e deklaratave të Nufriut në mediet norvegjeze në lidhje me shkeljet e të drejtave të shqiptarëve nga regjimi serbo-jugosllav në Kosovë.

Rrjedhimisht, ministri i Jashtëm i Norvegjisë, në atë kohë Thorvald Stoltenberg, e korrigjoi zëvendësministren e tij, Helga Hernes, në deklaratën e tij publike në shtypin norvegjez ku, përveç të tjerash, thuhet: "*Ministri i Jashtëm Thorvald Stoltenberg në gazetën "VG" ka*

---

[58] Harald Berg Sævereid, *"Torturoffer Kasteball"*, *VG*, 5 august 1988

*korrigjuar deklaratat e zëvendësministres së Jashtme Helga Hernes në lidhje me rrethanat në krahinën e Kosovës në Jugosllavi. Precizon: natyrisht nuk mund ta përjashtojmë mundësinë se ndodh persekutimi politik në Jugosllavi. Unë e pranoj me kënaqësi se ne kemi një marrëdhënie shumë të veçantë me Jugosllavinë dhe ne e përdorim pikërisht këtë marrëdhënie të mirë në bisedat tona me jugosllavët. Kështu që, është e mundur për t'u shprehur me saktësi dhe drejtpërdrejt miqve. Rrethanat në Kosovë janë shumë të komplikuara. Neve na kanë ardhur të dhëna për raste të veçanta, për persona të arrestuar me emër dhe mbiemër. Por, as Norvegjia e as ndonjë nga shtetet e tjera nordike nuk kanë mundur ta vërtetojnë këtë".*[59]

E me një rast, Nufriu u kërcënua hapur nga Ambasada Jugosllave duke i thënë "mos luaj me zjarr". Kjo ndodhi pas një përplasjeje në debat në një emision të radio-televizionit norvegjez në mes të Nufriut dhe përfaqësuesit të Ambasadës Jugosllave. Ky kërcënim në njëfarë mënyre u përsërit edhe nëpërmjet gazetës serbe "NIN" më 23.04.1989 ku, përveç të tjerash, shkruan: "*Separatistët shqiptarë gëzojnë një dozë përkrahje nga redaksitë norvegjeze..., por është dëgjuar edhe pala tjetër. Demonstratat e janarit (numër 4) nuk kishin aq bujë te gazetarët norvegjezë... u bënë me rastin e "përvjetorit të vrasjes së tre intelektualëve të njohur shqiptarë më 17 janar 1982 në Shtutgard nga ana e policisë jugosllave, duke i bindur kalimtarët sikur Gjermania të ishte bërë*

---

[59] Harald Berg Sævereid og Aage Storløkken, *"Stoltenberg Korrigerer", VG,* 13 august 1988

*terren gjahu privat për shtetin e RSFJ-së. Demonstratat e pesta në vendin mik ishin masive... kanë tërhequr vëmendjen me forcën dhe masivitetin. Ka vazhduar prezantimi në televizion dhe radio. Kush prezanton të vërtetën dhe falsifikimin. Kësaj radhe është dëgjuar edhe pala tjetër. Programi i dytë i radios ka emituar fjalën e arsyeshme të sekretarit të parë të ambasadës, Milorad Djuroviq. Menjëherë me replikën e tij paraqitet refugjati politik Nufri Lekaj, i cili, duke mos menduar se po luan me bumerang, i është drejtuar me 'kundërargument', duke ofenduar publikisht diplomatin jugosllav me: gënjen, gënjen, gënjen. Menjëherë ndaj kësaj kanë reaguar disa qytetarë jugosllavë me përkatësi jugosllave..."*[60]

Vlen të precizohet se këtyre personave që gazeta serbe "NIN" iu referohet si qytetarë jugosllavë me përkatësi jugosllave që kanë reaguar kundër përfaqësuesit të LPK-së në Oslo, në mesin e tyre kishte persona të lidhur me kryekriminelin e nëntokës serbe në Stokholm të Suedisë, i ashtuquajturi "Jokso", i cili ishte mik i ngushtë i Arkanit, madje një nga bashkëpunëtorët e tyre i ashtuquajturi "Čenta" (sipas dëshmitarëve) e kishte vizituar Oslon që në vitin 1987, kur sapo kishte marrë hov organizimi i demonstratave etj. në Oslo, me kërkesën Kosova Republikë e, gjithashtu, (sipas dëshmitarëve që i kishin identifikuar) në vjeshtën e vitit 1987, dy inspektorë të lartë shqipfolës të UDB-së në Pejë, kishin vizituar Norvegjinë "për të mbledhur informacion". Dihet tanimë botërisht se

---

[60] Хари Штајнер, *Норвешка - Ћошак поларног круга, NIN,* 23 април 1989.

kriminelët e nëntokës serbe kanë punuar ngushtë me shërbimin sekret serbojugosllav (UDB-në) kundër veprimtarisë së emigracionit politik shqiptar dhe kroat, njëherësh edhe njerëz të caktuar të redaksive të gazetave serbe kanë qenë të sinkronizuar me këtë veprimtari të UDB-së. Për më tepër që në vitin 1987, konkretisht me datën 24.11.1987, në gazetën serbe "Ilustrovana Politika", përveç të tjerash, shkruan: "*Kanë organizuar demonstrata antijugosllave në Norvegji, por edhe në Suedi... Ne jemi të interesuar të dimë se a ka ndër ta edhe të tillë që kanë mbajtur dënime për ngjarjet kundërrevolucionare të vitit 1981*".[61] Pasi që dy nga bashkëfamiljarët e përfaqësuesit të LPK-së në Oslo, me ndihmën e një kroati identifikuan nga kishin ardhur kërcënimet në kuadër të çerdhes së këtyre "qytetarëve jugosllavë me përkatësi jugosllave" në Norvegji, që disa prej tyre mbanin lidhje me nëntokën serbe të Stokholmit në Suedi, u shpartallua kjo çerdhe dhe u shkurtua fuqia e saj kërcënuese.

Si ilustrim në vijim janë të paraqitura pesë faksimile të gazetave të cituara (të sipërcekura), në periudhën 1987-1989.

[61] Илустрована Политика, 24. новембар 1987, стр. 8-10.

# «Torturistene trakk ut tåneglene mine»

**I sju måneder, ofte under tortur, satt jeg i enecelle, med sterkt lys på hele tida. Jeg satt med hendene og føttene lenket sammen. Bare når jeg skulle spise, ble håndjernene fjernet.**

Av JAN-ERIK SMILDEN

Det er den jugoslaviske asylsøkeren Leka (26) som forteller dette. Leka som er av albansk opprinnelse, ble plassert i militært fengsel uten kontakt med omverdenen etter at han deltok i oppstanden i Kosovo-provinsen i 1981.

— Jeg deltok i spontandemonstrasjoner, lagde paroler og var medlem av en liten nasjonalistisk ikke-voldsgruppe kalt Besa (Æresordet), forteller Leka. Vi drev celle-virksomhet og hadde bare ti medlemmer. Stort sett var aktiviteten vår å arrangere studiesirkler, lage løpesedler og skrive slagord på veggene. Målet vårt var at Kosovo skulle bli en selvstyrt jugoslavisk republikk sier den 26-årige asylsøkeren.

Leka var en av flere tusen som ble arrestert etter Kosovo-opprøret. Oppholdet i militærfengslet har satt spor for livet.

*Torturert*

— Torturistene slo ut flere av tennene mine, de trakk ut to stortånegler av føttene mine, og de slo og sparket meg over hele kroppen. Nyrene ble ødelagt og jeg mistet håret på hodet og kroppen, sier Leka og viser oss blant annet et tatovert nasjonalsymbol, den albanske ørn, på brystet.

— En av torturistene ville skjære bort merket med barberblad, men en av hans kolleger fikk stoppet ham forteller 26-åringen.

Etter sju måneder i militærfengsel, fulgte fem måneder i sivil varetekt før saken hans kom opp. Dommen — for «ilegal virksomhet» lød på fem års fengsel. I mars i år ble Leka løslatt og vendte tilbake til hjembyen.

— Jeg studerte til elektroingeniør og ville gjenoppta studiene mine etter løslatelsen. Da jeg spurte om å få studieplassen min tilbake, svarte rektor at det skulle jeg få straks jeg hadde fått republikken min.

— Jeg fikk heller ingen jobb, sier Leka. Arbeidsgiverne krever vandelsattest, den får man ikke utlevert av politiet når man har vært politisk fange.

Leka forteller at han hadde meldeplikt hos politiet hver dag etter løslatelsen og at han av og til ble hentet til avhør, også midt på natta. Han hadde også forbud mot å bevege seg utenfor hjembyen.

*Ingen framtid*

— Til slutt orket jeg ikke mer, det var ingen framtid for meg i Kosovo og Jugoslavia. Jeg bestemte meg for å dra til Norge fordi landet lå så langt unna Jugoslavia og fordi det ikke var så mange hemmelige jugoslaviske agenter der, sier Leka.

## Urosenter vil ha indre selvstyre

**Kosovo-provinsen kom i verdens søkelys i 1981, da den albanske majoriteten gjorde opprør mot den jugoslaviske regjeringen i Beograd. De etniske albanerne krevde at Kosovo skulle få status som selvstyrt republikk innen den jugoslaviske føderasjonen. I dag er bare Kosovo et såkalt autonomt område.**

Av de ca. 2,5 millioner etniske albanerne i Jugoslavia, bor mellom 1,6 og 1,7 millioner i Kosovo. Ellers utgjør Kosovo-befolkningen 200 000 serbere og montegrinere.

*Illyrere*

Albanerne stammer fra de såkalte illyrerne, et indo-europeisk folk som kom til det sørlige Albania ca. år 1000 f.Kr. De dannet flere stammefyrstedømmer og bredte seg utover deler av Balkan-området, inntil de måtte gi tapt for tyrkerne i begynnelsen av 1400-tallet. Da Albania og Jugoslavia oppsto som nasjoner i tida rett før og etter den 1. verdenskrig, ble den albanske befolkningen splittet.

Jugoslavene hevder at Kosovo-albanerne arbeider for gjenforening med det strengt kommunistiske Albania. Alle forsøk på politisk opposisjon blir slått hardt ned. Amnesty International kan berette om arrestasjoner, vilkårlige fengslinger og tortur.

*Smågrupper*

Kosovo-albanerne arbeider politisk i smågrupper, og hevder at de ikke ønsker noen gjenforening med Albania. Trolig er bare et lite mindretall for en slik gjenforening.

Asylsøkere i Norge hevder at det i dag sitter 5000 etniske albanere fengslet for politisk virksomhet i Jugoslavia. Jugoslaviske myndigheter har selv oppgitt at ca. 3000 etniske albanere er blitt dømt til fengsel i Kosovo siden 1981.

Striden mellom befolkningsgruppene i Kosovo tilspisser seg. Tidligere i år kom det til opptøyer etter at serbere og montegrinere demonstrerte mot det de kaller overgrep fra den albanske majoriteten i området.




*Kosovo-provinsen ligger på grensa til Albania. (Kart: Vidar Karlsen)*

---



# Torturoffer KASTEBALL

Av HARALD BERG SÆVEREID

**Tør ikke Norge lenger gi politisk asyl til søkere fra Jugoslavia? Spørsmålet er relevant, mener advokat Arild Farstadvoll, etter at alban-jugoslaven Noufri Lekaj (26) er blitt en «kasteball» mellom Justisdepartementet og Utenriksdepartementet.**

I snart to år har Lekaj ventet på en avgjørelse på søknaden om politisk asyl i Norge.





*FORUNDRET: Advokat Arild Farstadvoll har mistanke om at norske myndigheter legger andre forhold enn de juridiske til grunn ved behandlingen av Noufri Lekajs asylsøknad.*

*Godt forhold*

## ...рожени на Косову

па се отуда у штампи појавио и овакав наслов: „Немојте да нас враћате кући." Њихове приче иду дотле да тврде да тамо одакле долазе могу бити осуђени на пет година затвора, уколико их ухвате да носе традиционалну белу албанску капу.

### Незаинтересовани Швеђани

Са таквим капама на глави одржавали су антијугословенске демонстрације у Норвешкој, али и у Шведској, где живи један одређен број Албанаца, југословенских држављана. Када су пријављивали полицији своју намеру, како то овдашњи прописи налажу, очекивало се да ће у Стокхолму манифестовати око две стотине Албанаца.

Улица Валхавалеген, у Стокхолму у којој се налази југословенска ...узимемо чињеницу да је то истовремено важна саобраћајница с двоструким коловозом, па аутомобили стално тутње, било је свега неколико случајних пролазника. Тмуран зимски дан, с влажним тлом, није баш измамио становнике Стокхолма на улице а поготово не овако далеко од трговачког центра, где, иначе, суботом они купују оно што не стижу преко недеље.

Један Албанац је делио летке одштампане на шведском, али није имао много прилике да их растури. Само две пролазнице су узеле, други су одбијали, то их не интересује. Није их привукла ни његова бела капа на глави, нити двојица обучених у белу народну ношњу који су на челу колоне носили заставе.

Неколико говорника је преко мегафона већ изговорило уобичајени текст о лошем положају Ал-

---

Према незваничним информацијама, ти наши несуђени Норвежани су из Гњилана, Подујева, Дечана, Ђуника, Ђаковице, Призрена... Из Пећи и околине их је више од стотину.

Занима нас: има ли међу њима и оних повратника из затвора, оних којима су истекле казне за контрареволуционарно деловање 1981. године.

У недавном разговору са страним новинарима на Брезовици Азем Власи је, одговарајући на овакво питање, рекао да и њих има приличан број.

[illegible] је на конференцији за штампу пре неколико дана у Приштини саветовао новинаре да имају стрпљења када је у питању ова тема. Јер нетачно је, казао је, да се група од 300 већ вратила.

У Пећи идемо истим редом као у Приштини. У општини - ништа. Тек у канцеларији Слободана Војновића, секретара Социјалистичког савеза, први траг.

- Још летос, у јулу, примећено је да се масовно одлази у Скандинавију. Тада се веровало, у Данску. Затражили смо од месних организација да хитно доставе допис. Колико је таквих. Зашто одлазе... Не знамо.

Одлазимо у Горажевац. Мило Радовић је члан Савета месне заједнице. Са њим је неколико актива... Мило узима из [illegible] ...већ припремљен [illegible]

вежана". Ту ти је, да речем, осам породица и један појединац. Укупно тридесет и троје људи жена и деце.

Оно што не знају надлежне покрајинске и општинске установе зна Мило Радовић. Бар за свој атар.

- Шпен Чека је - чита из списка - отишао са пет чланова фамилије. Затим... Шаље Кадрија. Он, жена и дете. Претходно је радио у „Застави". Па онда, Шаље Реџеп. Он је био инкасант, па је суспендован. Нешто око наплата, не знам тачно. Иначе је члан Савеза комуниста. Син му је једно време похађао школу милиције, али су га удаљили. И он је сад тамо у Норвешкој са оцем.

Радовић се накашља па настави.

- Ту је и Беђир Хоџа. Он је син нашег председника месне организације ССРН-а. То је тај појединац. Ал' он је у Шведској. Тамо се запослио, оженио, добио дете... Затим, Бериша Енвер. Он је у Норвешкој. Отишао је са женом која је била трудна. Тамо се и породила. Па Беђир Кељменди, са троје чланова породице...

Прекиде читање за тренутак.

- Тамо је и Зађир Кастрати, са женом и дететом. И он је [illegible]

Foge 8.9.10.
ILUSTROVANA POLITIKA
nr. 1516 24.11.87

Fillimisht, GKKNH u quajt Grupi për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (i themeluar në vitin 1988), por me insistimin e Berit Backerit e vazhdoi veprimtarinë me emrin Grupi për Ballkanin në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH). Qëllimi i këtij ndryshimi ishte që informacioni dhe veprimtaria e këtij Grupi të mos paragjykoheshin krejtësisht si veprimtari dhe informacione subjektive për Kosovën, por të jenë sa më të depërtueshme, sa më bindëse dhe sa më të pranueshme për kancelaritë e shteteve perëndimore, njëherësh vlen të përmendet se Grupi për Ballkanin nga viti 1990 arriti të ketë edhe status zyrtar në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit dhe Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit.

Vlen të theksohet se në kuadër të konsolidimit të veprimtarisë së GKKNH-së, me sugjerim të Berit Backerit, Nufri Lekaj ka udhëtuar në Londër në vitin 1988, ku përveçse është takuar me disa personalitete të kulturës dhe të politikës angleze, është takuar edhe me Ihsan Toptanin, nga i cili ka marrë këshilla të vyeshme. Përveç të tjerash, sugjerimet e Ihsan Toptanit kanë qenë që organizatat e shqiptarëve në përpjekjet e tyre për arritjen e lirisë dhe barazisë së shqiptarëve në Jugosllavi, të mos merren me çështjet ideologjike, por të profilohen vetëm si organizata për të drejtën kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi, përkatësisht të mos merren me Enver Hoxhën dhe sistemin politik në Shqipëri. E, në fakt, Enver Hoxha dhe sistemi politik në Shqipëri nuk ishte qëllimi parësor i LPK-së, madje edhe formalisht u hoq dorë nga kjo, pas përmbysjes së sistemit në

Shqipëri. Dhe ky ishte tregues i qartë se LPK-ja, në esencë, kishte si qëllim parësor çështjen kombëtare mbi çdo ideologji, ashtu siç ishte shprehur një ndër themeluesit emblematik të LPK-së, Jusuf Gërvalla, në një intervistë të realizuar para demonstratave të vitit 1981, përkatësisht në vitin 1980, e publikuar më 20 janar 1982 në gazetën gjermane "Tagische Zeitung", në njërën nga pyetjet e gazetarit të kësaj gazete, se a do ta kërkonit bashkimin me Shqipërinë, pavarësisht se në Shqipëri mbretëron sistemi radikal komunist, radikal demokratik ose një sistem i së drejtës? Jusuf Gërvalla përgjigjet: Pavarësisht nga çfarëdo sistemi!

Ihsan Toptani, Anton Logoreci, Sami Repishti, Hysen Tërpeza, Tahir Kerrnaja dhe ca shembuj të tjerë të izoluar, ishin shembuj të rrallë në kuadër të emigracionit politik shqiptar nga gjenerata e vjetër (pas Luftës së Dytë Botërore), të cilët nuk ishin të preokupuar vetëm me veprimtarinë kundër Enver Hoxhës, por në një mënyrë ose tjetër preokupoheshin dhe angazhoheshin për të ndihmuar Kosovën në rrugën e saj drejt lirisë.

Më konkretisht, organizimi i takimit me Ihsan Toptanin ishte në vazhdimësinë e krijimit të kontakteve, respektivisht informimit dhe njohjes së realitetit të situatës së shqiptarëve në Jugosllavi, por dhe njohjes së Ihsan Toptanit me eksponentë të LPK-së, që si organizatë shihej me rezerva nga qarqe të caktuara për shkak të vijës së majtë ideologjike. Si personalitet, Ihsan Toptani, përveçse në të kaluarën e kishte dëshmuar përkushtimin e tij për të ndërmjetësuar mes palëve për të gjetur kompromis për qëllimet kombëtare (në cilësinë e

organizatorit për mbarëvajtjen e Konferencës së Mukjes në vitin 1943), në këtë vazhdë, pasi emigroi në Mbretërinë e Bashkuar, është konsideruar në vazhdimësi si personaliteti shqiptar më kredibil edhe për shkak të neutralitetit të tij rreth përplasjeve ideologjike të emigracionit shqiptar nga Shqipëria. Rrjedhimisht, Ihsan Toptani ishte informues kredibil për autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me çështjen shqiptare në përgjithësi. Në këtë kuadër Berit Backeri jorastësisht konsideronte se informacioni për eksponentët e emigracionit politik nga Kosova (të cilët kryesisht ishin rreshtuar në grupime organizative të majta), nuk perceptohej në mënyrë të duhur nga diplomacia perëndimore për shkak se shpërndahej një dezinformim nga ana e diplomacisë jugosllave në kuptimin se shqiptarët në Jugosllavi jo vetëm se dëshirojnë ta shkatërrojnë shtetin jugosllav, por dëshirojnë ta ndryshojnë edhe rendin shoqëror, duke aluduar se ata janë fanatikë dhe ekstremistë majtistë etj. Prandaj, Berit Backeri insistonte se informacioni i drejtpërdrejtë nga një ndër drejtuesit e LPK-së në emigracion do të shërbejë për një perceptim më të duhur, dhe se Ihsan Toptani e të tjerët ishin njerëz të duhur të cilët do mund ta shpinin më tutje këtë informacion dhe perceptim të duhur, sidomos duke e marrë parasysh faktin se në kontekstin e kohës, Mbretëria e Bashkuar konsiderohej shteti më kredibil për ta ndarë informacionin me vendet mike perëndimore, njëherësh konsiderohej se Mbretëria e Bashkuar kishte informacionin më të saktë për zhvillimet historiko-politike të shqiptarëve. Në fakt, Berit

Backer kishte krijuar shpejt bindjen e duhur për LPK-në, duke u njohur dhe diskutuar me eksponentë të LPK-së (Nufri Lekën, Ibrahim Kelmendin, Xhavit Halitin etj.), të cilët ajo i konsideronte si të pangarkuar ideologjikisht dhe, thjesht, si patriotë shqiptarë të cilët, për shkak se konsideronin se shqiptarët në Jugosllavi duhet gjithmonë të jenë luajalë ndaj shtetit amë Shqipërisë, ishin rreshtuar në një organizatë të majtë në dukje, por jo në esencë, dhe se nuk ishin rob të asaj të majte që në shtetet lindore kishte degraduar në totalitarizëm dhe autoritarizëm, dhe se si qëllim kryesor kishin lirinë dhe barazinë e shqiptarëve me popujt e tjerë në Jugosllavi.

Rrjedhimisht, themelimi dhe ngritja e GKKNH-së ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Berit Backerit, Nufri Lekës dhe Kristoffer Gjøtterudit, si dhe i mbështetjes së dhënë nga LPK-ja si organizatë, përmes dy prej eksponentëve të saj kryesorë të asaj kohe: njërit, anëtar i kryesisë dhe i angazhuar në riorganizimin e LPK-së (Xhavit Haliti), dhe tjetrit, anëtar i këshillit të përgjithshëm dhe përgjegjës për kontaktet me autoritetet dhe organizatat e huaja (Ibrahim Kelmendi). Në bazë të një nevoje dhe kërkese nga Berit Backeri, aktiviteti i GKKNH-së nuk u formalizua si pjesë e LPK-së, por u mbajt në fshehtësi për një pjesë të madhe të organizatës si dhe vet Komitetin Norvegjez të Helsinkit. Rrjedhimisht, përfaqësuesi i LPK-së, Nufri Lekaj, i cili gjatë kësaj kohe ishte anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së (Dega jashtë vendit), mund të ishte formalisht përgjegjës i GKKNH-së, në cilësinë e viktimës së torturës nga regjimi jugosllav, si ish-i burgosur dhe i përndjekur politik, por nuk mund të

ishte formalisht përgjegjës i GKKNH-së, në cilësinë e “njeriut të LPK-së”. Megjithëkëtë, në realitet, struktura e LPK-së ishte aktive në mbështetje të GKKNH-së, edhe pse kjo mbështetje nuk ishte e formalizuar, dhe GKKNH funksiononte kryesisht si një sektor i lobizmit dhe i diplomacisë joformale i LPK-së për Kosovën. Në fakt, duhet të kihet parasysh se gjatë kësaj periudhe, për-veçse veprimtaria e LPK-së në Kosovë (Dega brenda vendit) ishte veprimtari tërësisht klandestine, edhe veprimtaria e LPK-së (Dega jashtë vendit) ishte veprim-tari gjysmë klandestine.

Gjatë qëndrimit të sipërcekur në Londër, Nufriu është angazhuar vullnetarisht për të bërë regjistrimin e disa qindra të burgosurve politikë shqiptarë në regji-strin qendror në Amnesti Internacional në Londër, meqë shpesh kishte vështirësi të regjistroheshin të burgosurit politikë shqiptarë si të “burgosur të ndër-gjegjes” për shkak se aktakuzat serbo-jugosllave ishin të bazuara në “veprimtari armiqësore subverzive” dhe Amnesti Internacional i regjistronte këta të burgosur, por nuk i klasifikonte si “të burgosur të ndërgjegjes”. Me punën disamuajshe ka arritur ta dëshmojë prakti-kën e “akuzave” serbe dhe të “dënimeve”, ku del në pah se dënimet ishin “politike” e jo “subverzivo-armiqësore”. Kjo ndikoi që mbi 300 të burgosur të kohës nga numri i madh i të burgosurve në listat e Amnesti Internacional të adaptohen si të “burgosur të ndërgjegjes”.

Si ilustrim në vijim janë dy faksimile. Njëra faksimile është lista e emrave dhe adresave të Grupit për

Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH-së), i themeluar në vitin 1988, më pastaj i quajtur Grupi për Ballkanin i Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH). Në këtë dokument janë të listuar emrat dhe adresat e kryesisë së Grupit për Kosovën, bashkërisht me disa nga anëtarët e udhëheqjes së bordit dhe kryesisë së Komitetit Norvegjez të Helsinkit (KNH-së), të cilët bashkërisht e mbështetën veprimtarinë e GKKNH-së për Kosovën. Në këtë listë janë: *Berit Backer* (social-antropologe dhe veprimtare për të drejtat e njeriut, njëherësh kryekoordinatore e GKKNH-së); *Kristoffer Gjøtterud* (profesor i fizikës në Universitetin e Oslos dhe veprimtar për të drejtat e njeriut, njëherësh dhe nënkryetar i Bordit të Komitetit Norvegjez të Helsinkit dhe bashkëkoordinator i GKKNH-së); *Nufri R. Lekaj* (ish-i burgosur dhe i përndjekur politik, anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së dhe veprimtar për të drejtat e njeriut, njëherësh përgjegjës për GKKNH-n. Në Kosovë ka studiuar elektroteknikë, ndërsa në Norvegji ka ndjekur studimet në sociologji dhe gazetari); *Tore Lindholm* (filozof dhe veprimtar për të drejtat e njeriut, njëherësh profesor në Universitetin e Oslos); *Pål Haugland* (avokat dhe veprimtar për të drejtat e njeriut). *Svein Mønnesland* (profesor i gjuhëve sllave në Universitetin e Oslos dhe veprimtar për të drejtat e njeriut); *Aleksander Gleichegewicht* (fizikan, disident dhe veprimtar për të drejtat e njeriut, njëherësh pjesëtar i lëvizjes Solidarnost); *Stein Ivar Aarsæther* (gazetar dhe veprimtar për të drejtat e njeriut, njëherësh kryetar i Bordit të Komitetit Norvegjez të Helsinkit); *Bjørn Cato Funnemark*

(gazetar dhe veprimtar për të drejtat e njeriut, njëherësh sekretar i përgjithshëm i Komitetit Norvegjez të Helsinkit); *Jaroslaw Pawlak* (gazetar dhe veprimtar për të drejtat e njeriut, njëherësh pjesëtar i lëvizjes *Solidarnost*). GKKNH kishte edhe bashkëpunëtor të jashtëm: Shkëlzen Kukleci (sociolog, aktivist i të drejtave të njeriut dhe simpatizant i LPK-së, i cili që në vitet 1970 kishte krijuar miqësi me Berit Backerin, gjatë periudhës kur ajo zhvillonte një studim socialantropologjik në fshatin Isniq të Kosovës) etj.[62]

Faksimilja tjetër është një dokument nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit, që dëshmon se Grupi për Kosovën i Komitetit Norvegjez të Helsinkit nga viti 1990 arriti të ketë edhe status zyrtar në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, i riemëruar si Grupi për Ballkanin i Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH), me përgjegjësin e Grupit, Nufri Lekën, dhe koordinatoren e Grupit, Berit Backerin. Njëherësh kjo faksimile/dokument dëshmon se edhe projekti Aksioni Norvegji - Shqipëri (ANSh) kishte status zyrtar si pjesë integrale e Komitetit Norvegjez të Helsinkit, me përgjegjësen e këtij projekti Berit Backerin dhe koordinatorin e këtij projekti Nufri Lekën.

---

[62] Ndër mbështetësit/bashkëpunëtorët e tjerë të jashtëm të Grupit për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) ishin edhe aktivistët e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK-së): Ali Aliu, Hajrie Aliu, Isa Thaçi, Blerim Rexhepi, Jashar Etemaj, Qani Dehari dhe Afet Ismajli; si dhe simpatizantët e LPK-së: Jonuz Emini, Xhemadin Neziri, Rrahim Përçuku dhe Gëzim Haklaj, ky i fundit njëherësh deputet i Kuvendit të Kosovës, po ashtu edhe studentët e Universitetit të Oslos: Anila Hyka (IT), Anila Nauni (sociologji), Fisnik Bardudha (IT) dhe Najada Mandi (sociologji).

**Adresse liste for Kosovo-gruppen**

Pp

| Navn | Adresse | Telefon |
|---|---|---|
| Berit Backer | Baldersgt. 1 A<br>0263 Oslo 2 | P.449447<br>A.530890<br>F.449579 |
| Kristoffer Gjøtterud | Jacob Aallsgt. 45 A<br>0364 Oslo 3 | P.699715<br>A.456457<br>F.456422 |
| Nufri R. Lekaj | Enerhauggt. 3<br>0651 Oslo 6 | P.572977<br>P. Søker.<br>096 90022 |
| Tore Lindholm | Institutt for<br>Menneskerettigheter<br>St. Olavsgt. 29<br>0166 Oslo 1 | P.146262<br>A.111052<br>F.364801 |
| Pål Haugland | Grev Wedels plass 4<br>0151 Oslo 1 | P.299087<br>A.335815<br>F.335819 |
| Svein Mønnesland | Univeritetet i Oslo<br>p.b. 1028 Blindern<br>0315 Oslo 3 | P.461571<br>A.456351<br>F.454310 |
| Aleksander<br>Gleichegewicht<br><br>************************<br>************************ | Stasjonsveien 43<br>0385 Oslo 3<br><br>*********************<br>********************* | P.140669<br>F.570088<br><br>***********<br>*********** |
| Stein-Ivar Aarsæther | Fagerborggt. 40 A<br>N - 0360 Oslo 3 | P.606709<br>A.363500<br>F.363509<br>P. Søker<br>096 76725 |
| Bjørn Cato Funnemark | Ludvig Karstensvei 11<br>1064 Oslo 10 | P.326334<br>A.570070<br>F.570088 |
| Jaroslaw Pawlak | Elgtråkket 7 C<br>2014 Blystadlia | P.326334<br>A.570070<br>F.570088 |

**Den Norske Helsingforskomité**

**The Norwegian Helsinki Committee**

**Member of the International Helsinki Federation for Human Rights**

Oslo, January 2000

**TO WHOM IT MAY CONCERN**

Mr. Nufri Lekaj worked with the Norwegian Helsinki Committee in the period from 1990 to 1994, as a project-coordinator, establishing the so-called Action Norway-Albania, together with Ms. Berit Backer. In their work they succeeded in establishing a rehabilitation-center for victims of torture in Tirana, made a survey of living-standard among former political prisoners, organized humanitarian assistance, and established human rights education. The human rights education project later developed into the Albanian Human Rights Education Center in Tirana.

Mr. Nufri Lekaj was for a period responsible for the Balkan-group within the Norwegian Helsinki Committee, which established the basis for the later human rights engagement of the Committee in the Balkan area. During the period Mr. Nufri Lekaj worked for the Committee, he traveled extensively within the Balkan area, including up to 4 months every year in Albania.

In 1994 did Mr. Nufri Lekaj leave his position within the Committee to start studies at the Norwegian School of Journalism.

We strongly appreciate the work Mr. Nufri Lekaj did within the Norwegian Helsinki Committee. The work of Mr. Nufri Lekaj was always done according to the highest standards and he showed a remarkable high quality of understanding concerning the Balkan situation.

Mr. Bjørn Engesland
Secretary-General
Norwegian Helsinki Committee

**Den Norske Helsingforskomite**
**Urtegt. 50**
**N-0187 OSLO**

Faksimilja e tretë në vijim është e paraqitur si dokumentim i ndërlidhjes ndërmjet Grupit për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) dhe Lëvizjes

Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), e njohur mëpastaj si Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK). Konkretisht, bëhet fjalë për korrespondencë të zhvilluar përmes faksit ndërmjet Nufri Lekës, përgjegjës i GKKNH-së (njëherësh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LPRK-së, dega jashtë vendit), dhe Muhamet Kelmendit, nënkryetar i LPRK-së, dega jashtë vendit.



DEN NORSKE HELSINGFORSKOMITE

Kontoradresse:
Menneskerettighetshuset
Urtegt. 50
0187 Oslo 1

Postadresse:
Postboks 8261 Hammersborg
0129 Oslo 1

Tel. 02/57 00 70
Fax 02/57 00 88
Bankgiro 5001.06.26061
Postgiro 2 28 18 97

TELEFAX / FAXIMILE

Telefaxnr.: / Telefaxno.: 095-41-32-25-44-23

Til: / To: LEVIZJA POPULLORE PER REPUBLIKEN E KOSOVES

Ant. sider: / No. of pages: 4

ATTN.: Muhameti

Fra: / From: Nufri R. Leka
Enerhauggt. 3
0651 - OSLO 6
Norway

Dato: / Date: 30/8-90

☎ : +47-2-57-29-77; priv.fax: +472449579

Grupi për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH) e mbështeti politikën paqësore të Kosovës përmes shkrimeve në medie dhe pjesëmarrjes

në konferenca ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por edhe nëpërmjet shkresave të shumta apeluese drejtuar strukturave relevante të procesit të Helsinkit. Këto apele synonin që politika paqësore e Kosovës, e udhëhequr nga misionari vizionar i paqes, Ibrahim Rugova, të merrej seriozisht nga bashkësia ndërkombëtare, në mënyrë që Republika e Kosovës të mos neglizhohej në kuadër të vendimeve që merren për Jugosllavinë. Madje theksohej se, nëse shqiptarët vazhdonin të shpërfilleshin, ata do të detyroheshin të ndiqnin një rrugë që të gjithë duhet të përpiqeshin ta parandalonin: një konflikt të armatosur me pushtetin kolonial serb.

Në fakt, GKKNH-ja e ka mbështetur politikën paqësore të Kosovës deri në vitet 1993–1994, përkatësisht deri në momentin kur u bë e qartë se çështja e Kosovës nuk do të përfshihej në agjendën ndërkombëtare për zgjidhje, konkretisht as në kuadër të Konferencës së Dejtonit. Po këto vite, 1993–1994, përkonin edhe me vendimet gjithnjë e më të qarta dhe më konkrete të LPK-së për fillimin e rezistencës së armatosur, si dhe me vendimin e themelimit formal /emërtimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Si një ndër shembujt se GKKNH ka mbështetur politikën paqësore të Kosovës, në vijim një nga shkrimet e përgjegjësit të GKKNH-së, Nufri Lekës, i përkthyer në gjuhën shqipe, i vitit 1991, i botuar në gazetën zyrtare APEL të Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Më tutje në vijim është edhe faksimilja e këtij shkrimi në origjinal.

Vlen të përmendet se disa nga shkrimet për Kosovën në gazetën zyrtare APEL të KNH-së përktheheshin në

gjuhën angleze dhe shpërndaheshin si informacion në kuadrin e "Procesit Civil të Helsinkit" (përkatësisht në kuadrin e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit - FNH-së etj.), dhe në kuadrin e "Procesit Ndërshtetëror të Helsinkit" (përkatësisht delegacioneve të shteteve perëndimore në kuadrin e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – KSBE-së etj.).

GAZETA ZYRTARE E KOMITETIT NORVEGJEZ TË HELSINKIT, APEL, nr. 2, 1991,

Publikuar nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit

Kosova dhe shqiptarët, të harruar nga Evropa

Nga Nufri R. Lekaj

Kohët e fundit mediet e ndryshme kanë raportuar dhe sjell pamje të shumta nga zonat e konfliktit në Jugosllavi, duke fokusuar veçanërisht në Kroaci dhe Slloveni dhe duke vënë në dukje se ky konflikt është një kërcënim për sigurinë në zonën e Ballkanit dhe për sigurinë e Evropës në përgjithësi.

Sa i përket situatës në Kosovë, vazhdojnë të ndodhin ato që tashmë i kemi lexuar dhe dëgjuar: dhuna, terrori dhe vrasjet dhe siç deklaroi profesori nga Beogradi, Vojin Dimitrievic, rishtazi në një mbledhje të hapur në Oslo: "Në Kosovë tani kemi një qëndrim të ashpër racist nga ana serbe kundër shqiptarëve". Në medie kemi shumë pak informacion rreth situatës në Kosovë, sepse

Kosova është lënë nën hije për shkak të luftës në Kroaci. Perëndimi, sidomos BE-ja, janë të angazhuara për një zgjidhje paqësore të konfliktit në Jugosllavi, por një zgjidhje e tillë nuk është e mundshme përderisa nuk merret seriozisht situata në Kosovë dhe përderisa nënvlerësohet dëshira e shqiptarëve për të qenë të pranishëm në negociata. Një zgjidhje paqësore e konfliktit në Jugosllavi nuk do të ketë sukses në qoftë se nuk merren parasysh kërkesat e shqiptarëve në Kosovë. Kërkesat e shqiptarëve të Kosovës janë të moderuara, sepse qëllimi i shqiptarëve nuk është shkatërrimi i Jugosllavisë, por barazia me popujt e tjerë në një union të lirë - jugosllav, i përbërë nga shtetet sovrane që janë të pavarura në politikat e tyre të brendshme dhe të jashtme.

Marrëveshja për unionin do t'i sigurojë kufijtë e unionit dhe do ta krijojë bazën për një treg të përbashkët ekonomik. Shqiptarët janë të vetëdijshëm se në situatën që gjenden sot, e kanë të pamundur të formojnë një shtet që përfshin tërë popullin shqiptar në Jugosllavi. Pakicat në Jugosllavi janë të kurdisura të vazhdojnë të jetojnë në republikat e Jugosllavisë. Prandaj, një marrëveshje e unionit e ngulitur në të drejtën ndërkombëtare e krijon bazën për sigurinë e të drejtave të minoriteteve.

Si shembull për këtë mund t'i referohemi Kushtetutës së re të Republikës së Kosovës e miratuar nga Parlamenti i Kosovës më 15.09.90, e cila nuk njihet nga forcat okupuese serbe: "Kosova është republikë demokratike e përbërë nga shqiptarët (90 %), serbët dhe pakicat e tjera kombëtare (10 %) si bartës të sovranitetit të Republikës". Duhet ripërsëritur se përpjekjet e shqiptarëve

të Kosovës nuk kanë qenë kurrë të drejtuara për ta shkatërruar Jugosllavinë, por gjithnjë kanë qenë përpjekje për pavarësinë dhe barazinë e shqiptarëve në raport me republikat e tjera. Këto përpjekje u kanë kushtuar shqiptarëve shumë, në veçanti në 10 vjetët e fundit. Disa qindra janë vrarë gjatë demonstratave dhe protestave, qindra të tjerë janë plagosur dhe mijëra të tjerë janë burgosur dhe internuar për veprimtari politike. Përafërsisht 100 000 shqiptarë janë përjashtuar nga vendet e tyre të punës (nga sistemi gjyqësor, administrata, shëndetësia, policia, posta, universiteti, shkollat etj.) për shkak të bindjeve të tyre politike. Tani në këto vende të punës, në vend të shqiptarëve, janë kyçur kolonialistët serbë, të cilët marrin paga të dyfishuara krahasuar me pagat që kishin shqiptarët në këto vende të punës. Rrjedhimisht, Kosova është një "Territor autonom" i okupuar nga një fuqi koloniale me emrin "Shteti i Serbisë". Republikat e tjera në Jugosllavi e kanë ekskluduar Kosovën dhe shqiptarët në përpjekjet për një zgjidhje të konfliktit në Kosovë. Shqiptarët e kanë kuptuar këtë qëndrim të republikave të tjera jugosllave (të populluara kryesisht me banorë me origjinë sllave) që nënkupton se nuk dëshirojnë t'i pranojnë shqiptarët të jenë të barabartë me popujt e tjerë në një Jugosllavi të re, duke i lënë kështu shqiptarët të mbesin një koloni e Serbisë. Mbas një përpjekje nga ana e Perëndimit, shqiptarët filluan të shpresojnë për një të ardhme më të mirë. Këshilli i Evropës i ka dënuar shkeljet e të drejtave të njeriut nga regjimi serb në Kosovë. Të njëjtën gjë e ka bërë Kongresi Amerikan, gjithashtu

edhe partitë politike dhe organizatat për të drejtat e njeriut. Shqiptarët me udhëheqjen e tyre demokratike dhe "Gandin e shqiptarëve", dr. Ibrahim Rugova, kanë krijuar simpati në vijën e tyre politike kundër regjimit shtypës serb.

Pavarësisht prej provokimeve dhe represioneve nga ana serbe, asnjë serb në Kosovë nuk është dëmtuar, plagosur ose vrarë nga shqiptarët. Kjo tregon se me çfarë lloj konflikti kemi të bëjmë: një luftë e pastër çlirimtare me mjete demokratike kundër një pushtuesi kolonialist. Shpresat e shqiptarëve për ndihmë nga Perëndimi kanë filluar të zbehen. BE-ja i ka ftuar të gjitha republikat jugosllave në negociatat në Hagë, por ka harruar ta ftojë edhe republikën e shtatë, Republikën e Kosovës. Pse? A duhet Kosova të sakrifikohet për interesat serbe dhe kroate? A do ta përsëritë Evropa, Londrën dhe marrëveshjen e Versajës për Jugosllavinë, e përsëri t'i sakrifikojë shqiptarët për Serbinë?

Ky neglizhim ndaj shqiptarëve në Jugosllavi tregon se BE-ja po e përgatit një marrëveshje të re për Jugosllavinë, që nuk merr parasysh interesat e shqiptarëve. Në Londër dhe Versajë ka qenë më e lehtë për të bërë këtë. Por tani situata është krejtësisht ndryshe në Evropë, ku demokracia dhe liria janë fjalët më të dashura të kombeve të shtypura dhe do të jetë e vështirë për çdo shtet tjetër dhe për BE-në për të luajtur me fatin e popujve të shtypur. Në veçanti kur është fjala për shqiptarët, kjo është një lojë e rrezikshme. Nuk duhet të harrohet se shqiptarët në Jugosllavi janë populli i tretë për nga madhësia demografike (3 milionë) sa e gjithë popullsia

në Shqipëri. Nëse vazhdohet të shpërfillen shqiptarët, ata do të detyrohen për atë që ne të gjithë duhet të përpiqemi ta parandalojmë, për një konflikt të armatosur me pushtetin kolonial serb. Një situatë e tillë mund të çojë edhe në ndërhyrjen nga Shqipëria për t'i ndaluar krimet e luftës ndaj shqiptarëve në Kosovë (çfarë teknologjie ushtarake ka Serbia tregohet edhe nëpërmes eksportit të armëve të Serbisë në Irak). Është e qartë se nuk dëshirojmë të ndodhë një zhvillim i tillë në Ballkan. Prandaj është shumë e rëndësishme për të gjitha palët në tryezën e bisedimeve të mos i harrojnë shqiptarët të cilët kanë vullnet për bashkëpunim dhe duan të marrin pjesë në negociata.

Në vijim, faksimilja e këtij shkrimi në origjinal:



APPELL

Utgitt av Den Norske Helsingforskomité — APPELL NR. 2 1991

## Kosovo og albanerne glemt av Europa

**Av Nufri R. Lekaj**

Den siste tiden har vi sett mange nyhetsbilder fra konfliktområdene i Jugoslavia med spesiell vekt på det som skjer i Kroatia og Slovenia. I den forbindelse påpekes det at konflikten er en trussel mot sikkerheten i området og Europa forøvrig.

Når det gjelder Kosovo tenker vi på det vi tidligere har lest og hørt: vold, terror og drap, og som professor Vojin Dimitrievic fra Beograd nylig uttalte på et åpent møte i Oslo: «I Kosovo har vi nå en sterk rasistisk holdning fra serbisk side mot albanerne». Vi får altfor lite informasjon i norske media om hva skjer i Kosovo, fordi det kommer i skyggen av krigen i Kroatia. Vesten og særlig EF er engasjert for en fredelig løsning av konflikten, men man blir usikker på mulighetene til en slik løsning når man undervurderer albanerne og deres ønske om å være tilstede under forhandlingene. En fredelig løsning på konflikten i Jugoslavia vil ikke lykkes hvis man ikke tar hensyn til det albanerne i Kosovo dag krever, og dette er moderate krav. Albanerne vil at Jugoslavia skal bevares innenfor dagens grenser og omorganiseres til å bli en løs union av suverene stater med selvstendig utenriks- og innenrikspolitikk. Albanerne krever likestilling i en «Ny» Jugoslavisk Union.

Unionsavtalen skal sikre unionens grenser og danne grunnlag for et felles økonomisk marked. Albanerne vet idag at det er helt umulig å danne en stat som kan samle en hel nasjon. Folkegruppene i Jugoslavia er innstilt på at de kan få leve i forskjellige jugoslaviske republikker. Det forutsettes en avtale, med hjemmel i internasjonal lov, som skal danne grunnlaget for en forsikring om minoritetenes rettigheter.

Som eksempel kan det refereres til «Den nye Kosovo republikkens grunnlov» som ble vedtatt av parlamentet i Kosovo den 15.09.90 og som ikke er anerkjent av den serbiske okkupasjonsmakten i Kosovo: «Kosovo er en demokratisk republikk bestående av albanere (90%), serbere og andre (10%) folkegrupper (man har benyttet dette isteden for minoriteter) som bærer republikkens suverenitet». Det må påpekes at albanerne aldri har krevd løsrivelse fra Jugoslavia og at deres kamp har vært rettet mot selvstendighet og likestilling innenfor den jugoslaviske union. Dette kravet har imidlertid blitt en kostbart krav for Kosovo og albanerne de siste 10 år. Noen hundre har blitt drept under demostrasjoner og folkemøter, flere hundre har blitt såret og tusenvis har blitt fengslet på politisk grunnlag og internert. Ca. 100 000 har blitt oppsagt fra sine stillinger på politisk grunnlag (postverket, rettsvesen, administrasjon, helsevesen, politi, universitetet, skoleverket osv.) I disse stillingene er det nå bare serbiske kolonialister som mottar dobbelt så stor lønn som da det var kosovo-albanere i disse stillingene. Kosovo er idag et «autonomt område» som okkuperes av en kolonimakt med navnet «Den Serbiske stat». Kosovo og albanerne har blitt ekskludert av andre republikker i Jugoslavia i de resultatløse forhandlingene om en løsning av konflikten i Kosovo. Albanerne har forstått denne holdningen fra de andre jugoslaviske republikkene (alle av slavisk opprinnelse) slik at de ikke er villige til å ha albanerne i et nytt Jugoslavia og at disse skal etterlates i en serbisk koloni på Balkan. Etter en innsats fra Vesten begynte albanerne igjen å håpe på en bedre fremtid. Europarådet har fordømt Serbia for grove brudd på menneskerettighetene i Kosovo. Det samme har Kongressen i USA og mange andre, såvel politiske partier som menneskerettighetsorganisasjoner. Albanerne med sin demokratiske ledelse og «albanernes Ghandi» professor Ibrahim Rugova har tjent mye på den politiske linje mot det harde serbiske undertrykkelsesapparatet.

Uansett provokasjonene fra serbisk side i Kosovo har ingen serber blitt skadet eller såret av albanerne. Dette viser hvilken type konflikt man har å gjøre med her: en ren frigjøringskamp med demokratiske midler mot en kolonimakt. Det håp som albanerne har hatt i forhold til Europa og verdenssamfunnet forøvrig har nå begynt å svinne. EF har innkalt alle de jugoslaviske republikkene til forhandlinger i Haag, men de glemte å innkalle den syvende jugoslaviske republikken Kosovo. Hvorfor? Skal Kosovo ofres for serbiske og kroatiske interesser ?. Skal Europa forsøke å gjenta London- og Versailes-avtalen om Jugoslavia, og igjen ofre albanerne for Serbia ?.

Denne neglisjeringen av albanerne i Jugoslavia viser at EF forbereder en ny avtale om Jugoslavia uten å ivartea albanernes interesser. I London og Versailles var dette dengang lettere å gjøre. Men nå når situasjonen er en helt annen i et Europa hvor demokrati og frihet er de mest elskede ord for undertrykte nasjoner, blir det vanskelig for en hvilken som helst stat eller EF å neglisjere de enkelte folkegruppers skjebne. Ikke minst når det gjelder albanerne er dette et farlig spill. Man skal ikke glemme at albanerne er det tredje største folkeslag i Jugoslavia (3 millioner). Det er like mange som hele befolkningen i Albania. Hvis man setter albanerne utenfor kan de bli tvunget til, hva vi alle må forsøke å forhindre, en væpnet konflikt med den serbiske kolonimakten. Dette kan igjen føre til at Albania griper inn for å stanse nedslaktingen av albanerne i Kosovo (Hvilken militærteknologi Serbia besitter vises ikke minst gjennom deres eksport av våpen til Irak). Det er innlysende at man ikke ønsker en slik utvikling på Balkan. Det er derfor meget viktig for alle parter ved forhandlingsbordet å ikke glemme albanerne som er samarbeidsvillige og ønsker å delta i forhandlinger.

Në cilësinë e përgjegjësit të GKKNH-së, Nufri Lekës nga viti 1988 i jepej mundësia që si delegat nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit (KNH) të takojë nëpër konferenca ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, personalitete me influencë politike, në të cilat e shfrytëzonte rastin në maksimum edhe gjatë bisedave joformale, duke i informuar më hollësisht për shkeljet e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi dhe duke dhënë argumente për kërkesën me mjete paqësore "Kosova Republikë" si zgjidhje kompromisi dhe si zgjidhje që stabilizon politikisht Ballkanin. Përveç të tjerash, në kuadër të kësaj veprimtarie, në cilësinë e përgjegjësit të GKKNH-së, Nufriu u ftua të marrë pjesë edhe në mbledhjen themeluese të Asamblesë Qytetare të Helsinkit në Pragë, prej datës 18 deri më 21 tetor 1990, e cila ishte e sponsoruar nga një ndër iniciuesit e saj, Vaclav Havel, i cili, ashtu sikurse disidenti tjetër çek Jarosllav Shabata, në mënyrë implicite ishin për krijimin e strukturave të reja panevropiane, që nënkuptonte një riorganizim panevropian, duke filluar nëpërmes Asamblesë Qytetare të Helsinkit. Edhe GKKNH e përkrahte këtë ide, ngaqë shpresohej se Kosova do të mund të faktorizohej politikisht nëpërmes konceptit të të drejtave të njeriut, duke u anëtarësuar në një ristrukturim të ri organizativ panevropian në përpjekjet për t'u dekolonizuar nga Serbia në bazë të parimit për vetëvendosje. Por, ideja e sllovenit Tomazh Mastnak u mbështet më shumë, që Asambleja Qytetare e Helsinkit të mbetet një organizatë e asociacioneve të ndryshme joqeveritare të qytetarëve. Në kuadër të kësaj mbledhje, më 20 tetor u mbajt një tribunë e veçantë për Kosovën, Irlandën

veriore dhe Transilvaninë, ku Nufriu i bëri një kritikë qasjes që dominonte në diskursin e politikës perëndimore që, duke u thirrur në emër të një Evrope të bashkuar dhe të integruar, njëkohësisht ndërkomunikohej e drejta për vetëvendosje për shqiptarët në Jugosllavi. Rrjedhimisht, shpresën për një Evropë të bashkuar dhe të integruar, që parashihte ta përfshinte edhe Ballkanin dhe që nuk merrte parasysh zgjidhjen e çështjes shqiptare në Jugosllavi, në fjalimin e tij në këtë tribunë, Nufriu e cilësoi si: një eufori utopike që vetëm zëvendëson euforinë utopike të socializmit nga e cila mezi kishim dalë dhe se nuk guxojmë të mashtrohemi prapë, sidomos ne shqiptarët, sepse pa u zgjidhur çështjet e pazgjidhura nacionale në Evropë, në veçanti çështja shqiptare në Jugosllavi, nuk mund të shpresojmë për një Evropë të bashkuar dhe të integruar. I pranishëm ishte edhe delegacioni nga Kosova i kryesuar nga Shkëlzen Maliqi, i cili, në lidhje me këtë mbledhje themeluese të Asamblesë Qytetare të Helsinkit në Pragë (përfshirë edhe një pjesë të këtij prononcimi të Nufriut), ka shkruar dhe botuar një shkrim në gazetën "Koha" më 3 nëntor 1990. Në vazhdën e kësaj veprimtarie, Nufriu, përveç të tjerash, merr pjesë edhe në konferencën në Veronë (Itali) prej 17 deri më 20 shtator 1992, e ashtuquajtur "Forumi për Paqe dhe Pajtim në ish-Jugosllavi" ku, përveç të tjerëve, morën pjesë përfaqësues nga Federata e Helsinkit. Konferenca u udhëhoq nga një komitet prej 13 personash, në krye me Alexander Langer (anëtar i Parlamentit Evropian dhe president i Grupit Greens/EFFA në Parlamentin Evropian) dhe nga znj. Marijana Grandits nga Austria. Konkretisht,

konferenca kishte të bënte me propozimet për gjetjen e zgjidhjes së krizës politike në Jugosllavi.[63] Në këtë konferencë në delegacionin nga Norvegjia, Nufriu ishte së bashku me profesorin e filozofisë, Tore Lindholm. Gjatë kësaj konference, në kuadër të delegacionit skandinav, Nufriu pati rastin të marrë pjesë në një darkë joformale me Alexander Langer dhe gjatë një bisede me të, duke menduar se është norvegjez dhe, pasi e kuptoj se ishte shqiptar, u bë kurioz të dijë më shumë për Kosovën dhe, përveç të tjerash, u argumentua se kërkesa "Kosova Republikë nënkupton zgjidhjen më të mirë të problemeve serioze të të drejtave të njeriut në Jugosllavi".

Si orientim më konkret në lidhje me pjesëmarrjen e përgjegjësit të GKKNH-së në konferenca ndërkombëtare dhe vendore (brenda Norvegjisë), në vijim paraqiten dy faksimile. E para është shkrimi i Shkëlzen Maliqit (3 nëntor 1990), i cili lidhet me pjesëmarrjen në mbledhjen themeluese të Asamblesë Qytetare të Helsinkit në Pragë. E dyta pasqyron pjesëmarrjen në sesionin e Forumit për të Drejtat e Njeriut në Oslo, me temë Ballkanin/Jugosllavinë.

[63] *"Konklusjoner fra Veronakonferansen"*, *Appell*, nr. 1 (1993), Den norske Helsingforskomité, Oslo.



T NORSKE MENNESKERETTIGHETSHUSET
THE NORWEGIAN HUMAN RIGHTS HOUSE

Den Norske Helsingforskomité
Solidaritet Norge - Polen
Norsk P.E.N

Kjære medlemmer og andre interesserte!

Oslo, 26. april 1991

MØTE I MENNESKERETTS FORUM. TEMA: BALKAN. 30/4 KL. 17.30

Vi minner om vårt anonserte møte (i nyhetsbrev nr. 2/1991) et møte i Menneskeretts Forum 30. april klokken 17:30. Tema Balkan.

Som innledere om Balkan/Jugoslavia problematikken er professor Svein Mønnesland fra Universitetet i Oslo; Ivan Poljac representant for Kroatisk Forbund Norge; Nufri R. Lekaj fra Den Norske Helsingforskomité Kosovo-gruppen; Halvor Tjønn fra Aftenposten og Stein Ivar Aarsæther styreleder for Det Norske Menneskerettighetshuset som ordstyrer.

Det blir adgang til å kjøpe øl, mineralvann, rødvin og noe å spise.

Alle er hjertelig velkommen til en frisk debatt og sosialt samvær.

Med vennlig hilsen

Sissel H. Føyn
Daglig Leder

**SHTËPIA NORVEGJEZE E TË DREJTAVE TË NJERIUT**
THE NORWEGIAN HUMAN RIGHTS HOUSE

**Të dashur anëtarë dhe të gjithë të interesuarit!**

Oslo, 26 prill 1991

**SESION I FORUMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT. TEMA: BALLKANI. 30/4, ORA 17:30**

Ju rikujtojmë sesionin tonë të shpallur (në buletinin nr.

2/1991), një sesion i Forumit të të Drejtave të Njeriut, që do të mbahet më 30 prill në orën 17:30. Tema: Ballkani.

Si folës mbi problematikën e Ballkanit/Jugosllavisë do të jenë: profesori Svein Mønnesland nga Universiteti i Oslos; Ivan Poljac, përfaqësues i Asociacionit Kroat në Norvegji; Nufri R. Lekaj nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit, Grupi i Kosovës; Halvor Tjønn nga gazeta Aftenposten; si dhe Stein Ivar Aarsæther, kryetar i bordit të Shtëpisë - Norvegjeze të të Drejtave të Njeriut, në rolin e moderatorit.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të blejnë birrë, ujë mineral, verë të kuqe dhe ushqime të lehta.

Të gjithë janë të mirëpritur ngrohtësisht për një debat të fuqishëm dhe takim social.

Me nderime,

Sissel H. Føyn
Drejtoreshë Ekzekutive

Njëkohësisht, vlen të përmendet se pas iniciativës dhe insistimit të vazhdueshëm të Nufriut në Komitetin Norvegjez të Helsinkit, por edhe sqarimit të perspektivës politike për çështjen e shqiptarëve në ish-Jugosllavi (të cilët për dallim të popujve të tjerë në Jugosllavi ishin përcaktuar për zgjidhje të problemeve politike me mjete paqësore), në mbledhjen vjetore të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, mbajtur në godinën e parlamentit norvegjez më 19.03.1991, sekretari gjeneral i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Bjørn Catto Funnemark, propozon publikisht, dhe unanimisht aprovohet si një nga pikat e "këshillimit" të politikës së jashtme norvegjeze: "Kosova Republikë është zgjidhja më e mirë e problemeve serioze e të drejtave të njeriut në Jugosllavi". Ky amendamentim nga ana e një organizate pothuajse gjysmështetërore ishte shumë i rëndësishëm për kohën, mbase rasti i parë kur bëhen propozime për zgjidhje politike, dhe një forcim i ndikimit lobist dhe i diplomacisë joformale të Kosovës në Norvegji, në përgjithësi në Skandinavi, dhe në kuadër të Procesit Civil të Helsinkit (Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit).

Në lidhje me këtë, si dëshmi orientuese dhe konkrete, në vijim paraqitet faksmilja - përkatësisht shkrimi/lajmërimi i Nufriut, i botuar në gazetën *Shkëndija* në prill 1991, ku jepet informacion mbi vendimin e Komi-tetit Norvegjez të Helsinkit të datës 19 mars 1991.:



4 Shkëndija
PRILL 1991

ENKAS PËR «SHKËNDIJËN»

## NORVEGJIA FILLON TË REAGOJË

Populli shqiptar në Jugosllavi publikisht dhe juridikisht bëri deklarimin e vet rreth zgjedhjes së fatit të vet, zgjedhje që në mënyrë paqësore dhe njerëzore u kurorëzua me shpalljen e Kosovës shtet të pavarur në kuadër të federatës apo konfederatës jugosllave.

Këtë vendim historik të shpalljes juridike të shtetit të dytë shqiptar, politika serbe shpejt e shpalli jo të ligjshëm, sepse qenka bër në ilegalitet, por ato vendime historike bota i regjistroi me një interesim të madh dhe me simpati ndaj luftës paqësore të popullit shqiptar në Jugosllavi. Si rezultat i kësaj ishin shumë deklarata e rezoluta nga të gjitha anët e botës.

E tillë ishte Rezoluta e miratuar më 19 mars 1991 në Oslo të Norvegjisë prej anës të KOMITETIT KOMBËTAR NORVEGJEZ TË FEDERATËS SË HELSINKUT — për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Kongresi KKNH u mbajt në sallën e plotë të Parlamentit Norvegjez (Stortinget). Për të treguar për rëndësinë e këtij vendimi duhet shpjeguar se çfarë roli luan KKNG në relacion me politikën e jashtme të Norvegjisë në përgjithësi e në fushën e të drejtave të njeriut në veçanti të cilat shikohen përmes prizmit të Marrëveshjes së Helsinkit, që në realitet është një akt politik dhe çdo shtet që bie nën thumbin e kritikës të KKNH vëhet për refleksin e politikës norvegjeze ndaj atij shteti (kushtetuta Norvegjeze ndërtohet në tri themele kryesore e njëri ndër to është e drejta dhe liria e plotë e njeriut). Në anën tjetër, KKNH në radhët e veta ka personalitete të rëndësishme politike (P.sh Reulf Steen, nënkryetar i partisë në pushtet Arbeiderpartis) që është zgjedhur kryetar këshilli të KKNH-s, njerëz nga jeta kulturore, e humanistë të njohur që deri dje kanë qenë në Komitetit për dhënien e Çmimit Nobël për paqe.

Prandaj, rezoluta e miratuar është një vendim dmth. si fillim i reagimit zyrtar të shtetit norvegjez në lidhje me Republikën e Kosovës.

Për ta bërë të njohur këtë rezolutë po e shënojmë të përkthyer nga norvegjishtja:

**«IV rezolutat**

JUGOSLLAVIA/KOSOVA: Kongresi i KKNH-së kërkon që të gjithë të burgosurit politikë të lirohen menjëherë. Tani gjenden më shumë se 100 të burgosur politikë në Jugosllavi — që të gjithë shqiptarë nga Kosova.

Kongresi i KKNH kërkon nga Qeveria (norvegjeze) ta diskutojë këtë dhe shkeljet e tjera të rënda të njeriut në mënyrë direkte me pushtetin në Beograd. Kongresi posaçërisht veçon sjelljen e gjendjes së urisë te shqiptarët në Kosovë dhe mbylljen e shkollave dhe të universitetit në gjuhën shqipe.

Kongresi i KKNH-së mendon se shqiptarëve duhet t'u jepen të drejta të barabarta si popujve të tjerë në Jugosllavi. KKNH mendon se ky është kusht i domosdoshëm, i cili do të sjellë deri zbutjen e situatës në vend. Kongresi i KKNH-së mendon se kërkesa për Republikën e Kosovës në kuadër të federatës apo konfederatës jugosllave është një kërkesë e drejtë, e cila do ta zbutë situatën e tendosur në Jugosllavi».

Nga kjo Rezolutë shihet se Evropa përkrah ngadalë kërkesat tona dhe ngadalë ia paguan borxhet e veta popullit shqiptar. Mirëpo, ne duhet të përgatitemi mirë që të jemi ata të cilët kurorëzojnë fitoret e bota duhet t'i përkrahë, sepse ne jemi ata që duhet përkrahur, se bëjmë luftë paqësore dhe të drejtë. Kushti kryesor për t'ia dalë punës në fund është vendosmëria jonë për të shkuar më tutje dhe jetësuar vendimet e Kaçanikut. Posaçërisht kjo vendosmëri na duhet tani kur si shumë herë më parë fatin e Jugosllavisë e vendosin serbët dhe kroatët, por tani s'ka vendim që do të jetë koherent pa dëshirën e popullit shqiptar. Këtë e ka kuptuar bota e shpresojmë se do ta kuptojnë edhe serbët e kroatët.

Nufri R. LEKAJ
Oslo, Norvegji

Çështja e Kosovës nuk arriti të imponohej për zgjidhje në kuadër të Konferencës së Dejtonit pavarësisht prej përpjekjeve të gjithanshme që zhvilloheshin që para shembjes së murit të Berlinit. Këto përpjekje u artikuluan dhe u shtrinë përmes degës së LPK-së jashtë vendit, përfshirë Grupin për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, i ndërlidhur me LPK-në, si dhe angazhimin e rëndësishëm, në kohë dhe hapësirë, të disa strukturave të tjera të ish-emigracionit politik shqiptar, të themeluara para shembjes së murit të Berlinit: Organizatës "Rinia Shqiptare-Kosovare në Botën e Lirë" në Nju-Jork; Klubit Kombëtar "Jusuf Gërvalla" në Nju-Jork, i cili për një periudhë funksionoi

si degë e LPK-së; Besëlidhjes Kombëtare Demokratike Shqiptare në Shtutgart; Komitetit të Kosovës për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Bruksel; Komitetit të Kosovës për Informimin e Opinionit Botëror në Gjenevë, që rezultoi nga strukturat e LPK-së; Shoqatës "Migjeni" në Lubjanë; dhe Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, ndër të tjera. Duke përfshirë edhe përpjekjet e shtuara dhe vendimtare pas shembjes së murit të Berlinit - të zhvilluara përmes Këshillit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Prishtinë, Komitetit Kosovar të Helsinkit, Lidhjes Demokratike të Kosovës, Qeverisë së Kosovës në ekzil, degëve të LDK-së në diasporë, Komitetit të Kosovës në Paris dhe Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan, ndër të tjera, duhet veçuar veçanërisht angazhimi me ndikim të madh i presidentit Ibrahim Rugova, i cili, me vizionin e tij politiko-diplomatik dhe përkushtimin ndaj rrugës paqësore, dha kontribut vendimtar në ndërkombëtarizimin maksimal dhe afirmimin ndërkombëtar të çështjes së Kosovës.

Edhe pse përmes këtyre përpjekjeve nuk u arrit që çështja e Kosovës të përfshihej për zgjidhje në kuadër të Konferencës së Dejtonit, ky angazhim ishte thelbësor për ndërkombëtarizimin dhe afirmimin e plotë të Kosovës, si dhe për krijimin e një baze të fuqishme legjitimiteti politik dhe moral mbi të cilën më vonë u mbështet dhe u legjitimua lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si mjet i fundit dhe katalizator drejt çlirimit të vendit.

Pas përfundimit të Konferencës së Dejtonit në vitin 1995 dhe çlirimit të Kroacisë me forcat e veta, në Kosovë filluan të shtoheshin aksionet e armatosura të

UÇK-së pavarësisht prej numrit ende të kufizuar të pjesëtarëve të saj. Gjatë vitit 1997 UÇK-ja pësoi disa goditje të njëpasnjëshme nga forcat serbe; megjithatë, veprimtaria e saj vazhdoi, duke arritur së shpejti të shfaqej hapur para opinionit publik. Një moment kyç në këtë drejtim ishte 28 nëntori 1997, kur në Llaushë të Drenicës, gjatë varrimit të mësuesit Halit Gecaj, i vrarë nga forcat policore serbe, tre komandantë të UÇK-së - Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi dhe Daut Haradinaj - u paraqitën publikisht në prani të një numri të madh qytetarësh. Kjo paraqitje u interpretua si dalja e parë e hapur e UÇK-së në skenën publike, duke sinjalizuar kalimin e saj nga veprimtaria e fshehtë në një fazë të deklaruar të rezistencës së armatosur. Megjithatë, edhe pas kësaj ngjarjeje, në qarqe ndërkombëtare vazhdonin të ekzistonin dyshime lidhur me ekzistencën dhe përmasat reale të UÇK-së. Në këtë rrethanë u vlerësua si e domosdoshme që ekzistenca e UÇK-së të mos vihej më në pikëpyetje dhe që mbështetja për të të zgjerohej, veçanërisht në mesin e diasporës shqiptare. Rrjedhimisht, më 9 dhjetor 1997, Nufri Lekaj, në cilësinë e bashkëpunëtorit të afërt dhe me miratimin e Sektorit të Rëndësisë së Veçantë të LPK-së / Shtabit Qendror të UÇK-së (por pa dijeninë dhe miratimin e përgjithshëm të LPK-së), dha deklaratë publike për radiotelevizionin shtetëror norvegjez (NRK) në përkrahje të UÇK-së. Qëllimi i deklaratës ishte të kontribuonte në afirmimin e UÇK-së si faktor real politik e ushtarak në drejtim të zgjidhjes së çështjes së Kosovës dhe t’i inkurajonte shqiptarët e diasporës për mbështetje më të gjerë ndaj saj. Deklarata u transmetua në mediet skandinave dhe

më gjerë, ndërsa u pasqyrua edhe në mediet shqiptare, përfshirë gazetat "Bujku" dhe "Rilindja", me tituj *"Mjetet skandinave të informimit rreth ekzistimit dhe aksioneve të UÇK-së"*[64] Në vijim janë fragmentet nga gazeta "Bujku" dhe nga gazeta "Rilindja" :



MJETET SKANDINAVE TË INFORMIMIT RRETH EKZISTIMIT DHE AKSIONEVE TË UÇK-së

# Edhe durimi e ka fundin

***Siç thekson gazeta norvegjeze "Dagens Nytt", në këtë shtet shqiptarët kanë filluar të grumbullojnë mjete dhe të regjistrohen vullnetarisht në radhët e UÇK-së***

Stokholm, 9 dhjetor

Ka disa ditë rresht që gati në të gjitha mjetet skandinave të informimit është duke u folur e shkruar për aksionet e ndërmarra të UÇK-së në disa mjedise të Kosovës, të cilat ishin të drejtuara kundër stacioneve dhe policëve serbë si dhe të bashkëpunëtorëve shqiptarë të kësaj policie. Edhe sot, duke shikuar lajmet e byrove të ndryshme informative, vërehet një interesim i shtuar i këtyre agjencive lidhur me ekzistimin apo mosekzistimin e UÇK-së. Po ashtu, sot në Kanalin e [illegible] parë të Radio Suedisë dhjetë minuta u trajtua kjo çështje, e cila si epilog pati faktin se dalja në sipërfaqe e UÇK-së është pasojë e një status kuoje që mbretëroi deri më tash si dhe të një dhune të paparë që po ushtron regjimi i Beogradit mbi popullin e pafajshëm shqiptar. Me një fjalë, u tha në këtë emision, edhe durimi e ka fundin. Ndërkaq, gazeta e përditshme autoritative norvegjeze "Dagens Nytt" shkruan sot se shqiptarët e Kosovës me banim në këtë shtet nordik po tubojnë mjete materiale dhe po regjistrohen vullnetarisht në radhët e UÇK-së.

Në këtë informatë, të cilën e konfirmuan edhe mjetet suedeze të informimit, thuhet se Nufri Leka është njëri ndër ata që bën pjesë në udhëheqjen e kësaj organizate, i cili për këtë gazetë thekson se UÇK-ja synim kryesor dhe të vetmin ka çlirimin e Kosovës nga Serbia. Po kështu bëhet me dije se edhe në një tubim të mbajtur në Malme të Suedisë rreth 200 bashkatdhetarë tubuan rreth 12 mijë korona për UÇK-në.

Do theksuar se sot në emisionin informativ në gjuhën shqipe "Ditari" të Radio-Suedisë u zhvillua një bisedë me një anëtar të Shtabit Qendror të UÇK-së, i cili u përqendrua në aksionet e fundit që i ndërmori kjo ushtri, me theks të veçantë në aksionin e 12 nëntorit në Llaushë të Skenderajt, në të cilin, siç tha ai, armiku pati humbje në njerëz dhe dëme të mëdha materiale, por, si gjithherë ai këto nuk i qiti në sipërfaqe nga frika që pati prej popullit të vet.

SH. ÇITAKU

"BUJKU"

10. XII. 97

---

[64] *Gazeta Bujku,* "Mjetet skandinave të informimit rreth ekzistimit dhe aksioneve të UÇK-së – Edhe durimi e ka fundin," 10 dhjetor 1997; "Siç thekson gazeta norvegjeze *'Dagens Nytt'*, në këtë shtet shqiptarët kanë filluar të grumbullojnë mjete dhe të regjistrohen vullnetarisht në radhët e UÇK-së. Ka disa ditë rresht që gati në të gjitha mjetet skandinave të informimit është duke u folur e shkruar për aksionet e ndërmarra të UÇK-së në disa mjedise të Kosovës, të cilat ishin të drejtuara kundër stacioneve dhe policëve serbë si dhe të bashkëpunëtorëve shqiptarë të kësaj policie. Edhe sot, duke shikuar buletinet e ndryshme informative, vërehet një interesim i shtuar i këtyre agjencive lidhur me ekzistimin apo mosekzistimin e UÇK-së. […] Në këtë informatë, të cilën e konfirmuan edhe mjetet suedeze të informimit, thuhet se Nufri Lekaj është njëri ndër ata që bën pjesë në udhëheqjen e kësaj organizate, i cili për këtë qëllim thekson se UÇK-ja synim kryesor dhe të vetëm ka çlirimin e Kosovës nga Serbia..."



MJETET SKANDINAVE TË INFORMIMIT RRETH EKZISTIMIT DHE AKSIONEVE TË UÇK-SË

# EDHE DURIMI E KA FUNDIN

Rilindja 11.12.97

**Siç thekson gazeta norvegjeze "Dagens Nytt", në këtë shtet shqiptarët kanë filluar të grumbullojnë mjete dhe të regjistrohen vullnetarisht në radhët e UÇK-së**

Ka disa ditë rresht që gati në të gjitha mjetet skandinave të informimit është duke u folur e shkruar për aksionet e ndërmarra të UÇK-së në disa mjedise të Kosovës, të cilat ishin të drejtuara kundër stacioneve dhe policëve serbë si dhe të bashkëpunëtorëve shqiptarë të kësaj policie. Edhe sot, duke shikuar lajmet e byrove të ndryshme informative, vërehet një interesim i shtuar i këtyre agjencive lidhur me ekzistimin apo mosekzistimin e UÇK-së. Po ashtu, sot në Kanalin e parë të Radio Suedisë dhjetë minuta u trajtua kjo çështje, e cila si epilog pati faktin se dalja në sipërfaqe e UÇK-së është pasojë e një status kuoje që mbretëroi deri më tash si dhe të një dhune të paparë që po ushtron regjimi i Beogradit mbi popullin e pafajshëm shqiptar. Me një fjalë, u tha në këtë emision, edhe durimi e ka fundin. Ndërkaq, gazeta e përditshme autoritative norvegjeze "Dagens Nytt" shkruan sot se shqiptarët e Kosovës me banim në këtë shtet nordik po tubojnë mjete materiale dhe po regjistrohen vullnetarisht në radhët e UÇK-së. Në këtë informatë, të cilën e konfirmuan edhe mjetet suedeze të informimit, thuhet se Nufri Leka është njëri ndër ata që bën pjesë në udhëheqjen e kësaj organizate, i cili për këtë gazetë thekson se UÇK-ja synim kryesor dhe të vetmin ka çlirimin e Kosovës nga Serbia. Po kështu bëhet me dije se edhe në një tubim të mbajtur në Malme të Suedisë rreth 200 bashkatdhetarë tubuan rreth 12 mijë korona për UÇK-në.

Do theksuar se sot në emisionin informativ në gjuhën shqipe "Ditari" të Radio- Suedisë u zhvillua një bisedë me një anëtar të Shtabit Qendror të UÇK-së, i cili u përqendrua në aksionet e fundit që i ndërmori kjo ushtri, me theks të veçantë në aksionin e 12 nëntorit në Llaushë të Skënderajt, në të cilin, siç tha ai, armiku pati humbje në njerëz dhe dëme të mëdha materiale, por, si gjithherë ai këto nuk i qiti në sipërfaqe nga frika që pati prej popullit të vet.

XH.ÇITAKU

Për më tepër, tendenca për ta neglizhuar ekzistencën e UÇK-së, si dhe spekulimet se UDB-a mund të qëndronte pas saj, ose se UÇK-ja ishte një organizatë terroriste, siç propagandohej nga regjimi serb me qëllim pengimin e mbështetjes ndërkombëtare, shkonin në dëm të UÇK-së, e cila përbënte shpresën dhe mundësinë e fundit të shqiptarëve të Kosovës për t'u çliruar nga pushtimi dhe shtypja e regjimeve shtetërore serbe që nga viti 1912. Si rrjedhojë, kishte rëndësi të veçantë që organizatat e huaja me kredibilitet të dëshmonin për karakterin vetëmbrojtës - çlirimtar të UÇK-së. Në këtë kontekst, vlen të theksohet roli i rëndësishëm i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, si organizatë këshilluese

për Ministrinë e Jashtme Norvegjeze dhe me ndikim në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit. Në fakt, sekretari i përgjithshëm i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Bjørn Engesland, ishte informuar drejtpërdrejt për gjendjen duke vizituar zonat e konfrontimeve të armatosura në Kosovë gjatë fundvitit 1997. Në shpjegimin e tij për gazetën norvegjeze "Dagsavisen", Engesland la të kuptohej se mundësia që UDB-a të qëndronte pas UÇK-së ishte e vogël dhe se ishte më e mundshme që bëhej fjalë për një rezistencë të armatosur me karakter vetëmbrojtës, në kuptimin që UÇK-ja përbëhej nga grupe të vogla të armatosura, të cilat donin t'i mbronin shtëpitë dhe familjet e tyre. Në lidhje me këtë, numri i gazetës norvegjeze "Dagsavisen", i datës 1 shkurt 1998, raportonte, ndër të tjera: *"Konfrontimi i armatosur në Llaushë, më 26 nëntor të vitit të kaluar, tregon se pas tij qëndron një grup i organizuar mirë - një organizatë që ia doli të ndalonte forcat serbe", thotë sekretari i përgjithshëm Bjørn Engesland nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit, i cili kohët e fundit ka qenë në këtë zonë. Ai vazhdon: "(...) Nuk kam dokumentacion që të them me siguri se ekziston UÇK-ja, por konfrontimi i armatosur në Llaushë tregon se pas tij qëndron ndonjë organizatë nga ana e shqiptarëve, dhe ata ia dolën të kryejnë një sulm ushtarak. (...) Ose është UÇK-ja ajo që qëndron pas këtyre sulmeve, ose janë grupe të vogla të pavarura të armatosura që duan të mbrojnë shtëpitë dhe familjet e tyre (...)."*[65]

---

[65] *Dagsavisen* (Norvegji), "Vil kjempe for friheten / Klart KLA eksisterer / Her ble serberne stanset", 1 shkurt 1998. Artikuj nga Elisabeth Salvesen dhe

Engesland ishte sekretar i përgjithshëm i Komitetit Norvegjez të Helsinkit për 25 vjet, nga 1995 deri në vitin 2020. Gjatë periudhës 1995–2002 ai shpesh rrezikonte jetën e tij me vizitat në Kosovë dhe në zona të tjera të ish-Jugosllavisë, me qëllim që të dëshmonte për të vërtetën mbi gjendjen e të drejtave të njeriut dhe zhvillimet politike në ish-Jugosllavi. Së bashku me Gjøtterud, Backer dhe disa aktivistë të tjerë të shquar, Engesland konsiderohet si një nga figurat më të rëndësishme të Procesit Civil të Helsinkit, e njohur ndryshe si Lëvizja Ndërkombëtare e Helsinkit. Ai e kishte filluar veprimtarinë që në vitet '70, duke marrë pjesë në demonstrata para ambasadës sovjetike në Oslo për lirimin e Yuri Orlovit dhe të burgosurve të tjerë politikë në Bashkimin Sovjetik. Ndër të tjera, ai u nderua me një çmim për kontributin e tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Rusi. Historiania dhe aktivistja e njohur ruse Lyudmila Alexeyeva, një nga disidentet e fundit sovjetike që mbeti aktive në Rusi pas rënies së murit të Berlinit, e cila kishte themeluar Grupin e Helsinkit të Moskës së bashku me Orlovin dhe të tjerë në vitin 1976, i dërgoi Engeslandit në vitin 2018 këtë mesazh përshëndetës: *"Jeta juaj është një shembull i shkëlqyer i shërbimit ndaj një qëllimi më të lartë dhe i bashkimit të rrallë midis idealizmit dhe profesionalizmit të lartë. Anëtarët e Grupit të Helsinkit të Moskës kanë qenë unanimë në dëshirën e tyre për t'ju nderuar me këtë shenjë simbolike vlerësimi për kontributin tuaj të jashtëzakonshëm në zhvillimin e lëvizjes për*

---

Erling Borgen, me intervistë dhe fotografi të Bjørn Engesland gjatë vizitës së tij në Kosovë.

*të drejtat e njeriut në Rusi. Do t'ju jem gjithmonë mirënjohëse që ishit ndër përfaqësuesit e parë perëndimorë që shprehët solidaritet me grupin e vogël të disidentëve në Moskë, të cilët sfidonin sistemin totalitar sovjetik, si dhe për faktin që ishit ndër themeluesit e Lëvizjes Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut."*[66] Si person non grata, i padëshiruar nga autoritetet ruse për shkak të angazhimit të tij në fushën e të drejtave të njeriut, Engesland e mori çmimin gjatë një konference për të drejtat e njeriut në Vilnius, Lituani, ku u takua me anëtarë të Grupit të Helsinkit të Moskës. Ai deklaroi: *"Jam shumë mirënjohës për këtë nderim që më vjen nga mbrojtësit më të guximshëm dhe më të përkushtuar të të drejtave të njeriut në Evropë. E ndaj këtë çmim me të gjithë aktivistët rusë që sakrifikuan jetën e tyre, me ata që ende e rrezikojnë jetën kundër padrejtësisë, si dhe me kolegët e mi të përkushtuar në Komitetin Norvegjez të Helsinkit (NHC)."*[67]

Në vijim është faksimilja e fragmentit të cituar më sipër nga gazeta norvegjeze "Dagsavisen", e datës 1 shkurt 1998. Në fotografinë e përfshirë në këtë fragment është Bjørn Engesland gjatë vizitës së tij në Kosovë, në fund të vitit 1997, në zonën ku kishte ndodhur konfrontimi i armatosur midis UÇK-së dhe forcave të regjimit neo-fashist të Milošević-it.

[66] Norwegian Helsinki Committee. "Bjørn Engesland receives award." *NHC.no,* 29 May 2018. Accessed 31 October 2025. https://nhc.no/en/bjorn-engesland-receives-award/.
[67] Po aty



# Her ble serberne stanset

– Trefningen tyder på at en godt organisert gruppe står bak

LAUSHA (Dagsavisen): – Her skjedde angrepet, forteller en representant for det lokale menneskerettighetsrådet i Serbica. Han peker oppover skråningene noen kilometer utenfor landsbyen Lausha som på begge sider ender i bakketopper et stykke unna veien.

Det ideelle stedet for et godt planlagt angrep. Bakkeskråningene er tett kledd med løvtrær et stykke opp i lia, mens veien ligger åpen og ubeskyttet. Og ennå ligger tomme patronhylser spredd over et større område, to måneder etter angrepet som den mystiske organisasjonen, Kosovos frigjøringshær (KLA), skal ha stått for.

– Angrepet mot serbisk politi og pansrede kjøretøy på akkurat dette stedet, må ha vært godt planlagt, sier Bjørn Engesland, generalsekretær i Den norske Helsingforskomiteen. (Foto: Elisabeth Salvesen)

**INGEN DOKUMENTASJON**

– Trefningen ved Lausha 26. november i fjor tyder på at en godt organisert gruppe står bak, en organisasjon som lyktes i å stanse serbiske styrker, sier generalsekretær Bjørn Engesland i Den norske Helsingforskomiteen som nylig var i området.

– Jeg har ikke dokumentasjon for å si at KLA eksisterer, men trefningen ved Lausha tyder på at en eller annen organisasjon på albansk side står bak, og de lyktes med et militært angrep.

**17 DRAP**

Hittil har KLA tatt på seg ansvaret for minst 17 drap på serbere eller albanere som har samarbeidet med serberne.

Enten det nå er KLA som står bak disse voldshandlingene eller det er små, uavhengige væpnede grupper som vil forsvare sine hjem og familier eller det tredje alternativet som forklarer hendelsene som provokasjoner iverksatt av det hemmelige serbiske politiet for å få et påskudd til å sette i gang en større militæroffensiv, så er resultatet en svært spent situasjon med nye drap på begge sider snart hver uke nå, sier Engesland bekymret.

Etter at de serbiske styrkene måtte trekke seg tilbake fra bakholdet ved Lausha, skjøt de blant annet mot bolighus og en skole i området. En lærer som oppholdt seg i et kontor på skolen, ble drept da serbisk politi skjøt gjennom skolevinduet. (Foto: Elisabeth Salvesen)

Në kuadër të këtyre zhvillimeve të fundvitit 1997, Nufri Lekaj me bashkëpunëtorë inicioi rikonsolidimin e Bashkësisë Shqiptare në Norvegji (BShN), që si rast unik në diasporën shqiptare, arriti t'i unifikojë/përfshijë brenda vetes të gjitha subjektet politike dhe kulturore shqiptare në Norvegji, pa dallim bindjesh politike dhe fetare, me një qëllim: në përkrahje logjistike, politike dhe diplomatike të UÇK-së. BShN e organizoi edhe demonstratën e parë në diasporën shqiptare në përkrahje të drejtpërdrejtë të UÇK-së. Kjo u bë edhe simbolikisht, ngaqë 10 djem veshën uniformën ushtarake me emblemën e UÇK-së dhe parakaluan në fillim të rreshtit të demonstratës që kishte disa mijëra demonstrues, duke bartur banderolat "Rroftë UÇK-ja" dhe flamujt kombëtarë shqiptarë. Mund të thuhet se ishte demonstrata më e madhe në qytetin e Oslos organizuar nga ndonjë organizatë jonorvegjeze. Në këtë vazhdë (gjatë periudhës së luftës në Kosovë) Nufriu mori përgjegjësinë dhe detyrën e përfaqësuesit politik të UÇK-së për Skandinavinë, i emëruar nga përfaqësuesi i përgjithshëm politik i UÇK-së, Adem Demaçi, dhe të anëtarit të

Grupit Diplomatik të UÇK-së. Përfaqësimi i UÇK-së në Skandinavi, e veçanërisht në Norvegji, është konsideruar i rëndësishëm, meqë në atë kohë Norvegjia udhëhiqte OSBE-në nëpërmjet ministrit të Punëve të Jashtme, Knut Vollebæk. OSBE ishte vazhdimësi e Procesit të Helsinkit, përkatësisht Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian - KSBE, si një arenë e konferencave ndërkombëtare, të bazuara në Aktin Final të Helsinkit, pasi që shërbeu rreth 20 vjet si arenë konferencash, u institucionalizua në vitin 1995 në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - OSBE.

Si rezultat i bashkëpunimit në kuadër të Bashkësisë Shqiptare në Norvegji (BShN-së), u bashkuan edhe Fondet për Norvegji (Fondi 3 % dhe Fondi VTh). Rrjedhimisht, në muajin mars 1998, BShN dërgoi ndihmën e parë financiare të një vlere të konsiderueshme shikuar gjërat në rrafshin e kohës. Dërgesën e realizuan Isa Thaqi dhe Kadri Mehaj duke i dorëzuar shumën prej rreth 700 000 marka gjermane, kryetarit të Fondit Qendror të Fondit VTh në Zvicër, tashmë heroit të kombit, gjeneral Jashar Salihut, i cili, sipas kujtesës së dëshmitarëve, me lot në sy u tha: “O sa na ndihmon kjo ndihmë se kemi djemtë pa bukë e pa plumba”. Këto 700 000 marka gjermane (të vlerësuara në forcën blerëse të sotme 2 milionë euro) në bazë të gjitha të dhënave rezulton se ishin paratë e para të dërguara në këtë shumë për luftën tonë çlirimtare. Më vonë janë mbledhur shuma edhe më të mëdha nga shtete të tjera duke e përfshirë Norvegjinë, por është fjala për hapin e parë dhe periudhën kohore 97/98.

Vlen të theksohet se Bashkësia Shqiptare në Norvegji (BShN) fillimisht u themelua me iniciativë të LPK-së dhe funksionoi në periudhën e viteve 1991-1992. Përkatësisht me fillimin e pluralizmit politik në ish-Jugosllavi u krijuan kushtet për të formuar organizata të fuqishme gjithëpërfshirëse të shqiptarëve në diasporë (në shtetet e ndryshme) dhe Bashkësia Shqiptare në Norvegji (BShN) ishte një shembull i mirë për këtë. Por BShN pas një viti (që të mos ketë konfuzion dhe përçarje), vendosi ta ngrijë veprimtarinë e vet si rezultat i formimit/konsolidimit të Degës së LDK-së në Norvegji, e cila nuk pranoi të bëhej pjesë e BShN-së. Megjithëkëtë, struktura e LPK-së në Norvegji e vazhdoi aktivitetin nëpërmes GKKNH-së dhe, njëkohësisht, GKKNH/LPK bashkëpunoi në aktivitete të përbashkëta me Degën e LDK-së në Norvegji në periudhën e viteve 1992-1998. Dega e LDK-së në Norvegji e udhëhequr me vite nga afaristi Fatmir Zymberaj ishe shembull i mirë i bashkëpunimit në mes të LPK-së dhe LDK-së për disa vjet, duke i bashkorganizuar të gjitha aktivitetet në Norvegji të cilat kishin karakter patriotik për Kosovën.

Për më tepër, gjatë luftës në Kosovë Bashkësia Shqiptare në Norvegji (BShN) inicioi vendosjen e Spitalit Ushtarak Fushor *NorHosp* nga Norvegjia në zonën kufitare Shqipëri - Kosovë, në Krume. Kjo ndodhi në bashkëpunim me stafin mjekësor të organizatës humanitare norvegjeze të njohur, *Norwegian Aid Committee* (NORWAC), dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Në mënyrë të veçantë, sektori i BShN-së për shëndetësi në Kosovë dhe kryetari i NORWAC-ut, profesor dr. Erik Fosse,

kishin aplikuar për fonde nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë. Fosse ishte në krye të grupit të kirurgëve në këtë spital, i shoqëruar nga anesteziologu, profesor dr. Petter Andres Steen, dhe infermierja e sallës së operacionit, Kjersti Fiveland. Koordinatorja e ekipit të mjekëve ishte patologia Kristin Refsdal, e cila lëvizte me ndihmën e një karroce invalidore. Vëllai i Kristin Refsdal, gazetari Pål Refsdal, kishte hyrë në Kosovë si gazetar lufte në bashkëpunim me BShN-n, dhe ishte plagosur gjatë hyrjes në Kosovë. NORWAC kishte vetëm një të punësuar të përhershëm, ndërsa të tjerët ishin idealistë që punonin kryesisht në shërbimet shëndetësore norvegjeze. Këta norvegjezë dhe kolegët e tyre të stafit mjekësor në *NorHosp* qëndruan të heshtur, pa kërkuar lavdi apo meritë, por si humanistë të vërtetë ndihmuan shumë Kosovën. Jetët e shumë civilëve dhe ushtarëve të UÇK-së u shpëtuan në këtë spital ushtarak fushor. Me fjalë të tjera, ky spital kishte rëndësi të dyfishtë për ushtarët e UÇK-së, pasi ata kishin frikë nga plagosjet e rënda apo vdekja si rezultat i trajtimit të gabuar mjekësor ose mungesa e trajtimit. Për rrjedhojë, ky spital norvegjez u ofroi ushtarëve të UÇK-së siguri, po ashtu edhe trajtim të duhur. Koordinator i përgjithshëm i këtij spitali ishte BShN, e përfaqësuesit e BShN-së ishin gjithmonë të pranishëm aty. Vlen të përmendet se Norvegjia ishte i vetmi vend perëndimor që ndihmoi Kosovën në këtë mënyrë. Fosse është cituar në një artikull të gazetës së Universitetit të Oslos, *Uniforum*, duke thënë: *"Norvegjia është i vetmi vend që ka pranuar lutjen e përfaqësuesve të shqiptarëve të Kosovës në mërgim për të ndihmuar në ndërtimin e një spitali fushor.*

*Së bashku me Bashkësinë Shqiptare në Norvegji, dhe sektorin e kësaj Bashkësie për shëndetësinë në Kosovë, NORWAC aplikoi në Ministrinë e Punëve të Jashtme për fondet për projektin në Krume. Fosse nuk sheh asgjë problematike në faktin që një organizatë ndihmash zgjedh një anë në një konflikt, siç ka bërë NORWAC në favor të shqiptarëve të Kosovës dhe guerilëve të UÇK-së; përkundrazi. "Nëse norvegjezët do të përjetonin luftë në Norvegji dhe do të detyroheshin të arratiseshin në Suedi, ne do ta merrnim seriozisht nëse organizatat e ndihmës nga Pakistani, Turqia apo Afganistani do të ngritnin kampe refugjatësh dhe qendra ndihme pa na pyetur se çfarë na nevojitej. Ato duhet të kontaktojnë përfaqësuesit politikë dhe të hartojnë një plan së bashku", thotë Fosse. Ai konsideron se është e pa vend, madje mund të jetë rrezik i vërtetë, të përpiqesh të jesh i paanshëm kur punon në zona lufte. "Ne bashkëpunojmë me refugjatët shqiptarë të Kosovës dhe tashmë ua kemi dhuruar atyre spitalin. Ushtarët e UÇK-së përbëhen kryesisht nga refugjatë, dhe ne kemi fituar besim të madh te ata me të cilët kemi bashkëpunuar. Për të mos mbetur të paralizuar në veprim, duhej të zgjidhnim anë. Shqiptarët e Kosovës kanë qenë për një kohë të gjatë të persekutuar, dhe kjo ka arritur kulmin me deportimet dhe luftën e muajve të fundit...".*[68]

Në vijim, fillimisht është një fotografi nga demonstrata e parë publike në mbështetje të UÇK-së në diasporë, e mbajtur më 7 mars 1998, e organizuar nga Bashkësia Shqiptare në Norvegji (BShN). Faksimilja tjetër në radhë është fragmenti nga gazeta e Universitetit të

[68] Marit Schulstok, *"Med skalpell i krigssonen"*, *Uniforum*, nr. 10 (1999)

Oslos “Uniforum”, përkatësisht intervista e mjekëve dhe infermierëve kryesorë norvegjezë të Spitalit Fushor, në mbështetje të UÇK-së. Dhe një foto (korrik 1998), nga e djathta: Nufri Lekaj, Esat Kadrijaj dhe Isa Thaqi në mbështetje të UÇK-së në terren, përfshirë asistimin në emër të Këshillit të Përgjithshëm të Bashkësisë Shqiptare në Norvegji për të ndihmuar në vendosjen e Spitalit Fushor nga Norvegjia në zonën e kufirit Shqipëri - Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, Nufriu, ndër të tjera, në emër të Shtabit të Logjistikës dhe Mobilizimit në brezin kufitar, ka takuar edhe delegacionin e OSBE-së, anëtarët e të cilit kishin ardhur t’i vizitonin të plagosurit, me qëllim që t’u shpjegohej se artileria serbe kishte bombarduar caqet civile në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe se nga këto sulme kishin pësuar civilët. Delegacionin e shoqëronte deputeti shqiptar Namik Dokle. Në këtë rast, Nufriu është paraqitur me prapavijën e tij si anëtar i Federatës së Helsinkit dhe aktivist për të drejtat e njeriut, duke përfshirë mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve.





Në vitin 1999 Nufri Lekaj nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës u emërua përfaqësuesi i parë diplomatik i Kosovës në Norvegji. Në vjeshtën e po atij viti u bë hapja solemne e përfaqësisë diplomatike të Kosovës në Norvegji, në një ceremoni ku morën pjesë personalitete të rëndësishme politiko-shoqërore norvegjeze: ministri Erik Solheim, kryetari i Komitetit për Politikë të Jashtme të Parlamentit Norvegjez, Håkon Blankenborg, kryetari i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Bjørn Engesland, profesorë universiteti, përfaqësues të organizatave joqeveritare, gazetarë dhe miq të shumtë të Kosovës

dhe të shqiptarëve.[69] Gjatë periudhës 1999–2000, përfaqësia diplomatike e Kosovës në Norvegji, përveçse organizoi gjatë luftës në Kosovë vizitën e parë në Norvegji të kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, Hashim Thaçi, zhvilloi një veprimtari të gjerë diplomatike dhe mediatike, duke dhënë kontribut të rëndësishëm për mbështetjen e Kosovës së sapoçliruar nëpërmjet projekteve ndërlidhëse.

Në qershor të vitit 1999, në kuadër të veprimtarisë së përfaqësisë diplomatike të Kosovës në Norvegji, Nufri Lekaj, së bashku me Isa Thaçin, Shkëlzen Kuklecin dhe Gëzim Haklajn, organizuan kalimin e kufirit dhe shoqëruan gazetaren dhe regjisoren norvegjeze, njëherësh anëtare e Bordit të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Maria Fuglevaag Warsinska-Varsi, në Kosovë. Qëllimi i vizitës ishte realizimi i një filmi dokumentar dhe mbledhja e dëshmive mbi krimet e kryera nga regjimi neofashist i Miloševićit gjatë luftës në Kosovë. Në të njëjtën kohë ata iniciuan Komisionin për Dokumentimin e Krimeve të Luftës. Filmi dokumentar dhe katalogu fotografik i Warsinska-Varsi u klasifikuan nga Tribunali i Hagës si dëshmi në gjyqin kundër Miloševićit. Paraprakisht, Warsinska-Varsi kishte dhënë kontribut të veçantë në dokumentimin e krimeve të luftës edhe në Bosnjë përmes filmave të saj dokumentarë, shkrimeve dhe fotografive.

Në vitin 2000 Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) funksionalizoi Këshillin e Përkohshëm

---

[69] *"Hapja solemne e përfaqësisë diplomatike të Kosovës në Norvegji – 1999,"* video në YouTube: https://youtu.be/uRyl1UeeRxU.

Administrativ (KPA). Si rrjedhojë, përfaqësia diplomatike e Kosovës në Norvegji pezulloi aktivitetin e vet diplomatik pasi KPA-ja nuk kishte një departament për punë të jashtme, çka nënkuptonte se Kosova nuk mund të kishte përfaqësi diplomatike zyrtare jashtë vendit. Megjithatë, duke qenë se Kosova ende nuk ishte njohur shtet i pavarur, Nufri Lekaj, së bashku me bashkëpunëtorët, vendosën në fillim të vitit 2001 të ndërmerrnin një formë vetëriorganizimi brenda përfaqësisë së mëparshme, duke e regjistruar atë si Zyrë Interesi të Kosovës, me emrin Kosova Office in Norway. Kjo veprimtari kishte karakter vullnetar dhe synonte promovimin e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga vendet skandinave. Edhe pse Kosova Office in Norway nuk ishte formalisht përfaqësi zyrtare e Kosovës, ajo u përshëndet nga kryeministri norvegjez Kjell Magne Bondevik përmes një letre dërguar kësaj zyre më 29 tetor 2001.

Në vijim është faksimilja e letrës së sipërcekur e përshëndetjes nga kryeministri norvegjez Kjell Magne Bondevik dërguar Zyrës së Kosovës në Norvegji (Kosova Office in Norway) më 29 tetor 2001, ku thuhet: *"Ju falënderoj përzemërsisht për përgëzimin tuaj me rastin e marrjes së detyrës së kryeministrit! Të fala të përzemërta, Kjell Magne Bondevik"*[70]

[70] Kjell Magne Bondevik, *letër dërguar Zyrës së Kosovës në Norvegji,* 29 tetor 2001, Oslo, dokument zyrtar nga Zyra e Kryeministrit të Norvegjisë (Statsministeren).



STATSMINISTEREN

Oslo, 29. oktober 2001

Nufri Lekaj
Kosova Office in Norway
Postboks 121 Grorud
0905 Oslo

Min hjerteligste takk for hyggelig hilsen i forbindelse med min overtakelse av embetet som Statsminister.

Med vennlig hilsen

Kjell Magne Bondevik

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, Kosova Office in Norway organizoi vizitën e një delegacioni të Kosovës në Norvegji në mars të po atij viti. Më konkretisht, më 28 mars 2008, në orën 10:00, gjatë takimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, ku morën pjesë Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Daut Haxhaj dhe Nufri Lekaj, sekretarja e parë e ministrit të Jashtëm norvegjez njoftoi se Mbretëria Norvegjeze, nga ajo ditë - 28 mars 2008 - e njeh zyrtarisht Republikën e Kosovës. (Deri në këtë datë Norvegjia nuk e kishte formalizuar njohjen e pavarësisë së Kosovës të shpallur nga Kuvendi i Kosovës më 17 shkurt 2008). Po atë mbrëmje u organizua një ceremoni festive me

rastin e njohjes formale të pavarësisë së Kosovës nga shteti norvegjez[71], gjatë së cilës Nufri Lekaj njoftoi mbylljen e Kosova Office in Norway, duke theksuar se zyra kishte përmbushur misionin e saj si nismë vullnetare për promovimin e njohjes së Republikës së Kosovës nga Norvegjia dhe vendet e tjera skandinave. Megjithatë, për të mos iu shmangur përgjegjësisë ndaj Kosovës, Lekaj i njoftoi institucionet përkatëse politike në Prishtinë se, në rast nevoje, ishte në dispozicion për të kryer çdo shërbim diplomatik për Kosovën, pa pagesë. Në këtë vazhdë ai ka vazhduar të ofrojë ndihmë këshilluese dhe profesionale sa herë që i është kërkuar nga institucionet e Kosovës, përfshirë edhe angazhimin e tij si këshilltar i ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj, gjatë periudhës 2021–2023, pa pagesë.

Në vijim, në fotografinë e parë dhe të dytë janë Nufri Lekaj dhe Armend Mehaj, në shenjë respekti, gjatë një vizite te varri i Berit Backerit dhe i Kristoffer Gjøtterudit. Ndërsa në fotografinë e tretë Nufri Lekaj është me rastin e shënimit të 50-vjetorit të aktit final të Helsinkit (gusht 1975-gusht 2025), një aktivitet i organizuar nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Nga e majta në foto janë: Aage Borchgrevink, shkrimtar dhe këshilltar pranë Komitetit Norvegjez të Helsinkit; Berit Lindeman, sekretare e përgjithshme e Komitetit Norvegjez të Helsinkit; dhe Jan Brathu, diplomat me përvojë të gjatë, i cili iu bashkua Ministrisë së Punëve të Jashtme

71 *"Festa me rastin e njohjes zyrtare të Republikës së Kosovës nga Mbretëria Norvegjeze."* Video në YouTube: https://youtu.be/r26sNg7uB1Q.

të Norvegjisë në vitin 1985 dhe ka shërbyer në disa misione diplomatike jashtë vendit. Gjatë luftës në Kosovë, Brathu luajti rol pothuajse qendror në kuadër të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), përkatësisht në Seksionin e Kryesimit Norvegjez të OSBE-së pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë gjatë viteve 1998-2000, kur Norvegjia kryesonte OSBE-në nën udhëheqjen e ministrit të Punëve të Jashtme, Knut Vollebæk. Në këtë vazhdë ai ka qenë drejtpërdrejt i përfshirë në çështjen e Kosovës, veçanërisht në cilësinë e ambasadorit të Norvegjisë në Kosovë dhe Shqipëri gjatë periudhës 2011–2016, si dhe shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë nga tetori 2016 deri në dhjetor 2020. Aktualisht Jan Braathu është përfaqësuesi i gjashtë i OSBE-së për Lirinë e Medias, i emëruar në dhjetor të vitit 2024.






of the Board, Stefan Batory Foundation
Ellen Svendsen
Norway's ambassador to the OSCE
Gunnar Ekeløve Slydal
erator, Deputy Secretary General, NHC
NOR
CAP

## ARRITJA E VENDOSJES SË ÇËSHTJES SË KOSOVËS PËR ZGJIDHJE NË KUADËR TË AGJENDËS NDËRKOMBËTARE DHE RRUGA MË TEJ

Fatkeqësisht, pas një periudhe të gjatë pritjesh dhe shpresash për zgjidhje, çështja e Kosovës nuk u përfshi në agjendën ndërkombëtare të negociatave, përkatësisht as në kuadër të Konferencës së Dejtonit. Historiani Noel Malcolm e konsideron këtë, ndër të tjera, si një goditje ndaj Lëvizjes Paqësore të Kosovës, pasi, sipas tij: *"Fundi i luftës në Bosnjë nuk e solli edhe përfundimin e krizës në Kosovë. Ky fakt ishte vetëm një goditje për prestigjin e Rugovës. Ai, në të vërtetë, për katër vjet me radhë e kishte bindur popullin e vet se duhet të ketë durim derisa bashkësia ndërkombëtare të impononte një zgjidhje përfundimtare për ish-Jugosllavinë, në të cilën do të respektoheshin edhe interesat e tyre. Mirëpo, zgjidhja e paraqitur nga amerikanët në Dejton të Ohajos në nëntorin e vitit 1995, i la shqiptarët e Kosovës pikërisht aty ku ishin. E vetmja përkrahje në favor të Kosovës ishte një pajtim nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara se 'muri i jashtëm' i sanksioneve kundër Serbisë (duke përfshirë edhe mohimin e të drejtës për pjesëmarrje në Fondin Monetar Ndërkombëtar), do të mbetej derisa Beogradi ta përmirësonte gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Përndryshe, Marrëveshja e Dejtonit në përgjithësi ndikoi në konsolidimin e sundimit të Miloševićit në Serbi: diplomatët e Perëndimit deklaruan haptazi se ata i ishin atij mirënjohës për përpjekjet e tij "për vendosjen e paqes" dhe se e konsideronin*

*atë si një forcë konstruktive në rajon, largimi i të cilit mund të shpinte në një destabilizim"*[72]

Megjithatë, sikurse në vitet 1988–1990, ndikimi i grevave të minatorëve dhe i përpjekjeve politike të institucionalistëve në krye me Azem Vllasin, Kaqusha Jasharin etj., duke e përfshirë një numër të caktuar të delegatëve shqiptarë të Kuvendit të Kosovës, e veçanërisht rënia e dhjetëra dëshmorëve në demonstrata (kundër nismës dhe suprimimit të dhunshëm të autonomisë së Kosovës) si faktor i brendshëm dhe shembja e murit të Berlinit, si faktor i jashtëm, patën ndikimin e vet për t'i dhënë legjitimitet ndërkombëtar Lëvizjes Paqësore të Kosovës (LDK-së). Gjithashtu, politika e Lëvizjes Paqësore para Konferencës së Dejtonit, si faktor i brendshëm, dhe gjenocidi në Bosnjë, si faktor i jashtëm që preku thellë ndërgjegjen e shteteve perëndimore, ushtruan në mënyrë të tërthortë ndikim të dukshëm në formësimin e legjitimitetit ndërkombëtar të luftës së mëvonshme të UÇK-së, në kuptimin se shqiptarët e Kosovës, në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, kishin provuar për vite të tëra ta zgjidhnin problemin e Kosovës me mjete paqësore, por ishin refuzuar nga Miloševići; për pasojë, shtetet perëndimore nuk mund të toleronin përsëritjen në Kosovë të së njëjtës përmasë gjenocidiale që kishte ndodhur në Bosnjë. Veçanërisht duke marrë parasysh edhe faktorin gjeopolitik, një konflikt i armatosur në Kosovë - ndryshe nga ai në Bosnjë - kishte potencialin e zgjerimit të luftës

---

[72] Malcolm 2001: 368-369

përtej kufijve të ish-Jugosllavisë.[73] Për më tepër, dy merita të veçanta të Lëvizjes Paqësore të Kosovës, në krye me akademikun urtak dhe me ndjenjë të lartë përgjegjësie politike, Ibrahim Rugovën, janë: nga njëra anë, shmangia e luftës në Kosovë në fillimvitet '90 - në një kohë kur një luftë e tillë i konvenonte Serbisë - dhe, nga ana tjetër, arritja e ndërkombëtarizimit maksimal dhe afirmimit ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Përndryshe, ekzistonin gjasa të mëdha që gjenocidi me përmasa aq të mëdha që ndodhi në Bosnjë të ndodhte me përmasa edhe më të mëdha në Kosovë.

Njëherësh, vlen të theksohet se mospërfshirja e çështjes së Kosovës në Konferencën e Dejtonit përbënte një sinjal të qartë se çlirimi i Kosovës nuk mund të arrihej vetëm me mjete paqësore. Rrjedhimisht, mungonte një "plan B", një strategji shtesë por, çuditërisht, as pas Konferencës së Dejtonit nuk u arrit të sinkronizohej ndonjë strategji e përbashkët për çlirimin e Kosovës ndërmjet LDK-së (duke përfshirë edhe Qeverinë e Kosovës në ekzil) dhe LPK-së. Kjo nuk nënkuptonte domosdoshmërisht që Lëvizja Paqësore duhej ta ndryshonte kursin e saj politik në mënyrë radikale, pasi një hap i tillë do t'i jepte pretekst Miloševićit dhe disa qarqeve ndërkombëtare për ta legjitimuar dhunën e shtuar dhe pastrimin etnik ndaj shqiptarëve të Kosovës. Po ashtu, kjo nuk nënkuptonte që Lëvizja Paqësore të ndërmerrte vetë organizimin e strukturave të armatosura pasi, përveç të tjerash, ajo nuk kishte as përvojë

[73] Lekaj, 2021: 163-164

në rezistencë aktive dhe as traditë të konspiracionit të thellë - tipar që e karakterizonte më shumë LPK-në. Prandaj, do të kishte qenë e arsyeshme që Lëvizja Paqësore e Kosovës - përkatësisht drejtuesit kryesorë të LDK-së dhe të Qeverisë së Kosovës në ekzil - të kishin arritur një marrëveshje të fshehtë me drejtuesit e LPK-së, në mënyrë që kjo e fundit, edhe me miratimin e tyre, të merrte përsipër rolin e organizimit të rezistencës së armatosur në kuptimin e ngritjes së një strukture guerile, si mjet i fundit për imponimin e çështjes së Kosovës për zgjidhje në kuadër të agjendës ndërkombëtare. Në këtë kuptim, që prej themelimit formal - emërtimit të UÇK-së (17 nëntor 1994) nga LPK-ja, kjo e fundit do të duhej të mbështetej financiarisht nga LDK-ja dhe Qeveria e Kosovës në ekzil, të cilat kishin në dispozicion mjete të konsiderueshme të mbledhura nga qytetarët e Kosovës. Si institucione të zgjedhura me votë dhe të financuara nga kontributet e qytetarëve, ato kishin një obligim shtesë për ta shqyrtuar seriozisht një plan B - një strategji shtesë në vazhdën e përpjekjeve për liri. Në një situatë të tillë lufta e UÇK-së do të kishte mundur të zhvillohej, organizativisht, më fuqishëm dhe më efektshëm, në koordinim të brendshëm dhe në harmoni me institucionet politike të Kosovës. Mungesa e një koordinimi të duhur dhe të sinkronizuar në kohë bëri që disa eksponentë të Lëvizjes Paqësore si nga radhët e LDK-së, ashtu edhe nga përbërja e Qeverisë së Kosovës në ekzil - në disa raste të artikulonin deklarata të pamatura dhe, herë pas here, me prirje negative ndaj UÇK-së. Këto prononcime, të shprehura si në mjediset mediatike,

ashtu edhe në takime me përfaqësues ndërkombëtarë, rezultuan në dëm të UÇK-së - si në aspektin e vonesës së mobilizimit të brendshëm, ashtu edhe në atë të vonesës në legjitimimin ndërkombëtar të luftës së saj. Në këtë kuptim, këto deklarata mund të konsiderohen si një ndër faktorët që shënuan fillimin e mpleksjes ndërmjet UÇK-së dhe LDK-së, duke përfshirë edhe Qeverinë e Kosovës në ekzil.

Një ndër protagonistët e proceseve politike në Kosovë gjatë viteve '90 dhe më pas, Blerim Shala, në pasthënien e librit të Bardh Hamzajt, *Rrëfimi për luftën dhe lirinë: dialog me komandantin Ramush Haradinaj* (1999), përveç të tjerash, shkruan: "*Kurrë Serbia nuk do ta braktisë Kosovën. Kurrë Perëndimi nuk do të intervenojë ushtarakisht në Kosovë. Kurrë Kosova nuk do të bëhet e lirë dhe e pavarur. Ishin këto qëndrime politike të cilat ishin lidhur si gur rreth qafës së secilit shqiptar në vitet e nëntëdhjeta. Ideja e pavarësisë, e cila ishte zyrtarizuar në vitin 1990-1991, me vendimet e Kuvendit të Kosovës dhe me votën e qytetarëve në Referendum, në të nëntëdhjetat, u bë një fjalë goje, një llomotitje, një mburojë për ta mbajtur monopolin e një pushteti të rremë që ndërtohej pra mbi prononcimin verbal në dobi të shtetit të Kosovës. Në vete, secili prej nesh, druante që për të gjallët tanë nuk do të përjetonim asnjë ditë të vetme, asnjë çast të vetëm në liri. Robëria dukej si kob i përjetshëm. Në këtë skenë fati dhe politike, gjithçka u përmbys, me të paraqitur të disa dhjetëra vetave, të cilët kishin atë bindjen e moçme shqiptare se nuk mund të ketë liri pa luftë dhe se nuk mund të ketë pavarësi pa*

*flijim. Mbase nuk e kanë ditur në fillim se çka është lufta, se me kë në të vërtetë kapeshin fyt për fyti, se ç'gjë mund të dalë nga gjithë kjo rrëmujë, por e dinin mirë, tepër mirë, se të gjitha iluzionet ishin sosur, se afati i përdorimit të fjalëve përulëse kishte kaluar, se vdekja për liri kishte shumë më tepër vlerë sesa jeta nën Serbi".*[74]

Ky konstatim i Shalës mbi rolin e Lëvizjes Paqësore të Kosovës mund të konsiderohet, në masë të madhe, si antihistorik, pasi neglizhon faktin se politika paqësore e Kosovës, me gjithë kufizimet e saj, kontribuoi tërthorazi në krijimin e kushteve që më vonë mundësuan legjitimimin ndërkombëtar të luftës së UÇK-së. Po ashtu, edhe vlerësimi i tij mbi rolin e UÇK-së - në kuptimin se ajo ishte vetëm rezultat i veprimit të dhjetëra individëve - është, në thelb, po aq antihistorik. Duhet pasur parasysh se UÇK-ja, përveçse përfaqësonte traditën dhe vazhdimësinë historike të përpjekjeve të shqiptarëve për çlirimin e Kosovës dhe viseve përreth që nga viti 1912, ishte në mënyrë të veçantë rezultat i drejtpërdrejtë i organizimit dhe riorganizimit të veprimtarisë së LPK-së.

Me fjalë të tjera, vendimi i Degës së LPK-së jashtë vendit, i datës 17 nëntor 1994 që, ndër të tjera, përcaktonte që njësitë e armatosura të drejtuara nga LPK të emëroheshin Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)[75], ishte rezultat i drejtpërdrejtë i një procesi të vazhdueshëm zhvillimesh në kuadër të veprimtarisë së LPK-së. Kjo

---

[74] Hamzaj 1999: 179

[75] Emrush Xhemajli, "Dita e pagëzimit të UÇK-së," *KosovaPress,* 2021, https://kosovapress.com/%E2%80%8Bdita-e-pagezimit-te-uck-se/.

fazë shënonte një reagim të organizuar ndaj realitetit të ashpër politik në Kosovë, ku Dega e LPK-së brenda vendit - dhe veçanërisht udhëheqja e saj - përballej vazhdimisht me represionin e aparatit shtetëror serb, i cili manifestohej në mënyrë sistematike përmes arrestimeve, torturave dhe vrasjeve të veprimtarëve të LPK-së. Në këto rrethana, Dega e LPK-së jashtë vendit, e cila vepronte në kuadër të emigracionit politik shqiptar, kishte kompetenca që, në situata të jashtëzakonshme, të merrte përsipër udhëheqjen e përgjithshme të organizatës. Kjo bartje e kompetencave drejt Degës së LPK-së jashtë vendit u bë e domosdoshme pas mbledhjes së katërt të përgjithshme të LPK-së, mbajtur në Kosovë në vitin 1993, kur vala e arrestimeve që pasoi shkaktoi një ndërprerje në funksionimin e udhëheqjes së LPK-së brenda vendit. Prandaj, vendimi për themelimin formal - emërtimin e UÇK-së më 17 nëntor 1994, u mor në përputhje me vendimet e asaj mbledhjeje dhe në kontekstin e zhvillimeve pasuese, kur shërbimi sekret serb, në kuadër të arrestimeve, arriti të arrestonte edhe udhëheqësit emblematikë të LPK-së në Kosovë - Xhavit Hazirin, Ahmet Haxhiun dhe Bejadin Hallaqin - si pjesë e vazhdimësisë së udhëheqjes emblematike të Degës së LPK-së brenda vendit gjatë viteve ’80, të përfaqësuar nga Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu e të tjerë. Disa prej veprimtarëve që i shpëtuan valës së arrestimeve të vitit 1993 emigruan jashtë vendit, ndërsa të tjerë vepronin tashmë në kuadër të grupeve klandestine të armatosura në Kosovë, të cilat, që para mbledhjes së katërt të përgjithshme të LPK-së, kishin filluar gradualisht të shndërroheshin

nga struktura politike të Këshillave Popullorë të Degës së LPK-së brenda vendit, në njësi të armatosura me karakter ushtarak, brenda vendit.

Rrjedhimisht, ky vendim i emërtimit (themelimit formal) të UÇK-së ishte një proces, përveç të tjerash, i bazuar në vazhdën e veprimtarisë së LPK-së që nga viti 1982 e veçanërisht bazuar në vazhdën e vendimeve të katër mbledhjeve të përgjithshme të LPK-së në vitet 1987, 1989, 1991 dhe 1993, jo se grupe të armatosura nuk kishte edhe më herët para vitit 1994. Për shembull, grupi i armatosur i quajtur Fronti për Rezistencë dhe Bashkim Kombëtar (FRBK) ishte themeluar në Gjakovë në vitin 1990[76], por u dekonspirua pas disa muajsh, dhe pas vitit 1994 disa pjesëtarë të këtij grupi iu bashkëngjiten UÇK-së. Gjithashtu grupi i Prekazit në krye me Adem Jasharin dhe grupi në krye me Zahir Pajazitin në Llap kanë vepruar që në vitet 1990 -'91. Krahas këtyre grupeve vepronin Këshillat Popullorë të Degës së LPK-së brenda vendit, ku një pjesë e tyre kishin filluar gradualisht të shndërroheshin në grupe klandestine të armatosura të LPK-së që nga viti 1989. Duhet të kihet parasysh se LPK-ja si organizatë e fuqishme, në vazhdimësi që nga fillimvitet '80 (e deri te themelimi formal i UÇK-së më 17.11.1994), përveç se kishte krijuar traditë/përvojë të konspiracionit dhe riorganizimit (pas

[76] Besim Muhadri, "Fronti i Rezistencës dhe i Bashkimit Kombëtar u themelua si një organizatë politiko-ushtarake", *Zemra Shqiptare,* 2010, http://www.zemrashqiptare.net/news/14320/besim-muhadri-fronti-i-rezistences-dhe-i-bashkimit-kombetar-u-themelua-si-nje-organizate-politikoushtarake.html.

goditjeve) të radhëve të saj, njëkohësisht kishte krijuar traditë/përvojë të rezistencës aktive (përfshirë edhe shembujt e rezistencës së armatosur) kundër regjimit serbo-jugosllav. Në fakt, disa nga pjesëtarët e saj më të devotshëm (disa prej tyre edhe udhëheqës emblematikë) kishin rënë në altarin e lirisë si pasojë e atentateve, si pasojë e përballjeve të armatosura - të pabarabarta, dhe si pasojë e torturës, përveç të tjerëve: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla, Rexhep Malaj, Nuhi Berisha, Bajram Bahtiri, Zijah Shemsiu, Xhemajli Berisha, Ali Ajeti, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Fadil Vata, Tahir Lush Berisha, Arif Seferi, Ahmet Haxhiu, Hasan Ramadani, Xhavit Haziri, Bejadin Hallaqi etj. Kështu që kjo traditë/përvojë e LPK-së ndikoi që Këshillat Popullorë të Degës së LPK-së brenda vendit, që shtriheshin në gjithë territorin e Kosovës me vise, të fillojnë gradualisht nga viti 1989 të jenë edhe krahu ushtarak i kësaj organizate, dhe me ngulmim kërkonin nga organizata që të krijohet një strukturë ushtarake.

Në vitin 1989 u formua një Sektor ushtarak në kuadër të LPK-së.[77] Në të njëjtin vit, në tetor të 1989-s, në Zvicër u organizua Mbledhja e Dytë e Përgjithshme e LPK-së, në të cilën të pranishëm ishin edhe delegatët/përfaqësuesit e LPK-së, Dega brenda vendit.[78] Rrjedhimisht, Mbledhja e Dytë e Përgjithshme kontribuoi, përveç të tjerash, edhe për legjitimimin e këtij Sektori

---

[77] Emrush Xhemajli, "Lëvizja Popullore e Kosovës 1982–2002", *LPK Kosova,* 2002, http://lpkkosova.com/historiku.html.

[78] Po aty

ushtarak në kuadër të LPK-së, që kishte për detyrë parapërgatitjen e kryengritjes së armatosur në Kosovë, në kuptimin e futjes më të madhe të armatimit në Kosovë dhe krijimin e kushteve për kryerjen e aksioneve të mundshme guerile si opsion i fundit për çlirimin e shqiptarëve në Jugosllavi. Në Mbledhjen e Tretë të Përgjithshme të LPK-së, mbajtur në tetor të vitit 1991 në fshatin Ujmir të Klinës (në shtëpinë e veprimtarit Sadri Shala), nën organizimin e LPK-së, Dega brenda vendit, ku të pranishëm ishin edhe delegatët/përfaqësuesit e LPK-së, Dega jashtë vendit, u mor vendimi që të themelohet një forcë e armatosur në Kosovë.[79] Ndërsa në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme të LPK-së, mbajtur në korrik të vitit 1993 në Prishtinë (në shtëpinë e veprimtarit Fatmir Brajshori), nën organizimin e LPK-së, Dega brenda vendit, ku të pranishëm ishin edhe delegatët/përfaqësuesit e LPK-së, Dega jashtë vendit, u mor vendimi për nismën e kryengritjes së armatosur dhe u bënë ndryshimet e mëtutjeshme programore të LPK-së. Në nenin III, përveç të tjerash, thuhet: *Për arritjen e aspiratave kombëtare LPK do t'i përdorë të gjitha mjetet e luftës çlirimtare: demokratike, paqësore dhe politike dhe të rezistencës së armatosur. LPK, si mjet për arritjen e qëllimit, parasheh luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës.*[80] Kështu, paralelisht me vendimet e këtyre tri mbledhjeve të përgjithshme të LPK-së, filloi gradualisht

---

[79] Emisioni *"Rasti V-VI"*, pjesa 1 dhe 2, mysafir: Ibish Neziri etj., 2019, https://www.youtube.com/watch?v=RBW2PLxy9K4 dhe https://www.youtube.com/watch?v=JGS8QgABPSw&feature=youtu.be.

[80] *Zëri i Kosovës,* nr. 15, 15 shtator 1993, "Programi i LPK-së," f. 4.

edhe procesi i shndërrimit të Këshillave Popullorë të Degës së LPK-së brenda vendit në njësi të armatosura klandestine.

Në vitin 1991 pati një nismë nga LDK-ja (supozohet nën mbikëqyrjen e akademik Fehmi Aganit etj.,) në koordinim me Qeverinë e Kosovës në ekzil në krye me Bujar Bukoshin, për ushtrime të militantëve nga Kosova në Shqipëri. Në krye të këtij organizimi u vendos veprimtari i shquar i LDK-së, Sali Çekaj. Gjatë vitit 1991 bënë stërvitje ushtarake mbi 150 militantë të cilët simpatizonin struktura të ndryshme politike të kohës (LDK, LPK, PPK etj.) por, në thelb, kishin dëshirën për t'u përgatitur për të rezistuar në rast të luftës. Ndër ta ishin edhe Adem Jashari dhe Zahir Pajaziti. Fatkeqë-sisht, ky organizim i LDK-së/Qeverisë Bukoshi u dëkon-spirua me pasoja të mëdha për të gjithë ata që ishin listuar se kishin shkuar për ushtrime ushtarake në Shqi-përi ngaqë ato lista kishin rënë në duart e UDB-së serbe dhe pas operacioneve të arrestimeve një numër arrës-tohen dhe dënohen, të tjerë arratisen jashtë vendit, por një numër i vogël vazhdojnë të qëndrojnë të gatshëm për rezistencë siç ishte rasti i Adem Jasharit, i Zahir Pajazitit etj., të cilët e vazhduan organizimin e tyre duke u bërë pjesë e organizimit që kishte LPK-ja me njësitet e saj klandestine të armatosura.

Për dallim nga LPK-ja, LDK-ja dhe Qeveria e Kosovës në ekzil, përveçse nuk e kishin traditën apo përvojën e rezistencës aktive - përfshirë edhe shembujt e rezistencës së armatosur - kundër regjimit serbo-jugosllav, nuk posedonin as përvojë në fushën e konspiracionit dhe të riorganizimit pas goditjeve. Me gjithë meritat e tyre të

mëdha deri në Konferencën e Dejtonit, pas kësaj konference ato u konsumuan në masë të madhe politikisht, pasi nuk kishin shqyrtuar seriozisht ndonjë përgatitje për një plan B - si strategji shtesë, edhe pse kishte pasur iniciativa të tilla, madje edhe brenda vetë LDK-së - nga figura si Sali Çekaj, Hafiz Gagica e të tjerë - të cilat, megjithatë, nuk u mbështetën siç duhej. Iniciativa ka pasur edhe brenda vetë qeverisë. Për shembull, Xhafer Shatri, në cilësinë e ministrit të Informatave në Qeverinë e Kosovës në ekzil me seli në Gjenevë, u kishte paraqitur në vitin 1993 një projektpropozim kryeministrit të Kosovës në ekzil dhe presidentit të Kosovës, që parashihte përgatitjen (jashtë kufijve të Kosovës) të disa formacioneve ushtarake, të gatshme për t'i dalë në mbrojtje popullit të Kosovës. Mirëpo, ky projektpropozim nuk ishte përkrahur.[81] Madje, edhe pse LDK-ja, për vite me radhë, kishte ushtruar një ndikim të gjerë në popull në gjithë territorin e Kosovës, nëpërmjet degëve dhe nëndegëve të saj, ajo nuk kishte ndërmarrë më herët asnjë iniciativë për të organizuar, së paku, një plan apo strategji të mirëfilltë që do të ndihmonte dhe orientonte ikjen apo strehimin e civilëve shqiptarë në rast të shpërthimit të një konflikti të armatosur në Kosovë - me qëllim që të shmangeshin, ose të paktën të zvogëloheshin, krimet ndaj popullsisë civile - veçanërisht ndaj fëmijëve, grave dhe pleqve - të kryera nga forcat e regjimit të Miloševićit.

[81] Intervistë televizive e Xhafer Shatrit në *KTV – Kohavision,* emisioni *Desku,* "Telashet e Kosovës – Xhafer Shatri": https://www.youtube.com/watch?v=

Vlen të përmendet se ka pasur edhe një iniciativë tjetër serioze për formimin e njësive të armatosura, e ashtuquajtura iniciativa e grupit nga Kroacia, në vitin 1991. Pas kësaj iniciative qëndronte një grup kryesisht i ish-oficerëve të APJ-së të cilët më herët kishin qenë të burgosur politikë dhe anëtarë dhe simpatizantë të LPK-së gjatë viteve '80 (Ton Marku, Naim Maloku, Fadil Demiri, Xhafer Jashari etj.), të koordinuar nga Fehmi Lladrovci, si kuadër udhëheqës i LPK-së. Kjo iniciativë fillimisht u përkrah nga LDK-ja nëpërmes akademik Fehmi Aganit, mirëpo pasi që ky grup u organizua dhe arriti ta formojë njësitin ushtarak në zonën e Gospiqit/ Kroaci në krye me Fehmi Lladrovcin, u detyrua të shuhet pas urdhrit të drejtpërdrejtë të Qeverisë së Kosovës në ekzil, me pretekst se "po doni me na fut në luftë". Pjesëtarët e këtij grupi më vonë u rreshtuan në faza të ndryshme kohore në strukturat komanduese të UÇK-së.

Rrjedhimisht, periudha e viteve 1989-1993 (themelimit të sektorit - ushtarak brenda LPK-së, dhe organizimit të mbledhjes së dytë, tretë dhe të katërt të përgjithshme të LPK-së), karakterizohet nga përpjekjet e LPK-së për krijimin e një strukture ushtarake gjithëpërfshirëse dhe efikase për çlirimin e vendit, e cila formalisht u jetësua më 17.11.1994. Edhe më herët, gjatë viteve '80, ka pasur veprimtari të grupeve të armatosura (në kuadër të LPK-së) që kanë shërbyer si pikënisje konkrete për përgatitjen, inkurajimin dhe organizimin e kryengritjes së armatosur në Kosovë, siç janë shembujt e grupeve të armatosura "Partia e luftës" (1983), "Çeta e Llapit" (1989) etj. Por data e themelimit formal të UÇK-

së konsiderohet data e komunikatës së parë ushtarake të UÇK-së (më 17.11.1994), pas mbledhjes së kryesisë së LPK-së. Në kuptimin e unifikimit të grupeve të armatosura nën siglën e UÇK-së, të koordinuara, të mbështetura politikisht dhe me logjistikë etj. nga LPK-ja. Pra, unifikimi i grupeve të armatosura klandestine në vitin 1994, nën siglën e UÇK-së, ndodhi sikurse unifikimi i grupeve revolucionare klandestine më herët, në vitin 1982, nën siglën e LPK-së (e njohur nga viti 1982 si Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi - LRShJ, nga viti 1985 e njohur si Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës - LPRK, dhe nga viti 1993 e njohur si Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK).

Kështu që, në periudhën 1994–1997, pjesë aktive ushtarake, politike dhe logjistike e UÇK-së konsiderohet të kenë qenë rreth 1 000 persona. Këtu përfshihen ish-pjesëtarët e Këshillave Popullorë të Degës së LPK-së brenda vendit, tashmë të shndërruar në njësi të armatosura të UÇK-së[82]; Grupi i Prekazit, në krye me Adem Jasharin, dhe Grupi i Llapit, në krye me Zahir Pajazitin, si pjesë e organizimit ushtarak të UÇK-së[83] ; Sektori i veçantë i LPK-së, i njohur edhe si Shtabi Qendror i UÇK-së, bashkë me bashkëpunëtorët e ngushtë të këtij sektori/shtabi brenda dhe jashtë Kosovës; si dhe pjesëtarë të Kryesisë dhe të Këshillit të Përgjithshëm të

---

[82] Emrush Xhemajli, "Lëvizja Popullore e Kosovës 1982–2002", *LPK Kosova,* 2002, http://lpkkosova.com/historiku.html.

[83] Intervistë televizive e Nait Hasanit në *T7 – Pressing*, "Rrëfimi për Tribunalin, burgun, UÇK-në," transmetuar më 19 prill 2023, e disponueshme në YouTube: https://www.youtube.com/watch?v=fA0RgxX7CzU. Shih edhe: Rrëfimi i rrallë i Jakup Nurës, shokut të Adem Jasharit, në *T7 – Pressing,* https://www.youtube.com/live/m23TJau-Bhk.

Degës së LPK-së jashtë vendit. Po në këtë rreth përfshiheshin edhe individë të caktuar që, pa qenë formalisht pjesë e LPK-së, iu bashkëngjitën gradualisht UÇK-së nga viti 1994 e tutje, duke ofruar përkrahje logjistike e ushtarake. Në këtë kontekst, edhe pjesëtarë të fraksionit "radikal" të LPK-së - Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) - iu bashkuan UÇK-së, duke u bërë pjesë e procesit të saj konsolidues.

Përkundër numrit relativisht të vogël të pjesëtarëve të UÇK-së (pas Konferencës së Dejtonit dhe çlirimit të Kroacisë me forcat e veta, në vitin 1995) u shtuan aksionet e armatosura të UÇK-së. Në këtë vazhdë edhe UÇK-ja pësoi goditje të njëpasnjëshme, veçanërisht në vitin 1997, ku u vranë: Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha, Hakif Zejnullahu, Luan Haradinaj, Adrian Krasniqi, paraprakisht ishte plagosur në një aksion bashkëpunëtori i tyre Qerim Kelmendi, gjithashtu paraprakisht gjatë arrestimeve ishte arrestuar edhe Nait Hasani. Megjithëkëtë, pavarësisht prej vështirësive të mëdha, përpjekjet e UÇK-së vazhduan.

Në këtë vazhdimësi, kryesisht dy ndodhi të mëdha e bën ndryshimin e madh për mobilizimin, fuqizimin dhe faktorizimin e UÇK-së. Ndodhia e parë është e ngjashme me rënien heroike në krye të detyrës të prijësve emblematikë të LPK-së, Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Bardhosh Gërvallës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës etj., në një periudhë kyçe historike (pas demonstratave të vitit 1981), që ndikoi për një inkurajim dhe mobilizim të fuqishëm në kuadër të LPK-së. Ngjashëm, në një periudhë kyçe historike, rënia heroike në mars të vitit 1998, e prijësit emblematik ushtarak të UÇK-së, Adem Jasharit,

dhe 58 anëtarëve të familjes së tij, (ku u masakruan 59 persona nga ana e regjimit neofashist të Miloševićit), ndikoi për një inkurajim dhe mobilizim të fuqishëm ushtarak në kuadër të UÇK-së. Ndodhia e dytë është, gjithashtu, e ngjashme me ndodhinë para shumë dekadash në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për Çlirimin e Kosovës me vise, pas vitit 1912. Sikurse kryeideologu i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për Çlirimin e Kosovës me vise, Hasan Prishtina, që e pati një rol shumë të rëndësishëm për orientimin politik të Lëvizjes Kaçake, duke i dhënë dimension të gjerë kombëtar (antiprovincial). Ngjashëm, një rol shumë të rëndësishëm për mobilizimin edhe më të madh politik të UÇK-së në nivel kombëtar e pati simboli i rezistencës së shqiptarëve të Kosovës, për liri dhe barazi, Adem Demaçi, i cili më 13 gusht 1998 e mori përgjegjësinë dhe u emërua përfaqësues i përgjithshëm politik i UÇK-së me seli në Prishtinë, e ashtuquajtura Zyra e UÇK-së në Prishtinë.[84]

Në vijim disa nga frymëzuesit emblematikë, disa prej tyre edhe themelues emblematikë të UÇK-së, duke e përfshirë prijësin emblematik ushtarak të UÇK-së, Adem Jasharin dhe prijësin emblematik politik të UÇK-së, Adem Demaçin:

[84] Lekaj, 2021: 166-177




Edhe pas krimit monstruoz të regjimit të Miloševićit në sulmin ndaj familjes Jashari, duke e përfshirë sulmin të njëjtin muaj më 24 mars 1998 ndaj familjes Haradinaj, që së bashku me bashkëluftëtarët e tyre bëri një rezistencë heroike në një përballje luftarake krejtësisht të pabarabartë me forcat serbe[85], institucionet politike

[85] *Lajmi.net,* "22 vjet nga Epopeja e Dukagjinit", 2020, https://lajmi.net/22-vjet-ngaepopeja-e-dukagjinit/.

ndërkombëtare ende vazhdonin të kishin një qasje refuzuese dhe paragjykuese ndaj UÇK-së. Rrjedhimisht, hapja e Zyrës së UÇK-së në Prishtinë ishte e një rëndësie të veçantë edhe si vlerë në vete, sepse udhëhiqej nga Adem Demaçi, si personalitet i mirënjohur ndërkombëtarisht në fushën e të drejtave të njeriut (përveç të tjerash i mirënjohur edhe me çmimin *Sakharov* etj.). Njëherësh konsolidimi i Grupit Diplomatik të UÇK-së, që përbëhej kryesisht nga veprimtarë të mirëshkolluar në universitete prestigjioze perëndimore dhe që përfaqësonin UÇK-në në pothuajse të gjitha shtetet perëndimore, pati një rol vendimtar për arritjet e para diplomatike të UÇK-së. Në këtë mënyrë, UÇK arriti të shënojë një etapë të re në vazhdën e (dhe si kulmina-cion) i kryengritjeve të armatosura dhe përpjekjeve të shqiptarëve për çlirimin e Kosovës prej vitit 1912. Sepse, tashmë UÇK, duke qenë e inkurajuar nga altruizmi patriotik, heroizmi dhe sakrifica sublime e familjes Jashari, përveçse arrinte të bënte një përballje titanike ushtarake, edhe pse ishte tërësisht asimetrike në raport me forcat ushtarake të regjimit të Miloševićit (sikurse Davidi kundër Goliatit), gjithashtu për të parën herë përfaqësimi politiko-diplomatik i një kryengritje të armatosur të shqiptarëve të Kosovës (UÇK-së) arrinte suksese të njëpasnjëshme diplomatike. Fillimisht ky sukses diplomatik u arrit si rezultat i veprimtarisë së Grupit Diplomatik të UÇK-së, nëpërmes takimeve dhe komunikimeve të suksesshme fillestare në emër të UÇK-së, përveç të tjerash me Richard Holbrooke (i dërguar

special i ShBA-së për Ballkanin)[86], ministrin e Punëve të Jashtme të Austrisë, Wolfgang Schüssel (gjatë kësaj periudhe Austria ishte udhëheqëse e radhës së BE-së)[87], ministrin e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Knut Vollebæk, i cili gjatë luftës në Kosovë ishte udhëheqës i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)[88], dhe me shumë personalitete të tjera me ndikim politiko-diplomatik në shtetet perëndimore, përfshirë interesimin e madh të gazetarëve të huaj që i mundësuan Grupit Diplomatik të UÇK-së mbajtjen e konferencave dhe paraqitjen në debatet televizive dhe në mediet e shkruara në shtetet perëndimore[89], duke përfshirë edhe deklaratat fillestare në mediet e huaja në emër të UÇK-së dhe në mbështetje të UÇK-së.[90] Rrjedhimisht, si rezultat i rëndësisë së hapjes së Zyrës së UÇK-së, në Prishtinë, dhe veprimtarisë intensive politike, diplomatike dhe mediatike të Grupit Diplomatik

---

[86] Intervistë e Bardhyl Mahmutit për gazetën *Epoka e re* më 25 shtator 2023, "Si u hoq cilësimi i UÇK-së si organizatë terroriste", https://www.epokaere.com/interviste-ekskluzive-me-bardhyl-mahmutin-si-u-hoq-cilesimi-i-uck-se-si-organizate-terroriste-1/.

[87] Kiçmari, 2017): 62-70

[88] Intervistë e Bardhyl Mahmutit për gazetën *Epoka e re,* më 20 dhjetor 2023, "Deklarata politike numër 7 i hapi dyert e diplomacisë", https://www.epokaere.com/deklarata-politike-numer-7-i-hapi-dyert-e-diplomacise/?fbclid=IwAR3.

[89] Po aty

[90] *Gazeta Bujku,* 10 dhjetor 1997, "Mjetet skandinave të informimit rreth ekzistimit dhe aksioneve të UÇK-së". Shih në lidhje me këtë edhe: *Politika Nordike dhe Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK),* https://www.scribd.com/document/557546433/Politika-Nordike-dhe-Levizja-Popullore-e-Kosoves-LPK, f. 203–207.

të UÇK-së, duke e përfshirë Kryesinë dhe Këshillin e Përgjithshëm të LPK-së, Dega jashtë vendit (përfshirë disa personalitete në kuadër të diasporës shqiptare dhe në përgjithësi aktivitetet pro UÇK-së të diasporës shqiptare), u arrit të ndryshohej qasja refuzuese dhe paragjykuese që ishte krijuar për UÇK-në në kuadër të institucioneve politike ndërkombëtare. Në këtë kontekst, më 23 shtator 1998 Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1199, që shënoi një ndryshim cilësor lidhur me qëndrimin ndaj UÇK-së. Në lidhje me këtë, studiuesi Daniel Cservolgyi, përveç të tjerash, shkruan: *"Pas riklasifikimit të saj, UÇK-ja u bë një lojtar i domosdoshëm në procesin e paqes në Kosovë. Përfshirja e UÇK-së në bisedimet për zgjidhjen e konfliktit kishte ndodhur tashmë gjatë procesit të riklasifikimit të saj në qershor-korrik 1998, pas të cilit, UÇK-ja nuk u lidh më kurrë përsëri me terrorizmin në deklarata të gjera politike. Më pastaj, në shtator të vitit 1998, të gjithë anëtarët e KS të OKB-së nënshkruan Rezolutën nr. 1199, e cila e mbishkroi ose e zëvendësoi në shumë fusha Rezolutën e marsit nr. 1160".*[91] Kjo ishte me rëndësi sepse propaganda e regjimit serb përpiqej, përveç të tjerash, ta paraqesë UÇK-në në arenën ndërkombëtare si një organizatë terroriste dhe si organizatë fundamentaliste fetare. Për më tepër, kjo ishte e një rëndësie të

[91] Daniel Cservolgyi, "The Role and Ramifications of the Kosovo Liberation Army's Reclassification in the Peace Process of Kosovo", *Naval Postgraduate School, Monterey,* California, 2002, i disponueshëm në: https://apps.dtic.mil/sti/pdfs/AD1173258.pdf.

veçantë, sepse shqiptarët e Kosovës prej vitit 1912 në disa raste kishin korrur suksese gjatë betejave ushtarake, por tani si UÇK për të parën herë korrnin suksese gjatë betejave të njëpasnjëshme diplomatike, duke i përforcuar dhe siguruar binarët drejt imponimit të çështjes së Kosovës për zgjidhje në kuadër të agjendës ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës në ekzil krijoi konfuzion gjatë mesit të pranverës së vitit 1998, me iniciativën për formimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), njëkohësisht iniciativë shumë e vonuar, ngaqë kishte pasur në dispozicion gati dhjetë vjet për të formuar një ushtri dhe nuk e formoi e, gjithashtu, edhe iniciativat nga grupet që kishin treguar gatishmëri dhe guxim brenda LDK-së, të cilat përfaqësoheshin nga Sali Çekaj etj., u ndërprenë dhe u demotivuan si rezultat i mosmbështetjes së duhur që nga viti 1991/92. Për më tepër, kjo iniciativë ishte konfuze në kuptimin e ndërtimit të një strukture paralele ushtarake krahas UÇK-së por, fatmirësisht, persona të përgjegjshëm, të udhëhequr nga Sali Çekaj etj., treguan maturi duke e orientuar këtë strukturë si përforcim në kuadër të UÇK-së dhe jo si rivale e saj, në kuptimin se FARK-u ishte pjesë e UÇK-së. Kjo gjë edhe u përsqarua në bisedimet në mes të përfaqësuesve të UÇK-së dhe të FARK-ut në takimin e Oslos. Kështu që në këtë vazhdë, FARK-u u bë edhe formalisht pjesë e UÇK-së, duke iu përmbajtur siglës dhe strukturës organizative të UÇK-së, por në nivel të njësive udhëhiqej nga komandantët e emëruar nga ministri i Mbrojtjes në Qeverinë e

Kosovës në ekzil, koloneli me përvojë të gjatë ushtarake, Ahmet Krasniqi etj. Në fakt, kyçja paraprakisht e disa ushtarakëve profesionalë shqiptarë (me prapavijë ushtarake profesionale nga ish-Armata Jugosllave, dhe me prapavijë profesionale ushtarake nga armata e shtetit shqiptar), dhe në këtë vazhdë kyçja edhe e ushtarakëve të tjerë (me prapavijë ushtarake nga ish-Armata Jugosllave), të inkurajuar nga kolonel Ahmet Krasniqi, e fuqizuan UÇK-në, deri në një masë, edhe në aspektin profesional ushtarak.

Për takimin në Oslo në muajin maj të vitit 1998, në mes të përfaqësuesve të UÇK-së dhe të FARK-ut, është përkujdesur Bashkësia Shqiptare në Norvegji (BShN), e cila përfshinte brenda vetes të gjitha subjektet politike dhe kulturore shqiptare në Norvegji, pa dallim bindjesh politike dhe fetare, me një qëllim të përbashkët: në përkrahje logjistike, politike dhe diplomatike të UÇK-së, si mjet i fundit për kyçjen e çështjes së Kosovës për zgjidhje në kuadër të agjendës ndërkombëtare. Suksesi më i madh i takimit në Oslo, përkundër sfidave, është se ka arritur ta shmangë mundësinë potenciale të luftës vëllavrasëse në mes të shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë, meqë jo vetëm shërbimi serb, por edhe disa shërbime të tjera - rajonale - punonin me ngulm për të vënë përçarje/vëllavrasje në mes të shqiptarëve. Njëherësh edhe shërbimet e tjera përtej rajonale, punonin me ngulm që të kufizohej potenciali i fuqizimit ushtarak për UÇK-në, në mënyrë që lufta në Kosovë të mos përshkallëzohej (përtej kufijve të Kosovës) dhe veçanërisht që UÇK-ja të vihej nën kontrollin e faktorëve

relevantë ndërkombëtarë. Rrjedhimisht, kush nuk ishte në takt me këto qëndrime të faktorëve relevantë ndërkombëtarë konsiderohej prej tyre i paakceptueshëm për bashkëpunim, madje edhe i rrezikshëm. Me fjalë të tjera, u pamundësua evoluimi i UÇK-së në një ushtri me mobilizim të përgjithshëm kombëtar dhe me profesionalizëm të plotë ushtarak. E tëra rezultoi me Konferencën e Rambujesë.

Udhëheqja politiko-ushtarake e Kosovës u sfidua shumë nga dokumenti i propozuar për negociata në Konferencën e Rambujesë ngaqë në pikënisje ky dokument garantonte sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federative Jugosllave (RFJ-së) de facto të Serbisë, mbi Kosovën, dhe parashihte një autonomi për Kosovën që nuk ishte në nivel as me autonominë që kishte Kosova në bazë të Kushtetutës të vitit 1974. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, kryesuesi i delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë, Hashim Thaçi, sa e kishte privilegjin po aq e kishte të vështirë pozitën e kryesuesit të delegacionit. Për më tepër, ishte nën hijen, në kuptimin e presionit psikologjik, të dy personaliteteve më me ndikim politik në Kosovë gjatë kësaj periudhe. Kjo gjendje, në fakt, e ndihmoi Hashim Thaçin ta gjejë zgjidhjen më të mirë të mundshme. Brenda kështjellës e kishte simbolin e rezistencës paqësore të Kosovës, Ibrahim Rugovën, i cili, me personalitetin e tij si misionar i paqes, e rriste presionin psikologjik pro nënshkrimit gjithsesi të një marrëveshjeje si rrugë drejt paqes. Jashtë kështjellës e kishte simbolin e rezistencës së shqiptarëve të Kosovës për liri dhe barazi, njëherësh prijës emblematik politik i

UÇK-së, Adem Demaçin, i cili (edhe pse e kishte refuzuar që në fillim dokumentin e propozuar për negociata), me ndikimin që kishte, e rriste presionin psikologjik në kuptimin që të mos pranohet ndonjë zgjidhje pa asnjë perspektivë politike për Kosovën dhe kështu, tërthorazi, ndikonte për forcimin e pozicionit negociues të delegacionit shqiptar të Kosovës në Konferencën e Rambujesë. Madje edhe Madeline Albright në librin e saj *Madam Secretary: a memoir*, përveç të tjerash, shkruan se Demaçi ishte: "*Një prej atyre që i bënin presion Thaçit ta ruante qëndrimin më të ashpër të mundshëm.*"[92] Në këtë vazhdë, pasi që u premtua se zgjidhja finale për Kosovën do të bazohet në *vullnetin e popullit* (edhe pse shprehja "vullneti i popullit" nuk ishte e konkretizuar)[93], delegacioni i shqiptarëve të Kosovës, i kryesuar nga Hashim Thaçi dhe Ibrahim Rugova, në të cilin kontribut të rëndësishëm dhanë edhe Rexhep Qosja dhe Veton Surroi (bashkërisht me delegatët e tjerë), e pranoi propozimin për Marrëveshjen e Rambujesë dhe e nënshkroi më 18 mars 1999 në Paris të Francës, e gjithë kjo në kombinim me refuzimin e Miloševićit të kësaj marrëveshje, rezultoi me intervenimin ajror të NATO-s dhe çlirimin përfundimtar të Kosovës. Sipas ballkanologut norvegjez Svein Mønnesland, Miloševići e refuzoi marrëveshjen e Rambujesë sepse nuk pranoi, siç parashihte kjo marrëveshje, stacionimin e trupave paqeruajtëse të udhëhequra

[92] Albright, 2003: 404

[93] *Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo,* 1999, f. 85, https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990123_RambouilletAccord.pdf.

nga NATO dhe se kjo marrëveshje pas tre vjetësh parashihte një lloj referendumi për Kosovën.[94] Këto dy arsye kryesore në lidhje me refuzimin e marrëveshjes së Rambujesë nga Miloševići janë konfirmuar para rreth dy vjetësh edhe nga Vuk Drašković (ish-kryediplomat i Serbisë gjatë Konferencës së Rambujesë) në një intervistë të tij për një TV të Kosovës. Në këtë intervistë, Draškovići gjithashtu jep edhe një shpjegim tjetër shtesë pse Miloševići e refuzoi marrëveshjen e Rambujesë ku, përveç të tjerash, thotë: *"Personalisht mendoj se Miloševići, i kishte disa arsye të vetat që e refuzojë marrëveshjen e Rambujesë. Deri para luftës në Kosovë dhe deri para bombardimeve të NATO-s, Miloševići në botë njihej si agresor. Si një njeri që qëndronte prapa të gjitha krimeve dhe agresioneve në Bosnjë e Kroaci. Por, ai tani përnjëherë dëshironte të ishte në pozitën e viktimës. Dhe, që bota ta njihte si dikë që ishte viktimë e agresionit të forcës më të madhe ushtarake në historinë e njerëzimit. Nuk e di, ndoshta kjo ishte njëlloj kënaqësie për te".*[95]

Njëherësh vlen të theksohen disa aspekte sa i përket intervenimit të NATO-s. Së pari, intervenimi kishte të bënte me aspektin e sigurisë (për shkak të pozitës gjeografike të Kosovës) që, njëkohësisht, e legjitimonte ndërhyrjen e NATO-s. Në kuptimin se konflikti në Kosovë përfaqësonte një kërcënim tejet serioz për stabilitetin dhe sigurinë në zonën thelbësore të NATO-

---

[94] Mønnesland, 2006: 359

[95] *Intervistë ekskluzive me Vuk Drashkoviqin: "Flet për krimet serbe dhe për raportet me shqiptarët,"* 5 qershor 2023, e disponueshme në YouTube: https://www.youtube.com/watch?v=K6R-lxnfF-w&t=2727s.

s (jo vetëm në Ballkan, por në të gjithë rajonin). Kjo do të thotë se kriza në Kosovë ishte një kërcënim për sigurinë edhe për shtetet anëtare të NATO-s, prandaj NATO kontribuoi jo vetëm në shmangien e një kërcenimi madhor të sigurisë, por edhe për t'u konsoliduar më mirë dhe për t'u zgjeruar në Ballkan. Ndërhyrja e NATO-s ishte, gjithashtu, në masë të madhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të bazuar në dispozitat e Kartës së OKB-së për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe në rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit për Kosovën. Me fjalë të tjera, Këshilli i Sigurimit i OKB-së e trajtoi krizën në Kosovë në përputhje me Kapitullin VII të Kartës së OKB-së - kërcënimet ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare të cilat mund ta autorizojnë përdorimin e forcës. Prandaj, nuk kishte nevojë të domosdoshme për një rezolutë/ autorizim eksplicit nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së.

Së dyti, aspekti humanitar vjen si shtesë dhe pothuajse si faktor vendimtar, ngaqë ishte hera e parë që NATO sulmoi një shtet sovran me justifikimin në konceptin e ndërhyrjes humanitare. Si aspekti i sigurisë ashtu edhe ai humanitar duhen parë si vazhdimësi e procesit të Helsinkit pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Përkatësisht si vazhdimësi e konsolidimit më të fortë të politikave të sigurisë/paqes në Evropë përmes NATO-s dhe, njëherësh, si vazhdimësi e forcimit të qëndrimit se parimi i të drejtave të njeriut peshon më shumë sesa parimi i mosndërhyrjes në shtete, në rastet kur regjimet shtetërore shkelin rëndë të drejtat themelore të qytetarëve të vet dhe, rrjedhimisht, krijojnë kriza të rënda humanitare. Në kuadër të kësaj game

zhvillimesh, vlen të theksohet se intervenimi ajror i NATO-s në rastin e Kosovës ishte i lidhur ngushtë edhe me presionin moral që ushtrohej mbi shtetet perëndimore dhe mbi organizatat ndërkombëtare (NATO, OKB, OSBE, KE etj.) për të ndërmarrë veprime të menjëhershme për ndalimin e regjimit represiv dhe vrastar të Milošević-it, me qëllim të parandalimit të përsëritjes së gjenocidit të Bosnjës në Kosovë. Ky presion moral artikulohej brenda vetë shoqërive perëndimore, përmes medieve, organizatave joqeveritare dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile, të cilët kontribuuan në formësimin e agjendës humanitare dhe politike të kohës. Për më tepër, një dimension i rëndësishëm i këtij presioni buronte nga veprimtaria intensive e diasporës shqiptare, e cila, në mënyrë të vazhdueshme luajti rol të rëndësishëm në sensibilizimin e opinionit publik ndërkombëtar dhe në aktivizimin e mekanizmave ndërkombëtarë të reagimit.

Së treti, aleanca e NATO-s kundër regjimit të Miloševićit ka qenë aleancë kundër një regjimi (siç kanë qenë aleancat kundër regjimit të Hitlerit dhe kundër shembujve të tjerë të regjimeve tiranike në botë), dhe nuk ka qenë aleancë kundër popullit serb. Gjithashtu, edhe përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për liri dhe barazi kanë qenë përpjekje kundër regjimit të Miloševićit (duke përfshirë regjimet e mëparshme shtypëse të shtetit serb ndaj shqiptarëve), dhe jo kundër popullit serb. Si shembull për këtë vlen t'i referohemi një fragmenti nga libri i historianit Noel Malcolm, që dëshmon se që në fillesën e tyre, përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për liri dhe barazi, të frymëzuara nga kryeideologu Hasan

Prishtina, kanë qenë të drejtuara kundër regjimit serb dhe jo kundër popullit serb. Në lidhje me këtë, Malcolm përveç të tjerash shkruan: *"Shumica e udhëheqësve politikë të Kosovës të kohës së luftës tashmë ishin larguar nga territori i Kosovës, një grup i tyre, nën udhëheqjen e Hasan Prishtinës, u mblodh në Shkodër në nëntorin e vitit 1918 dhe e formoi Komitetin për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, i njohur më mirë si Komiteti i Kosovës...(....) Ç'është e vërteta, Komiteti i Kosovës pjesën më të madhe të energjisë ia kushtoi përkrahjes, deri në një shkallë edhe udhëheqjes së Lëvizjes Kaçake brenda Kosovës. Në fillim të vitit 1919, ky komitet përgatiti një varg rregullash të përgjithshme të lëvizjes, duke filluar me këto dy pika; 1: asnjë kryengritës nuk bën t'i lëndojë serbët vendës, por vetëm ata të cilët rrokin armët kundër shqiptarëve; 2: asnjë kryengritës nuk bën të djegë ndonjë shtëpi apo të rrënojë ndonjë kishë"*[96] Madje simboli i shqiptarëve të Kosovës për liri dhe barazi, Adem Demaçi, edhe pse i kaloi 28 vjet në burgjet e Jugosllavisë, mbeti kundërshtar i betuar i politikës së hakmarrjes dhe urrejtjes ndëretnike, duke konsideruar se populli serb po manipulohet nga push-teti dhe se një popull i tërë nuk duhet të identifikohet me asnjë klasë politike në pushtet. Rrjedhimisht, për Demaçin nuk kishte popuj të këqij, por vetëm regjime të këqija, gjithashtu nuk harronte t'i vlerësonte intele-ktualët serbë të cilët ishin mjaft të guximshëm për të gjetur mënyra për ta artikuluar kundërshtimin e tyre ndaj autoriteteve serbe: Bogdan Bogdanović, Milan

[96] Malcolm, 2001 : 284-285

Nikolić, Zagorka Golubović, Srđa Popović, Lazar Stojanović etj., duke i konsideruar si bijtë e vërtetë të popullit serb. [97]

Së katërti, Miloševići u ndal vetëm pasi që NATO e kërcënoi me përgatitjen e sulmeve me trupat tokësore, madje edhe vetë gjenerali Wesley K. Clark e vërteton këtë në njëfarë mënyre se sikur të kishin filluar që në fillim përgatitjet për intervenim tokësor do të shpëtoheshin shumë njerëz të pafajshëm. Në librin e tij *Waging Modern War* (2001), përveç të tjerash, shkruan: *Planifikimi dhe përgatitjet për ndërhyrje tokësore ishin në proces aty nga fundi i fushatës ajrore dhe unë jam i bindur se kjo, në veçanti, e shtyu Miloševićin të dorëzohet.*[98] Rrjedhimisht, edhe pse intervenimi i NATO-s në Kosovë nuk ndodhi sikurse intervenimi për çlirimin e Kuvajtit në vitet 1990-'91 nga aleatët perëndimorë (të cilët përdorën trupat tokësore). Njëherësh, edhe pse gjatë periudhës 78-ditëshe të sulmeve ajrore të NATO-s (që filluan më 24 mars 1999 me qëllim për ta ndalur gjenocidin e regjimit të Miloševićit në Kosovë), Miloševići u hakmor në popullatën e pambrojtur civile shqiptare të Kosovës, duke kryer krime me përmasa gjenocidiale. Gjithashtu, edhe pse ndihma për Kosovën (si rezultat i intervenimit ajror të NATO-s) nuk është shembull i izoluar, ngaqë historia na mëson se nuk ka popull që është çliruar krejtësisht vetë ose shtet që është formuar krejtësisht vetë pa ndihmën më shumë dhe më pak të të tjerëve/të huajve. Megjithëkëtë, shqiptarët e Kosovës

[97] Gashi, 2010 : 99-101
[98] Clark, 2001 : 429

janë dhe do të mbesin përgjithmonë mirënjohës për ndihmën e të huajve për arritjen dhe forcimin e paqes në Kosovë, sepse mirënjohja është edhe pjesë e rëndësishme e traditës shqiptare. Për më tepër, siç thotë filozofi i shquar gjerman Emanuell Kant, mirënjohja është "detyrë e shenjtë".

Njëkohësisht mund të konkludohet se parakushte kryesore dhe të domosdoshme për zbërthimin e nyjës gordiane drejt ndërhyrjes së NATO-s dhe çlirimit përfundimtar të Kosovës ishin, në kuptim komplementar, UÇK-ja dhe Lëvizja Paqësore e Kosovës, që arritën më shumë dhe më pak në kuptim komplementar që çështjen e Kosovës (që kishte mbetur çështje e pazgjidhur prej vitit 1912) ta vendosin për zgjidhje në kuadër të agjendës ndërkombëtare, dhe me sakrificën e heronjve, dëshmorëve dhe viktimave të luftës, shërbyen si katalizatori kryesor për çlirimin e Kosovës. Duke e përfshirë mbështetjen e shtetit shqiptar (Shqipërisë Londineze) dhe rolin vendimtar të intervenimit ushtarak ajror të NATO-s, në krye me ShBA-në (përfshirë të gjitha shtetet anëtare të NATO-s).

Në vijim është një nga fotot që dokumenton skenën e hyrjes së forcave paqeruajtëse në Kosovë, një çast kur qindra qytetarë i pritën me entuziazëm dhe me lehtësim trupat e NATO-s. Kjo fotografi ngërthen një çast që shumë njerëz e mbajnë mend jo vetëm me sytë, por edhe me zemër. Një pjesë e turmës përshëndet me dy gishtërinj të ngritur në shenjë paqeje, të tjerë me grushtin lart si simbol force e qëndrese, ndërsa shumë të tjerë shtrijnë duart drejt ushtarëve të vendosur mbi kamionë, sikur po kapin më në fund bregun e shpëtimit

pas një stuhie të gjatë. Nga ana tjetër, ushtarët u përgjigjen me buzëqeshje të qeta dhe me një thjeshtësi prekëse. Mes tyre nuk shkëmbehen fjalë, por ekziston një gjuhë më e thellë - prekja e duarve, një gjest që thotë: "Erdhëm. Nuk jeni vetëm". Ky është një çast ku historia, dhimbja dhe shpresa takohen. Një moment i paharrueshëm kur Kosova, e lodhur nga vuajtjet, më në fund merr frymë lirshëm :



Rrugëtimi i Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë është një histori lavdie, sakrifice dhe përpjekjeje të pandalshme. Megjithatë, përtej sukseseve të padiskutueshme, ky proces u shoqërua me disa gabime të dukshme politike, ndër të cilat veçohen disa thelbësore. Në radhë të parë mungesa e koordinimit të duhur ndërmjet protagonistëve kryesorë politikë të Kosovës në fazën paraprake të organizimit të UÇK-së, si dhe mungesa e mbështetjes së duhur për UÇK-në gjatë luftës

nga një pjesë e udhëheqjes politike të vendit, rezultoi me humbjen e çdo mundësie për vendosjen e kontrollit efektiv në veriun e Kosovës menjëherë pas përfundimit të luftës. Kjo mangësi në koordinim në lidhje me UÇK-në nuk kufizohej vetëm në mpleksjen ndërmjet LDK-së dhe Qeverisë së Kosovës në ekzil, nga njëra anë, dhe LPK-së, nga ana tjetër, por edhe nga mungesa e koordinimit të duhur ndërmjet vetë LDK-së dhe Qeverisë së Kosovës në ekzil, si dhe, në një masë të caktuar, brenda secilës prej tyre veç e veç – pra, si brenda LDK-së, ashtu edhe në strukturat e Qeverisë së Kosovës në ekzil, dhe të LPK-së.

Në vijim, pas përfundimit të Konferencës së Rambujesë (1999) dhe themelimit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës nën drejtimin e Hashim Thaçit, nuk u manifestua gatishmëri e mjaftueshme politike për ta njohur Ibrahim Rugovën si president i Kosovës. Një nga arsyet kryesore për këtë qëndrim mund të gjurmohet që në vitin 1997, kur Ibrahim Rugova kishte shprehur disa qëndrime dekurajuese lidhur me UÇK-në. Megjithatë, Ibrahim Rugova dëshmoi maturi dhe konstruktivitet politik gjatë Konferencës së Rambujesë, kur, pas një hezitimi fillestar, pranoi që drejtori politik pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Hashim Thaçi, ta kryesonte delegacionin e Kosovës. Ky hap, i nxitur edhe nga Rexhep Qosja, ishte me rëndësi strategjike, pasi legjitimoi më tej luftën çlirimtare të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Megjithatë, mungesa e vullnetit politik - si nga ana e Qosjes, ashtu edhe e anëtarëve të tjerë të delegacionit që gëzonin ndikim mbi Thaçin - për ta formalizuar njohjen e Rugovës si president i Kosovës, përbën

një rast të humbur politik. Një veprim i tillë do të kishte kontribuar ndjeshëm në unifikimin e faktorit politik shqiptar dhe në forcimin e legjitimitetit institucional të Kosovës, pikërisht në një moment vendimtar të nisjes së procesit të shtetformimit të vendit. Pas luftës, përçarjet politike u reflektuan edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. LDK-ja, megjithëse doli forca e parë dhe siguroi pozitën e presidentit, nuk arriti shumicën e nevojshme për ta formuar qeverinë. Për rrjedhojë, ajo refuzoi ta pranonte Hashim Thaçin kandidat për kryeministër - një qëndrim që mund të interpretohet si reaksion politik ndaj zhvillimeve të periudhës së Rambujesë. Pas ndërhyrjes dhe ndërmjetësimit të bashkësisë ndërkombëtare, u arrit një kompromis që Bajram Rexhepi, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), të emërohej kryeministër në një qeveri koalicioni në mes të LDK-së dhe PDK-së.

Rrjedhimisht, divergjencat ndërmjet liderëve shqiptarë të Kosovës, para dhe pas Konferencës së Rambujesë, krijuan terren të përshtatshëm për ndërhyrje dhe manipulim nga faktorë të jashtëm, përfshirë strukturat e shërbimit sekret serb (UDB-ën), e cila, me gjasë, shfrytëzoi këto divergjenca për ta thelluar përçarjen brenda shqiptarëve. Fatmirësisht, kjo përçarje nuk u përshkallëzua në nivelin e konflikteve të brendshme të armatosura - vëllavrasëse, siç ka ndodhur në raste të tjera ndërkombëtare. Megjithatë, pasojat politike të këtyre divergjencave ishin të shumta dhe afatgjatë: nisma për ndarjen e Mitrovicës, trazirat e marsit 2004, të cilat krijuan pretekstin për decentralizim etnik të vendit dhe, në mënyrë të tërthortë, vonesën e shpalljes

së pavarësisë. Më vonë, përmes Planit të Martti Ahtisaarit u institucionalizua ndarja etnike si element i strukturës së re politike të Kosovës. Sidoqoftë, Martti Ahtisaari nuk mund të fajësohet, pasi zgjidhja që ai ofroi përfaqësonte kompromisin më të arsyeshëm të mundshëm brenda kontekstit politik të pasluftës. Përgjegjësia bie mbi liderët politikë shqiptarë, të cilët, përveçse nuk arritën t'i parandalonin trazirat e vitit 2004, nuk demonstruan as përgatitje, as unitet dhe as kreativitet të mjaftueshëm për të hartuar një platformë negociuese gjithëpërfshirëse për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë. Një platformë e tillë do të kishte siguruar barazi të drejtash për të gjitha komunitetet, pa bërë dallim ndërmjet minoritetit serb dhe minoriteteve të tjera, siç bën dallim Plani i Ahtisaarit.

Është për keqardhje që, gjatë përgatitjeve për shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, nuk u konsiderua e arsyeshme që, në mënyrë simbolike, aktin e shpalljes ta bënte vetë simboli i rezistencës kombëtare - fituesi i Çmimit "Saharov" dhe ish-përfaqësuesi i përgjithshëm politik i UÇK-së, Adem Demaçi. Ai ishte i vetmi ndër personalitetet më emblematike të lirisë së Kosovës që ende ishte gjallë, një figurë që simbolizonte përpjekjet e pandërprera të popullit të Kosovës për liri që nga viti 1912. Çuditërisht, lidhur me këtë, pothuajse askush nga bashkëveprimtarët apo bashkëpunëtorët e Hashim Thaçit nuk reagoi siç duhej. Madje në mënyrë të pashpjegueshme nuk reagoi as Rexhep Qosja as kur duhej e as siç duhej. Megjithatë, duhet theksuar se shpallja e 17 shkurtit 2008 ishte, në thelb, vetëm një

rikonfirmim i shpalljes së parë të Republikës së Kosovës e cila u artikulua përmes demonstratave të vitit 1981 - demonstrata që, në thelb, përbënin një referendum popullor për Republikën e Kosovës. Njëkohësisht, ajo përbënte edhe rikonfirmim të shpalljes së pavarësisë më 2 korrik 1990, tri akte historike që shënojnë rrugëtimin e pandërprerë drejt pavarësimit të plotë të vendit. Në këtë vazhdë, edhe pse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) në korrik të vitit 2010 konstatoi se pavarësia e Kosovës ishte e ligjshme dhe jo në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, negociatat që pasuan me Serbinë çuan në marrëveshjen e vitit 2013 për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ky zhvillim i hapi rrugë regjimit të Beogradit për të insistuar në krijimin e një de facto republike serbe brenda territorit të Kosovës. Edhe ky nxitim, gabim dhe lëshim në negociata nga pala shqiptare, ishte rezultat i mungesës së koordinimit të duhur ndërmjet forcave politike shqiptare rreth platformës së përbashkët të bisedimeve - në kuptimin se çfarë mund dhe çfarë nuk mund të negociohej, sidomos pas korrikut të vitit 2010, përkatësisht pas legjitimimit ndërkombëtar të pavarësisë së Kosovës nga GjND-ja. Kështu, insistimi i Beogradit për Asociacionin - tanimë si marrëveshje e vitit 2013, e mbështetur edhe nga Bashkimi Evropian - u inkorporua më pas edhe në kuadër të Marrëveshjes së Ohrit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të vitit 2023.

Krejtësisht në fund, vlen të theksohet se, duke marrë parasysh që Kosova po përmbyll një çerek shekulli liri në shekullin XXI dhe tashmë po hyn në çerekun e dytë

të këtij shekulli, ky është një moment i rëndësishëm për të reflektuar jo vetëm mbi arritjet, por edhe mbi sfidat e rrugëtimit që kemi bërë. Populli dhe udhëheqësit politikë të vendit kanë çdo arsye të ndihen krenarë për heroizmin, sakrificat dhe kontributet që shërbyen si katalizatorë në arritjen e lirisë dhe në përpjekjen e vazhdueshme drejt pavarësisë së plotë të vendit. Por krenaria për të kaluarën duhet të shoqërohet me gatishmërinë për të mësuar nga gabimet politike të saj. Vetëm përmes këtij reflektimi Kosova mund të ndërtojë institucione më të forta dhe një demokraci që pasqyron idealet për të cilat u bë gjithë ai përkushtim dhe flijim. Të gabosh është njerëzore, por të mos mësosh nga gabimet, e madje t'i përsëritësh ato, veçanërisht kur përfaqëson popullin, është e pafalshme. Me fjalë të tjera, Kosova mbetet ende një shtet në bërje, një projekt politik dhe institucional që nuk është përmbyllur plotësisht. Prandaj, udhëheqësit politikë të vendit duhet ta marrin përgjegjësinë morale dhe politike për të mirën e përbashkët, përtej interesave partiake - të korrigjojnë bashkërisht atë që mund të korrigjohet, pa ia hedhur fajin njëri-tjetrit dhe pa lejuar që procesi i shtetndërtimit të stagnojë. Në këtë kuadër, uniteti dhe pragmatizmi në politikën e jashtme të Kosovës marrin një rëndësi të veçantë, sidomos në raport me Shtetet e Bashkuara të Amerikës - aleaten më të rëndësishme dhe më të besueshme të Kosovës. Nuk duhet harruar se, përveç sakrificave të panumërta gjatë luftës së viteve 1998-1999, pothuajse asnjë familje shqiptare në Kosovë, në tërë periudhën e okupimit serb (1912-1999), nuk ka

mbetur pa përjetuar, në një formë apo tjetër, dhe më shumë a më pak, shtypje, dhunë ose diskriminim nga regjimet serbe. Prandaj, është paradoksale që edhe sot, në rrethana lirie dhe shtetësie, të vërehet mungesë bashkëpunimi dhe madje stigmatizim brenda udhëheqjes politike të Kosovës, veçanërisht në çështjet madhore që përcaktojnë të ardhmen e vendit. Nëse klasa politike e Kosovës ende nuk ka reflektuar mjaftueshëm dhe, më keq ende, nëse për shkak të egove personale vazhdon të mos mësojë nga përvoja e së kaluarës, atëherë do t'i mallkojnë varret e heronjve dhe dëshmorëve. Dhe mos të harrojmë postulatin e Hasan Prishtinës: "Para së gjithash, ruhuni nga mallkimi i historisë."

## SHËNIME PËR AUTORIN

Fatmir Lekaj - Muriqi rrjedh nga një familje e fshatit Koshutan të Rugovës, e vëllazërisë Muriqi, pasardhëse e Gjekë Prenit (i njohur edhe si Gjekë Stanishi - Rugovalia), i cili la pas katër djem të vëllazërisë Muriqi: Dedën, Lekën, Lucën dhe Palin. Me ta kishte organizuar edhe rezistencën e parë në Rugovë kundër Perandorisë Osmane para rreth 400 vjetësh. Si pasardhës i Lekë Gjekës, Fatmiri e mban me krenari mbiemrin Lekaj (Lekmuriqi). Babai i Fatmirit, Rexhepi, ka qenë pjesëmarrës i Lëvizjes Kaçake të Rugovës kundër ripushtimit të Kosovës nga Serbia dhe, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, për t'iu shmangur burgosjes, është arratisur në krahinën e Plavë-Gucisë, ku kishte dajallarët - pasardhës të Alush Smajlit të Hotit - si dhe nipat në fshatin Hakaj të Plavë-Gucisë. Në këtë vazhdë, ai është martuar me Hasnije Feratajn, të bijën e Ramë Feratajt, i cili, së bashku me disa nga bashkëfamiljarët e tij - An Feratajn, Medi Feratajn etj. - u vranë, u plagosën dhe u persekutuan për shkak të angazhimit të tyre në kuadër të rezistencës vetëmbrojtëse të popullatës shqiptare të Plavë-Gucisë në vitet 1912-1913. Djali i dajës së nënës së Fatmirit, Mustafë Shala, ishte redaktori i parë dhe më vonë kryeredaktor i gazetës së parë në gjuhën shqipe në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore, "Rilindja". Në fillim të viteve 1960 babai i Fatmirit vendosi të kthehej në Kosovë me familjen, fillimisht në Rugovë, e më pas në Pejë, me qëllim që t'i shkollonte fëmijët. Rrjedhimisht, Fatmir Lekaj - Muriqi lindi në Pejë në vitin 1971, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm.

Për shkak të së kaluarës së tij, babai i Fatmirit mbeti vazhdimisht në shënjestër të regjimit serbo-jugosllav, duke përfshirë edhe periudhën e burgosjes së tij pas Luftës së Dytë Botërore. Rrjedhimisht, gjatë viteve 1960 dhe 1970 shtëpia e tij në Pejë u bastis disa herë me pretekstin se kishte dhe trafikonte armë, megjithëse nuk ekzistonte asnjë provë për këtë. Në fillim të viteve 1980, pas burgosjes së djalit të tij, Nufriut, për të ashtuquajturën veprimtari armiqësore të lidhur me kërkesën për "Republikën e Kosovës", familja e Rexhepit u etiketua si nacionaliste dhe irredentiste dhe u maltretua vazhdimisht përmes bastisjeve dhe marrjeve në pyetje nga shërbimi agjenturor i regjimit serbo-jugosllav (UDB). Këto ngjarje patën pasoja të rënda traumatike për tërë familjen, veçanërisht për Fatmirin, i cili i përjetoi ato që në fëmijëri. Megjithatë, si adoleshent, Fatmiri filloi të shfaqte solidaritet me veprimtarinë klandestine të LPRK-së në Kosovë (më vonë e njohur si LPK).

Me zhvillimet politike të viteve 1988–1989, si pjesëmarrës aktiv në demonstrata dhe protesta, ai u ekspozua ndaj rrezikut të arrestimit, sidomos pas dekonspirimit të një detyre të LPRK-së (të cilën e kishte marrë nga vëllai, Nufriu), që kishte të bënte me pritjen dhe strehimin e një gazetareje norvegjeze, e cila raportonte për gjendjen e rëndë në Kosovë. Për t'iu shmangur arrestimit, Fatmiri u detyrua të largohej përkohësisht nga vendi. Megjithatë, për shkak të përkeqësimit të situatës politike dhe pamundësisë për t'u kthyer në mënyrë të ligjshme, ai mbeti jashtë Kosovës dhe u vendos në Norvegji. Në Norvegji ai mbështeti veprimtarinë e LPK-së dhe të LDK-së, pa qenë anëtar i asnjërës prej

tyre, si dhe veprimtarinë e Grupit për Kosovën që vepronte në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH). Në këtë vazhdë, gjatë periudhës 1998–2008 ka shërbyer bashkëpunëtor i përfaqësuesit politik të UÇK-së për Skandinavinë (1998–1999), i përfaqësuesit diplomatik të Kosovës në Norvegji (1999–2000), si dhe i kryetarit të Zyrës së Kosovës në Norvegji (Kosova Office in Norway, 2001–2008). Në Norvegji edhe është arsimuar. Fillimisht ka studiuar për të drejtat e njeriut dhe trajtim konfliktesh, ndërsa më pas shkencë politike. Ka magjistruar për shkencë politike në Universitetin e Oslos, me fokus në nacionalizëm, multikulturalizëm dhe integrim. Aktualisht merret me veprimtari si kërkues i pavarur dhe këshilltar për çështjet e integrimit. Është përkthyes i kualifikuar norvegjisht–shqip dhe sekretar i Rrjetit të Profesionistëve Shqiptarë në Norvegji, si dhe anëtar i Asociacionit të Politologëve Norvegjezë dhe anëtar i Asociacionit Norvegjez të Shkrimtarëve dhe Përkthyesve të Letërsisë Non-fiksionale. Njëherësh është autor dhe bashkautor librash dhe artikujsh në revista shkencore. Nuk ka qenë dhe nuk është formalisht anëtar i asnjë partie politike, por vazhdon – edhe pas njohjes formale të pavarësisë së Kosovës nga shteti norvegjez më 28 mars 2008 – të kontribuojë me mendime dhe këshilla për politikëbërësit e Kosovës dhe për ruajtjen e bashkëpunimit të qëndrueshëm në kuadër të mërgatës shqiptare në Norvegji.

# BIBLIOGRAFIA

***Dokumente:***
Dokument / Faksimile e agjendës së vizitës së parë zyrtare të delegacionit të Kosovës të kryesuar nga Ibrahim Rugova në Oslo dhe me nisje nga Oslo (shkurt 1990): *Vizita e Rugovës dhe Maliqit në Oslo, 14–18 shkurt 1990.* Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile dërguar Berit Backerit nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë (korrik 1990): *"Lista e personave për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë".* Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile e korrespondencës së ndërsjellë të Berit Backerit me Britaninë e Madhe - Ministrinë e Punëve të Jashtme (korrik 1990): *Vizita e deputetëve të Kosovës.* Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile e korrespondencës së ndërsjellë të Berit Backerit me Federatën e Helsinkit (qershor 1990): *Vizita e deputetëve të Kosovës.* Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile e korrespondencës së ndërsjellë të Berit Backerit me Parlamentin Evropian - Presidencën dhe Delegacionin për Marrëdhënie me Jugosllavinë (qershor 1990): *Vizita e deputetëve të Kosovës.* Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile e korrespondencës së ndërsjellë të Berit Backerit me U. S. Helsinki Watch / Human Rights Watch (qershor 1990): *Vizita e deputetëve të Kosovës.* Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile e letrës përshëndetëse nga Kryeministri i Norvegjisë, dërguar Zyrës së Kosovës në Norvegji (tetor 2001): *"Statsministeren"*. Nga arkivi i ish-Zyrës së Kosovës në Norvegji.

Dokument / Faksimile e listës së emrave dhe adresave të Grupit të Kosovës brenda Komitetit Norvegjez të Helsinkit (1988): *"Adresseliste for Kosovo gruppen"*. Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile e një letre drejtuar delegacionit të Kuvendit të Kosovës nga Kristoffer Gjøtterud, në cilësinë e tij si nënkryetar i Komitetit Norvegjez të Helsinkit (korrik 1990): *"Të nderuar zotërinj"*. Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile e shënimeve të Berit Backerit nga takimet përgatitore për formimin e LDK-së (shtator 1989), *Shoqata e Shkrimtarëve, 12 shtator 1989*. Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë dhe tri parti politike nga Kosova, dërguar Nufri Lekajt (qershor 1990): *"S.O.S. KOSOVA"*. Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile/Letër falënderimi e dërguar nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë (KMDLNj) për Komitetin Norvegjez të Helsinkit (maj 1993): *"Të dashur miq"*. Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile: CV e Nufri Lekajt, nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit (janar 2000): *"To whom it may concern"*. Nga arkivi i ish-Zyrës së Kosovës në Norvegji.

Dokument / Faksimile: Deklaratë e LPK-së kundër vrasjes së Berit Backerit (mars 1993): *"Lajmërim"*. Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokument / Faksimile: Letër nga LPK-ja drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë lidhur

me demonstratën e mbajtur në Oslo më 17 shkurt 1990, gjatë së cilës u rishpreh indinjata kundër dhunës së ushtruar nga regjimi i Beogradit ndaj shqiptarëve në Jugosllavi dhe u ripërsërit kërkesa politike për Republikën e Kosovës (shkurt 1990). Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Dokumentet / Faksimilet në lidhje me iniciativën në takimin në Greqi në vitin 1993, për etablimin e Qendrës në Kosovë për rehabilitimin e ish-të burgosurve politikë shqiptarë, (1993 dhe 1994): Procesverbali i *"Takimit të Ballkanit"* dhe letra *"I dashur mik…"*. Nga arkivi i ish-Grupit të Kosovës në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

***Artikuj gazetash***

"Appell om nødhjelp til Albania." *Vårt Land* (Oslo), Den Norske Helsingforskomité, 21 gusht 1991.

Backer, Berit. 1990. *"Kosovo under total politi kontroll." Appell,* nr. 3/4, 1990. Oslo: Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

Bujku. 10 dhjetor 1997. *"Mjetet skandinave të informimit rreth ekzistimit dhe aksioneve të UÇK-së – Edhe durimi e ka fundin."*

Dagsavisen. 1 shkurt 1998. *"Her ble serberne stanset."*

Dagbladet. Mars 1993. *"Kosovos president beklager drapet."*

Der Spiegel. *"Die mörderische Zärtlichkeit der dunkelhaarigen Zorica."* Nr. 4 (1982).

Gazeta Koha. 3 nëntor 1990. *"Asambleja Qytetare e Helsinkit – Pragë 1990. Institucion i Lirisë."*

Илустрована Политика (Ilustrovana Politika). 24 nëntor 1987, f. 8–10.

Kosova Group of the Norwegian Helsinki Committee (KGNH). *Kosova-info,* 29 korrik 1990. *"Europe should be concerned."*

Le Soir. *"Le Chabanais Albanais – À qui le tour ?"* Tetor 1981.

Lekaj, Nufri R. 1991. *"Kosovo og albanerne glemt av Europa." Appell,* nr. 2, 1991. Oslo: Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

Politika ekspres. Rubrika *Svet,* 2 shkurt 1990.

"Programi i LPK-së." *Zëri i Kosovës*, nr. 15, 15 shtator 1993, f. 4.

Rilindja. 11 dhjetor 1997. *"Mjetet skandinave të informimit rreth ekzistimit dhe aksioneve të UÇK-së – Edhe durimi e ka fundin."*

Schulstok, Marit. *"Med skalpell i krigssonen." Uniforum,* nr. 10 (1999).

Shkëndija. 1991 (prill). *"Norvegjia fillon të reagojë." Shkëndija,* f. 4. Prishtinë.

Sillén, Jan af. *"Berit Backer." Aftenposten,* 18 mars 1993.
Smilden, Jan-Erik. *"Torturistene trakk ut tåneglene mine." Dagbladet,* 29 shtator 1987.

Sævereid, Harald Berg. *"Torturoffer Kasteball." VG,* 5 gusht 1988.

Sævereid, Harald Berg, dhe Aage Storløkken. *"Stoltenberg Korrigerer." VG,* 13 gusht 1988.

Štajner, Hari (Хари Штајнер). *"Норвешка – Ћошак поларног круга." NIN,* 23 prill 1989.

Zeka, Milaim. *"Jetëshkrim i shkurtër i Dr. Berit Backer-it." Revista Ekskluzive,* nr. 7 (2000), f. 54.

***Librat, disertacionet, raportet***

Aidinoff, M. B. & Anderson, K. (1989): *As the Federation Disintegrates: Human Rights in Yugoslavia.* Helsinki Watch, New York.

Albright, Madeleine (2003): *Madam Secretary: a memoir.* Miramax Books. United States.

Amnesty International Publications. (1985): *Yugoslavia: prisoners of conscience.* Shadowdean Limited, Mitcham, Surrey.

Anderson, K. (1990): *Yugoslavia: Crisis in Kosovo*. International Helsinki Federation and Human Rights Watch, New York.

Backer, Berit (2003): *Behind the stone walls: Changing household organization among the Albanians of Kosova*. Dukagjini Balkan Books, Peja.

Esterik, C. Van dhe Minnema, Hester (1991): ”The Conference that came in from the Cold”, i *The Human Dimension of the Helsinki Process, the Vienna Follow-up Meeting and its Aftermath,* red. A. Bloed and P. Van Dijk, Martinus Nijhoff Publishers, Nederland.

Freeman, John (1991): *Security and the CSCE Process. The Stockholm Conference and Beyond.* Macmillan, Basingstoke, London.

Freire, Maria Raquel (2003): *Conflict and Security in the Former Soviet Union. The Role of the OSCE*. Ashgate Publishing Limited, Hants.

Fry, John (2003): *The Helsinki Process. Negotiating Security and Cooperation in Europe.*
University Press of Pacific. Hawaii.

Gashi, Shkëlzen (2010): *Adem Demaçi, biografi e paautorizuar.* Shtëpia Botuese Rrokullia.

Hamzaj, Bardh (1999): *Rrëfimi për luftën dhe lirinë (dialog me komandantin Ramush Haradinaj)*. Prishtinë: Drita press.

Hoti, Ukshin (1995): *Filozofia Politike e Çështjes Shqiptare*. Tiranë.

Kiçmari, Sabri (2017): *Fitorja diplomatike: Kujtime nga përfaqësimi diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*. Prishtinë: Epoka e re.

Kleva, Anne Elin (2007): *Konferansen om sikkerhet og samarbeid i Europa 1975-1989. Øst versus Vest: Konferansediplomati om menneskerettighetene. Norge i grenselandet mellom realpolitikk og idealisme.* Masteroppgave i historie, Institutt for arkeologi, konservering og historiske studier. Universitetet i Oslo.

Lekaj, Fatmir (2021): *Kombformimi dhe përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe barazi.* Shtëpia botuese "Armagedoni".

Malcolm, Noel (2001): *Kosova, një histori e shkurtër*. Prishtinë. Koha.

Mevik, Leif (1990): *Underveis Europa*. Oslo: Aventura Forlag.

Mevik, Leif (1992): *Sikkerhet i samarbeid: Hovedlinjer i norsk KSSE-politikk*. Universitetsforlaget, Oslo.

Mønnesland, Svein (2006): *Før Jugoslavia og etter*. Oslo: Syspress Forlag.

Olstad Busterud, Ingrid (2010): *Norske visjoner og balkanske realiteter. Fredsmegling på Balkan 1993-1995.* Masteroppgave i historie, Institutt for arkeologi, konservering og historiske studier. Universitetet i Oslo.

Stykket, Hege (2010): *Norge og institusjonaliseringen av Helsinki-prosessen.* Masteroppgave i historie, Institutt for arkeologi, konservering og historiske studier. Universitetet i Oslo.

Thomas, Daniel C. (2001): *The Helsinki Effect. International norms, human rights, and the demise of communism.* Princeton University Press. New Jersey.

***Burime elektronike***

"Berit Backer – PRIO." Peace Research Institute Oslo (PRIO). https://www.prio.org/people/5165.

Blaku, Rifat. "Referendumi i parë shqiptar në Kosovë u mbajt në mënyrë dinjitoze." Kosova Sot, 2016. https://www.kosova-sot.info/opinione/140682/referendumi-i-pare-shqiptar-nekosove-u-mbajt-ne-menyre-dinjitoze/.

"Christine von Kohl gestorben. Ein fast unbemerkter Abgang." Ö1 / ORF, 8 prill 2017. https://oe1.orf.at/artikel/214323/Christine-von-Kohl-gestorben.

Cservolgyi, Daniel (2002): *The role and ramifications of the Kosovo Liberation Army's reclassification in the peace process of Kosovo*. AD1173258.pdf (dtic.mil)

Dahl, Ann-Sofie. "Anna Lindhs mördare hade politiskt motiv." Smedjan (Timbro), 9 tetor 2023. https://timbro.se/smedjan/anna-lindhs-mordare-hade-politisk-motiv/.

"Emisioni 'Rasti V-VI', pjesa 1 dhe 2." 2019. https://www.youtube.com/watch?v=RBW2PLxy9K4 dhe https://www.youtube.com/watch?v=JGS8QgABPSw.

"Festa me rastin e njohjes zyrtare të Republikës së Kosovës nga Mbretëria Norvegjeze." Video në YouTube. https://youtu.be/r26sNg7uB1Q.

Forskningsmagasinet Apollon. "Kristoffer Gjøtterud: En åpen horisont." Universitetet i Oslos magasin, 1995. https://www.apollon.uio.no/portretter/1995/horisont.html.

Gjøtterud, Kristoffer. Norsk biografisk leksikon, 2009. https://nbl.snl.no/Kristoffer_Gjøtterud.

Havel, Václav. "Moi aussi je me sens albanais." Le Monde, 29 prill 1999. https://www.lemonde.fr/. Shih gjithashtu: Libquotes, "Václav Havel Quote." https://libquotes.com/václav-havel/quote/lbz0b6j.

"Hapja solemne e përfaqësisë diplomatike të Kosovës në Norvegji – 1999." Video në YouTube. https://youtu.be/uRyl1UeeRxU.

"Intervistë e Jusuf Gërvallës botuar në gazetën gjermane Tageszeitung." https://m.gazetaexpress.com/arkiva/interviste-e-jusuf-gervalles-botuar-ne-gazeten-gjermane-tages-zeitung-131866/?arch_tb=temp. https://rajonipress.com/interviste-e-jusuf-gervalles-botuar-ne-gazeten-gjermane-tagische-zeitung/.

"Intervistë ekskluzive me Vuk Drashkoviqin: 'Flet për krimet serbe dhe për raportet me shqiptarët.'" 5 qershor 2023. Video në YouTube. https://www.youtube.com/watch?v=K6R-lxnfF-w&t=2727s.

Lajmi.net. "22 vjet nga Epopeja e Dukagjinit." 2020. https://lajmi.net/22-vjet-ngaepopeja-e-dukagjinit/.

Mahmuti, Bardhyl. "Deklarata politike numër 7 i hapi dyert e diplomacisë." Epoka e Re, 20 dhjetor 2023. https://www.epokaere.com/deklarata-politike-numer-7-i-hapi-dyert-e-diplomacise/.

Mahmuti, Bardhyl. "Si u hoq cilësimi i UÇK-së si organizatë terroriste." *Epoka e re*, 25 shtator 2023. https://www.epokaere.com/interviste-ekskluzive-me-bardhyl-mahmutin-si-u-hoq-cilesimi-i-uck-se-si-organizate-terroriste-1/.

Maliqi, Shkëlzen. Intervistë për Klan Kosova, 18 janar 2022. https://youtu.be/Sbn_tAwjTLc.

Muhadri, Besim. "Fronti i Rezistencës dhe i Bashkimit Kombëtar u themelua si një organizatë politiko-ushtarake." Zemra Shqiptare, 2010. http://www.zemrashqiptare.net/news/14320/besim-muhadri-fronti-i-rezistences-dhe-i-bashkimit-kombetar-u-themelua-si-nje-organizate-politikoushtarake.html.

"New Clues Unveiled in Mysterious Jill Dando Murder Case as Second Witness Links 'Serbian Assassin' to

TV Star's Death." LBC, 25 prill 2025. https://www.lbc.co.uk/article/new-clues-unveiled-mysterious-jill-dando-murder-case-serbian-assassin-5Hjd5nD_2/.

"OSSE." Store norske leksikon. https://snl.no/OSSE.

Pick, Hella. "Warren Zimmermann: Principled US diplomat who resigned in protest at the west's failure to intervene early in former Yugoslavia." The Guardian, 10 shkurt 2004. https://amp.theguardian.com/news/2004/feb/10/guardianobituaries.hellapick.

Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo. 1999, f. 85. https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990123_RambouilletAccord.pdf.

"Rrëfimi i rrallë i Jakup Nurës, shokut të Adem Jasharit." T7 – Pressing. https://www.youtube.com/live/m23TJau-Bhk.

Sinani, Shaban. "Komiteti Shqiptar i Helsinkit, dallëndyshja e parë e demokracisë në Shqipëri." Telegraf, 8 dhjetor 2015. https://telegraf.al/opinion/shaban-sinani-komiteti-shqiptar-i-helsinkit-dallendyshja-e-pare-e-demokracise-ne-shqiperi/.

Telegrafi.com. "Kujtesë: 25 vjet nga suprimimi i dhunshëm i autonomisë së Kosovës." 2014. https://telegrafi.com/kujtese-25-vite-nga-suprimimi-i.

The Independent International Commission on Kosovo. (2000): *The Kosovo Report*. The Kosovo Report - Albania | ReliefWeb

Xhemajli, Emrush. “Dita e pagëzimit të UÇK-së.” KosovaPress, 2021. https://kosovapress.com/%E2%80%8Bdita-e-pagezimit-te-uck-se/.

Xhemajli, Emrush. “Lëvizja Popullore e Kosovës 1982–2002.” LPK Kosova, 2002. http://lpkkosova.com/historiku.html.

***Foto***

Shumica e fotove në këtë libër janë nga arkivi i ish-Zyrës së Kosovës në Norvegji, si dhe nga Ann Christine Eek dhe Blerim Rexhepi. Njëkohësisht, autori i librit shpreh mirënjohje ndaj autorëve të tjerë të fotove që janë të qasshme publikisht, duke iu referuar në nyjat në vijim:

https://hetq.am/en/article/79823

https://multimedia.europarl.europa.eu/en/video/sakharov-prize-1991-award-ceremony-adem-demai-kosovo-_EP071187

https://multimedia.europarl.europa.eu/da/video/sakharov-prize-1998-award-ceremony-ibrahim-rugova-kosovo_EP071510

https://sq.wikipedia.org/wiki/Ukshin_Hoti
https://m.youtube.com/watch?v=7rBzxq8cYus

http://www.albanianhistory.net/1921_Prishtina/index.html

https://upload.wikimedia.org/wikipedia/sq/archive/0/07/20100808212127%21Metush_Krasniqi.jpg

https://prointegra.ch/atdhetari-kadri-osmani-1937-2012/

https://telegrafi.com/en/1982%2C-the-murder-of-Jusuf-Gervalle%2C-Kadri-Zeke-and-Bardhosh-Gervalle/

https://xhafershatri.info/zijah-shemsiu-analize-bedri-muhadri/

https://prishtinainsight.com/lifelong-political-activist-adem-demaci-dies-at-82/

https://xhafershatri.info/rexhep-mala-truri-i-levizjes-kombetare/

https://www.koha.net/en/arberi/36-vjet-nga-renia-e-deshmoreve-rexhep-mala-e-nuhi-berisha

https://storm-rks.com/dy-heronj-te-pavdekshem-36-vjet-nga-renia-e-fahri-fazliut-dhe-afrim-zhitise/

https://gazetaprojekti.com/shaqir-cervadiku-sjell-kenge-per-heroin-e-kosoves-fadil-vat/

https://en.wikipedia.org/wiki/Ahmet_Haxhiu

https://arberia.tv/sot-behen-26-vjet-nga-rrembimi-i-xhavit-haziri-ne-prishtine/

https://pashtriku.org/binak-berisha-rikuiem-per-luftetarin-e-lirise-behajdin-allaqi/

https://www.argumentum.al/sot-24-vjet-nga-nderhyrja-e-nato-s-ne-kosove/

Autor:
FATMIR LEKAJ

Titulli:
VËSHTRIM MBI PROCESIN E HELSINKIT DHE DISA NGA ARRITJET E KOSOVËS NË KUADËR TË KËTIJ PROCESI
*në 50-vjetorin e Aktit Final të Helsinkit (1975-2025)*

Recensent:
PROF. DR. GAZMEND PULA

Redaktor:
BERAT ARMAGEDONI

Botoi:
N. Sh. ARMAGEDONI
shbarmagedoni@gmail.com
+383 44 835 499

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

327.7:341.123.6(4)(496.51)"1975/2025"

Lekaj, Fatmir
Vështrim mbi procesin e Helsinkut dhe disa nga arritjet e Kosovës në kuadër të këtij procesi : në 50-vjetorin e Aktit Final të Helsinkit (1975-2025) / Fatmir Lekaj. - Prishtinë : Armagedoni, 2025. - 246 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-994-06-4